



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt

Për: **Trupin Gjykses II**
Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës
Gjykatës Kristof Barte
Gjykatës Genël Metro
Gjykatës Fergal Gejnor, Gjykatës rezervë

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 4 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i 'Dosjes Përfundimtare të Prokurorisë'

me Shtojcën Publike 1

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të z. Gucati

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit të z. Haradinaj

Tobi Kadman

Përmbajtja

I.	HYRJE.....	2
II.	ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË PROVAVE	3
A.	Standardi i vërtetimit	3
B.	Analizimi i provave	4
III.	PARAQITJA E FAKTEVE	7
A.	Postet e mbajtura nga të akuzuarit para shtatorit 2020	7
B.	Konferenca e parë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.....	10
C.	Ngjarjet që pasuan konferencën e parë për shtyp	16
D.	Konferenca e dytë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë	24
E.	Ngjarjet që pasuan konferencën e dytë për shtyp	27
F.	Konferenca e tretë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.....	37
G.	Ngjarjet që pasuan konferencën e tretë për shtyp.....	42
H.	Pasojat e veprimeve të të akuzuarve	50
IV.	ANALIZA DHE TEORIA E ÇËSHTJES GJYQËSORE.....	53
A.	Dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së	53
B.	Dëshmitë e të akuzuarve	55
C.	Dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes	58
D.	Autenticiteti i Paketave	61
E.	Për shpalljen e fajësisë në mënyrë të drejtë nuk është e nevojshme nxjerrja e të gjithë dokumenteve të Paketave	66
F.	Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare	67
G.	Frikësimi	80
H.	Hakmarrja.....	88
I.	Shkelja e fshehtësisë së procedurës	92
J.	Përgjegjësia penale individuale.....	104
K.	Mbrojtjet	112
L.	Përfundim	125
V.	PËRCAKTIMI I DËNIMIT	126
A.	Hyrje	126
B.	Dënimet përkatëse.....	129
C.	Krimet e kryera nga të akuzuarit janë padyshim të rënda.....	131
D.	Ekzistojnë shumë faktorë rëndues.....	142
E.	Nuk ekzistojnë faktorë lehtësues	150
F.	Dënimi i përshtatshëm.....	153
G.	Nuk ka nevojë të anashkalohej procedura e rregullës 159(6).....	158
VI.	KLASIFIKIMI	160
VII.	MJETI LIGJOR QË KËRROHET	160

I. HYRJE

1. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj (bashkërisht, 'të akuzuarit') janë përgjegjës jashtë dyshimit të arsyeshëm për të gjitha krimet e paraqitura në Aktakuzë.¹
2. Gjatë gjyqimit nuk pati shumë kundërshtime ndaj pretendimeve faktike që mbështesin akuzat, pasi ato në fakt janë të pakundërshtueshme. Veprimet kriminale të të akuzuarve janë incizuar në video dhe vlera provuese e këtyre provave është bindëse dhe nuk lë vend për dykuptimësi. Dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e ZPS-së plotësuan tablonë e provave dhe u përforcuan më tej nga dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe, veçanërisht, nga dëshmitë e të akuzuarve.
3. Në këtë dosje përfundimtare,² ZPS-ja parashtrohet qëndrimin e saj në lidhje me aspektet e përgjithshme të provave;³ tregon se si faktet e provuara në gjykim⁴ përmbushin të gjitha elementet e veprave penale të Pikave 1 deri 6,⁵ dhe bën parashtrimet e saj në lidhje me dënimin e duhur.⁶
4. ZPS-ja e ka bërë qysh herët të qartë qëndrimin e saj lidhur me elementet e veprave penale dhe format e përgjegjësisë në konferencën përgatitore për gjykimin

¹ Aktakuza me më pak Redaktime, KSC-BC-2020-07/F00251/A01/RED, 5 korrik 2021 (versioni me më pak redaktime u vu në dispozicion më 4 tetor 2021) ('Aktakuza').

² *Dorëzuar në përputhje me rregullën 134(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'); Neni 45 i Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-2015, 17 maj 2019; Urdhri për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave, KSC-BC-2020-07/F00553. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet 'rregulla' ose 'rregullat' fjala është për Rregulloren. Për 'neni' ose 'nenet', nëse nuk përcaktohet ndryshe, fjala është për nenet e Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). 'neni/nenet e KPK-së' i referohen Kodit nr. 06/L-074 - Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 14 janar 2019 ('KPK'), dhe 'neni/nenet e KPPK-së' i referohen Kodit nr.04/L-123 – Kodi i Procedurës Penale, 13 dhjetor 2012 ('KPPK').

³ Pjesa II.

⁴ Pjesa III.

⁵ Pjesa IV.

⁶ Pjesa **Error! Reference source not found..**

dhe në dy parashtrime të mëpasshme me shkrim.⁷ Në këtë dosje, ZPS-ja rikonfirmon parashtrimet e saj, të cilat burojnë nga dispozitat ligjore të shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit.⁸

II. ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË PROVAVE

5. Ligji dhe Rregullorja, në veçanti neni 21(3) dhe rregullat 139 dhe 140, përcaktojnë shprehimisht standardin e vërtetimit që duhet të zbatohet trupi gjykes si dhe një numër aspektesh në lidhje me vlerësimin e provave në kuadër të vendimit të gjykimit. Këto dispozita pasqyrojnë gjerësisht jurisprudencën e gjykatave ose tribunalëve të tjerë të cilët, sipas rastit, përbëjnë një burim të rëndësishëm për interpretimin dhe zbatimin e tyre.

A. STANDARDI I VËRTETIMIT

6. Fajësia e të akuzuarve duhet të vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm.⁹ Dyshimet e arsyeshme duhet të jenë të bazuara në arsye.¹⁰ Rrjedhimisht:

Standardi i dyshimit të arsyeshëm në të drejtën penale nuk mund të konsistojë në një dyshim të imagjinuar ose të pavlerë të bazuar në simpati ose paragjykim. Ai duhet të bazohet në logjikë dhe arsyetim të shëndoshë dhe të ketë një lidhje racionale me provat, mungesën e provave ose me mospërputhshmëritë e provave.¹¹

7. Standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm zbatohet për faktet që përbëjnë elementet e veprës penale dhe të formës së përgjegjesisë së të akuzuarit që

⁷ Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, 30 shtator 2021 ('Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme'); Version i Redaktuar Publik i 'Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave për Rrëzimin e Akuzave', KSC-BC-2020-07/F00447, KSC-BC-2020-07/F00447/RED, 24 nëntor 2021 (versioni i redaktuar u vu në dispozicion më 10 dhjetor 2021) ('Parashtrimet sipas Rregullës 130').

⁸ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED.

⁹ *Shih* neni 21(3), rregullat 140(1) dhe 158(3).

¹⁰ *Ongwen* TJ, ICC-02/04-01/15-1762-Red, para.228.

¹⁰ Rregulla 140(2).

¹¹ *Rutaganda* AJ, ICTR-96-3-A, para.488; *Shih gjithashtu Ongwen* TJ, ICC-02/04-01/15-1762-Red, para.228.

¹¹ Rregulla 140(2).

përmban aktakuza, si dhe për fakte të tjera ku bazohet vendimi i shpalljes së fajësisë.¹² Standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk zbatohet veçazi për çdo provë.¹³

8. Sa u përket provave rrethore, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm, përmbushet vetëm në qoftë se përfundimi i nxjerrë prej këtyre provave është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirrej prej provave të paraqitura.¹⁴ Provat rrethore vlerësohen me kujdes dhe vëmendje dhe ofrohen konstatime të arsyetuara, në veçanti në lidhje me përputhshmërinë dhe lidhjen e brendshme logjike të provave të tilla, në qoftë se trupi gjyqësor e bazon vendimin e fajësisë vetëm mbi këto prova, ose kryesisht mbi këto prova.¹⁵

9. Shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare në: (a) deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë; (b) dëshmitë e dëshmitarëve identitetet e të cilëve nuk u janë bërë të njohura Mbrojtjes; ose (c) dëshminë e një personi nën 18 vjeç, ose të një personi me aftësi gjyqësore të dëmtuar dhe për të cilin trupi gjyqësor ka mendimin se nuk kupton domethënien e detyrimit për të treguar të vërtetën.¹⁶ Sidoqoftë, në varësi të këtyre tri rasteve, trupi gjyqësor nuk vendos kushtin ligjor të konfirmimit për vërtetimin e veprave penale apo veprimeve kriminale nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.¹⁷

B. ANALIZIMI I PROVAVE

10. Në kuadër të vendimit të gjyqësorit, trupi gjyqësor nuk mund të marrë parasysh

¹² Rregulla 140(2); *Ongwen* TJ, ICC-02/04-01/15-1762-Red, para.227; *Ntaganda* AJ, ICC-01/04-02/06-2666-Red, para.37.

¹³ Rregulla 140(2).

¹⁴ Rregulla 140(3); *Ngirabatware* TJ, ICTR-99-54-T, para.60.

¹⁵ Rregulla 139(5).

¹⁶ Rregulla 140(4).

¹⁷ Rregulla 139(3); *Taylor* AJ, SCSL-03-01-A, para.78.

prova që janë shpallur të papranueshme.¹⁸ Trupi gjykues duhet të vlerësojë secilën provë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara para tij në gjykim dhe të kryejë një vlerësim dhe peshim tërësor të të gjitha provave të marra në tërësi për të përcaktuar nëse janë vërtetuar ose jo faktet në fjalë.¹⁹

11. Mënyrat me të cilat vlerësohet besueshmëria ndryshojnë sipas formës dhe llojit të provave të sjella para gjykuesit të fakteve.²⁰ Gjatë vlerësimit të besueshmërisë së provave shkresore, trupi gjykues, ndër të tjera, mund të mbajë parasysh burimin, autenticitetin, përmbajtjen dhe përdorimin e supozuar të dokumentit.²¹

12. Gjatë përcaktimit të rëndësisë që i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykues vlerëson besueshmërisë e dëshmitarit dhe nëse mund të bazohet në dëshminë e tij apo të saj.²²

13. Vlerësimi i rëndësisë dhe besueshmërisë së duhur që duhet t'i jepet dëshmisë së një dëshmitari, duhet të bëhet rast pas rasti.²³ Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, trupi gjykues, ndër të tjera, mund të marrë parasysh: (i) besueshmërinë, lidhjen logjike, hollësitë e dhëna dhe qartësinë e dëshmisë së dëshmitarit; (ii) nëse dhe në çfarë mase dëshmitari është ose jo në gjendje të ofrojë informacione të caktuara si dhe burimin e njohurive mbi të cilat është bërë një deklaratë e caktuar; (iii) rrethanat individuale të dëshmitarit, duke përfshirë rolin e tij ose të saj në ngjarjet në fjalë dhe motivet për të gënjyer; dhe (iv) sjelljen e dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë në gjykatë, gatishmërinë për t'iu përgjigjur pyetjeve, natyrshmërinë gjatë dhënies së përgjigjeve

¹⁸ Rregulla 139(1).

¹⁹ Rregulla 139(2); *Shih gjithashtu Ongwen TJ*, ICC-02/04-01/15-1762-Red, para.227; *Al Jadeed AJ*, STL-14-05/A/AP, para.56; *Ngirabatware TJ*, ICTR-99-54-T, para.50.

²⁰ *Shih Al Jadeed AJ*, STL-14-05/A/AP, fn.201; *Musema TJ*, ICTR-96-13-T, para.60.

²¹ *Shih Musema TJ*, ICTR-96-13-T, para 59-60, 63-67, 70-72.

²² Rregulla 139(4).

²³ *Nyiramahuko et al. AJ*, ICTR-98-42-A, para.2971.

dhe përgjigjet e dhëna gjatë marrjes në pyetje nga pala kundërshtare.²⁴

14. Mospërputhjet e një dëshmie, në vetvete, nuk bëjnë që trupi gjykues ta përjashtojë automatikisht atë dëshmi si jo të besueshme; trupi gjykues mund të pranojë pjesë të një dëshmie dhe të mos pranojë pjesë të tjera të asaj dëshmie.²⁵ Në dëshmitë e dëshmitarëve zakonisht hasen mospërputhje të vogla, por kjo nuk i bën ato dëshmi jo të besueshme; është në kompetencën diskrecionale të trupit gjykues që të vlerësojë çdo mospërputhje të tillë, të shqyrtojë nëse provat në tërësi janë të sakta e të besueshme dhe të pranojë ose të refuzojë veçoritë themelore të provave.²⁶

15. Ashtu si për çdo dëshmi tjetër të paraqitur, i takon trupit gjykues të vlerësojë besueshmërinë dhe vlerën provuese të raporteve dhe dëshmive të ekspertëve.²⁷ Trupi gjykues duhet të shqyrtojë me kujdes burimet në të cilat janë mbështetur ekspertët në nxjerrjen e përfundimeve të tyre.²⁸

16. Besueshmëria, bazueshmëria dhe rëndësia e provave të paraqitura nga i akuzuari duhet të vlerësohen në të njëjtën mënyrë si për provat e paraqitura nga ZPS-ja.²⁹

17. Në rrethana të caktuara, trupi gjykues mund të mbështetet në prova që nuk përfshihen brenda kuadrit kohor të akuzave, me qëllimin: (i) për të sqaruar një kontekst të caktuar; (ii) për të vërtetuar me deduksion elementet e veprimtarisë kriminale, veçanërisht synimin kriminal, të kryer gjatë periudhës që përfshijnë akuzat; ose (iii) për të demonstruar një praktikë sjelljeje të qëllimshme.³⁰

²⁴ *Shih Ongwen* TJ, ICC-02/04-01/15-1762-Red, paras 255-260; *Ngirabatware* TJ, ICTR-99-54-T, para.52; *Nyiramasuhuko et al.* AJ, ICTR-98-42-A, para.692; *Stanišić and Simatović* TJ, MICT-15-96-T, para.13.

²⁵ *Rregulla* 139(6); *Shih gjithashtu Ngirabatware* TJ, ICTR-99-54-T, para.53.

²⁶ *Ngirabatware* TJ, ICTR-99-54-T, para.53.

²⁷ *Nahimana et al.* AJ, ICTR-99-52-A, para.199.

²⁸ *Khieu Samphan and Nuon Chea* TJ, 002/19-09-2007/ECCC/TC, para.66.

²⁹ *Ntaganda* AJ, ICC-01/04-02/06-2666-Red, paras 13, 587.

³⁰ *Khieu Samphan and Nuon Chea* TJ, 002/19-09-2007/ECCC/TC, para.60; *Taylor* TJ, SCSL-03-01-T, para.101.

III. PARAQITJA E FAKTEVE

18. Termi 'dëshmitarët' në këtë dosje përdoret në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në Aktakuzë.³¹

A. POSTET E MBAJTURA NGA TË AKUZUARIT PARA SHTATORIT 2020

19. Hysni Gucati (DW1240) dhe Nasim Haradinaj (DW1249) kanë qenë anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('UÇK')³² dhe kanë mbajtur postet e kryetarit dhe nënkryetarit (dhe zëdhënësit) të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së ('OVL-UÇK') që nga tetori 2017.³³

20. OVL-UÇK-ja është një organizatë joqeveritare, e cila synon të mbështesë veteranët e UÇK-së³⁴ - ndër të tjera me anë të lobimit në institucionet e Kosovës për miratimin e masave të favorshme për interesat e veteranëve.³⁵ Kjo organizatë numëron mbi dhjetë mijë anëtarë,³⁶ dhe ka një strukturë piramidale, me degë lokale në bazë, të cilat mbulojnë të gjitha qytetet dhe territorin e Kosovës.³⁷ Përfaqësuesit e degëve lokale zgjedhin Këshillin Drejtues, të përbërë nga 61 anëtarë,³⁸ dhe Kryesinë të përbërë nga

³¹ *Shih* Aktakuza, KSC-BC-2020-07/F00251/A01/RED, para.4 (termi "dëshmitar" ose "dëshmitarë" në këtë Aktakuzë u referohet të gjithë personave që ka gjasa të kenë informacion për një krim, kryesin e një krimi ose për rrethana të rëndësishme që kanë lidhje me procedurat e DHS-së). *Shih gjithashtu* Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Përdorimin e Termit 'Dëshmitar', KSC-BC-2020-07/F00281, 23 gusht 2021 ('Parashtrime për termin 'dëshmitar'), para.3. Kini parasysh se gjatë përgatitjes së tabelave në lidhje me paketat, Zdenka Pumper (W04841) ka punuar mbi bazën e një kuptimi më të ngushtë të termit 'dëshmitar' nga ai që është përdorur për këtë term në Aktakuzë. Pumper, T.871-72, 1079-85.

³² Gucati, 1D00003ET, para. 6-7; Gucati, T.2156-57; Haradinaj, 2D00001ET, para. 9-12; Haradinaj, T.2704-05.

³³ Gucati, 1D00003ET, para.8; Haradinaj, 2D00001ET, para.16; Haradinaj, T.2706-07; Kryeziu, 1D00008ET, para.7.

³⁴ Gucati, T.2158; Haradinaj, 2D00001ET, para. 9-12; Haradinaj, T.2969; Marashi, 1D00007ET, para.8.

³⁵ Gucati, 1D00003ET, para.9.

³⁶ Marashi, T.2528-2530.

³⁷ Kryeziu, 1D00008ET, para. 6-7; Marashi, 1D00007ET, para. 9-10; Marashi, T.2525-2526; Gucati, 1D00003ET, para.8; Gucati, T.2158. *Shih gjithashtu*, Gucati, 1D00003ET, para. 74.

³⁸ Marashi, 1D00007ET, para.9; Marashi, T.2526-2527; Cele Gashi, 1D00009ET, para. 9.

gjashtë deri në rreth njëzet e tre anëtarë.³⁹ Kryetari, nënkryetari dhe sekretari mbajnë postet kryesore në Kryesinë e OVL-UÇK-së.⁴⁰ Faton Klinaku është sekretar i OVL-UÇK-së.⁴¹ Pren Marashi (DW1243), Metush Kryeziu (DW1244) dhe Çelë Gashi (DW1245) janë anëtarë të Këshillit Drejtues të OVL-UÇK-së.⁴²

21. Që nga themelimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës, OVL-UÇK-ja ka kundërshtuar legjitimitetin dhe mandatin e tyre.⁴³ Para shtatorit 2020, të dy të akuzuarit shprehën publikisht kundërshtimin e tyre ndaj DHSK-së/ZPS-së dhe ndërmorën iniciativa për të përfunduar ose ndryshuar mandatin e tyre.⁴⁴ Në dhjetor 2018 dhe janar 2019, Gucati u bëri thirrje publikisht personave që të mos u përgjigjeshin fletëthirrjeve të DHSK-së.⁴⁵

22. Të akuzuarit, ndër të tjera, kanë deklaruar publikisht se pretendimet se anëtarët e UÇK-së mund të kenë kryer krime gjatë konfliktit të Kosovës janë trillime, dhe se dëshmitarët që deklarojnë të kundërtën në gjyqet kundër anëtarëve të UÇK-së janë gënjeshtarë ose bashkëpunëtorë të Serbisë.⁴⁶ [REDAKTUAR], Haradinaj postoi një

³⁹ Marashi, T.2526-27, 2458, Gucati, T.2158, ku theksohet se ai u zgjodh si anëtar i Kryesisë në vitin 2002; Kryeziu, 1D00008ET, para.7 (ku bëhet dallimi ndërmjet Këshillit të përbërë prej 23 anëtarësh të OVL-UÇK-së dhe Kryesisë).

⁴⁰ Taibe Miftari, T.2472.

⁴¹ Gucati, 1D00003ET, para.76; Kryeziu, 1D00008ET, para.7.

⁴² Marashi, 1D00007ET, para.12; Cele Gashi, 1D00009ET, para. 9, 18; Kryeziu, 1D00008ET, para.7; Gucati, 1D00003ET, para. 77-78.

⁴³ Haradinaj, 2D00001ET, para.26; Haradinaj, T.2708-2709, 2715-2717; Marashi, 1D00007ET, para. 13-14; Marashi, T.2531, 2536-38; Kryeziu, 1D00008ET, para.9; P00028ET, f.2.

⁴⁴ Gucati, 1D00003ET, para. 57-58, 67-68, 70; Haradinaj, 2D00001ET, para. 17-33; Marashi, T.2538; P00037ET, f.3-4; P00038ET, f.1-2; P00043ET, f.1-3, P00047ET, f.1; P00083, f.SPOE00222205-SPOE00222207, SPOE00222236, SPOE00222243, SPOE00222251, SPOE00222288 (P00083-ET, f. SPOE00222205-SPOE00222207-ET; SPOE00222236-ET, SPOE00222243-ET, SPOE00222251-ET, SPOE00222288-ET).

⁴⁵ P00040ET, f.1; P00041ET, f.1.

⁴⁶ P00036ET, f.1; P00037ET, f.5; P00083, f.SPOE00222222-SPOE00222223; SPOE00222235, SPOE00222238-SPOE00222240, SPOE00222260-SPOE00222263, SPOE00222264-SPOE00222267 (P00083-ET, f. f.SPOE00222222-SPOE00222223-ET; SPOE00222235-ET, SPOE00222238-SPOE00222240-ET, SPOE00222260-SPOE00222263-ET, SPOE00222264-SPOE00222267-ET); P00040ET, f.2. *Shih gjithashtu*, P00037ET, f.1-2; Haradinaj, T.2889-90.

mesazh në profilin e tij në *Facebook*⁴⁷ [REDAKTUAR]⁴⁸ - [REDAKTUAR].⁴⁹ Më 15 tetor 2019, duke komentuar në rrjetet sociale fletëthirrjen e marrë nga një dëshmitar, Gucati deklaroi në profilin e tij në *Facebook*⁵⁰ se 'luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund ta njëllos dhe ta gjykoj askush!'⁵¹ Të akuzuarit i quajtën ata që përkrahnin DHSK-në si bashkëpunëtorë, spiunë dhe tradhtarë kundër UÇK-së.⁵²

23. Të dy të akuzuarit kanë deklaruar se janë kundër DHSK-së, bazuar në pretendimet se ajo është 'njëetnike' dhe raciste, bashkëpunon me Serbinë dhe me armiqtë e Kosovës,⁵³ dhe 'ka marrë drejtësinë e aparatit të Millosheviqit'.⁵⁴

⁴⁷ *Shih* Haradinaj, T.2929, ku pranon se profili në *Facebook* 'nasim.haradinaj' i përket atij. *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2812 ku pranon se ai 'pëlqeu' ose shpërndau fotografitë e dokumenteve të nxjerra gjatë tri herëve të cilat fillimisht ishin publikuar nga media) me, *p.sh.*, P00061, f.SPOE00220754; P00128; P00124, f.081917-081918 (P00124ET, f.081917-081918); P00073; Pumper, T.1003-1004. *Shih gjithashtu* postimet në *Facebook* në P00084 (ku tregohet se përditësimi i fundit në profilin e Haradinajt në *Facebook* ishte bërë më 24 shtator 2020, një ditë para arrestimit të tij); P00064, P00065, P00068, P00069, P00077, P00081 (ku paraqiten fotografi nga jeta personale e Haradinajt ose komente në lidhje me të), P00060, P00066, P00067, P00070, P00072, P00074, P00075, P00078, P00079, P00080 (ku i bëhet reklamë paraqitjeve publike të Haradinajt ose bëhen komente në lidhje me aktivitetet e OVL-UÇK-së). Postimet në *Facebook* të bëra nga Haradinaj dhe Gucati të përmendura në këtë dosje u bënë të gjitha si 'publike', siç tregohet nga figura e globit që paraqitet në postime të tilla, që do të thotë se ato mund të shiheshin nga publiku.

⁴⁸ [REDAKTUAR].

⁴⁹ [REDAKTUAR].

⁵⁰ *Shih* Gucati, T.2286, T.2418-21, në lidhje me P00059, dhe T.2354-63, në lidhje me P00084, f.SPOE00245660-63, SPOE00245664-67, ku pranon se profili në *Facebook* 'hisni.gucati' i përket atij; Gucati, T.2434, ku konfirmon se postimet në profilin e tij në *Facebook* janë publikuar nga ai vetë, ose me autorizim të tij dhe se ai do ta hiqte menjëherë një postim të publikuar pa autorizimin e tij. *Shih gjithashtu* postimet në *Facebook* në P00084, f.SPOE00245663-65 (ku tregohet se përditësimi i fundit në profilin e Gucatis në *Facebook* nga përdoruesi i tij u bë më 24 shtator 2020, një ditë para arrestimit të tij); P00083, SPOE00222274-75, SPOE00222287, P00084, f.SPOE00245665-67 (ku paraqiten fotografi nga jeta personale e Gucatis ose komente në lidhje me të), P00083, f.SPOE00222245-46, SPOE00222250 (ku bëhen komente në lidhje me aktivitetet e OVL-UÇK-së); P00083, f. SPOE00222247 (ku postohen artikuj të mediave në lidhje me faktet e pretenduara në Aktakuzë). *Shih gjithashtu* Taibe Miftari, T.2470-2471.

⁵¹ P00083, f.SPOE00222241-SPOE00222242, (P00083ET, f.SPOE00222241-SPOE00222242-ET).

⁵² P00037ET, f.4-5, 16-17; P00037, min.01:03:57-01:05:30, 01:44:49-01:45:23; P00083, f. SPOE00222219, SPOE00222236-SPOE00222237, SPOE00222264-SPOE00222268 (P00083-ET, f. SPOE00222219-ET, SPOE00222236-SPOE00222237-ET; SPOE00222264-SPOE00222268-ET).

⁵³ Gucati, T.2204-05, 2209-10, 2263-64; Haradinaj, 2D00001ET, para. 21, 32-33, 132-34; Haradinaj, 2735, 2815-16, 2844, 2858-64, 2875-79, 2944, 2956-57; P00083, f.SPOE00222233-SPOE00222235, SPOE00222286 (P00083-ET, f. SPOE00222233-SPOE00222235-ET, SPOE00222286-ET); P00037ET, f.4-5, 16-17; P00037, min.01:03:57-01:05:30, 01:44:49-01:45:23; P00038ET, f.1-2, P00038 min.28:21-28:58, 36:39-37:51.

⁵⁴ Haradinaj, T.2875-79.

B. KONFERENCA E PARË PËR SHTYP DHE DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË PARË

24. Më 7 shtator 2020, rreth orës 09:50, një person i panjohur për ZPS-në dhe me fytyrë të fshehur, dorëzoi një kuti në recepsionin e selisë së OVL-UÇK-së.⁵⁵ Duke folur në gjuhën shqipe, ai i tha recepsionistes së OVL-UÇK-së, Taibe Miftari (DW1241), se pakoja ishte për personin që flet në televizion, dhe u largua.⁵⁶ Taibe Miftari njoftoi Hysni Gucatin, Nasim Haradinajn, Faton Klinakun, dhe Çelë Gashin, të cilët ishin në zyrën e Gucatit.⁵⁷ Të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të Kryesisë së OVL-UÇK-së shikuan pamjet e incizuara të dorëzimit në kamerat e sigurisë të OVL-UÇK-së.⁵⁸ Më pas, ata e sollën kutinë në zyrën e Gucatit dhe e hapën.⁵⁹

25. Të akuzuarit dhe anëtarët e tjerë të OVL-UÇK-së kuptuan se pakoja përmbante dokumente ('dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë') dhe i këqyrën ato.⁶⁰ Të akuzuarit dhe anëtarët e tjerë të OVL-UÇK-së i vendosën grumbujt e dokumenteve mbi një tavolinë, i krahasuan ato dhe panë se, nga sa dukej, ato ishin katër kopje dokumentesh,⁶¹ me rreth 1000 faqe secili,⁶² të shkruara në anglisht dhe serbisht⁶³ dhe mbanin 'stemën e DHSK-së'.⁶⁴ Të akuzuarit, të cilët e kuptonin të dy gjuhën serbe dhe

⁵⁵ 1D00019; 1D00020; 1D00021; 1D00022; Taibe Miftari, 1D00004ET, para. 3-4; P00001ET, f.1; P00001, min.00:00:01-00:01:22.

⁵⁶ Taibe Miftari, 1D00004ET, para. 5-7; Taibe Miftari T.2454; Haradinaj dëshmoi se kishte mësuar nga Taibe Miftari se persona të panjohur kishin thënë se ai do të sillte edhe dokumente të tjera; Haradinaj, T.2741. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2164-65, T.2212.

⁵⁷ Taibe Miftari, T.2454; Gucati, T.2165; Haradinaj, 2D00001ET, para. 47-48; Haradinaj, T.2720-22, Cele Gashi, 1D00009ET, para.10.

⁵⁸ Taibe Miftari, 1D00004ET, para.9; Taibe Miftari, T.2455, 2461. *Por shih, p.sh.*, Cele Gashi, 1D00009ET, që thotë se nuk i kujtohet kjo pikë.

⁵⁹ Gucati, T.2165-66, 2168; Haradinaj, 2D00001ET, para. 49-50; Haradinaj, T.2721-23; Cele Gashi, 1D00009ET, para.11; Taibe Miftari, 1D00004ET, para. 10-12.

⁶⁰ Gucati, T.2172; Haradinaj, 2723-24, Cele Gashi, 1D00009ET, para.14; Cele Gashi, T.2583 (që vlerëson se kanë këqyrur 70 deri 100 faqe).

⁶¹ Gucati, T.2172, 2250-51, 2254-55; Haradinaj, 2D00001ET, para.51; Haradinaj, 2723-24.

⁶² Haradinaj, 2D00001ET, para.53; Haradinaj, T.2724.

⁶³ Gucati, T.2169. *Por shih* Haradinaj, T.2724, që përmend gjuhët angleze, serbe dhe shqipe.

⁶⁴ Gucati, T.2169.

pak anglisht,⁶⁵ i këqyrën dokumentet.⁶⁶ Ata kuptuan se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përmbanin kërkesa për bashkëpunim në hetime penale, të cilat TFHS-ja ua drejtonte autoriteteve serbe, e ndër to kishte edhe kërkesa për intervistime dëshmitarësh, emrat dhe të dhënat personale të të cilëve ishin specifikuar në dokumente.⁶⁷ Haradinaj vuri re se shumë materiale mbanin shënimin 'top sekret'.⁶⁸ Ai e konsideroi ardhjen e këtyre dokumenteve si një ngjarje të jashtëzakonshme.⁶⁹

26. Gucati vuri re se dokumentet në cirilik vinin nga prokuroria serbe dhe i shikoi ato me vëmendje të mjaftueshme sa për të njohur logot dhe vultat me stemat serbe.⁷⁰ Gucati dëshmoi se nuk i kishte lexuar në detaje deklaratat e individëve serbë, turq dhe romë, pasi sipas tij këta ishin 'dëshmitarë të vegjël'.⁷¹ Në dëshminë e tij, Gucati rikujtoi fjali konkrete nga dokumentet që kishte lexuar.⁷² Gucati nuk kishte parë kurrë dokumente të tilla të bëra publike dhe e konsideroi si 'një ëndërr' që dokumentet e DHSK-së të përfundonin në zyrat e OVL-UÇK-së.⁷³ Nasim Haradinaj mbajti shënime për disa nga informacionet që përmbanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.⁷⁴

27. Pas shqyrtimit të dokumenteve, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Faton Klinaku dhe anëtarë të tjerë të Kryesisë mbajtën një mbledhje në të cilën vendosën të mbanin një konferencë për shtyp.⁷⁵ Të akuzuarit dhe Çelë Gashi dëshmuan se ata kishin vendosur të thërrisnin konferencën për shtyp, ndër të tjera, për të informuar publikun

⁶⁵ Gucati, T.2169. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, 2D00001ET, para.53.

⁶⁶ P00024ET, f.7-8; P00024, min.00:13:22-00:13:47, 00:14:24-00:15:51; P00021ET, f.4-5; P00021, min.00:07:17-00:11:53; Cele Gashi, 1D00009ET, para.14.

⁶⁷ Gucati, 1D00003ET, para.14; Gucati, T.2175, 2241-43, 2255-57, 2259, 2264-66; Haradinaj, T.2731, 2962-2963; Cele Gashi, 1D00009ET, para.13.

⁶⁸ Haradinaj, T.2941.

⁶⁹ Haradinaj, 2D00001ET, para.54.

⁷⁰ P00009; P00009ET, f.6; Gucati, T.2246-48.

⁷¹ Gucati, T.2257-58. Gucati nuk qe në gjendje të shpjegonte pse ata ishin 'dëshmitarë të vegjël'; Gucati, T.2258.

⁷² Gucati, T.2266.

⁷³ Gucati, T.2288-89.

⁷⁴ Haradinaj, T.2731.

⁷⁵ Gucati, 1D00003ET, para.17; Gucati, T.2170; Haradinaj, T.2727, 2746.

për bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe pasi kjo do të minonte punën e DHSK-së.⁷⁶ Siç kujtojnë vetë të akuzuarit, bashkëpunimi i TFHS-së dhe ZPS-së me autoritetet serbe ishte i njohur publikisht shumë kohë para datës 7 shtator 2020.⁷⁷

28. Faton Klinaku njoftoi për mbajtjen e konferencës për shtyp përmes postës elektronike dhe rrjeteve sociale,⁷⁸ sipas udhëzimeve të Gucatit.⁷⁹ Disa orë më vonë, të akuzuarit mbajtën konferencën për shtyp ('konferenca e parë për shtyp'),⁸⁰ në të cilën morën pjesë rreth njëzet persona.⁸¹ Konferenca e parë për shtyp u transmetua drejtpërdrejt.⁸²

29. Gjatë konferencës së parë për shtyp, Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte lajme 'për mediat edhe për qytetarët edhe për të gjithë. Edhe për politikanët e Kosovës edhe për Parlamentin e Kosovës', dhe njoftoi se atë mëngjes, në selinë e OVL-UÇK-së kishte mbërritur një pako me 'dikun afër 4000 dosje të Gjykatës Speciale'⁸³ Gucati sugjeroi që të pranishmit të fokusonin kamerat e tyre tek dokumentet⁸⁴ të cilat ishin ekspozuar mbi një tavolinë.⁸⁵ Ai më pas ia dha fjalën Haradinajt, duke vënë në dukje se Haradinaj i kishte analizuar dokumentet së bashku me Faton Klinakun dhe me të tjerë dhe do të shpjegonte gjithçka.⁸⁶ Faton Klinaku dhe Çelë Gashi u ulën në krah të të akuzuarve.⁸⁷

⁷⁶ Cele Gashi, 1D00009ET, para.15; Gucati, 1D00003ET, para. 17, 68,70; Haradinaj, 2D00001ET, para.52.

⁷⁷ Haradinaj, T.2711, 2713-14; P00001ET, f.4. *Shih gjithashtu, p.sh.,* C00001, f.6.

⁷⁸ Gucati, T.2170; Haradinaj, 2D00001ET, para.56; Haradinaj, T.2727. *Shih gjithashtu* Berisha, T.1515-16.

⁷⁹ Gucati, 1D00003ET, para.18.

⁸⁰ P00001ET, f.1; Haradinaj, 2D00001ET, para.55. *Shih gjithashtu* P00051; P00051ET.

⁸¹ Haradinaj, 2D00001ET, para.57; Haradinaj, T.2730.

⁸² Gucati, T.2173; Haradinaj, 2D00001ET, para.55.

⁸³ P00001ET, f.1; P00001, min.00:00:01-00:01:22.

⁸⁴ P00001; P00051.

⁸⁵ P00001; P00051; Gucati, T.2171; Haradinaj, 2D00001ET, para.57; Haradinaj, T.2732.

⁸⁶ P00001ET, f.1; P00001, min.00:00:01-00:06:30. P00001ET, f.1; P00001, min.00:00:01-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00001ET, f.5-8; P00001, min.00:13:21-00:14:32, 00:15:53-00:15:54 ku Haradinaj dhe Gucati gjithashtu i ftuan të pranishmit të fokusonin kamerat e tyre tek dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.

⁸⁷ P00001, min00:09:21; 00:14.29; Pumper, T.1005.

30. Haradinaj deklaroi se OVL-UÇK-ja ishte befasuar për të mirë nga marrja e dokumenteve sepse ato konfirmonin se ata të cilët kishin votuar për krijimin e gjykatës ishin faqezinj, renegatë dhe njerëzit më të dëmshëm që nuk ia duan të mirën Kosovës, pasi kishin legjitimuar 'një gjykatë njëetnike, me emnat ndërkombëtarë' të cilët 'kanë ra preh dhe karrem i vetë Serbisë'.⁸⁸ Ai deklaroi se në konferencën për shtyp ishin vënë në dispozicion katër kopje të dokumenteve, të cilat numëronin rreth 1000-1400 faqe secila.⁸⁹

31. Haradinaj tregoi dokumentet dhe deklaroi: 'këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë se i kemi në mbrojtje. Të gjithëve', duke theksuar se në dokumente (mes të cilave kishte edhe deklarata) përfshiheshin të gjitha 'të dhënat e tyre sekrete' për dëshmitarët, me emra, mbiemra të shqiptarëve, romëve, serbëve, të çdo personi që ishte intervistuar si dhe vendndodhja e intervistës.⁹⁰

32. Në veçanti, duke treguar një grumbull dokumentesh përpara tij dhe duke lexuar emrat dhe hollësitë në një bllok shënimesh, Haradinaj deklaroi se: (i) dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë tregonin se 'Vladimir Vuçkoviqi', [REDAKTUAR] kishin bashkëpunuar me ZPS-në;⁹¹ (ii) dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përmbanin një fletëthirrje për [REDAKTUAR], duke vënë në dukje vendin ku [REDAKTUAR] ka thënë se banonte;⁹² (iii) [REDAKTUAR], ishte kontaktuar dhe kishte bashkëpunuar, duke theksuar vendin ku banonte aktualisht [REDAKTUAR] sipas dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë;⁹³ (iv) kishte

⁸⁸ P00001ET, f.1-2; P00001, min.00:01:26-00:06:30.

⁸⁹ P00001ET, f.2-3; P00001, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00017ET, f.2-3; P00017, min.00:02:10-00:06:38; P00017ET, f.6-8; P00017, min.00:14:21-00:17:28; P00060, f. SPOE00220748; P00060ET, f. SPOE00220748; Gucati, T.2172. Por *shih gjithashtu*, Gucati, T.2171, ku rikujtohet se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përbëheshin nga rreth 9000 faqe.

⁹⁰ P00001ET, f.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2379-2381.

⁹¹ P00001ET, f.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30.

⁹² P00001ET, f.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30.

⁹³ P00001ET, f.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00086, para.10.

dokumente që përmendnin [REDAKTUAR], duke treguar vendbanimin e tij;⁹⁴ (v) [REDAKTUAR] ishte biseduar dhe jepej informacion për vendin e tij të punës;⁹⁵ dhe (vi) [REDAKTUAR] kishte bashkëpunuar, duke përmendur punësimin e tij të mëparshëm.⁹⁶ Haradinaj vuri në dukje gjithashtu se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë ishin emrat e shqiptarëve që ishin thirrur.⁹⁷

33. Haradinaj iu referua dokumenteve si 'konfidenciale' dhe 'top sekrete' dhe deklaroi se dëshmitarët e përmendur në dokumente tani duhet ta dinë 'se janë emra të lexum dhe nuk po del këtu diçka që është dikush i fshehtë' sepse në dokumente jepen vendi i saktë, thirrja e saktë dhe deklaratat e dhëna.⁹⁸ Ai pastaj përmendi se deklaratat ishin marrë në vende të ndryshme në Serbi 'jashtë marrjeve të tjera, ku i kanë marrë nëpër institucionet e kësaj Gjykate'.⁹⁹

34. Gucati konfirmoi se informacioni për dëshmitarët gjendej në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë duke treguar një nga dokumentet dhe duke deklaruar se ai kishte të bënte me një informacion të marrë në vitin 2013 'për dëshmitarë që i kanë thirrë i kanë çu në Beograd krejt'.¹⁰⁰ Më vonë gjatë konferencës së parë për shtyp, Haradinaj nënvizoi edhe një herë se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë kishte deklarata dëshmitarësh dhe të dhëna personale duke treguar dokumentet dhe duke thënë: 'Pra, këtu ka edhe deklarata, ka emën, ka mbiemën të personit, vendin ku ka banu, vendin ku jeton tash. Numra telefoni diku-diku'.¹⁰¹ Haradinaj vazhdoi: 'Si ju garantohet dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush, ose ku je i sigurt që ai sot nuk i shpërndan, q' ai që na i ka pru ne, nuk i qet sot nëpër rrugë! Ose ne duhet

⁹⁴ P00001ET, p.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00086, para.10.

⁹⁵ P00001ET, p.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00086, para.10.

⁹⁶ P00001ET, f.2; P00001, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* P00086, para.10.

⁹⁷ P00001ET, f.2-3; P00001, min.00:01:26-00:06:30.

⁹⁸ P00001ET, f.3-4; P00001, min.00:06:31-00:09:09.

⁹⁹ P00001ET, f.3; P00001, min.00:06:31-00:09:09.

¹⁰⁰ P00001ET, f.3-4; P00001, min.00:09:09-00:09:20.

¹⁰¹ P00001ET, f.5; P00001, min.00:09:43-00:11:21.

t'jua qesim. Pse mos të jua qesim? Ne i bëmë publike për me u ditë'.¹⁰² Më tej ai shtoi se pak e kishte dert punën e 'dëshmitarëve të Hagës', dhe se do të kishte dashur t'i bënte të gjitha publike.¹⁰³ Duke iu referuar vetvetes dhe anëtarëve të tjerë të OVL-UÇK-së, Haradinaj tha se 'edhe pse një kopje na e kemi, në emën të Zotit e rujmë edhe juve ju japim kopje sa të doni. Sa të guxoni me lexu ju emna këtu keni'.¹⁰⁴

35. Haradinaj tha gjithashtu se OVL-UÇK-ja do t'u çonte një kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë edhe 'atyne faqezinjve' në parlament me qëllim që fëmijët e tyre ta dinin se për çfarë kishin votuar,¹⁰⁵ dhe u bëri thirrje të pranishmëve të merrnin një kopje të dokumenteve, duke thënë se do t'ua jepte të gjitha.¹⁰⁶ Si Gucati ashtu edhe Haradinaj treguan para kamerave faqe te ndryshme të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe i inkurajuan të pranishmit me fjalët 'këqyri emnat. Këqyri deklaratat!'¹⁰⁷

36. Në fund të konferencës së parë për shtyp, të pranishmit u afruan tek folësit, fotografuan dokumentet dhe i filmuan ato me kamera.¹⁰⁸ Halil Berisha (W04866), gazetar i gazetës 'Infokus',¹⁰⁹ i pyeti Gucatin dhe Haradinajn nëse mund të merrte një kopje të dokumenteve.¹¹⁰ Haradinaj iu përgjigj se Berisha mund t'i merrte dokumentet dhe, meqenëse nuk kishte kopje të mjaftueshme për të gjitha mediat, ai duhet t'ua jepte dokumentet edhe gazetarëve të tjerë, nëse ja kërkonin.¹¹¹ Berisha mori një kopje të dokumenteve, të përbërë nga rreth 1000 faqe.¹¹² Mediat e tjera morën edhe dy kopje

¹⁰² P00001ET, f.4-5; P00001, min.00:09:43-00:13:16.

¹⁰³ P00001ET, f.5; P00001, min.00:11:27-00:13:16.

¹⁰⁴ P00001ET, f.5; P00001, min.00:11:27-00:13:16.

¹⁰⁵ P00001ET, f.3; P00001, min.00:06:31-00:09:09.

¹⁰⁶ P00001ET, f.6; P00001, min.00:13:21-00:14:41.

¹⁰⁷ P00001ET, f.8; P00001, min.00:16:02-00:16:11.

¹⁰⁸ Berisha, T.1519-20.

¹⁰⁹ Berisha, T.1513.

¹¹⁰ Berisha, T.1520. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, 2D00001ET, para.59, 64, 76; Haradinaj, T.2732.

¹¹¹ Berisha, T.1520-22; Haradinaj, T.2732.

¹¹² Berisha, T.1520-21.

të dokumenteve të vëna në dispozicion nga të akuzuarit.¹¹³ Kushdo që donte të merrte dokumente ishte i lirë ta bënte këtë.¹¹⁴ Të akuzuarit nuk ndërmorën asnjë hap për të fshirë referencat për identitetet e dëshmitarëve në materialet që ata shpërndanë,¹¹⁵ pavarësisht se Gucati ishte shprehur se e kuptonte se 'duhet të ruhej gjithmonë privatësia e çdo qytetari',¹¹⁶ se dëshmitë e dëshmitarëve janë të rëndësishme për procedurën penale,¹¹⁷ dhe se identitetet e dëshmitarëve duhej të mbroheshin.¹¹⁸

C. NGJARJET QË PASUAN KONFERENCËN E PARË PËR SHTYP

37. Menjëherë pas përfundimit të konferencës së parë për shtyp, disa media kontaktuan ZPS-në me pyetje lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, duke vënë në dukje se, sipas OVL-UÇK-së, ato kishin rrjedhur nga DHSK-ja dhe përfshinin emra të dëshmitarëve të mbrojtur.¹¹⁹ Një numër artikujsh me lajme dhe videomateriale lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të cilët i referoheshin gjerësisht përmbajtjes së tyre dhe që riprodhonin fotografi të tyre, dolën në internet.¹²⁰ Në këta artikuj u raportuan emrat dhe të dhënat personale të të paktën tre dëshmitarëve, të gjithë këta të përmendur në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.¹²¹ Haradinaj postoi lidhje me këta artikuj dhe videomateriale në profilin e tij në

¹¹³ Gucati, T.2183, 2390-91; Haradinaj, 2732.

¹¹⁴ Gucati, T.2370, 2382.

¹¹⁵ Gucati, T.2373-74.

¹¹⁶ Gucati, T.2370-72.

¹¹⁷ Gucati, T.2373-74.

¹¹⁸ Gucati, T.2374.

¹¹⁹ P00098, para. 2-5; P00101; P00089, para. 14-20.

¹²⁰ *Shih* P00125, f.081364-081368 (P00125ET.2); P00125, f.081361-081363 (P00125ET.1); P00124, f.081915-081916 (P00124ET, f.081915-081916); P00124, f.081917-081918 (P00124ET, f.081917-081918); P00124, f.081919 (P00124ET, f.081919); P00125, f.081369-081370 (P00125ET.3); *Shih gjithashtu* P00086, para. 13-18; P00123ET, f.1; P00123; Pumper, T.990-997; P00093-P00097.

¹²¹ P00086, para. 16-17, i cili i referohet P00124, f.081915-081916 (P00124ET, f.081915-081916), f.081917-081919 (P00124ET, f.081917-081918); Pumper, T1001-1002; P00093, P00095, P00097. *Shih gjithashtu*, P00090, shtojca 1, f.095538 (rreshti 5), 095574 (rreshti 4), 095572 (rreshti 11).

*Facebook.*¹²²

38. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua disa orë pas konferencës së parë për shtyp, Gucati deklaroi se ai dhe të tjerë nuk kishin mundur t'i shqyrtonin të gjitha dokumentet, por i kishin parë dhe u kishin dhënë një kopje të dokumenteve KosovaPress-it dhe disa mediave.¹²³ Nga ekrani i telefonit të tij mobil, Gucati i tregoi kamerës televizive një nga kërkesat për ndihmë të përfshirë në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe tregoi përmbajtjen e saj.¹²⁴

39. Gucati deklaroi se në dokumente përmendeshin me emra një numër i madh njerëzish, ndër të cilët serbë, romë e turq, dhe tregoi datën kur në [REDAKTUAR] ishte zhvilluar një intervistë me një dëshmitar shqiptar¹²⁵ dhe se kishte edhe të tjerë që ishin intervistuar në [REDAKTUAR] në vitin 2015 dhe në [REDAKTUAR].¹²⁶

40. Gucati deklaroi se ishte 'befasuar' të shihte në dosje njerëz të cilët ai dhe të tjerët kishin besuar, që kishin bashkëpunuar me DHSK-në, duke shtuar se ai besonte se disa prej dëshmitarëve e kishin bërë këtë për të fituar azil në Perëndim.¹²⁷ Gucati i quajti personat e identifikuar në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë që bashkëpunonin me DHSK-në si 'tradhtar që gënjejn dhe shqipfolsa',¹²⁸ të cilët ai i barazoi me tradhtarët.¹²⁹ Gjatë dëshmisë, Gucati nuk shpjegoi pse kishte deklaruar se

¹²² P00061, f.SPOE00220754; P00073 (P00073ET); P00128; P00124, f.081917-081918 (P00124ET, f.081917-081918); P00061, f.SPOE00220755; P00074 (P00074ET); P00060, f.SPOE00220729 (P00060ET, f.SPOE00220729); P00123ET, f.1; P00123; Pumper, T.989, 1003-04.

¹²³ P00009ET, f.6-13. Më 11 shtator 2020, gjatë një interviste në *Skype* të transmetuar në një program televiziv, Haradinaj deklaroi se KosovaPress dhe shumë media të tjera kishin marrë kopje të dokumenteve, P00021ET, f.3-4; P00021, min.00:07:17-00:09:17.

¹²⁴ P00009ET, f.5-6; P00009, min.00:59:42-01:01:00. *Shih gjithashtu* Gucati, 1D00003ET, para.22.

¹²⁵ P00009ET, f.7. *Shih*, Gucati, T.2259-62, ku keqinterpretton fjalët e tij të incizuara për të mohuar se kishte konfirmuar publikisht se deklaratat e dëshmitarëve shqiptarë ishin të përfshira në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.

¹²⁶ P00009ET, f.6-7; P00009, min.01:01:00-01:03:52. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2179, 2210.

¹²⁷ P00009ET, f.9-12; P00009, min.01:05:00-01:09:36; *Shih gjithashtu* P00044ET, f.1; P00044 min.08:01-08:54.

¹²⁸ P00009ET, f.6-7, 12-13; P00009, min.01:01:00-01:02:33, 01:09:36-01:10:49; *Shih gjithashtu* P00044ET, f.1; P00044, min.08:01-08:54.

¹²⁹ P00009ET, f.12-13; P00009, min.01:09:36-01:10:49.

dëshmitarët e përmendur në Paketën 1 ishin gënjeshtarë duke thënë vetëm se nuk ishte e mundur që UÇK-ja të kishte kryer ndonjë krim.¹³⁰

41. Gjatë këtij programi televiziv, kur u pyet nëse kishte bërë mirë që kishte shpërndarë dokumentet, Gucati deklaroi se besonte se kishte bërë mirë.¹³¹ Kur prezantuesi tha se mund të ndodhnin gjëra sepse në dokumente kishte emra, Gucati u përgjigj se 'mund të ndodhin gjëra'.¹³²

42. Më 7 shtator 2020, Pren Marashi deklaroi në rrjetet sociale se, pas dosjeve, DHSK-ja do të punojë në bazë të deklaratave të 'dëshmitarëve të mbrojtur publik'.¹³³ Më 8 shtator 2020, Marash iu referua dëshmitarëve të ZPS-së si spiunë.¹³⁴

43. Më 8 shtator 2020, në zbatim të një urdhri të DHSK-së,¹³⁵ ZPS-ja sekuestroi dokumentet që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë ('Paketa 1').¹³⁶ Urdhri i Parë i referohet, ndër të tjera, natyrës së ndjeshme të dokumenteve dhe rrezikut konkret që shpërndarja e tyre e mëtejshme mund të shkaktonte për sigurinë e dëshmitarëve dhe integritetin e hetimeve.¹³⁷ Urdhri ndalonte kopjimin dhe shpërndarjen e mëtejshme të dokumenteve dhe përmbajtjes së tyre.¹³⁸

44. Punonjësi i sigurisë operative të ZPS-së, Daniel Moberg (W04876), u paraqit në selinë e OVL-UÇK-së në Prishtinë, ku i dorëzoi Urdhrin e Parë Faton Klinakut.¹³⁹ Klinakut iu lexuan pjesët përkatëse të Urdhrit të Parë në gjuhën angleze, iu përkthyen

¹³⁰ Gucati, T.2368-71.

¹³¹ P00009ET, f.8; P00009, min.01:03:52-01:05:00.

¹³² P00009ET, f.8-9; P00009, min.01:03:52-01:05:00.

¹³³ Marashi, T.2535-37.

¹³⁴ Marashi, T.2538-40.

¹³⁵ P00052; P00052AT ('Urdhri i Parë').

¹³⁶ P00092; Moberg, T.1930; P00056. *Shih gjithashtu* Marashi, 1D00007ET, para. 15-20; Taibe Miftari, T.2456.

¹³⁷ P00052, para.21; P00052AT, para.21.

¹³⁸ P00052, para.22(c); P00052AT, para.22(c).

¹³⁹ Moberg, T.1930; P00056. Paketa 1 përmban një shënim të shkruar me shkrim dore në shqip që flet për dorëzimin e dokumenteve të Paketës 1 më 8 shtator 2020 dhe përmend sekretarin Faton Klinaku si personin që dorëzoi dokumentet. , P00057 (P00057ET); P00089, para. 8-10; Pumper, T.855-856.

në shqip, dhe atij iu dha një kopje e Urdhrit të Parë.¹⁴⁰ Faton Klinaku, Çelë Gashi dhe Marashi fillimisht refuzuan të dorëzonin dokumentet, bazuar në një vendim të mëhershëm të OVL-UÇK-së për të mos bashkëpunuar me DHSK/ZPS-në.¹⁴¹ Më pas Klinaku I telefonoi Gucati i cili ishte nisur për pushime atë ditë,¹⁴² dhe Gucati autorizoi dorëzimin e dokumenteve.¹⁴³ Klinaku i tha Gucati se kishte ardhur një urdhër nga ZPS-ja për dorëzimin e dokumenteve.¹⁴⁴ Klinaku i dërgoi Gucati një fotografi të formularit të dorëzimit të dokumenteve.¹⁴⁵

45. Gjatë sekuestrimit, Klinaku theksoi se dokumentet ishin sjellë në OVL-UÇK një ditë më parë nga një person i panjohur dhe se tri kopje të këtyre dokumenteve u ishin dhënë mediave, konkretisht KosovaPress-it, gazetës 'Infokus' dhe kanalit televiziv T7.¹⁴⁶

46. Paketa 1 përfshin kërkesa konfidenciale për ndihmë në hetimet penale ('Kërkesat') që TFHS-ja u kishte drejtuar autoriteteve serbe midis viteve 2013 dhe 2015, si edhe dokumente të autoriteteve serbe, ndër to edhe përgjigjet ndaj Kërkesave ('dokumentet serbe'). Paketa 1 përmban gjithashtu raporte të brendshme dhe korrespondencë me autoritetet serbe,¹⁴⁷ dhe kërkesat dhe dokumentet serbe kanë të bëjnë me hetimet konfidenciale të TFHS/ZPS-së dhe me procedurat penale.¹⁴⁸ Të gjitha kërkesat e përfshira në Paketën 1, me vetëm disa përjashtime, kanë korrespondues në bazën e të dhënave të brendshme të ZPS-së.¹⁴⁹ Në kohën e sekuestrimit, faqet e Paketës

¹⁴⁰ P00092, f.083988-083989, para. 3-6. *Shih gjithashtu*, Marashi, T.2534; Cele Gashi, 1D00009ET, para.21; Cele Gashi, T.2602.

¹⁴¹ Cele Gashi, 1D00009ET, para.20; Cele Gashi, T.2602; Marashi, 1D00007ET, para.19; Marashi, T.2534.

¹⁴² Gucati, 1D00003ET, para.27; Gucati, T.2181-2182. *Shih gjithashtu*, Marashi, 1D00007ET, para.20.

¹⁴³ Gucati, T.2182-83; Marashi, T.2534-35.

¹⁴⁴ Gucati, T.2393-94, që bie në kundërshtim me Gucati, T.2182.

¹⁴⁵ Gucati, T.2182.

¹⁴⁶ P00092, para.7.

¹⁴⁷ P00088, f.091791, para.8; P00090, para. 3-4, Shtojca 1.

¹⁴⁸ P00086, para.7; P00088, f.091791-091792, para. 6-12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; Pumper, T.860-861, 1471.

¹⁴⁹ Pumper, T.869, 876-79, 1068-69; 1470.

1 nuk kishin numrat e regjistrimit të provave ('NRP') që gjenden në versionet identike të identifikuar në bazën e të dhënave të brendshme.¹⁵⁰

47. Nga mbi njëqind kërkesat e përfshira në Paketën 1, shumica dërrmuese përmbajnë shtojca të cilat janë të klasifikuara shprehimisht si konfidenciale.¹⁵¹ Në shtojcat konfidenciale renditen qindra emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm, të cilët nuk janë bërë asnjëherë publikë nga TFHS/ZPS-ja, dhe në lidhje me të cilët TFHS-ja kërkonte të merrte nga autoritetet kompetente serbe: (i) ndihmë për të kryer intervista me dëshmitarët; dhe/ose (ii) procesverbalet e deklaratave dhe dëshmime të mëhershme të dëshmitarëve.¹⁵²

48. Paketa 1 përmban tridhjetë e pesë deklarata ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve që janë marrë nga autoritetet serbe, në të cilat jepen të dhëna personale dhe informacione të hollësishme për krime të rënda.¹⁵³

49. Emrat, adresat e fundit të njohura dhe numrat e telefonit të [REDAKTUAR] – emrat e të cilëve u përmendën gjatë konferencës së parë për shtyp – janë përfshirë në shtojcat konfidenciale të kërkesave të ndryshme.¹⁵⁴

50. Brenda disa orësh nga sekuestrimi i Paketës 1, Klinaku, Marashi dhe Çelë Gashi njoftuan Haradinajn, i cili po ashtu ishte nisur për pushime,¹⁵⁵ për sekuestrimin.¹⁵⁶ Haradinaj postoi në profilin e tij në *Facebook* një kopje të dokumentit që Klinaku kishte nënshkruar, ku konfirmonte sekuestrimin e dokumenteve.¹⁵⁷ Më 9 shtator 2020,

¹⁵⁰ Pumper, T.867-69. *Shih gjithashtu*, Pumper, T.848-49.

¹⁵¹ P00086, para. 8-9; P00087; P00090, para. 3-4, Shtojcat 1-2. *Shih gjithashtu*, Pumper, T.869-870, 1077, 1199-1200.

¹⁵² P00086, para. 9-12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1.

¹⁵³ P00088, f.091792, para.12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1.

¹⁵⁴ P00086, para.10; P00087, f.1; Pumper, T.884-885.

¹⁵⁵ Haradinaj, 2D00001ET, para.65; Haradinaj, 2736-2738.

¹⁵⁶ Haradinaj, 2D00001, para.87; Marashi, 1D00007ET, para.20; Haradinaj, 2D00001ET, para. 66, 69; Haradinaj, T.2738, 2927-2928.

¹⁵⁷ P00078 (P00078ET); P00079 (P00079ET).

Haradinaj postoi në profilin e tij në *Facebook* një foto të kopjes së legalizuar të Urdhrit të Parë, që në atë kohë mbante ende klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.¹⁵⁸

51. Gjatë një programi televiziv të transmetuar më 8 shtator 2020, Klinaku pranoi se ai dhe persona të tjerë u kishin thënë hetuesve të ZPS-së se ata u kishin shpërndarë mediave tri kopje të dokumenteve të dorëzuara nga personi i paidentifikuar dhe shtoi se ata u kishin thënë mediave se mund të bënin shumë kopje që të kishte për të gjithë, sepse DHSK-ja është inekzistente dhe nuk e kanë pranuar kurrë.¹⁵⁹

52. Më 8 shtator 2020, Haradinaj postoi në profilin e tij në *Facebook* disa pamje të incizuara prej kamerave të sigurisë, me shënimin se pamjet tregonin momentet e dorëzimit të dokumenteve në OVL-UÇK dhe sekuestrimin e tyre nga ZPS-ja, duke komentuar se OVL-UÇK-ja i mirëpriste kurdoherë të dy palët.¹⁶⁰ Postimi i Haradinajt u shpërnda nga Gucati.¹⁶¹ Në një koment të bërë nën postimin e tij në *Facebook*, Haradinaj, duke iu referuar dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, deklaroi se ‘more nuk mund i zhdukim ata ato më kurr’.¹⁶² Ai theksoi se ishin shpërndarë edhe tri kopje, se këto kopje ishin shpërndarë në dhjetë vende dhe se këto dhjetë vende kanë detyrë që të shpërndajnë edhe tri kopje secili.¹⁶³

53. Më 9 shtator 2020, ZPS-ja mori një mesazh elektronik nga Berisha,¹⁶⁴ ku theksohej se gjatë konferencës së parë për shtyp, gazetës ‘Infokus’, mes mediave të tjera, i ishte dhënë një kopje e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra

¹⁵⁸ P00083, f.SPOE00222202. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, T.2929.

¹⁵⁹ P00013ET, f.1; P00013, min.00:12:22-00:12:49.

¹⁶⁰ P00080 (P00080ET). *Shih gjithashtu*, Haradinaj, T.2773, ku konfirmohet se OVL-UÇK-ja publikoi pamjet e incizuara të kamerave të sigurisë.

¹⁶¹ P00083, f.SPOE00222250 (P00083ET, f.SPOE00222250).

¹⁶² P00080 (P00080ET).

¹⁶³ P00080 (P00080ET).

¹⁶⁴ P00098, para. 5-6, f.091917; P00099, f.083986, para.1.

gjatë herës së parë.¹⁶⁵Më vonë atë ditë, anëtarët e personelit të ZPS-së i morën këto dokumente nga gazeta 'Infokus' ('Paketa 4').¹⁶⁶

54. Paketa 4 përmban 930 faqe,¹⁶⁷ në pjesën më të madhe të njëjta me ato të Paketës 1.¹⁶⁸ Të gjitha dokumentet që përfshihen në Paketën 4 janë të përfshira edhe në Paketën 1, me përjashtim të disa kërkesave dhe dokumenteve serbe që nuk përfshihen në Paketën 1¹⁶⁹ dhe një modeli dokumenti me dy faqe që nuk ka lidhje me dokumentet e tjera të Paketës 4.¹⁷⁰ Në disa raste, dokumentet identike në Paketat 1 dhe 4 kanë cilësi të ndryshme printimi, çka bën që një version të jetë më i lexueshëm se tjetri.¹⁷¹

55. Një nga mesazhet elektronike që iu dërguan ZPS-së nga mediat pas konferencës së parë për shtyp kishte të bashkëngjitur, ndër të tjera, katër fotografi të dokumenteve që përmbante Paketa 1 dhe dy fotografi të cilat ndodhen vetëm në Paketën 4.¹⁷² Dokumentet që tregohen në këto gjashtë fotografi të bashkëngjitura janë kërkesa dhe dokumente të autoriteteve serbe që, ndër të tjera, u referohen intervistave të dëshmitarëve; dy nga këto dokumente janë shënuar si rreptësisht konfidenciale ndërsa dy prej dokumenteve u referohen dokumenteve të tjera të përshkruara si konfidenciale.¹⁷³

56. Gjatë një programi televiziv që u transmetua më 9 shtator 2020,¹⁷⁴ Haradinaj

¹⁶⁵ P00098, para. 5-6, p.091917; P00099, f.083986, para.1.

¹⁶⁶ P00099; 078569-078569; P00089, para.5. Më vonë atë ditë Haradinaj mësoi se ZPS-ja kishte marrë dosje nga kjo media, *shih* P00082 (P00082ET).

¹⁶⁷ P00089, para.7.

¹⁶⁸ Pumper, T.893; P00091, Shtojca 1.

¹⁶⁹ P00089, para. 11-12; Pumper, T.893-95; P00091, Shtojca 1. *Shih gjithashtu*, Pumper, T.895-96.

¹⁷⁰ P00089, para.13. *Shih gjithashtu* P00089, para. 8-10; P000087, ku renditen disa dokumente të Paketës 1 që nuk janë në Paketën 4, ndër të cilat shënimi me shkrim dore që flet për dorëzimin ZPS-së të Paketës 1 më 8 shtator 2020 (P00057; P00057ET).

¹⁷¹ Pumper, T.894. *Shih, p.sh.*, P00091, Shtojca 1, f.095607, rreshti 2, 095619, rreshti 3, rreshti 6, 095621, rreshtat 1-2, rreshtat 5-8, 095625, rreshti 2, 095648, rreshti 2.

¹⁷² P00101; P00089, para. 14-20; Pumper, T.903-04. *Shih gjithashtu* P00102.

¹⁷³ P00089, para. 14-20 (P00091).

¹⁷⁴ Më vonë atë ditë, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në *Facebook*, *shih* P00060, f.SPOE00220752 (P00060ET, f.SPOE00220752).

deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë katër kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, dhe se ai dhe të tjerët i kishin këqyrur dokumentet për një periudhë prej katër orësh.¹⁷⁵ Ai deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin dhënë kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë gazetarëve, të cilët më tej u kishin shpërndarë kopje të tjera përfaqësuesve të tjerë të shtypit, duke shtuar se nuk mendonte që këto dosje mund të fshiheshin më në Kosovë.¹⁷⁶ Ai deklaroi: ‘ne ato si kemi pas ilegale, na e kemi bo përmes mediave, e kemi bo publike’, dhe se askush nuk mund të ndalonte tashmë publikimin e kopjeve të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë.¹⁷⁷

57. Haradinaj deklaroi se në mesin e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë ishte informacioni nga ‘[REDAKTUAR]’.¹⁷⁸ Ai theksoi se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshiheshin kërkesa drejtuar Serbisë për të treguar vendndodhjet e dëshmitarëve.¹⁷⁹

58. Në atë që u shndërrua në një seri lutjesh për dorëzimin e dokumenteve të tjera të cilat do të ishin të mirëpritura, Haradinaj deklaroi se nëse do të merrte sërish materiale të tilla, ai do t’i bënte publike dhe, edhe nëse OVL-UÇK-ja do të bënte shkelje të ligjit, ajo kishte për detyrë që të bënte çdo gjë që të provonte moskorrektësinë e DHSK-së sepse ajo është raciste dhe selektive.¹⁸⁰ Haradinaj përsëriti gjithashtu thirrjen e tij për përfaqësuesit e shtypit që t’i botonin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.¹⁸¹

59. Më 11 shtator 2020, gjatë një paraqitjeje në një program tjetër televiziv,

¹⁷⁵ P00024ET, f.7; P00024, min.00:13:10-00:13:47, 00:14:24-00:15:51; *Shih gjithashtu* P00082 (P00082ET).

¹⁷⁶ P00024ET, f.5-6; P00024, min.00:07:42-00:08:04, 00:08:42-00:08:58, 00:10:15-00:11:29.

¹⁷⁷ P00024ET, f.3; P00024, min.00:04:19-00:05:37.

¹⁷⁸ P00024ET, f.7-8; P00024, min.00:14:24-00:15:51.

¹⁷⁹ P00024ET, f.8; P00024, min.00:14:24-00:15:51. Për deklarata të ngjashme të bëra gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat, *shih gjithashtu* P00006ET, f.4; P00008ET, f.3-4; P00035ET, f.2-3, 8; P00034ET, f.2; P00028ET, f.12-13; P00031ET, f.2; P00007ET, f.4-5.

¹⁸⁰ P00024ET, f.7-8; P00024, min.00:13:54-00:15:51.

¹⁸¹ P00024ET, f.3, 10; P00024, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06.

Haradinaj deklaroi sërish se ai dhe të tjerë i kishin këqyrur dokumentet për katër orë e gjatë asaj kohe kishin lexuar emra dëshmitarësh dhe ish-dëshmitarësh.¹⁸² Ai pohoi se të gjithë avokatët shqiptarë duhej të merrnin kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë sepse ato do t'i ndihmonin në mbrojtjen e klientëve të tyre dhe në hedhjen poshtë të akuzave pasi të paraqiteshin aktakuzat para DHSK-së.¹⁸³ Haradinaj deklaroi se sa herë atij dhe të tjerëve t'u vinin dosje, ata do t'i bënin publike sepse këtë detyrë kishin meqenëse nuk e njohin DHSK-në ose 'Prokurorin Special', duke shtuar se nuk ishte detyrë e OVL-UÇK-së e as e dikujt tjetër që të kujdeset për sekretet e DHSK-së ose ZPS-së.¹⁸⁴

D. KONFERENCA E DYTË PËR SHTYP DHE DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË DYTË

60. Më 16 shtator 2020, rreth orës 15.30, të akuzuarit pretenduan se një person i panjohur, i maskuar, dorëzoi tri kuti me dokumente në receptionin e OVL-UÇK-së pa thënë asgjë.¹⁸⁵ Taibe Miftari, Çelë Gashi dhe Elvir Gucati ishin të pranishëm dhe nuk tentuan ta ndalonin personin.¹⁸⁶ Taibe Miftari shkoi në zyrën e Hysni Gucatit dhe njoftoi të akuzuarit, Faton Klinakun dhe anëtarët të tjerë të OVL-UÇK-së të pranishëm.¹⁸⁷ Personi i maskuar eci lart e poshtë korridorit për disa sekonda, derisa erdhi Faton Klinaku dhe e ndoqi atë tek zbriste shkallët.¹⁸⁸

61. Të akuzuarit, Çelë Gashi dhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së i shqyrtuan

¹⁸² P00021ET, f.4-5; P00021, min.00:07:17-00:11:53.

¹⁸³ P00021ET, f.3-5; P00021, min.00:06:03-00:06:55, 00:12:27-00:14.23.

¹⁸⁴ P00021ET, f.3-5; P00021, min.00:06:03-00:06:55, 00:09:41-00:11:53. Më vonë atë ditë, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në *Facebook*, *shih* P00060, f.SPOE00220744 (P00060ET, f.SPOE00220744).

¹⁸⁵ 1D00023, 1D00024, 1D00025; 1D00026; Gucati, T.2187-2188, 2212; Taibe Miftari, 1D00004ET, para.19; Cele Gashi, 1D00004ET, para.24; Cele Gashi, T.2462.

¹⁸⁶ Cele Gashi, 1D00009ET, para.24; 1D00023, 1D00024, 1D00025; 1D00026.

¹⁸⁷ Taibe Miftari, 1D00004ET, para. 20-21; Gucati, 1D00003ET, para.34; Haradinaj, 2D00001ET, para.70.

¹⁸⁸ 1D00026, 15:32:32-15:33:20. *Shih gjithashtu*, Taibe Miftari, 1D00004ET, para.21; Cele Gashi, 1D00009ET, para. 24-25, 27; Gucati, 1D00003ET, para.34; Haradinaj, 2D00001ET, para.71.

dokumentet ('dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë')¹⁸⁹ dhe vlerësuan se në to, ndër të tjera, përfshiheshin dokumente të ngjashme me ato të nxjerra gjatë nxjerrjes së parë,¹⁹⁰ dhe në veçanti letërkëmbimi ndërmjet prokurorëve të TFHS-së dhe prokurorëve serbë, duke përfshirë kërkesat për gjetjen e individëve që do të merreshin në pyetje dhe për gjetjen e vendeve të sigurta në Serbi.¹⁹¹ Gucati ka dëshmuar se në mesin e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë ai kishte parë dokumente që i përkisnin çështjeve gjyqësore të TPNJ-së *Limaj dhe të tjerët* dhe *Haradinaj dhe të tjerët*.¹⁹²

62. Në ditët para 16 shtatorit, Këshilli Drejtues i OVL-UÇK-së vendosi që, nëse do të dorëzoheshin paketa të reja me materiale, duhej thirrur një konferencë për shtyp sa më shpejt që të ishte e mundur.¹⁹³ Pas konsultimit, të akuzuarit dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë vendosën të mbanin një konferencë për shtyp, të cilën e autorizoi Gucati.¹⁹⁴

63. OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë tjetër për shtyp ('konferenca e dytë për shtyp'), në të cilën Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë një sasi tjetër dokumentesh rreth orës 15:30 të asaj dite.¹⁹⁵ Ai u tha të pranishmëve se mund t'i merrnin dokumentet.¹⁹⁶ Në mesin e shumë dokumenteve publike të përfshira në dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë,¹⁹⁷ Gucati përzgjedhi dhe tregoi para kamerave tri kërkesa konfidenciale për bashkëpunim në çështjet penale, në anglisht dhe serbisht, dhe vuri në dukje se [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kishin

¹⁸⁹ P00018ET, f.3-4; P00018, min.25:32-26:20. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, 2D00001ET, para.77; Cele Gashi, 1D00009ET, para.28; Cele Gashi, T.2588-2589.

¹⁹⁰ Haradinaj, 2D00001ET, para. 75-76; Cele Gashi, 1D00009ET, para.28; Cele Gashi, T.2589; Gucati, T.2190, 2267-69, T.2273. Gucati, T.2273. *Shih gjithashtu* Gucati, T.2277-79, ku konfirmohet pasaktësia e Gucatit, 1D00003ET, para.37

¹⁹¹ Haradinaj, 2D00001ET, para.76; Haradinaj, T.2744-45.

¹⁹² Gucati, T.2193, 2274-76. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2267-69.

¹⁹³ Haradinaj, 2D00001ET, para.73; Haradinaj, T.2746; Cele Gashi, 1D00009ET, para.23; Kryeziu, 1D00008ET, para.9.

¹⁹⁴ Gucati, 1D00003ET, para. 35, 18; Gucati, T.2191, 2215-16; Cele Gashi, 1D00009ET, para.18, 29.

¹⁹⁵ P00002ET, f.1-2; P00002, min.00:00:01-00:02:31.

¹⁹⁶ P00002ET, f.1; P00002, min.00:00:01-00:02:31.

¹⁹⁷ *Shih* P00104.

bashkëpunuar me prokurorët serbë dhe DHSK-në.¹⁹⁸ Gucati ka dëshmuar se, në kohën kur ai dhe anëtarët e tjerë të OVL-UÇK-së i kishin shqyrtuar dokumentet, ai kishte menduar se dy zyrtarët publike që ai përmendi mund të ishin dëshmitarë.¹⁹⁹ Ai pastaj ia dha fjalën Haradinajt dhe qëndroi aty gjatë kohës që foli Haradinaj.²⁰⁰ Faton Klinaku dhe Çelë Gashi qëndruan të ulur në krah të të akuzuarve.²⁰¹

64. Haradinaj vuri në dukje se dokumentet tregonin se Klint Uilliamson, ish-kryeprokurori i TFHS-së, kishte pasur mbi 57 komunikime me 'Vuskoviqin', dhe se Dejvid Shvendiman, ish-kryeprokuror i TFHS-së dhe Prokuror i Specializuar i ZPS-së, kishte pasur mbi 130 komunikime me [REDAKTUAR].²⁰² Haradinaj deklaroi se komunikimet që ai dhe të tjerë kishin parë në dokumente ishin bërë për [REDAKTUAR].²⁰³ Haradinaj vuri gjithashtu në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë përfshinin 'aktakuza Ramusha, e kësisha' dhe iu referua aktakuzave kundër Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt.²⁰⁴

65. Haradinaj u tha personave të pranishëm në konferencën e dytë për shtyp që t'i merrnin dosjet, duke theksuar 'Ne i qesim qetu, për kush të ka qejf me i marrë'²⁰⁵ Kur një person nga të pranishmit pyeti nëse mund të bënte fotografi të dokumenteve, Haradinaj u përgjigj: 'Qysh s'guxon, guxon me i marr n'xhep krejt'.²⁰⁶ Haradinaj e përsëriti premtimin e tij për t'i bërë publike dokumentet sa herë që OVL-UÇK-ja të merrte të tilla.²⁰⁷ Duke iu referuar vetes dhe anëtarëve të tjerë të OVL-UÇK-së, Haradinaj shtoi se ata nuk mbanin përgjegjësi, se ai nuk lodhej për atë punë dhe shtoi

¹⁹⁸ P00002ET, f.1; P00002, min.00:00:01-00:02:31. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2272-73.

¹⁹⁹ Gucati, T.2192. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2205-2207.

²⁰⁰ P00002ET, f.1-4; P00002, min.00:00:01-00:09:49.

²⁰¹ P00002, min.00:00:00; 00:14.06; Pumper, T.1005.

²⁰² P00002ET, f.2-3; P00002, min.00:02:40-00:09:49.

²⁰³ P00002ET, f.3; P00002, min.00:02:40-00:09:49.

²⁰⁴ P00002ET, f.4-5; P00002, min.00:09:49-00:10:29.

²⁰⁵ P00002ET, f.4; P00002, min.00:02:40-00:09:49.

²⁰⁶ P00050ET, f.1; P00050, min.00:15:52-00:16:19.

²⁰⁷ P00002ET, f.4; P00002, min.00:02:40-00:09:49.

se ishte detyra e tyre të diskreditonin DHSK-në.²⁰⁸ Ai deklaroi se mbase arsyeja pse dokumentet i ishin dhënë OVL-UÇK-së ishte se ata kishin guximin që t'i nxirrnin dhe se nuk pajtoheshin me këtë Gjykatë.²⁰⁹

66. Pas përfundimit të konferencës së dytë për shtyp, të akuzuarit dhe bashkëpunëtorët e tyre iu vunë në dispozicion të pranishmëve dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë për t'i fotografuar dhe marë.²¹⁰ Haradinaj kujton se aty ishin tre grumbuj me dokumente dhe se ai veçoi një kopje.²¹¹ Të pranishmit morën kopje të dokumenteve.²¹² Dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë vazhduan të ishin në dispozicion për t'u marrë nga kushdo deri më 17 shtator 2020.²¹³ Hyrja në selinë e OVL-UÇK-së nuk kontrollohet dhe është e hapur për të gjithë.²¹⁴ Shumica e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë, 'mbi 70 për qind e dokumentacionit' u mor.²¹⁵

E. NGJARJET QË PASUAN KONFERENCËN E DYTË PËR SHTYP

67. Ashtu siç bënë pas konferencës së parë për shtyp, Haradinaj dhe Gucati dolën në disa programe televizive pas konferencës së dytë për shtyp, duke mundësuar që përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe të dytë të përhapej sa më shumë.

68. Gjatë një interviste më 16 shtator 2020,²¹⁶ Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerë i kishin shfletuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë për tre orë, kohë gjatë së cilës

²⁰⁸ P00002ET, f.2-4; P00002, min.00:02:40-00:09:49.

²⁰⁹ P00002ET, f.6-7; P00002, min.00:12:09-00:12:45.

²¹⁰ Gucati, T.2282-2285; Haradinaj, T.2751; P000004, 00:02:27-00:03:57, P00004ET, f.3.

²¹¹ Haradinaj, T.2753-2754.

²¹² Haradinaj, 2D00001ET, para.79.

²¹³ Gucati, T.2282-85. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, T.2771.

²¹⁴ Haradinaj, T.2981.

²¹⁵ Gucati, T.2282-85; Haradinaj, 2754; P00004, 00:02:27-00:03:57, P00004ET, f.3.

²¹⁶ Më 19 shtator 2020, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në Facebook, *shih* P00060, f.SPOE00220735 (P00060ET, f.SPOE00220735).

ai dhe të tjerët kishin marrë çfarë u duhej.²¹⁷ Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerë kishin thënë se do të nxirrnin çdo material që komprometonte DHSK-në dhe ZPS-në, duke shtuar se ai dhe të tjerë nuk e njohin DHSK-në dhe kjo është arsyeja që do ta nxjerrin atë informacion, e gjithashtu theksoi se 'nuk është detyra jonë që të ruajmë sekretet'²¹⁸ Ai më tej përmendi emra në dokumente, duke iu referuar 'z. Uilliamson' që komunikonte me 'Vuçkoviqin' që ishte gjithashtu 'Kryeprokuror', me '[REDAKTUAR], me [REDAKTUAR]'.²¹⁹ Ai më pas përmendi '[REDAKTUAR]', dhe u zotua se do të nxirrte emra ndër të cilët '[REDAKTUAR], Vuçkoviqin, [REDAKTUAR]'.²²⁰ Haradinaj deklaroi hapur, duke iu referuar dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, se ai dhe të tjerë i bënë ato publike sepse ishte e dobishme për ta.²²¹ Në përgjigje të pyetjes nëse ishte i vetëdijshëm që kjo që po ndodhte mund të dëmtonte procesin gjyqësor, Haradinaj deklaroi se këtë donte që të ndodhte.²²²

69. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 17 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte pasur kohë për t'i parë dokumentet që u kishte sjellë personi i panjohur.²²³ Haradinaj deklaroi se ndër dëshmitarët e ZPS-së '[REDAKTUAR]'.²²⁴ Ai u bëri sërish thirrje gazetarëve që t'i merrnin dokumentet nga OVL-UÇK-ja dhe t'i botonin,²²⁵ dhe deklaroi se shpresonte që personi që i kishte sjellë dosjet, të sillte edhe të tjera.²²⁶ Haradinaj i quajti ata të cilët kishin bashkëpunuar me ZPS-në 'çetnikë, kriminelë'.²²⁷

70. Më 17 shtator 2020, dy punonjës të ZPS-së, në prani të dy të akuzuarve, Faton

²¹⁷ P00018ET, f.3-4; P00018, min.25:32-26:20.

²¹⁸ P00018ET, f.1-2; P00018, min.00:27-01:10.

²¹⁹ P00018ET, f.2-3; P00018, min.09:30-11:01.

²²⁰ P00018ET, f.2-3; P00018, min. 09:30-11:01, 24:45-25:32.

²²¹ P00018ET, f.3-5; P00018, min.25:32-26:20.

²²² P00018ET, f.5-6; P00018, min.28:52-29:38.

²²³ P00033ET, f.3; P00033, min.00:05:02-00:07:52.

²²⁴ P00033ET, f.2; P00033, min.00:00:19-00:03:50.

²²⁵ P00033ET, f.3; P00033, min.00:05:02-00:07:52.

²²⁶ P00033ET, f.2-3; P00033, min.00:04:37-00:07:52.

²²⁷ P00033ET, f.1-2; P00033, min.00:00:19-00:03:50.

Klinakut, Kryeziut, Marashit dhe gazetarit Milaim Zeka, sekuestruan dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë të mbetura në OVL-UÇK ('Paketa 2').²²⁸ Gjatë sekuestrimit, një hetues i ZPS-së paralajmëroi Gucatin, Haradinajn dhe të tjerët të pranishëm se OVL-UÇK-ja nuk duhej t'i bënte publike dokumentet, duke përfshirë emrat e dëshmitarëve dhe provat, por duhej të thërrisnin ZPS-në,²²⁹ gjë për të cilën Gucati u përgjigj se ata nuk punojnë për DHSK-në dhe nuk duhet të mbrojnë një dokumentacion të tillë.²³⁰ OVL-UÇK-ja fillimisht refuzoi të dorëzonte dokumentet, duke deklaruar se ata do të prisnin intervenimin e policisë së Kosovës.²³¹ Të akuzuarit pranuan të dorëzonin dokumentet pas ardhjes së avokatit Tomë Gashi.²³² Gucati nënshkroi dokumentin që konfirmonte sekuestrimin.²³³

71. Një kopje e Urdhrit të Dytë,²³⁴ që i referohej natyrës së ndjeshme dhe jopublike të dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë dhe përsëriste urdhrin për të mos shpërndarë më tej këtë material, iu dha Gucati.²³⁵ Të dy të akuzuarit kanë pranuar se hetuesi i ZPS-së u kishte thënë se dokumentet mund të kishin natyrë të ndjeshme dhe se as nuk duhej të shpërndaheshin, as të shumëfishoheshin.²³⁶

72. Paketa 2 përbëhet nga 937 faqe, gjashtë prej të cilave²³⁷ riparaqisin kërkesat dhe dokumentet serbe tashmë të përfshira në Paketën 1²³⁸ dhe Paketën 4,²³⁹ ku përmenden

²²⁸ P00104; Moberg, T. 1939-40; Taibe Miftari, 1D00004ET, para.27; Kryeziu, 1D00008ET, para. 10-14; Gucati, 1D00003ET, para. 38-39; T.2194-97, 2289; Haradinaj, 2D00001ET, para. 83-98; Haradinaj, 2760-65.

²²⁹ Gucati, 1D00003ET, para.39; Gucati, T.2195, 2291-93.

²³⁰ Gucati, 1D00003ET, para.39; Gucati, T.2195.

²³¹ Gucati, 1D00003ET, para.40; Gucati, T.2197; Haradinaj, T.2766-70.

²³² Gucati, 1D00003ET, para.42; Gucati, T.2198; Haradinaj, T.2770.

²³³ P00055; Haradinaj, 2D00001ET, para.94.

²³⁴ P00053; P00053AT ('Urdhri i Dytë').

²³⁵ P00053ET; Gucati, T.2293-96; P00004ET, f.3, 8; P00004, min.00:02:27-00:03:57, 00:16:42-00:17:19.

²³⁶ Haradinaj, T.2936; Gucati, T.2292-96. *Shih gjithashtu*, P00006, min.00:58:21-00:58:48; P00006ET, f.35.

²³⁷ P00104, f.080126-080131.

²³⁸ P00139-P00144. *Shih gjithashtu* P00086, para. 22-26; P00090, para. 5-6, Shtojcat 3-4; Pumper, T.915-17.

²³⁹ P00145-P00150.

[REDAKTUAR].²⁴⁰ Nga këto gjashtë faqe, pesë kanë dokumente korresponduese në bazat e të dhënave të brendshme të ZPS-së.²⁴¹ Faqja që nuk është e përfshirë në bazën e të dhënave të ZPS-së është një dokument në gjuhën serbe, i lëshuar për policinë serbe nga Prokurori Serb për Krime të Luftës, lidhur me organizimin e një takimi ndërmjet TFHS-së dhe një dëshmitari të përmendur në kërkesë.²⁴² 931 faqet e mbetura janë kopje të aktvendimeve gjyqësore dhe dokumenteve përkatëse të lëshuara nga gjykatat e Kosovës dhe institucione të tjera gjyqësore, duke përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ('TPNJ'), lidhur me çështje të krimeve të luftës,²⁴³ dhe, siç u përmend konkretisht nga Haradinaj gjatë konferencës së dytë për shtyp,²⁴⁴ kopje të aktakuzave, ndër të cilat ato kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve dhe kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.²⁴⁵ Kopjet e këtyre aktvendimeve nuk kanë ndonjë stemë ose shenjë tipike të dokumenteve të TFHS-së ose ZPS-së.²⁴⁶

73. Menjëherë pas sekuestrimit të Paketës 2, Gucati dhe të tjerë mbajtën një konferencë për shtyp në selinë e OVL-UÇK-së, gjatë së cilës Gucati pohoi se anëtarët e personelit të ZPS-së i kishin dorëzuar atij një kopje të urdhrit të dytë dhe se urdhri i dytë thoshte ashtu siç i kishin thënë edhe anëtarët e personelit të ZPS-së se këto dokumente nuk mund të shumëfishoheshin ose shpërndaheshin dhe se nuk mund të publikoheshin emnat e dëshmitarëve.²⁴⁷ Gucati deklaroi se përfaqësuesit e OVL-UÇK-

²⁴⁰ P00086, para. 22-27; P00090, para. 5-6, Shtojca 3; Pumper, T.914-917, 1197-1210.

²⁴¹ Pumper, T.1200.

²⁴² Pumper, T.1207-1210; P00086, para.26; P00091, Shtojca 3, f.2; P00104, f.080131.

²⁴³ P00104; P00086, para.21. Gjatë një interviste në televizion, Haradinaj pohoi se Paketa 2 përmbante edhe aktgjykime 'që i kan çu kta të tan atje', P00006ET, f.30; P00006, min.00:52:33-00:53:07. Pas konferencës së dytë për shtyp në internet dolën artikuj me lajme, në të cilat, ndër të tjera, raportohej se dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë përfshinin aktvendime gjyqësore të lëshuara nga EULEX-i dhe TPNJ-ja, *shih* P00125, f.081371-081373 (P00125ET), që paraqet pamje të dy faqeve që janë gjithashtu pjesë e Paketës 2 (P00104, f.080319, 080346) por në të cilat ishin bërë redaktime.

²⁴⁴ P00002ET, f.4-5; P00002, min.00:09:49-00:10:29.

²⁴⁵ P00104, f.080007-080030, 080032-080034, 080346-080441; P00002ET, f.4-5; P00002, min.00:09:49-00:10:29.

²⁴⁶ P00086, para.21; P00104.

²⁴⁷ P00004ET, f.3, 8; P00004, min.00:02:27-00:03:57, 00:15:25-00:17:19. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2293-94, ku mohon fjalët e tij të incizuara në kamera.

së u kishin thënë anëtarëve të personelit të ZPS-së se çdo moment që atyre do t'u vinin dokumente nga DHSK-ja, ata do t'i bënin publike për mediat.²⁴⁸ Gucati deklaroi se arsyeja pse ai dhe të tjerët do t'i bënin publike dokumentet ishte se do të vërtetonin çka u kishin thënë para tre vitesh pjesëtarëve të Ushtrisë dhe qytetarëve të Kosovës në mënyrë që të bindeshin edhe ata si dhe media, që DHSK-ja është duke bashkëpunuar me autoritetet serbe kundër pjesëtarëve të UÇK-së.²⁴⁹

74. Gucati deklaroi se 'ne jemi të interesu me demasku Dhomat Speciale', duke shtuar se përmes informimit të personave për çdo material të marrë nga OVL-UÇK-ja, kjo organizatë do të tregojë pse është kundër DHSK-së dhe se 'ne e kemi thënë me kohë që kjo Gjykatë është raciste, është e njëanshme. Për ne është e papranueshme dhe kjo është arsyeja pse ne i publikojmë të gjitha këto dokumentacione'.²⁵⁰ Gucati më pas, lidhur me dokumentet që i ishin dorëzuar OVL-UÇK-së deklaroi se interesi i tyre ishte që t'i shpërndanin sa më shumë në media dhe të bindnin publikun dhe median se kjo Gjykatë është e papranueshme dhe theksoi se ai dhe të tjerët kanë qenë gjithmonë kundër saj.²⁵¹

75. Në një intervistë tjetër më 17 shtator 2020, Haradinaj falënderoi personin që dorëzoi dokumentet në OVL-UÇK dhe deklaroi se nëse ai person mund të sillte edhe materiale të tilla të tjera, ata e mirëprisnin.²⁵² Haradinaj deklaroi se sa herë që OVL-UÇK-ja do të merrte materiale të tilla, ZPS-ja nuk do të mund t'i ndalonte dhe se ai nuk e njihte këtë Gjykatë.²⁵³ Për dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja, Haradinaj deklaroi 'Për kë o vlla sensitive janë? Janë për gjykatën e Hagës që bashkëpunon me Serbinë sensitive. [...] Për mu s'janë'.²⁵⁴ Ai deklaroi se edhe nëse ai dhe të tjerë nxirrnin

²⁴⁸ P00004ET, f.3; P00004, min.00:02:27-00:03:57.

²⁴⁹ P00004ET, f.3; P00004, min.00:02:27-00:03:57.

²⁵⁰ P00004ET, f.8; P00004, min.00:15:25-00:17:19.

²⁵¹ P00004ET, f.8; P00004, min.00:17:26-00:17:40.

²⁵² P00006ET, f.4; P00006, min.00:24:24-00:25:12.

²⁵³ P00006ET, f.14; P00006, min.00:34:18-00:35:13.

²⁵⁴ P00006ET, f.19-20; P00006, min.00:39:29-00:39:36.

ndonjë emër, çdo deklaratë ishte dhënë nën presion, nuk ishte relevante dhe nuk kishte bazë për ngritje aktakuze, prandaj e kishin bërë publike.²⁵⁵

76. Gjatë një interviste tjetër atë ditë, Haradinaj deklaroi se po ndërmerrnin veprime për të diskredituar profesionalizmin e pretenduar të gjykatës.²⁵⁶

77. Në një intervistë tjetër më 17 shtator 2020,²⁵⁷ Haradinaj deklaroi se dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja 'kanë vulën origjinale' dhe shënimin 'top sekret'.²⁵⁸ Ai theksoi se ishte e qartë se dokumentet 'janë origjinale dhe dokumentet e tyre', duke shtuar se 'as s'kish ditë kush me i mbarue, pa konë aty'.²⁵⁹ Haradinaj përmendi bashkëpunimin e DHSK-së me 'Vuçkoviqin, [REDAKTUAR]'.²⁶⁰ Ai kritikoi median me fjalët 'qyqarë' për '[mos]nxjerrjen e të vërtetës' dhe për hezitimin për botimin e materialeve të nxjerra publikisht nga OVL-UÇK-ja, duke theksuar se kjo bënte të nevojshme që Haradinaj dhe të tjerët t'i nxirrnin këto dokumente për 'mediat e huaja'.²⁶¹

78. Më 17 shtator 2020, Haradinaj postoi në profilin e tij në *Facebook* një lidhje me një artikull nga gazeta 'Newborn'.²⁶² Artikulli i referohej një individi që aty përshkruhet si një dëshmitar i mundshëm i DHSK-së dhe përfshinte fotografi të disa faqeve të palexueshme që tregonin paraqitjen tipike të kërkesave.²⁶³ Individi për të cilin bëhej fjalë në artikull përmendej në kërkesat e përfshira në Paketën 1, midis

²⁵⁵ P00006ET, f.25-26; P00006, min.00:46:29-00:47:54.

²⁵⁶ P00034ET, f.2; P00034, min.00:06:24-00:08:04.

²⁵⁷ Më 18 shtator 2020, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në *Facebook*, shih P00060, f.SPOE00220737 (P00060ET, f.SPOE00220737ET).

²⁵⁸ P00019ET, f.2; P00019, min.00:02:48-00:04:05.

²⁵⁹ P00019ET, f.2; P00019, min.00:02:48-00:04:05. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, T2951-2954.

²⁶⁰ P00019ET, f.1, 3-4; P00019, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53.

²⁶¹ P00019ET, f.2; P00019, min.00:04:24-00:05:16.

²⁶² P00061, f.SPOE00220754; P00128; P00124, f.081917-081918 (P00124ET, f.081917-081918); P00073 (P00073ET); Pumper, T.1003-1004. *Shih gjithashtu*, Haradinaj, T.2812, ku pranon se kishte 'pëlqyer' ose shpërndarë fotografi të dokumenteve të nxjerra gjatë tri herëve, të cilat ishin publikuar fillimisht nga media.

²⁶³ P00095; P00128; P00124, f.081917-081918 (P00124ET, f.081917-081918); P00086, para.17.

dëshmitarëve të tjerë dhe dëshmitarëve të mundshëm, të cilët TFHS-ja kishte kërkuar t'i intervistonte dhe në lidhje me të cilët ishte kërkuar të jepeshin procesverbalet e deklaratave të tyre të mëparshme.²⁶⁴ Në të njëjtën ditë, Haradinaj postoi në profilin e tij në *Facebook* një lidhje me një artikull tjetër nga gazeta 'Newborn'.²⁶⁵ Ky artikull përfshinte pamjen e një dokumenti që tregonte paraqitjen tipike të kërkesave.²⁶⁶

79. Gjatë një intervistë më 18 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se anëtarët e ZPS-së që sekuestruan materialin nga OVL-UÇK-ja konfirmuan 'sensitivitetin' e atij materiali.²⁶⁷ Ai deklaroi se shpresonte që personi i cili kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK ta bënte sërish këtë dhe e cilësoi dorëzimin e dokumenteve në OVL-UÇK si 'mrekulli'.²⁶⁸ Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin thënë përfaqësuesve të ZPS-së të cilët sekuestruan materialin nga OVL-UÇK-ja, se nuk e njihnin DHSK-në.²⁶⁹

80. Gjatë të njëjtës intervistë, Tomë Gashi deklaroi se personi i paidentifikuar që kishte sjellë dokumentet në selinë e OVL-UÇK-së, kishte kryer një punë atdhetare për të mirën e përgjithshme, por posaçërisht në të mirë të atyre që do të jenë të akuzuar në DHSK.²⁷⁰ Ai i bëri jehonë Haradinajt duke thënë se 'por dëshmitarët nuk mund t'i mbrojnë një Gjykatë Speciale e cila i lejon apo iu mundëson personave të caktum që të rrjedhin emrat e tyre'.²⁷¹ Ai vuri në dukje se dokumentet e sekuestruara nga ZPS-ja kishin logon e tyre dhe ishin origjinale, duke shtuar se këto ishin dokumente sensitive për ZPS-në.²⁷² Gashi deklaroi se dokumentacioni ishte shumë i favorshëm për OVL-

²⁶⁴ P00086, para.17; P00093.

²⁶⁵ P00061, f.SPOE00220755 (P00061ET, f.SPOE00220755-ET); P00073 (P00073ET); P00074 (P00074ET); 1D00017.

²⁶⁶ P00094; 1D00017, f.DHG0389.

²⁶⁷ P00007ET, f.2-3; P00007, min.00:01:20-00:01:58, 00:03:22-00:04:38; P00020. Më vonë atë ditë, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në *Facebook*, shih P00060, f.SPOE00220739 (P00060ET, f.SPOE00220739).

²⁶⁸ P00007ET, f.2; P00007, min.00:01:59-00:03:22.

²⁶⁹ P00007ET, f.2-3; P00007, min.00:03:27-00:04:38.

²⁷⁰ P00007ET, f.4-5; P00007, min.00:08:26-00:09:47.

²⁷¹ P00007ET, f.5.

²⁷² P00007ET, f.3; P00007, min.00:04:59-00:08:25.

UÇK-në dhe për cilindo që mund të ketë probleme të natyrës juridike me DHSK-në, duke shtuar se dokumentet mund të përdoreshin për të sulmuar besueshmërinë e DHSK-së dhe të disa provave.²⁷³ Ky sugjerim pasqyroj ato që një apo dy ditë më parë kishte deklaruar Haradinaj si arsye të tij dhe të OVL-UÇK-së për nxjerrjen e dokumenteve që u ishin dorëzuar atyre,²⁷⁴ dhe do të përsëritej nga Tomë Gashi në një rast tjetër.²⁷⁵

81. Tomë Gashi deklaroi se publikimi i këtyre dokumenteve do të thotë se gjykatësi duhet të mendojë edhe njëherë para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit Thaçi dhe të tjerëve dhe se shpresonte se rrjedhja e dokumentacionit do të ndihmonte në moskonfirmimin e aktakuzës kundër Presidentit Thaçi.²⁷⁶ Haradinaj u pajtua me Gashin se DHSK-ja tani duhet të mendohej mirë para se të konfirmonte aktakuzat.²⁷⁷ Tomë Gashi vlerësoi se po vërtetohej teoria se nuk është e mundshme që dëshmitarët të mbrohen në Kosovë dhe pyeti nëse me të vërtetë ata po mbrohen në Hagë.²⁷⁸ Ai deklaroi se ai dhe të tjerë e dinin se dokumentet mund të përdoreshin për të shantazhuar dikë dhe se keqpërdorimi i dokumenteve përbën vepër penale, por ky nuk ishte problem i tij.²⁷⁹

82. Më 18 shtator 2020, Gucati postoi në profilin e tij në *Facebook* një lidhje me një artikull të botuar nga gazeta 'Newborn'.²⁸⁰ Në artikull thuhej se gazeta 'Newborn' kishte marrë një dokument që tregonte se [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të përshkruar si oficerë serbë, ishin kontaktuar nga DHSK-ja për të dhënë dëshmi kundër UÇK-së dhe anëtarëve të saj dhe në artikull tregoheshin edhe dy pamje të

²⁷³ P00007ET, f.3-5; P00007, min.00:04:59-00:08:25.

²⁷⁴ P00002ET, f.2-4; P00002, min.00:02:40-00:09:49; P00034ET, f.1-2; P00034, min.00:06:24-00:08:04.

²⁷⁵ P00012ET, f.2; P00012, min.00:01:31-00:04:33.

²⁷⁶ P00007ET, f.11, 16-17; P00007, min.00:20:00-00:20:44, 00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22.

²⁷⁷ P00007ET, f.12; P00007, min.00:22:22-00:22:31.

²⁷⁸ P00007ET, f.5; P00007, min.00:09:48-00:10:22.

²⁷⁹ P00007ET, f.8-9; P00007, min.00:15:33-00:16:08.

²⁸⁰ P00083, f.SPOE00222247 (P00083ET, f.SPOE00222247); P00124, f.081915-081916 (P00124ET, f.081915-081916).

dokumenteve me paraqitjen tipike të kërkesave.²⁸¹ Këta dy individë përmenden me emra në kërkesat që janë pjesë e Paketës 1.²⁸²

83. Gjatë një interviste më 19 shtator 2020, Haradinaj iu referua dosjeve të marra dhe të publikuara nga OVL-UÇK-ja me fjalët 'si dëshmitar për ndërtimin e një aktakuze kundër djemve të luftës' dhe i quajti ato konfidenciale.²⁸³ Gjithashtu, Haradinaj vuri gjithashtu në dukje se dihej nga të gjithë që ai dhe të tjerët i kishin vënë dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë në dispozicion të mediave dhe se mediat kishin bërë kopje të tyre,²⁸⁴ dhe deklaroi se kishte dëshirë që personi i cili i kishte sjellë dokumentet OVL-UÇK-së, të sillte më shumë dokumente, se ishte i mirëpritur dhe se kishte kryer detyrë kombëtare të rëndësishme.²⁸⁵

84. Haradinaj tregoi para kamerës një version të legalizuar të urdhrit të dytë, i cili ishte klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, bashkë me një dokument të ZPS-së që konfirmonte marrjen e materialit të sekuestruar; duke iu referuar urdhrit të dytë, ai pranoi se urdhri përmbante detyrimin për të dhe të tjerët që të mos publikonin dokumentet, duke shtuar 'ne s'kemi nevojë me i publiku. Ne i kemi dhanë kush i publikon. Tani janë kompetencat e atyne, a dojnë me i publiku apo s'dojnë me i publiku'.²⁸⁶ Haradinaj deklaroi se ZPS-ja kishte marrë mbi 20 për qind të materialit të përgjithshëm që ishte në selinë e OVL-UÇK-së dhe gazetarët kishin marrë pjesën tjetër, duke shtuar 'ndonjë sekret, d.m.th. që a mbetë pa dalë, s'ka mbetë'²⁸⁷ Ai deklaroi se mediat nuk duhej të fshihnin çfarë kishte bërë Zëvendësprokurori i Specializuar i

²⁸¹ P00124, f.081915 (P00124ET, f.081915); 1D00016.

²⁸² P00093; P00086, para.16; P00090, f.095538 (i korrespondon faqeve me numrat 15-16).

²⁸³ P00017ET, f.2-3, 9; P00017, min.00:02:10-00:06:38, 00:18:58-00:19:24.

²⁸⁴ P00017ET, f.3-5; P00017, min.00:06:48-00:11:44.

²⁸⁵ P00017ET, f.5; P00017, min.00:12:16-00:12:35. Fakti se Haradinaj dhe Gucati mirëpritën ardhjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë duket edhe më qartë nga postimet që ata bënë në profilet e tyre në Facebook, shih P00075 (P00075ET); P00083, f.SPOE00222248 (P00083ET, f.SPOE00222248).

²⁸⁶ P00017ET, f.6; P00017, min.00:12:44-00:15:00; Shih P00055; P00053; P00053AT. Shih gjithashtu, Haradinaj, T.2931-2933, ku përpiqet të argumentojë se ai ishte informuar për ekzistencën dhe përmbajtjen e Urdhrit të Dytë vetëm pak çaste përpara se ta tregonte atë para kamerave.

²⁸⁷ P00017ET, f.6; P00017, min.00:14:21-00:17:28.

mëparshëm i ZPS-së, duke përmendur mbi 130 komunikime me 'Vukçeviqin', [REDAKTUAR] dhe të tjerë.²⁸⁸

85. Më vonë atë ditë, Haradinaj postoi një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në *Facebook*.²⁸⁹ Një përdorues në *Facebook* me emër përdoruesi 'Xhavit Hajzeri' komentoi me fjalët se ky përdorues dhe të tjerë duhej të botonin libra me deklarata të 'tradhtarëve që janë jashqitje'.²⁹⁰

86. Më 20 shtator 2020, gjatë një paraqitjeje tjetër në një program televiziv, Haradinaj deklaroi se kishte lexuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë sa kishte mundur brenda orarit të punës së OVL-UÇK-së.²⁹¹ Haradinaj tha se dokumentet ishin marrë prej depove sekrete.²⁹²

87. Haradinaj deklaroi se DHSK-ja është 'selektive' dhe 'raciste' dhe se dokumentet që ai dhe të tjerë kishin publikuar tregonin se Gjykata i bazonte akuzat e saj në informacionet e dhëna prej 'kriminelëve, gjakpirësve'.²⁹³ Ai gjithashtu i quajti këta persona spiunë, i akuzoi si tradhtarë të popullit të tyre dhe bëri të ditur se qëllimi i nxjerrjes së dokumenteve gjatë herës së parë ishte që t'u bënte të qartë këtyre personave se askush nuk i mbronte veç i shfrytëzonte dhe shtoi se personat të cilët kishin dhënë informacion nuk janë mbrojtur, por janë vrarë, diskredituar ose turpëruar.²⁹⁴ Haradinaj deklaroi se Gjykata do të rrëzohej krejt sepse njerëzit tashmë i njihnin dëshmitarët.²⁹⁵ Ai i përshkroi dokumentet që OVL-UÇK-ja kishte bërë publike si 'sukses kombëtar' dhe deklaroi se në OVL-UÇK ishin shumë të lumtur me faktin që

²⁸⁸ P00017ET, f.7-8; P00017, min.00:14:21-00:17:28.

²⁸⁹ P00070; P00070ET.

²⁹⁰ P00070; P00070ET.

²⁹¹ P00008ET, f.9.

²⁹² P00008ET, f.24.

²⁹³ P00008ET, f.7.

²⁹⁴ P00008ET, f.26.

²⁹⁵ P00008ET, f.30-31.

kishin marrë dosjet dhe tha se njerëzit ishin të mirëpritur të sillnin më shumë.²⁹⁶

88. Gjatë një programi tjetër televiziv që u transmetua në të njëjtën ditë, Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerët do të bënin çdo gjë që komprometon ZPS-së, sepse nuk e njohin atë dhe se ai do të ishte krenar dhe i nderuar nëse do të arrestohej për veprimet e tij.²⁹⁷

89. Më 20 shtator 2020, Haradinaj postoi një lidhje me një videomaterial të publikuar nga gazeta 'Newborn' në profilin e tij në *Facebook*.²⁹⁸ Videoja paraqiste pamjen e një dokumenti në gjuhën serbe që mbante stemën e TFHS-së, [REDAKTUAR].²⁹⁹ Një kopje e kësaj kërkesë është pjesë e Paketës 1.³⁰⁰

90. Më 21 shtator 2020, në orën 08:21, Gucati publikoi një postim në profilin e tij në *Facebook*³⁰¹ në të cilin deklaronte se dosjet që iu dorëzuan OVL-UÇK-së ishin dokumente zyrtare të DHSK-së që përfshinin emrat e shumicës së dëshmitarëve; ai shkruante se dokumentet kishin dalë nga zyrat e DHSK-së dhe se ato ishin 'tepër sekrete dhe shumë të ndjeshme'.³⁰²

F. KONFERENCA E TRETË PËR SHITYP DHE DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË TRETË

91. Rreth orës 10:35 të datës 22 shtator 2020, një burrë i panjohur dhe i maskuar la disa grumbuj me dokumente ('dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë') në korridorin e selisë së OVL-UÇK-së në Prishtinë.³⁰³ Taibe Miftari e pa këtë person duke i lënë dokumentet dhe e pyeti se kush ishte, pyetje së cilës personi i maskuar iu përgjigj në

²⁹⁶ P00008ET, f.2-4.

²⁹⁷ P00025ET, f.1-2, 9-10.

²⁹⁸ P00060, f.SPOE00220729-SPOE00220730 (P00060ET, f.SPOE00220729-SPOE00220730); P00123.

²⁹⁹ P00123ET, f.1; P00123, min.00:00:20-00:00:33.

³⁰⁰ P00097; P00090, f.095574 (korrespondon me faqen numër 582); Pumper, T.989-91.

³⁰¹ Gucati, T.2285-86. *Shih gjithashtu* Taibe Miftari, T.2475, ku konfirmohet se profili i Hysni Gucatit menaxhohet nga vetë i akuzuari ose, me autorizimin e tij, nga Elvir Gucati.

³⁰² P00059; P00059ET, f.081983-081986.

³⁰³ 1D00027; 1D00028; 1D00029; 1D00030; P00163; Taibe Miftari, 1D0004ET, para. 28-31; Gucati, T.2197-98, 2296; Haradinaj, T.2781.

gjuhën shqipe me fjalët ‘mos më pengo’.³⁰⁴

92. Dokumentet u sollën në zyrën e Gucatit, ku të akuzuarit dhe të tjerë lexuan disa faqe dhe vlerësuan se ato përbënin një ‘draft aktakuzë’ kundër Presidentit Thaçi dhe disa anëtarëve të tjerë të lartë të UÇK-së.³⁰⁵ ‘Draft aktakuza’ ishte në tri kopje.³⁰⁶ Dokumentet iu treguan ushtarëve gjermanë të KFOR-it që ndodhën të pranishëm në atë kohë dhe ato u fotografuan.³⁰⁷ Gazetarja e *Arbresh.info* Elmedina Ballhazhi (DW1242) mbërriti në seli menjëherë pas dorëzimit të dokumenteve, u prit nga Haradinaj dhe qëndroi në zyrën e Hysni Gucatit për rreth 25 minuta me dokumentet.³⁰⁸ Menjëherë pas ardhjes së Ballhazhit, *Arbresh.info* publikoi një artikull ku paraqitej një foto e faqes së parë të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë.³⁰⁹

93. Gucati dëshmoi se ishte në dijeni se dokumenti përmbante emra të ndryshëm të cilët ai nuk ishte i autorizuar t’i nxirrte, sepse këtë ia ndalonte ligji.³¹⁰ Ai ishte i vetëdijshëm se nxjerrja e emrave të dëshmitarëve të mbrojtur ishte e ndaluar me ligj dhe se mund të dëmtonte dëshmitarët dhe rrezikonte sigurinë e tyre.³¹¹

94. Sipas një praktike tashmë të qartë dhe të njëjtë, të akuzuarit dhe bashkëpunëtorët e tyre vendosën të thërrisnin një konferencë për shtyp, e cila u mbajt pas disa orësh (‘konferenca e tretë për shtyp’).³¹² Të akuzuarit nuk verifikuan se kush

³⁰⁴ Taibe Miftari, 1D0004ET, para.32; Taibe Miftari, T.2463-64.

³⁰⁵ Gucati, T.2200, 2297, 2299; Haradinaj, 2D00001ET, para. 106-07, 111; Haradinaj, T.2782; Cele Gashi, 1D00009ET, para.31, ku deklaroi se u ndje i tronditur kur pa aktakuzat kundër heronjve të tij të cilët kishin qenë ‘vetëmohues për çështjen’.

³⁰⁶ Haradinaj, 2D00001ET, para.104, 111.

³⁰⁷ Taibe Miftari, 1D0004ET, para.28; Gucati, 1D0003ET, para.46; Gucati, T.2198-99; Haradinaj, 2D00001ET, para. 103-04, 106, 108-09; Haradinaj, T.2777-78, 2782. *Shih gjithashtu* P00035ET, f.9; P00035, min.00:20:25-00:20:41.

³⁰⁸ P00163; P00164 (pamjet nga 10:58-11:25:30 e mëngjesit).

³⁰⁹ P00125, f.081374-081375.

³¹⁰ Gucati, T.2300, 2302-06.

³¹¹ Gucati, T.2308-09, 2374.

³¹² Gucati, T.2200, 2215-16; Gucati, 1D0003ET, para.47; Haradinaj, T.2783; Haradinaj, 2D00001ET, para.110; Konferenca e parë, e dytë dhe e tretë bashkërisht quhen ‘tri konferencat për shtyp’.

ishin të pranishmit në të,³¹³ por kujtojnë se të pranishme ishin edhe media të huaja.³¹⁴ Gucati deklaroi se dikush kishte sjellë dosje të tjera në zyrat e OVL-UÇK-së dhe se ai dhe të tjerët besonin se këto dosje kishin dalë nga DHSK-ja ose 'Gjykata e Hagës'.³¹⁵ Gucati ftoi personat e pranishëm të afroheshin për të parë dokumentet, të cilat ishin vendosur mbi një tavolinë.³¹⁶ Gucati deklaroi se Haradinaj i kishte lexuar për rreth 30 minuta dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.³¹⁷ Si në rastet e mëparshme, ai pastaj ia dha fjalën Haradinajt dhe qëndroi aty i pranishëm gjatë kohës që fliste Haradinaj.³¹⁸ Faton Klinaku dhe Çelë Gashi u ulën në krah të të akuzuarve.³¹⁹

95. Haradinaj deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte dy kopje të dokumenteve që u ishin dorëzuar atyre më herët gjatë asaj dite.³²⁰ Ai deklaroi se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë shihte që ishte më tepër një 'projekt-aktakuzë' për pesë persona që mund të akuzoheshin: 'Azem Syla, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi'.³²¹ Haradinaj dëshmoi se kishte përmendur emrat që ishin shënuar në faqen e parë të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë.³²² Aktakuza e konfirmuar kundër Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit u bë publike nga DHSK-ja vetëm më 5 nëntor 2020.³²³

96. Haradinaj deklaroi se Xhavit Haliti, emri i të cilit doli më vonë edhe në versionin publik të aktakuzës kundër Thaçit dhe të tjerëve, përmendej në dokumentet

³¹³ Gucati, T.2201.

³¹⁴ Gucati, T.2201-02.

³¹⁵ P00035ET, f.1-2; P00035, min.00:03:15-00:06:04; *Shih gjithashtu* P00003.

³¹⁶ P00035ET, f.1-2; P00035, min.00:03:15-00:06:04; Gucati, T.2200-2201.

³¹⁷ P00035ET, f.2; P00035, min.00:03:15-00:06:04.

³¹⁸ P00035ET, f.1-2; P00035, min.00:03:15-00:06:51.

³¹⁹ P00035, min.00:01:04; Pumper, T.1005.

³²⁰ P00035ET, f.2; P00035, min.00:06:54-00:10:28.

³²¹ P00035ET, f.2; P00035, min.00:06:04-00:06:51.

³²² Haradinaj, T.2784.

³²³ *Shih në përgjithësi Prokurori kundër Thaçit dhe të tjerëve*, Aktakuza e Redaktuar më Tej, KSC-BC-2020-06/F00045/A03, 4 nëntor 2020 (riklasifikuar më 5 nëntor 2020). Në të njëjtin version publik të Aktakuzës, Syla renditet si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët, pjesëtarë të së cilës pretendohet të kenë qenë edhe katër të akuzuarit në atë çështje.

e nxjerra gjatë herës së tretë bashkë me njerëz dhe vendngjarje të tjera si [REDAKTUAR].³²⁴ ZPS-ja zbuloi publikisht disa nga këto vende si vendngjarje krimesh vetëm kur publikoi aktakuzën më 5 nëntor 2020.

97. Haradinaj tha se në dokumente përmenden të dhënat personale të shumë njerëzve dhe se përmendej edhe emri i [REDAKTUAR], e emrat e shumë të tjerëve.³²⁵ Ai deklaroi se në atë moment dokumentet ishin në dispozicion të të pranishmëve, u tha të bënin punën e tyre dhe i falënderoi që ishin aktivë e shtoi se mendonte se ai dhe ata duhej ta kryenin atë detyrë të gjithë së bashku.³²⁶

98. Haradinaj theksoi se dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë kishin emblemën e ZPS-së dhe ishin kopje të origjinaleve.³²⁷ Kur u pyet nëse OVL-UÇK-ja i kishte informuar pesë personat emrat e të cilëve përmendeshin në dokumente, Haradinaj u përgjigj se këtë duhej ta bënte personi që bëri pyetjen, duke shtuar: 'për çka të thirrëm ty?'³²⁸ Kur u pyet për më shumë detaje të përmbajtjes së dokumentit, Haradinaj tha se personi që po e pyeste mund të afrohej dhe ta shihte dokumentin dhe deklaroi se për këtë arsye Haradinaj e kishte thirrur atë dhe të tjerët që të vinin atje, ndryshe ata do t'i kishin botuar vetë dokumentet.³²⁹

99. Haradinaj tha se dokumentet që u ishin dorëzuar më herët atë ditë, ishin në dhomë dhe i ftoi të pranishmit t'i këqyrnin dokumentet, të merrnin nga një kopje dhe t'i fotografonin.³³⁰ Kur u pyet nëse po sugjeronte se media duhej t'i publikonte dokumentet, Haradinaj u përgjigj se media duhej të publikonte çka të mundte.³³¹ Kur

³²⁴ P00035ET, f.2; P00035, min.00:06:04-00:10:28.

³²⁵ P00035ET, f.3; P00035, min.00:06:54-00:10:28.

³²⁶ P00035ET, f.3; P00035, min.00:06:54-00:10:28; Gucati, T.2386-87. *Shih gjithashtu* P00027ET, f.1; P00027, min.00:06:23-00:07:10 ku Haradinaj falënderoi mediat për punën që po bënin, deklaroi se shpresonte që mediat të mos e injoronin atë dhe të tjerët, dhe se mediat duhej të ishin më të guximshme.

³²⁷ P00035ET, f.3-4; P00035, min.00:10:41-00:11:45.

³²⁸ P00035ET, f.4; P00035, min.00:12:02-00:12:10.

³²⁹ P00035ET, f.5; P00035, min.00:14:19-00:15:30.

³³⁰ P00035ET, f.6-7; P00035, min.00:16:57-00:17:59.

³³¹ P00035ET, f.12; P00035, min.00:23:40-00:24:06.

një person që merrte pjesë në konferencën për shtyp tha se publikimi i dokumenteve ishte i ndaluar me ligj dhe i dënueshëm me deri në dhjetë vjet burgim, Haradinaj u përgjigj: 'Tash ti je ka më tut me dhjetë vjet. 300 vjet të më japshin për qitë punë, unë e qes. Unë, unë, jam ka foli unë edhe ne Kryesia komplet [...] Na jena të përgatitun 300-vjet [...]Ne jemi kanë të përgatitun me vdek'.³³²

100. Gucati ndërhyri për të kujtuar se mediat kishin publikuar më parë emra të 'veteranëve fallco' dhe se ata duhej t'i publikonin në të njëjtën mënyrë emrat në dokumente, duke shtuar se 'edhe këta janë shqiptarë. 80% janë shqiptarë që kanë dëshmu atje'.³³³ Gucati pastaj iu drejtua shtypit me fjalët: 'Ju merreni qat guxim të njëjtë, si guximin e veteranëve'.³³⁴ Në dëshminë e tij, Gucati kujtoi se shtypi kishte publikuar më parë një listë me emrat e veteranëve, me numrat e tyre të identifikimit, të cilën ai e konsideronte si shkelje të ligjit.³³⁵

101. Të pyetur nëse në dokumente ishte përmendur edhe [REDAKTUAR], Gucati dhe Haradinaj deklaruan se personi i cili bëri pyetjen e kishte dokumentin dhe lirisht mund ta lexonte.³³⁶

102. Aty nga fundi i konferencës së tretë për shtyp, ndërsa personat e pranishëm u afruan tek tryeza e folësve ku ishin vendosur dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, Gucati, Haradinaj dhe Çelë Gashi u vunë në dispozicion kopjet që ishin mbi tryezë.³³⁷ Një numër personash u mblodhën rreth dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë dhe bënë fotografi të tyre.³³⁸ Përfaqësuesit e mediave morën 'shumë' prej

³³² P00035ET, f.13; P00035, min.00:24:44-00:25:16.

³³³ P00035ET, f.13; P00035, min.00:25:23-00:25:41. *Shih gjithashtu*, Gucati, T.2304-2307, ku mohon fjalët e thëna nga ai vetë të incizuara.

³³⁴ P00035ET, f.14; P00035, min.00:26:03-00:26:05.

³³⁵ Gucati, T.2305-06, 2308.

³³⁶ [REDAKTUAR].

³³⁷ P00035ET, f.15; P00035, min.00:26:46-00:26:59.

³³⁸ P00035, min.00:26:45-00:27:18.

dokumenteve, ndërsa një pjesë e tyre mbetën në OVL-UÇK.³³⁹

103. Haradinaj deklaroi se personi që kishte sjellë dokumentet kishte lënë porosinë se më tej do të sillte CD.³⁴⁰ Ai deklaroi se ai dhe të tjerët e mirëprisnin atë, se OVL-UÇK-ja do të publikonte çdo gjë që do të merrte, se ata mbanin përgjegjësi në lidhje me këtë.³⁴¹ Haradinaj deklaroi se nuk do ta zbulonte identitetin e personit që i kishte sjellë dokumentet OVL-UÇK-së, edhe sikur personi të mos mbante maskë.³⁴²

104. Kur u pyet nëse anëtarët e personelit të ZPS-së i kishin kërkuar Haradinajt që të mos ua jepte dokumentet mediave në rastet e mëparshme kur kishin sekuestruar dokumente nga OVL-UÇK-ja, Haradinaj u përgjigj se ZPS-ja nuk donte që media të informohej për dokumentet.³⁴³

G. NGJARJET QË PASUAN KONFERENCËN E TRETË PËR SHTYP

105. Pak orë pas konferencës së tretë për shtyp, në prani të Gucatit, Klinakut, Tomë Gashit dhe të tjerëve, ZPS-ja i dorëzoi Haradinajt një urdhër të lëshuar nga ZPS-ja që udhëzonte Gucatin dhe/ose OVL-UÇK-në të dorëzonin të gjitha dokumentet e ZPS-së dhe të mos incizonin, kopjonin dhe shpërndanin më tej ato dokumente.³⁴⁴ Haradinaj nënshkroi një dokument për pranimit-dorëzimin e urdhrin në prani të Gucatit dhe të tjerëve.³⁴⁵ Anëtarët e personelit të ZPS-së morën dokumentet që përfshiheshin në

³³⁹ Gucati, T.2201; Haradinaj, 2D00001ET, para.111; Haradinaj, T.2786. *Shih gjithashtu*, Gucati, 1D0003ET, para. 49, 51.

³⁴⁰ P00035ET, f.2-3; P00035, min.00:06:54-00:10:28.

³⁴¹ P00035ET, f.2-3; P00035, min.00:06:54-00:10:28; *Shih gjithashtu* P00030ET, f.2-4; P00030, min.00:01:33-00:04:16.

³⁴² P00035ET, f.10; P00035, min.00:21:28-00:21:38. *Shih gjithashtu* P00083, f.SP0E0022245-46 (P00083, f.SP0E0022245-46-ET) ku tregohet se pak pas dorëzimit të dokumenteve, Haradinaj dhe Gucati publikuan pamjet e dorëzimit të tyre të incizuara në kamerat e sigurisë së OVL-UÇK-së, me titullin 'Rrufeja 3!!!'.

³⁴³ P00035ET, f.6; P00035, min.00:16:18-00:16:45.

³⁴⁴ Moberg, T.1939-40; P00054 ('Urdhri i Tretë'); Gucati, T.2202; Haradinaj, 2D00001ET, para. 112-115.

³⁴⁵ Haradinaj, T.2787; P00058.

dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë ('Paketa 3').³⁴⁶

106. Paketa 3 përfshin dy kopje jo të plota me nga 244 dhe 245 faqe, të një dokumenti konfidencial të ZPS-së me 261 faqe, që ka të bëjë me hetimet dhe procedurat zyrtare të ZPS-së, të cilat janë material i brendshëm pune.³⁴⁷ Aty përfshihet një analizë e provave dhe e dispozitave ligjore përkatëse në lidhje me pesë persona, konkretisht Azem Syla, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi.³⁴⁸ Aty përmenden afërsisht edhe 150 dëshmitarë, [REDAKTUAR], si dhe hollësi për deklaratatë dëshmitarësh dhe të dyshuarish.³⁴⁹

107. Pothuajse të 489 faqet e përfshira në Paketën 3 kanë shenja të qarta që tregojnë se janë material i brendshëm pune i ZPS-së, ndër të cilat:³⁵⁰

Fundi i faqes:



Kreu:



108. Paketa 3 përfshin identitetet e dëshmitarëve të cilët në kohën kur u nxorën dokumentet e herës së tretë ishin objekt i: (i) urdhrave rreptësisht konfidenciale dhe

³⁴⁶ Gucati, T.2202; 2789-90.

³⁴⁷ P00086, para.29; P00090, para. 7-10, Shtojca 5; Pumper, T.926-33, 952, 1008, 1471. *Shih gjithashtu*, P00106-P00119.

³⁴⁸ P00086, para.29; P00090, para. 7-9; Pumper, T.931-33, 951-52; P00106, f.1; P00107, f.1.

³⁴⁹ P00086, para.31; P00090, para. 7-9, Pumper, 949-50, 953.

³⁵⁰ P00086, para.35; P00090, para. 7-10, Shtojca 5; Pumper, T.929-30. *Shih gjithashtu*, P00106-P00119.

ex parte për mosnxjerrje në procedurat para DHSK-së,³⁵¹ dhe/ose (ii) kërkesave rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* për mosnxjerrje në pritje të shqyrtimit para DHSK-së.³⁵²

109. Paketa 3 përfshin gjithashtu përmendje të deklaratave të dëshmitarëve dhe dokumenteve dhe informacioneve të tjera të dhëna ZPS-së nga organizata ndërkombëtare, ndër të cilat [REDAKTUAR], me kusht që të mbaheshin konfidenciale dhe të përdreshin me kufizime.³⁵³ Këto përfshijnë deklaratat e dëshmitarëve dhe dokumentet e dhëna ZPS-së, me kushtin që materialet të trajtoheshin si konfidenciale dhe të përdreshin vetëm për hetime dhe procedura gjyqësore.³⁵⁴ Informacioni tjetër i përmendur është dhënë mbi bazë konfidenciale dhe vetëm për të siguruar prova të reja; çdo përdorim ose nxjerrje e atij informacioni për qëllime të tjera kërkon miratimin e dhënësit të tij.³⁵⁵

110. Gjithashtu, Paketa 3 përfshin përmendje të emrave, pseudonimeve dhe dëshmive të dëshmitarëve, identitetet e të cilëve ishin objekt i masave mbrojtëse të mëparshme të urdhëruara nga gjykatat e Kosovës, ndër të cilat ato për mosnxjerrjen e identiteteve të dëshmitarëve, caktimin e pseudonimeve dhe mosnxjerrjen e të dhënave të dëshmitarëve.³⁵⁶

111. Siç theksohet nga [REDAKTUAR], '[REDAKTUAR]'.³⁵⁷ Si rrjedhojë, çdo ndryshim i mundshëm i kufizimeve të vendosura nga [REDAKTUAR] do të çonte, më së paku, në vendosjen e kushteve të konfidencialitetit dhe përdorimin e tyre vetëm

³⁵¹ P00086, para.32; Pumper, T.953-60; P00151, para. 132-139, 140(c),(g),(e); P00152, para. 155-62, 163(c), (g), (e). *Shih gjithashtu* P00153.

³⁵² P00086, para.32; Pumper, T.953-60; P00154, para. 54-55.

³⁵³ P00086, para.34, Pumper, T.967-70.

³⁵⁴ P00086, para.34, Pumper, T.967-70.

³⁵⁵ P00086, para.34.

³⁵⁶ P00086, para.33; P00161.

³⁵⁷ P00126, f.1.

për hetimet dhe proceset gjyqësore të DHSK-së.

112. Më 22 shtator 2020 dhe gjatë ditëve në vijim, përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, duke përfshirë emrat e dëshmitarëve dhe provat, u shpërnda më tej, ndër të tjera edhe në organet e shtypit e Internet.³⁵⁸ Haradinaj kishte deklaruar më parë se, për shkak të hezitimit të disa mediave për të publikuar materialet e vëna në dispozicion nga OVL-UÇK-ja, ishte e nevojshme, sipas mendimit të Haradinajt dhe të tjerëve, që këto dokumente t'u jepeshin 'mediave të huaja'.³⁵⁹ Në fakt, një numër artikujsh dhe materialesh filmike që riprodhonin pjesë të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, u publikuan nga një media që e kishte selinë në Shqipëri.³⁶⁰

113. Gjatë një konference për shtyp me përfaqësues të mediave të ndryshme të mbajtur në selinë e OVL-UÇK-së më 22 shtator 2020, pasi ZPS-së i ishte dorëzuar Paketa 3, Gucati konfirmoi se DHSK-ja kishte marrë materialin dhe deklaroi se kjo donte të thoshte që materiali ishte i DHSK-së.³⁶¹ Gjatë të njëjtës konferencë për shtyp, Tomë Gashi pranoi se Gucati, Haradinaj dhe të tjerët i kishin parë dokumentet e përmendura gjatë tri konferencave për shtyp 'për çështje të veta'.³⁶² Gashi theksoi se përfaqësuesit e mediave kishin pasur mundësinë e këqyrjes së materialit që ishte pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, nëse do të kishin dashur, duke shtuar se materiali 'është origjinal' dhe 'duket që është material me ndjeshmëri të lartë, ku ka të

³⁵⁸ P00120 (P00120ET); P00125, f.081374-081378 (P00125ET.4); P00155 (P00155ET), përfshirë materialin filmik P00156 (P00156ET); P00157 (P00157ET), përfshirë materialin filmik P00158 (P00158ET); P00159 (P00159ET), përfshirë materialin filmik P00160 (P00160ET); P00120 (P00120ET); P00121 (P00121ET); P00122 (P00122ET). *Shih gjithashtu* P00086, para. 36-74; Pumper, T.973-89. *Shih gjithashtu* P00106-P00119.

³⁵⁹ P00019ET, f.2; P00019, min.00:04:24-00:05:16.

³⁶⁰ P00155 (P00155ET), përfshirë materialin filmik P00156 (P00156ET); P00157 (P00157ET), përfshirë materialin filmik P00158 (P00158ET); P00159 (P00159ET), përfshirë materialin filmik P00160 (P00160ET).

³⁶¹ P00012ET, f.1-2; P00012, min.00:01:06-00:01:31.

³⁶² P00012ET, f.3; P00012, min.00:07:18-00:08:24.

bëjë me hetimin penal të personave që janë hetuar nga Gjykata për vite të tëra'.³⁶³

114. Tomë Gashi deklaroi se besonte që 'kryetari z. Gucati, z. Haradinaj dhe të tjerë kanë thënë gjithmonë se çfarëdo që të bjerë, a kushdo që t'i sjellë këtu, do t'i bëjnë publike, në kuptimin që opinionin shqiptar kudo që të jemi dhe të jenë, ta marrë vesh se çfarë është duke ndodhur me Dhomat e Specializuara', duke shtuar se 'ne mendojmë që në të ardhmen, nëse aktakuzat e ngritura kundër pjesëtarëve të UÇK-së konfirmohen, atëherë mund të jenë materiale që mund të përdoren dhe mund të dëmtohet dhe të sulmohet kredibiliteti i Dhomave të Specializuara'.³⁶⁴ Tomë Gashi pranoi se gjatë konferencës së tretë për shtyp, Haradinaj kishte përmendur emra dhe mbiemra të personave nën hetim që përmendeshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.³⁶⁵ Gashi gjithashtu deklaroi se premtimi i OVL-UÇK-së 'është gjithmonë, çfarëdo që marrin në raport me Dhomat e Specializuara, do ta njoftojnë opinionin sepse ne jemi kundër kësaj Gjykate'.³⁶⁶

115. Gjatë një interviste më 22 shtator 2020, Gucati deklaroi se personi i panjohur i cili kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK, u kishte thënë që në ditët në vijim do të dërgonte edhe CD të ndryshme me materiale; Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja do t'i publikonte dokumente të tilla që t'u tregonte opinionit kosovar dhe shqiptarëve mbarë rruzullit tokësor se DHSK-ja bashkëpunon me autoritetet serbe, duke shtuar se ishte me rëndësi që t'i bindnin qytetarët e Kosovës dhe t'u tregonin që kjo Gjykatë është pa vlerë.³⁶⁷

116. Gjatë një interviste tjetër atë ditë dhe duke iu përgjigjur akuzave se po minonin administrimin e drejtësisë, Gucati deklaroi se ishte e padrejtë që ai dhe të tjerë të

³⁶³ P00012ET, f.2; P00012, min.00:01:31-00:04:33.

³⁶⁴ P00012ET, f.2; P00012, min.00:01:31-00:04:33; *Shih gjithashtu* P00012ET, f.2-3, P00012, min.00:04:42-00:06:21.

³⁶⁵ P00012ET, f.3; P00012, min.00:07:18-00:08:24.

³⁶⁶ P00012ET, f.4; P00012, min.00:09:45-00:13:18.

³⁶⁷ P00029ET, f.2; P00029, min.00:03:29-00:04:17.

akuzoheshin se po tentonin të minonin administrimin e drejtësisë dhe se ai dhe të tjerët kishin ruajtur çdo emër të përmendur në dokumente dhe kishin mundësuar që të ishin të ruajtur.³⁶⁸ Ai deklaroi se ai dhe të tjerët e dinin se nuk kishin shkelur ligjin, sepse nuk kishin treguar emrat dhe mbiemrat e dëshmitarëve, ata kishin treguar vetëm dokumentacionin.³⁶⁹

117. Gucati deklaroi se dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja përmbanin vula zyrtare, numra protokolli, nënshkrime të prokurorëve ndërkombëtarë dhe emblemën e DHSK-së.³⁷⁰ Gucati deklaroi se ai vazhdon të publikojë dokumente sepse ai dhe të tjerët donin të tregonin realitetin dhe ata ishin në konflikt me DHSK-në për tre vjet sepse DHSK-ja është duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e Serbisë.³⁷¹ Gucati deklaroi se do t'i publikonte të gjitha dosjet që mund t'i vinin dhe se ai e të tjerët janë kundër DHSK-së sepse është raciste, e njëanshme dhe nuk vlente fare, duke theksuar se ruajtja e dokumenteve nuk ishte detyrë e tij.³⁷² Gucati deklaroi se dokumentet i kishin ardhur në zyrë dhe përgjegjësi e tij ishte të minonte DHSK-në.³⁷³ Ai shtoi se nëse do të ishte e mundshme për të dhe të tjerët, ata do ta hiqnin dhe do ta shpërbënin DHSK-në.³⁷⁴

118. I pyetur nëse konsideronte se kishte ndonjë përgjegjësi lidhur me çfarë ndodhi duke pasur parasysh faktin që ai publikoi dokumentet, Gucati pretendoi se ai dhe të tjerët nuk kishin përgjegjësi sepse nuk kishin bërë publik emra dëshmitarësh dhe nuk kishin deklaruar çfarë shkruhej në dokumente.³⁷⁵ I pyetur nëse do të pendohej për publikimin e dokumenteve nëse do të kishte pasoja penale, Gucati deklaroi se nuk do

³⁶⁸ P00028ET, f.1-2; P00028, min.00:00:00-00:03:08.

³⁶⁹ P00028ET, f.2; P00028, min.00:00:00-00:03:08.

³⁷⁰ P00028ET, f.14; P00028, min.00:17:50-00:19:36.

³⁷¹ P00028ET, f.2; P00028, min.00:01:36-00:03:08.

³⁷² P00028ET, f.7-8; P00028, min.00:08:55-00:10:20.

³⁷³ P00028ET, f.8-9; P00028, min.00:10:20-00:13:16.

³⁷⁴ P00028ET, f.11; P00028, min.00:14:47-00:16:12.

³⁷⁵ P00028ET, f.10-11; P00028, min.00:13:16-00:14:47.

t'i vinte aspak keq edhe sikur të dënohej me pesë vjet burgim.³⁷⁶ Gucati deklaroi se ai dhe të tjerët nuk dinin si mund t'i akuzonte DHSK-ja ose si mund të ngrinte aktakuzë kundër tyre, kur ata nuk kishin nxjerrë asnjë emër dëshmitari.³⁷⁷

119. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 22 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerët ua kishin dhënë mediave dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.³⁷⁸ I pyetur nga një gazetar nëse kishte mbajtur kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, Haradinaj u përgjigj se nuk kishte mbajtur dhe se ai e të tjerët po ua jepnin dokumentet personave të pranishëm.³⁷⁹ Kur u pyet nëse dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë po mbaheshin në arkivat e OVL-UÇK-së, Haradinaj deklaroi se jo, sepse media ishte forca e katërt në Kosovë dhe se OVL-UÇK-ja mbështetej te media, duke shtuar se OVL-UÇK-ja ua dha dokumentet mediave që kishin arkivuar sa kishin dashur dhe se mediat mund të merrnin sa dokumente të donin.³⁸⁰ Haradinaj deklaroi se nëse mediat nuk kishin marrë aq kopje të dokumenteve sa kishin dashur nga OVL-UÇK-ja, mediave duhej t'u vinte turp,³⁸¹ dhe se ai shpresonte që OVL-UÇK-së mos t'i kishte shkuar munda dëm sepse OVL-UÇK-ja mendonte se duke ua dorëzuar dokumentet mediave, mediat do t'i ruanin dokumentet.³⁸² Haradinaj deklaroi se OVL-UÇK-ja gjithmonë ka qenë dhe është kundër Gjykatës dhe do të bëjnë çdo gjë që ta diskreditojnë këtë gjykatë raciste, selektive, politike.³⁸³ Ai deklaroi se e rëndësishme ishte që materiali i ardhur në OVL-UÇK dekonspiron punën pesëvjeçare të Gjykatës.³⁸⁴ I pyetur se çfarë donte ai që të bënte media, Haradinaj deklaroi se ai donte që mediat të publikonin sa dokumente të

³⁷⁶ P00028ET, f.12; P00028, min.00:14:47-00:16:12.

³⁷⁷ P00028ET, f.12-13; P00028, min.00:16:12-00:17:50.

³⁷⁸ P00030ET, f.3-4; P00030, min.00:01:33-00:04:16.

³⁷⁹ P00030ET, f.5; P00030, min.00:04:16-00:06:36.

³⁸⁰ P00030ET, f.5-6; P00030, min.00:05:34-00:06:36.

³⁸¹ P00030ET, f.5-7; P00030, min.00:05:34-00:07:28.

³⁸² P00030ET, f.8-9; P00030, min.00:08:22-00:09:39.

³⁸³ P00030ET, f.15; P00030, min.00:15:02-00:18:18.

³⁸⁴ P00030ET, f.17-18; P00030, min.00:21:08-00:22:51.

guxonin.³⁸⁵

120. Prezantuesi i një programi tjetër televiziv në të cilin Haradinaj mori pjesë më 22 shtator 2020 theksoi se Haradinaj kishte përmendur disa emra më herët atë ditë dhe Haradinaj u përgjigj se kishte përmendur një emër [REDAKTUAR].³⁸⁶ Haradinaj deklaroi se materiali që po publikohej i konvenonte atij dhe të tjerëve sepse vërtetonte atë që kishin thënë gjithmonë në lidhje me bashkëpunimin e Gjykatës me serbët,³⁸⁷ dhe, duke iu referuar DHSK-së tha se 'edhe rrjedhja e dosjeve, [ishte] diskreditim [për] ta'.³⁸⁸

121. Duke iu drejtuar një gazetari i cili deklaroi se nuk i kishte dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, Haradinaj deklaroi se në konferencën e shtypit, dokumentet ishin në tryezë që gazetari t'i merrte dhe gazetari mund t'i kishte marrë.³⁸⁹

122. Gjatë një programi televiziv më 24 shtator 2020, Klinaku tha se shpërndarja e dokumenteve ishte një skandal për DHSK-së³⁹⁰, pranoi se ai dhe të tjerë kishin publikuar emrin e 'Vukçeviqit'³⁹¹ dhe e quajti DHSK-në 'pseudo-Gjykata Speciale'.³⁹²

123. Gjatë një interviste më 25 shtator 2020, Haradinaj deklaroi: 'Sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund [...] Ne na i ka prit ai që na i ka sjell ato. Ishallah na bjen apet', duke shtuar se kjo nuk do të thoshte se vetëm Haradinaj, Gucati ose Klinaku do t'i jepnin dokumente medias, meqenëse edhe anëtari me rang më të ulët i UÇK-së mund ta

³⁸⁵ P00030ET, f.20-21; P00030, min.00:24:30-00:25:41.

³⁸⁶ P00011ET, f.30; P00011, min.00:39:20-00:39:58.

³⁸⁷ P00011ET, f.3-6; P00011, min.00:04:16-00:05:55.

³⁸⁸ P00011ET, f.56; P00011, min.01:14:00-01:14:06.

³⁸⁹ P00011ET, f.7-8; P00011, min.00:10:54-00:12:41.

³⁹⁰ P00023ET, f.2; P00023, min.00:07:53-00:07:56.

³⁹¹ P00023ET, f.6; P00023, min.00:10:04-00:10:07.

³⁹² P00023ET, f.7; P00023, min.00:10:57-00:11:04.

bënte këtë dhe se: 'Kemi me e qit në media.'³⁹³

124. Gjatë një interviste tjetër më 25 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se ai nuk do t'i zbatonte urdhrat e kësaj Gjykate dhe nuk e njihte atë dhe se ai dhe të tjerë kishin detyrë të punonin kundër Gjykatës.³⁹⁴ Pa asnjë pendim të dukshëm, pak para arrestimit të tij, Haradinaj deklaroi se nëse do të merrte më shumë dokumente, ai do t'ia jepte medias.³⁹⁵

H. PASOJAT E VEPRIMEVE TË TË AKUZUARVE

125. Pas publikimit të dokumenteve nga OVL-UÇK-ja në shtator 2020, disa dëshmitarë të ZPS-së telefonuan anëtarë të personelit të ZPS-së, ndër të cilët edhe punonjës in e ZPS-së për sigurinë e dëshmitarëve të asaj kohe (që aktualisht është shef i ekipit për sigurinë e dëshmitarëve) Miro Jukiq (Miro Jukić) (W04842), dhe shprehën zemërim, shqetësim dhe frikë për faktin se emrat e tyre ishin publikuar nga mediat në Kosovë dhe rajon.³⁹⁶ Telefonata të tilla nga dëshmitarët për ZPS-në filluan në të njëjtën ditë që u mbajt konferenca e parë për shtyp, ku një prej këtyre dëshmitarëve kërkoi një takim po atë ditë dhe Jukiqi më pas zhvilloi takimin.³⁹⁷ Një nga personat që kontaktoi ZPS-në i tha Jukiqit se ai i kishte besuar ZPS-së por tani emri i tij ishte bërë publik dhe familja e tij ishte në rrezik, duke theksuar se ai e dinte se çfarë u kishte ndodhur dëshmitarëve në Kosovë, gjë të cilën Jukiqi e kuptoi se e kishte fjalën për dëshmitarët që janë kërcënuar gjatë proceseve ligjore në Kosovë.³⁹⁸

126. Nga 24 shtatori 2020,³⁹⁹ Jukiqi, punonjës për sigurinë e dëshmitarëve, prokurorë dhe hetues, me ndihmën e përkthyesve ose ndihmësve gjuhësorë, kontaktuan

³⁹³ P00015ET, f.2; P00015, min.00:03:24-00:04:59.

³⁹⁴ P00026ET, f.2, 4-5; P00026, min.00:06:32-00:07:30, 00:09:29-00:10:50.

³⁹⁵ P00026ET, f.4-5; P00026, min.00:09:29-00:10:50.

³⁹⁶ Jukić, T.1690, 1693, 1703-07.

³⁹⁷ Jukić, T.1723-25; P00134.

³⁹⁸ Jukić, T.1704-05, 1758-59.

³⁹⁹ Jukić, T.1700.

personat të cilët kishin dhënë deklaratat për ZPS-në, emrat e të cilëve përmendeshin në dokumentet e bëra publike gjatë konferencës së tretë për shtyp.⁴⁰⁰ Ky kontaktim përfundoi në mesin e dhjetorit të vitit 2020.⁴⁰¹ Këto kontakte u zhvilluan kryesisht me telefon; disa takime u mbajtën personalisht.⁴⁰² Kontaktimi i personave pati përparësinë më të lartë në atë kohë për ZPS-në dhe kërkonte kohë.⁴⁰³ Disa anëtarë të personelit, të cilët ishin duke punuar nga shtëpia për shkak të pandemisë që po vazhdonte, ishin të detyruar të paraqiteshin në zyrat e ZPS-së për të kryer këtë detyrë.⁴⁰⁴

127. Disa persona që u kontaktuan nga ZPS-ja shprehën frikë dhe se ndiheshin të kërcënuar pas publikimit të emrave të tyre⁴⁰⁵ dhe disa ishin të brengosur për faktin se emrat e tyre ishin përfshirë në dokumentet e bëra publike nga OVL-UÇK-ja dhe kërkuan nga ZPS-ja që të mos kontaktonte më me ta.⁴⁰⁶ Publikimi i emrave të personave nga OVL-UÇK-ja bëri që disa persona të ndërronin mendim lidhur me angazhimin e mëtejshëm të tyre me ZPS-në.⁴⁰⁷

128. Dhjetëra dëshmitarë me të cilët ZPS-ja ishte në kontakt pasi dokumentet konfidenciale u bënë publike nga OVL-UÇK-ja, deklaruan se ata ndiheshin të shqetësuar, të stresuar, të pasigurt, të kërcënuar dhe/ose të frikësuar pas publikimeve.⁴⁰⁸ Ekziston një atmosferë e njohur e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë,⁴⁰⁹ që përkeqësoi ndikimin që veprimet e të akuzuarve patën te dëshmitarët.

129. Shumica e personave të kontaktuar nga ZPS-ja gjatë këtij aktiviteti kishin dëgjuar që OVL-UÇK-ja i kishte publikuar dokumentet përmes mediave në shtator

⁴⁰⁰ Jukić, T.1692-95, 1697-98, 1700, 1711, 1715, 1803-05; Pumper, T.1009.

⁴⁰¹ Jukić, f.1832.

⁴⁰² Jukić, T.1695, 1698, 1761; Pumper, T.1009.

⁴⁰³ Jukić, T.1700-01.

⁴⁰⁴ Jukić, T.1701.

⁴⁰⁵ Jukić, T.1699-1700; *Shih gjithashtu* Jukić, T.1712, 1714-15, 1723-24, 1726, 1731-32; Pumper, T.1010.

⁴⁰⁶ Jukić, T.1702-03.

⁴⁰⁷ Jukić, T.1905. *Shih gjithashtu*, Pumper, T.1012.

⁴⁰⁸ Jukić, T.1719; *Shih gjithashtu* Jukić, T.1712, 1714-15, 1722-24, 1726.

⁴⁰⁹ Jukić, T.1758; Reid, T.3305-10; P00165; C00002.

2020.⁴¹⁰ Miq ose familjarë kishin informuar disa persona të kontaktuar nga ZPS-ja se emrat e tyre figuronin në këto dokumente.⁴¹¹

130. [REDAKTUAR] kontaktoi ZPS-në pasi emri i tij ishte publikuar në media dhe më pas atë e kontaktoi edhe ZPS-ja; [REDAKTUAR] u ankua për publikimin e dokumenteve nga OVL-UÇK-ja.⁴¹²

131. Pas kontaktimit të personave, emrat e të cilëve përmendeshin në dokumentet e bëra publike nga OVL-UÇK-ja, dhe si rezultat i publikimit të këtyre dokumenteve, ZPS-ja ndërmori disa masa, ndër të cilat dhënia këtyre personave e numrave të rinj të telefonave dhe telefonave për komunikim të sigurt për shkak të publikimit të dokumenteve nga OVL-UÇK-ja, përgatitja e planeve të menaxhimit të rrezikut në raste urgjencash dhe zhvendosja jashtë Kosovës.⁴¹³

132. Përgatitja e planeve të menaxhimit të rrezikut në raste urgjencash përfshiu punën e disa personave, ndër të cilët punonjësit për sigurinë e dëshmitarëve dhe punonjësit e sigurisë operative.⁴¹⁴ Përgatitja e përsheptuar e planeve për menaxhimin e rrezikut në raste urgjencash ishte një masë e nevojshme për shkak të rrjedhjes së dokumenteve dhe u mor në lidhje me një numër të kufizuar dëshmitarësh, niveli i rrezikut të të cilëve u rrit dhe të cilët ishin të rëndësishëm për ZPS-në.⁴¹⁵

133. Dy zhvendosjet që u kryen nga ZPS-ja kishin të bënin me persona të cilët ishin të frikësuar dhe nuk donin të qëndronin më në shtëpitë e tyre pas publikimit të dokumenteve nga OVL-UÇK-ja; Jukiqi u përfshi në procesin e marrjes së vendimit në lidhje me këto zhvendosje.⁴¹⁶ Një zhvendosje u krye rreth [REDAKTUAR], ndërsa e

⁴¹⁰ Jukić, T.1715-16.

⁴¹¹ Jukić, T.1715-16.

⁴¹² Jukić, f.1790-91, 1903-04.

⁴¹³ Jukić, T.1707-08, 1882-84.

⁴¹⁴ Jukić, T.1708.

⁴¹⁵ Jukić, T.1760-61.

⁴¹⁶ Jukić, T.1708-09, 1762-63, 1901-02.

dyta u krye [REDAKTUAR].⁴¹⁷ Zhvendosja është një masë e jashtëzakonshme dhe mjet i fundit që ndërmerret vetëm kur ZPS-ja nuk ka asnjë mundësi tjetër për të mbrojtur dikë në Kosovë; kjo masë është e përligjur kur vlerësohet se ekziston një nivel i lartë i kërcënimit ndaj dëshmitarit.⁴¹⁸ Për të përcaktuar nëse zhvendosja është e përligjur, prokurori dhe hetuesi përkatës së bashku me punonjësit përgjegjës për sigurinë e dëshmitarëve përgatisin propozimin lidhur me zhvendosjen, të cilin ia dorëzojnë Prokurorit të Specializuar.⁴¹⁹

134. Krahas zhvendosjes, në lidhje me 20 deri në 30 dëshmitarë u morën edhe masa sigurie ose mbrojtëse.⁴²⁰

IV. ANALIZA DHE TEORIA E ÇËSHTJES GJYQËSORE

135. Në këtë pjesë analizohen disa tema kyçe të përzgjedhura. Këtu gjithashtu përfshihet edhe pjesa e teorisë së çështjes së ZPS-së për çdo vepër penale/formë të përgjegjësisë penale.

A. DËSHMITË E DËSHMITARËVE TË ZPS-SË

136. Të katër dëshmitarët e ZPS-së dhanë dëshmi të qarta, përputhëse dhe të besueshme.

137. *Zdenka Pumper*. Zdenka Pumper (W04841) është hetuese e ZPS-së me mbi 20 vjet përvojë pune në hetimin e krimeve në policinë austriake dhe misionet e OKB/BE-së.⁴²¹ Ajo dëshmoi se si u morën Paketat me dokumente dhe çfarë përmbanin ato. Burimi i njohurive të saj lidhur me aspektet për të cilat ajo tregon në dëshminë e saj ishte përcaktuar qartë dhe ajo bëri dallimin midis aspekteve për të cilat kishte dijeni

⁴¹⁷ Jukić, T.1891-92.

⁴¹⁸ Jukić, T.1760-61.

⁴¹⁹ Jukić, T.1906.

⁴²⁰ Jukić, T.1763.

⁴²¹ Pumper, T.832.

dhe atyre për të cilat nuk kishte.⁴²² Ajo theksoi rastet kur përgjigjet do të ishin hamendësuese, duke përfshirë përgjigjet ndaj pyetjeve të gjykatësve.⁴²³ Madje edhe mbrojtësi që i drejtoi pyetjet nga pala kundërshtare e vlerësoi atë për faktin se ishte ‘e sinqertë’ pasi ajo nuk bëri hamendësime gjatë dhënies së dëshmisë së saj.⁴²⁴

138. *Halil Berisha*. Berisha është ish-gazetar i gazetës ‘Infokus’⁴²⁵, i cili mori Paketën 4 nga OVL-UÇK-ja dhe ia ktheu atë më pas ZPS-së. Ai nuk ishte kundër kauzës së UÇK-së ose OVL-UÇK-së – përkundrazi, në fakt⁴²⁶ - por bëri një përshkrim të paanshëm të ngjarjeve që kishte përjetuar personalisht. Ai ishte i hapur në përgjigjet e tij si për ZPS-në ashtu edhe për Mbrojtjen.

139. Nuk ka arsye të besohet se Berisha dha dëshmi inkriminuese sepse atë e kishin siguruar se nuk do të ndiqej penalisht. ZPS-ja vetëm bëri të ditur se nuk ishte kundër zbatimit të garancive sipas rregullës 151 për këtë dëshmitar, në përgjigje të kërkesës nga avokati i dëshmitarit.⁴²⁷ ZPS-ja shprehu qëndrimin e saj në gjykatë se Berisha nuk kishte kryer asnjë krim, por këtë e bëri pa praninë e dëshmitarit para dhënies së dëshmisë së tij.⁴²⁸ Në fakt është Mbrojtja e Gucatit ajo që e para e informoi Berishën për komentet e ZPS-së në gjykim.⁴²⁹

140. *Miro Jukiq*. Jukiqi është shëf i ekipit për sigurinë e dëshmitarëve i ZPS-së, me 20 vjet përvojë pune në mbrojtjen e dëshmitarëve në rajonin e Ballkanit, ndër të cilat gjashtë vjet me TPNJ-në.⁴³⁰ Ai shpjegoi qartë burimin e njohurive të tij personale, duke bërë dallimin midis çfarë kishte përjetuar personalisht dhe çfarë kishte mësuar ose

⁴²² *P.sh.* Pumper, T.1049, 1070-71, 1217-18, 1392.

⁴²³ *P.sh.* Pumper, T.1477.

⁴²⁴ Pumper, T.1049.

⁴²⁵ Berisha, T.1513.

⁴²⁶ *Shih* Berisha, T.1603-04, 1609, 1613.

⁴²⁷ Përcjellja e kërkesës sipas rregullës 151, KSC-BC-2020-07/F00327, 27 shtator 2021 (riklasifikuar si publike më 18 janar 2022; me shtojcë), para.2.

⁴²⁸ Transkripti, 26 tetor 2021, T.1506-07.

⁴²⁹ Berisha, T.1577.

⁴³⁰ Jukić, T.1690-92.

deduktuar nga të tjerët.⁴³¹ Gjithashtu, ai pranoi qartësisht kur disa informacione nuk shfaqeshin në shënimet ku ishin regjistruar kontaktet me dëshmitarët.⁴³² Ai ishte i drejtpërdrejtë në përgjigjet e tij ndaj pyetjeve dhe bëri edhe saktësime shtesë kur mundi në përgjigje të pyetjeve nga Mbrojtja dhe gjykatësit.⁴³³ Kur u përball me pyetjet acaruese të palës kundërshtare – me ç’rast iu tha edhe se po gënjente – ai ruajti qëndrimin e tij profesional dhe të qetë duke mohuar me vendosmëri akuza të tilla.⁴³⁴ Dëshmia e Jukiqit për frikën e përgjithshme të shprehur nga dëshmitarët dhe kërcënimet me të cilat ata përballëshin, ishte e qartë dhe e prerë, në përputhje me dëshminë që dha Pumper⁴³⁵ dhe me informacionin që përmbanin shënimet e marra nga kontaktet me dëshmitarët.

141. *Daniel Moberg*. Moberg, punonjës i sigurisë operative i ZPS-së⁴³⁶, i cili ka marrë pjesë në operacionet për sekuestrimin e paketave me dokumente, dha përgjigje të drejtpërdrejta dhe të qarta gjatë gjithë dëshmisë së tij. Ai ishte gjithashtu i gatshëm të pranonte se njohuritë e tij ishin të kufizuara, gjë që i bëri edhe më të besueshme ato pjesë të dëshmisë së tij për të cilat ai ishte i prerë.⁴³⁷ Mobergu bëri gjithashtu dallimin midis bisedave që kishte kuptuar dhe atyre që nuk i kishte kuptuar në OVL-UÇK,⁴³⁸ duke u kujdesur që të mos e zmadhonte çka dinte për ngjarjet, edhe kur kishte marrë pjesë personalisht në to.

B. DËSHMITË E TË AKUZUARVE

142. Të dy të akuzuarit i përdorën dëshmitë e tyre për të paraqitur programin e tyre

⁴³¹ *P.sh.* Jukić, T.1719-20, 1805.

⁴³² *P.sh.* Jukić, T.1856, 1880.

⁴³³ *Shih* Jukić, T.1784-93, 1813.

⁴³⁴ Jukić, T.1860, 1892.

⁴³⁵ *Shih veçanërisht* Pumper, T.1009-1010, 1012.

⁴³⁶ Moberg, T.1930.

⁴³⁷ Moberg, T.1938-39, 1959.

⁴³⁸ *Shih* Moberg, T.1954.

kundër DHSK-së, nga i cili motivoheshin veprimet e tyre kriminale në këtë çështje.⁴³⁹ Ata ishin vazhdimisht të paqartë në përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve, të prirur për të kaluar në tema politike dhe flisnin për të njëjtat gjëra për të cilat kishin folur në intervistat e dhëna gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat. Të dy u qortuan nga Kryegjykatësi për faktin se nuk po u përgjigjeshin pyetjeve që po u bëheshin.⁴⁴⁰

143. Gjithashtu, të dy të akuzuarit gënjyen haptazi gjatë dhënies së dëshmimeve. Sa për ilustrim, Nasim Haradinaj tha se Ballhazhi nuk ishte e mirëpritur në selinë e OVL-UÇK-së, por atij iu tregua një video ku ai e përqafoi dhe i jep qasje në Paketën 3 për rreth 25 minuta para konferencës së tretë për shtyp.⁴⁴¹ Hysni Gucati u përpoq më kot të shtrembëronte kuptimin themelor të deklaratave të tij të mëhershme, duke mos dashur të pranonte, për shembull, se kishte parë emra të dëshmitarëve shqiptarë në paketa⁴⁴² ose se ai i kishte quajtur ata dëshmitarë 'tradhtarë'.⁴⁴³ Gucati gjithashtu deklaroi se nuk kishte parë asnjë nga letrat përcjellëse lidhur me kërkesat për informacion ose prova në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë,⁴⁴⁴ edhe pse është incizuar në kamera duke marrë këto kërkesa dhe duke iu referuar përmbajtjes së tyre.⁴⁴⁵ Në mënyrë të ngjashme, ai deklaroi se kishte dijeni vetëm për përmbajtjen publike të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë në lidhje me çështjen *Limaj dhe të tjerët*.⁴⁴⁶ Sidoqoftë, ai është incizuar duke përzgjedhur dhe treguar në kamera

⁴³⁹ Gucati, T.2174-75, 2179, 2205, 2412-13, 2428; Haradinaj, T.2709-12, 2715, 2815-16, 2863-65.

⁴⁴⁰ Gucati, T.2221; Haradinaj, T.2823-24, 2867-68.

⁴⁴¹ Haradinaj, T.2747-48, 3006-16; P00163; P00164; P00125, f.14-18.

⁴⁴² Gucati, T.2260-63 (nga 2260-61: 'Pyetje. Më vonë, më pas në të njëjtën intervistë, pyetën, iu referuat intervistave specifike, intervistimeve specifike dhe thatë: "A janë dëshmitarët serbë në këtu dhe aty përmenden?" Dhe ju thatë: "Jo, shqiptarë." A pajtoheni që e keni parë se kishte edhe dëshmitarë shqiptarë pra në paketën e dokumenteve që ndatë në konferencën për shtyp më 7 shtator 2020? Përgjigje. Jo unë nuk e di qysh e kupton ti, "jo shqiptarë". Kam thënë, jo atë ditë s'kam pa ato fletë që e kam pasun në dorë. Është reale që s'kam pa dëshmitarë shqiptarë, kështu kam thënë: "Jo shqiptarë". Kjo është shumë reale.'). Interpretimi i të akuzuarit është i pakuptimtë në kontekstin e pyetjeve dhe përgjigjeve lidhur me intervistë. P00009ET, f.6-7.

⁴⁴³ Gucati, T.2365-67, 2424-26; P00009ET, f.12.

⁴⁴⁴ Gucati, 1D00003ET para.16.

⁴⁴⁵ P00001ET, f.3-4; P00001, min.00:09:09-00:09:20.

⁴⁴⁶ Gucati, 1D00003ET, para.37.

kërkesat konfidenciale gjatë konferencës së dytë për shtyp.⁴⁴⁷

144. Askund tjetër nuk është më e dukshme mungesa e përkushtimit të të akuzuarve ndaj së vërtetës sesa tek këmbëngulja e tyre se nuk kishin publikuar asnjëherë emrat e dëshmitarëve. Si gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat ashtu edhe gjatë dëshmive të tyre, të akuzuarit theksuan se ata nuk kishin përmendur asnjëherë emrat e dëshmitarëve dhe se i kishin udhëzuar mediat të bënin të njëjtën gjë.⁴⁴⁸ Mirëpo të dy pranuan se i lanë emrat pa redaktime në dokumente për çdo përfaqësues të medias që t'i lexonte dhe t'i publikonte sipas dëshirës.⁴⁴⁹ Një sjellje e tillë është një zbulim i qartë i emrave të dëshmitarëve. Të akuzuarit bëjnë sofizma duke u munduar të mohojnë realitetin.

145. Kujdes i veçantë duhet të tregohet sa herë të akuzuarit janë distancuar nga deklaratat e tyre të mëparshme publike gjatë dhënies së dëshmisë. Duke përdorur retrospektivën si të akuzuar në një proces penal, të akuzuarit janë dukshëm të interesuar të mohojnë deklaratat e dhëna në të kaluarën, të cilat janë tejet inkriminuese. Por këto deklarata të mëparshme – të cilat janë bërë publikisht, lirisht, në mënyrë të përsëritur dhe spontanisht – janë dëshmi më të besueshme të synimeve të tyre të vërteta sesa çdo distancim i llogaritur gjatë dhënies së dëshmisë.

⁴⁴⁷ P00002ET, f.1; P00002, min.00:00:01-00:02:31.

⁴⁴⁸ Gucati, T.2175, 2206-07 (ku thuhet se ai dhe Haradinaj nuk zbuluan emrat e 'asnjë shqiptari, asnjë romi, asnjë boshnjaku, asnjë turku që jetojnë në Kosovë', dhe më pas menjëherë nxjerrin identitetin e dy zyrtarëve serbë, që u bë shkak për lëshimin e urdhrave për redaktime dhe duke shkelur udhëzimet e qarta të Kryegjykatësit), 2373-74; P00028ET, f.10-11; P00009ET, f.6-7; P00002ET, f.4.

⁴⁴⁹ Gucati, T.2173 ('Pyetje. Gjatë konferencës, gjatë vetë konferencës, a keni zbuluar dhe a keni shpërndarë informacion konfidencial jopublik? Përgjigje. Nuk e besoj. Janë transkriptimet që mund t'i shohim të gjitha. Njoftimi im ka qenë, që kam njoftu "ka ardh një paketë sot në orën 09:30 afër, apo 09:40 minuta". Kam njoftu që ka ardh një paketë. Në këtë paketë ka dosje të Gjykatës Speciale. Rrjedhja e tyre ne nuk e dimë. Ky ka qenë njoftimi jem, dhe kjo është krejt'.); 2281-83 (nga 2281, dhe pak para se të pranonte deklaratën e tij për media se 70% e dokumenteve të Paketës 2 u mor nga mediat: ('Ne *de facto*, dokumentacione s'kenë shpërnda. Po ne kemi bërë konferencë për media dhe e kemi pasë dokumentacionin në tavolinë. Askujt s'i kemi thënë "mere".), 2373; Haradinaj, T.2945-50 (ku mohon se dokumentet e Paketave u publikuan, pavarësisht se e përdori vetë fjalën në P00030ET, f.7-8); Gucati, 1D00003ET, para.19; Haradinaj, T.2731, 2821, 2830-31, 2965. *Shih gjithashtu* P00004ET, f.3.

146. Nga ana tjetër dhe lidhur me sa më lart, pohimeve pranuese të të akuzuarve kundër interesit të tyre gjatë dhënies së dëshmimeve, duhet t'u jepet rëndësi e qenësishme. Fakti që të akuzuarit inkriminojnë veten gjatë dhënies së dëshmimeve të tyre, pavarësisht se i dinë akuzat e ngritura kundër tyre, sugjeron që ato deklarata pasqyrojnë ndjenjat e tyre të vërteta. Një shembull spikatës është se si të dy të akuzuarit ishin të palëkundur në mungesën e pendimit dhe vendosmërinë e tyre për të nxjerrë më shumë materiale konfidenciale.⁴⁵⁰ Një tjetër është kur Gucati refuzoi të distancohej nga deklaratat e Haradinajt të shtatorit 2020,⁴⁵¹ duke sqaruar me shembuj se ata kishin vepruar bashkërisht gjatë gjithë harkut kohor që përfshijnë akuzat.

C. DËSHMITË E DËSHMITARËVE TË TJERË TË MBROJTJES

147. Dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes së Gucatit – konkretisht të disa punonjësve të OVL-UÇK-së dhe Elmedina Ballhazhit – u karakterizuan nga një njëanshmëri e theksuar pro të akuzuarve. Deklaratat kundër DHSK-së ishin të zakonshme dhe nderimi për të akuzuarit ishte i dukshëm.⁴⁵² Fotografia që dëshmitarët e Mbrojtjes së Gucatit bënë të gjithë së bashku pak para se të hipnin në aeroplan për të ardhur në Hagë, tregon në mënyrë simbolike se si këta persona po vinin të bashkuar për një kauzë të përbashkët.⁴⁵³ Kjo ndikoi në mënyrë të pamohueshme dëshmitë e tyre, siç ndodhi me Çelë Gashin i cili e ndryshoi dukshëm deklaratën e tij të mëparshme për të mbështetur më mirë argumentet e Mbrojtjes.⁴⁵⁴ Duke pasur parasysh anësinë e

⁴⁵⁰ Gucati, T.2218-19, 2221-22, 2401; Haradinaj, T.3021-24.

⁴⁵¹ Gucati, T.2374-78 (NGA 2375-76: 'Pyetje: A ka diçka prej atyre që ka thënë Nasim Haradinaj gjatë tre pres-konferencave dhe paraqitjeve publike të tjera në lidhje me dokumentet që u vunë në dispozicion, u bënë publike nga OVL-UÇK-ja prej të cilave ju vetë do të tërhiqeshit, të cilat ju nuk i përkrahni? Përgjigje: Nuk e besoj se ka, s'kam ndigju diçka se unë do t'i kisha thënë në prezencë Nasimit mas konferencës që ke gabu por jo nuk kam dëgju.').

⁴⁵² Ballhazhi, T.2503 (ku shpjegon pse e quajti Haradinajn 'person me drejtësi të plotfuqishme', 2509; Marashi, T.2533-41; Kryeziu, 1D00008ET, para.15; Cele Gashi, T.2604-06.

⁴⁵³ P00162; P00162ET (nga postimi shoqëruar i Klinakut: 'Në përcjellje të shokëve e shoqeve për në Hagë, në mbrojtje të UÇK-së, OVL-së dhe krerëve të saj'). *Shih gjithashtu* Taibe Miftari, T.2464-67.

⁴⁵⁴ Cele Gashi fillimisht vlerësoi se shqyrtimi kishte zgjatuar 2-3 orë (Cele Gashi, 1D00009ET, para.14), dhe më pas e korrigjoi vlerësimin në 30-40 minuta kur u udhëzua në gjykatë nga mbrojtësi (Cele Gashi, T.2584), duke mos dhënë një shpjegim të besueshëm për këto mospërputhje, dhe arsyen pse nuk e kishte

këtyre dëshmitarëve, dhe njësoj si në rastin e të akuzuarve, çdo deklaratë e bërë nga këta dëshmitarë e cila në fakt inkriminonte të akuzuarit, ishte veçanërisht e besueshme.

148. Në përgjithësi, dëshmitarët e Mbrojtjes së Gucatit nuk dinin asgjë me rëndësi lidhur me akuzat përtej asaj çfarë thanë të akuzuarit. Disa nuk njihnin faktet të cilat ishin vërtetuar qartësisht nga dëshmitë e tjera, si Ballhazhi që dëshmoi se ZPS-ja u takua me të akuzuarit përpara konferencës së dytë për shtyp më 16 shtator 2020⁴⁵⁵ në një kohë që: (i) çdo dëshmitar tjetër dhe formulari i dorëzimit që u nënshkrua për Paketën 2, tregojnë se kjo ndodhi një ditë më pas, më 17 shtator; dhe (ii) vetë Ballhazhi pranoi se konferenca për shtyp që asaj i kujtohej ishte ajo e datës 17 shtator 2020.⁴⁵⁶

149. Sa u përket dëshmitarëve të Mbrojtjes së Haradinajt, ata thjesht nuk dinin asgjë që do të ishte me rëndësi për këtë çështje gjyqësore. Thelbi i dëshmisë së pritur të ish-drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj (DW1246) ishte se ZPS-ja i kishte thënë policisë së Kosovës që të mos hetonte, por kur ai dha dëshminë e tij, u bë menjëherë e qartë se këtë atij ia kishte thënë PSRK-ja dhe se ai nuk kishte folur asnjëherë me ZPS-në.⁴⁵⁷ Ana Majers (Anna Myers) (DW1252) ishte një eksperte në

korrigjuar deklaratën e tij kur i ishte dhënë mundësia për ta bërë këtë (Cele Gashi, T.2591-2597, 2603-2604, 2606-2607). Në mënyrë të ngjashme, Çelë Gashi fillimisht vlerësoi se shqyrtimi i dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë kishte zgjatur deri në katër orë (Cele Gashi, 1D00009ET, para.28), e më pas e ndryshoi vlerësimin në 10-20 minuta kur u mor në pyetje nga Mbrojtja (Cele Gashi, T.2588-2589); gjatë marrjes në pyetje nga pala kundërshtare, ai fillimisht deklaroi se i kishte shqyrtuar dokumentet për 1,5 orë (Cele Gashi, T.2596) dhe më pas e korrigjoi vlerësimin e tij në 20-30 minuta (D1245, T.2598), duke mos dhënë një shpjegim të besueshëm për këto mospërputhje, dhe arsyen pse nuk e kishte korrigjuar deklaratën e tij kur i ishte dhënë mundësia për ta bërë këtë (D1245, T.2591-2597). Në një dalje publike më 16 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerët i kishin shqyrtuar dokumentet për rreth tre orë, P00018ET, f.3-4; P00018, min.25:32-26:20.

⁴⁵⁵ Ballhazhi, T.2493-95, 2512.

⁴⁵⁶ Ballhazhi, T.2500-03.

⁴⁵⁷ Qalaj, T.3062-63, 3067-68, 3071-72 (nga 3071: 'Pyetje. Pra, për ta përmbledhur në pika të shkurtra, a është e saktë se asnjëherë nuk keni marrë udhëzim prej vetë ZPS-së që të mos hetoni rastin në lidhje me dorëzimin e dokumenteve në zyrat e OVL-UÇK-së? Përgjigje. Po, dhe po e them prapë. Në asnjë moment, asnjëherë, nuk kemi marrë asnjë kërkesë nga Zyra e Prokurorisë së Specializuar këtu në Hagë që të hetojmë apo mos të hetojmë këtë rast').

lidhje me sinjalizuesit e cila, siç e pranoi dhe vetë, nuk ishte e informuar për dispozitat ligjore të zbatueshme në këtë çështje dhe nuk solli ndonjë rast nga jurisprudenca që të mbështeste interpretimin e saj tepër të gjerë të sinjalizimit.⁴⁵⁸ Ajo ishte e rezervuar për të klasifikuar çdo nxjerrje publike të dokumenteve si të pambrojtur, edhe kur iu paraqit në mënyrë të supozuar rasti i një personi që nxjerr emrat e dëshmitarëve të mbrojtur në një çështje penale.⁴⁵⁹

150. Mendimi i përgjithshëm i ekspertit hetimor të Mbrojtjes së Haradinajt, Robert Rid (Robert Reid) (DW1253) se hetimi i ZPS-së nuk ishte bërë në përputhje me 'praktikat më të mira', është thellësisht po aq i gabuar.⁴⁶⁰ Ridit nuk iu dha informacioni i nevojshëm për të vlerësuar siç duhej hetimin e ZPS-së.⁴⁶¹ Madje ai as nuk e shqyrtoi me kujdes informacionin që mori, pasi:

- i. pretendoi gabimisht se ZPS-ja nuk kishte kryer një krahasim faqe për faqe të dokumenteve të Paketave 1 dhe 4;⁴⁶²
- ii. nuk kishte dijeni se dokumentet e sekuestruara nuk kishin numra të regjistrimit të provës (NRP);⁴⁶³
- iii. pati vështirësi të kujtonte llojin e dokumenteve që përmbante Paketa 3, gjë që ndikoi në rekomandimin e tij mbi dobishmërinë ose jo të verifikimit të tyre në bazën e të dhënave të provave Zylab;⁴⁶⁴ dhe
- iv. nuk iu kujtua se ZPS-ja në fakt arriti të izolonte një version të Paketës 3 në bazën e saj të dhënave të brendshme (çka përfundimisht konfirmoi se metoda e zgjedhur ishte efektive për të verifikuar vërtetësinë e

⁴⁵⁸ Myers, T.3149-52, 3169-70, 3175-77.

⁴⁵⁹ Myers, T.3181-83.

⁴⁶⁰ Reid, T.3257-58.

⁴⁶¹ *Shih* Kërkesë e Redaktuar Publike për Autorizimin e Nxjerrjes Paraprake të Dokumenteve për Dëshmitarin Ekspert Rid, KSC-BC-2020-07/F00524/RED, 18 janar 2022 (versioni i redaktuar publik u vu në dispozicion më 25 janar 2022), para. 23, 26; Rid, T.3350-52 (nga 3352: 'Pyetje. Pra, kur ju keni hartuar raportin tuaj të ekspertit, ju nuk keni pasur të gjithë informacionin e nevojshëm për të vërtetuar n.q.s. të gjitha procedurat e ZPS-së janë respektuar apo jo? Përgjigje. Unë thashë që çfarëdo dokumentesh kam pasur në dispozicion. Nuk kam pasur as deklaratat e hetuesve të procedurës').

⁴⁶² Rid, T.3259-63; Pumper, T.893.

⁴⁶³ Rid, T.3264-66; Pumper, T.1476-77.

⁴⁶⁴ Rid, T.3268-73.

dokumentit).⁴⁶⁵

151. Rid gjithashtu shpërfilli aspekte të rëndësishme kontekstuale, siç është fakti që verifikimi i faqeve konkrete të një dokumenti konfidencial nuk është i nevojshëm nëse të gjitha dokumentet e atij hetimi janë klasifikuar si konfidenciale.⁴⁶⁶ Dëshmia e Ridit nuk hedh asnjë dyshim mbi provat e ofruara nga ZPS-ja në këtë çështje gjyqësore, duke përfshirë ato lidhur me vërtetësinë e materialeve të sekuestruara, të vërtetuar qartë nga një sërë burimesh, siç parashtrohet hollësisht më poshtë. Në përgjithësi, vlerësimi i Ridit për hetimin e ZPS-së bazohet në asgjë më shumë se në një hamendje të pambështetur në informacion.

152. Gjithashtu, vëmë në dukje se Ridi nuk ishte në gjendje të kujtonte me saktësi detajet e operacioneve të tij të mëparshme të verifikimit në TPNJ, pavarësisht se u mbështet në to si udhërrëfyes për të mbështetur vlerësimet e tij.⁴⁶⁷ Pas një shqyrtimi më të imët, rezultoi se këto verifikime nuk ishin në përputhje me modelet procedurale që ai pretendonte se ishin.

153. Në të njëjtën kohë, përvojat e përgjithshme hetimore të Ridit në TPNJ i dhanë atij një bazë të mjaftueshme për të folur për vështirësitë e përgjithshme të hetimit në Kosovë. Kjo dëshmi ishte e besueshme dhe përputhej me dëshmitë e tjera në këtë çështje.

D. AUTENTICITETI I PAKETAVE

154. Autenticiteti i paketave është i padiskutueshëm. Kjo është e vërtetë si në rastin kur me 'autenticitet' kuptohet nëse dokumentet i përkisnin TFHS/ZPS-së (ose kishin lidhje me hetimet e TFHS/ZPS-së), ashtu si edhe nëse ka prova të mjaftueshme që Paketat për të cilat u diskutua gjatë gjykimit janë Paketat e sekuestruara. Në kuptimin

⁴⁶⁵ Rid, T.3273-77; Pumper, T.951-52.

⁴⁶⁶ Rid, T.3283.

⁴⁶⁷ Rid, T.3318-22, 3332-33.

e parë të autenticitetit, Pumperi verifikoi përputhshmërinë e dokumenteve të Paketave me informacionin në bazën e të dhënave të brendshme të ZPS-së.⁴⁶⁸ Në kuptimin e dytë të autenticitetit, Pumperi shqyrtoi dokumentacionin zyrtar të sekuestrimit të tyre, i cili përfshinte informacion mbi qeset përkatëse të provave dhe numrat e regjistrimit të provave (ERN) të caktuara, për të konfirmuar se dokumentet që ajo shqyrtoi ishin në fakt materialet e sekuestruara.⁴⁶⁹ Më tej, siç paraqitet më hollësisht më poshtë, përshkrimet e paketave të bëra nga të akuzuarit dhe mediat përputhen plotësisht me paketat e sekuestruara dhe të shqyrtuara nga Pumperi.

1. Paketa 1

155. Të akuzuarit treguan dhe përshkruan përmbajtjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë në konferencën e parë për shtyp⁴⁷⁰ dhe pranuan se në kohën kur u mbajt ajo konferencë për shtyp, besonin se dokumentet ishin autentike.⁴⁷¹ Në përputhje me përshkrimin që ata bënë, Paketa 1 përfshinte kërkesa konfidenciale për ndihmë drejtuar autoriteteve serbe, shumica e të cilave përmbanin emra dhe të dhëna personale të dëshmitarëve me ndonjë deklaratë të mëparshme.⁴⁷² Dokumentet serbe të përfshira në Paketë u referoheshin kërkesave të TFHS-së dhe/ose dëshmitarët e TFHS/ZPS-së të përmendur në kërkesa.⁴⁷³ Mobergu i mori këto materiale, të cilat më pas u transportuan në mënyrë të sigurt në Hagë.⁴⁷⁴ Pumperi dorëzoi një analizë faqe

⁴⁶⁸ Pumper, T.866-69, 876-79. Pumperi kontrolloi përputhshmërinë e çdo kërkesë në Paketën 1 me bazën e të dhënave të brendshme të ZPS-së, por jo çdo dokument në atë paketë (Pumper, T.1069). Kjo nuk ishte as e nevojshme të bëhej në mënyrë që Pumperi të vlerësonte treguesit e konfidencialitetit ose emrat e dëshmitarëve të mundshëm mbi bazën e dokumenteve të përfshira në deklaratat e saj P00090 dhe P00091.

⁴⁶⁹ Pumper, T.854, 891-93, 905-09, 914, 921-22.

⁴⁷⁰ P00001, min.00:15:53-00:16:07; P00001ET, f.2, 4-5.

⁴⁷¹ Gucati, T.2415-16 (pyetje nga gjykatësi Metro: 'Po a do të ishte e saktë të prezumohej që në kohën kur po zhvillohej konferenca, ju besonit se këto dokumente ishin origjinale? A është kështu? Përgjigje. Po. Bazuar në stemën e Gjykatës dhe emrat që ne pamë aty, ne besuam se ato mund të jenë edhe të Gjykatës Speciale').

⁴⁷² Pumper, T.860-67; P00086, para. 7-9; P00088.

⁴⁷³ Pumper, T.885-887; P00090, Shtojca 1. *Shih gjithashtu*, Pumper, T.886-887.

⁴⁷⁴ Moberg, T.1930-37, 1940-41, 1958; P00092; P00138; P00056; P00057.

për faqe të tyre, duke përshkruar përmbajtjen e tyre në përputhje me kriteret kompensuese të mosnxjerrjes të përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴⁷⁵ Pumperi qe gjithashtu në gjendje të verifikonte përputhshmërinë e kërkesave për koordinim në këtë paketë me dokumentet në bazën e të dhënave të brendshme të ZPS-së.⁴⁷⁶

156. Faqet e Paketës 1 që mori media u publikuan në artikuj më 7 shtator 2020 ose rreth kësaj date.⁴⁷⁷ Gazetarët, ndër të cilët edhe Berisha, i drejtuan pyetje ZPS-së rreth materialeve që OVL-UÇK-ja u kishte vënë në dispozicion në këtë datë.⁴⁷⁸ Faqet e Paketës 1 në ata artikuj përputhen me përshkrimet e të akuzuarve, dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes, dhe Pumperit.⁴⁷⁹ Mobergu mori Paketën 4 nga Berisha, e cila më pas u transportua në mënyrë të sigurt në Hagë.⁴⁸⁰

157. Gjithashtu, Berisha mori edhe një kopje të plotë të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë nga OVL-UÇK-ja – që në këtë çështje njihet si Paketa 4 – dhe përshkroi të njëjtën përmbajtje si ajo që shfaqej në Paketën 1.⁴⁸¹ Pumperi gjithashtu konfirmon se Paketa 4 ka pothuajse një përputhje të plotë me Paketën 1.⁴⁸²

158. Faqet e Paketës 1 të paraqitura për pranim përmes Pumperit, përputhen plotësisht me përshkrimin e të gjitha provave të tjera të paraqitura.⁴⁸³

2. Paketa 2

159. Të akuzuarit përshkruan përmbajtjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së

⁴⁷⁵ Pumper, T.869-72, 1084-85; P00090. *Shih gjithashtu* P00086, para.7.

⁴⁷⁶ Pumper, T.866-69, 876-79; P00093; P00094; P00095; P00096; P00097.

⁴⁷⁷ Berisha, 1539-41, 1559-73; Pumper, T.903-04, 989-94, 1001-04; P00123; P00124; P00128; P00129. *Shih gjithashtu* P00092, para.7.

⁴⁷⁸ Berisha, T.1524, 1526; P00089, para. 14-20; P00098; P00101; P00102.

⁴⁷⁹ P00086, para. 13-18.

⁴⁸⁰ Berisha, T.1535-36; P00099; P00100.

⁴⁸¹ Berisha, T.1519-26, 1566-67, 1571-73, 1601-09. *Shih gjithashtu* P00092, para.7; P00129.

⁴⁸² Pumper, T.893-95; P00091; P00089, para. 5-13.

⁴⁸³ P00093; P00094; P00095; P00096; P00097.

dytë gjatë dhe pas konferencës së dytë për shtyp, duke vënë në dukje se mes tyre kishte disa materiale si ato që ishin nxjerrë gjatë herës së parë si dhe dokumente të tjera nga aktvendime të vjetra gjyqësore.⁴⁸⁴ Megjithëse 70% e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë ishin shpërndarë përpara mbërritjes së ZPS-së,⁴⁸⁵ Paketa 2 u mor më 17 shtator 2020 dhe një formular dorëzimi i nënshkruar nga Hysni Gucati vërteton sekuestrimin e saj.⁴⁸⁶

160. Pumperi bëri të njëjtin përshkrim të Paketës 2 si dhe të akuzuarit. Ajo konfirmoi se Paketa 2 përbëhej nga materiale gjyqësore publike, përveç gjashtë faqeve të letërkëmbimit konfidencial me Serbinë që gjenden edhe në Paketën 1.⁴⁸⁷

161. Të gjithë dokumentet e Paketës 2 u paraqitën për t'u pranuar si prova gjatë gjykimit, me redaktime që u zbatuan në gjashtë faqet e Paketës 1.⁴⁸⁸ Kjo dëshmi përputhet me përshkrimin e bërë nga të akuzuarit dhe dëshmitarët të cilët dëshmuan në këtë çështje gjyqësore. Në veçanti, Paketa 2 përputhet me analizën faqe për faqe të përmbajtjes së Paketës 2 të bërë nga Pumperi, duke forcuar besueshmërinë e analizave të ngjashme të saj të Paketave 1, 3 dhe 4.⁴⁸⁹

3. Paketa 3

162. Të akuzuarit e përshkruan Paketën 3 si 'draft-aktakuzë' kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Azem Sylës.⁴⁹⁰ Megjithëse ajo, në vetvete, ishte vetëm një përshkrim i ZPS-së për vendet e ndalimit⁴⁹¹ dhe jo një projekt-aktakuzë, një memorandum i brendshëm i ZPS-së ku tregoheshin këto vende dhe

⁴⁸⁴ P00002ET, f.1; Gucati, T.2273; P00017ET, f.4.

⁴⁸⁵ Gucati, T.2282-83; P00004ET, f.3.

⁴⁸⁶ Gucati, T.2193-94; P00055.

⁴⁸⁷ Pumper, T.914-15, 994-95; P00086, para. 19-27. *Shih gjithashtu* P00125, f.081371-081373.

⁴⁸⁸ P00104 (veçanërisht f.080126-31). *Shih gjithashtu* Pumper, T.913.

⁴⁸⁹ P00090, Shtojca 3.

⁴⁹⁰ P00035, f.2, 5; Gucati, T.2297.

⁴⁹¹ Pumper, T.926.

emrat e dëshmitarëve u publikua nga media të ndryshme në datën e mbajtjes së konferencës së tretë për shtyp ose rreth asaj date.⁴⁹²

163. Në faqet e dokumenteve të kësaj pakete shfaqen vula të qarta dhe tregues se ato përbënin materiale të brendshme pune të ZPS-së, ku në fund të shumicës së faqeve është fjala 'Konfidencial' dhe në krye të tyre stema e ZPS-së dhe fjalët 'KONFIDENCIAL, material i brendshëm pune, përshkrimi i lidhjes me NKP-në, dhjetor 2019'.⁴⁹³

164. Si dhe në rastin e paketave të tjera, Pumperi bëri një përshkrim të hollësishëm të përmbajtjes së Paketës 3 dhe konfirmoi se faqet e publikuara në media përfshiheshin në paketën e marrë nga ZPS-ja.⁴⁹⁴ [REDAKTUAR].⁴⁹⁵

165. Faqet e Paketës 3 që u paraqitën për t'u pranuar si prova përputhen gjithashtu me përshkrimet e bëra nga të akuzuarit, Pumperi dhe me faqet e publikuara në media.⁴⁹⁶ Theksimi prej Mbrojtjes i dallimeve dytësore lidhur me shenjat e mbërthimit bashkë të dokumenteve, nënvizimin, kopjimin dhe vijat e zeza ndërmjet faqeve në dokumentet e publikuara nga media krahasuar me ato të Paketës 3, thjesht i shmanget të vërtetës thelbësore se përmbajtja e dokumenteve është saktësisht e njëjtë.⁴⁹⁷ Në këtë aspekt vihet në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë përbëheshin nga (të paktën) tri kopje të të njëjtit dokument,⁴⁹⁸ nga të cilat ZPS-ja mori vetëm dy kopje të pjesshme.⁴⁹⁹ Logjikisht, vetëm ZPS-ja mund të kishte krijuar dokumente të tilla me treguesit se ishin materiale të brendshme pune dhe atë nivel hollësish që jepen në ato

⁴⁹² P00120ET; P00121ET; P00122ET; P00125ET.4; P00155ET; P00156ET; P00157ET; P00159ET; P00160ET.

⁴⁹³ Pumper, T.929; P00086, para.35; P00090, Shtojca 5.

⁴⁹⁴ Pumper, T.926-32, 940-46, 973-84; P00157; P00158; P00159; P00120; P00121; P00122; P00086, para. 28-74.

⁴⁹⁵ [REDAKTUAR].

⁴⁹⁶ P00106; P00107; P00108; P00109; P00110; P00111; P00112; P00113; P00114; P00115; P00116; P00117; P00118; P00119.

⁴⁹⁷ Pumper, T.1354-77.

⁴⁹⁸ *Shih* Haradinaj, 2D00001ET, para.104, 111.

⁴⁹⁹ Pumper, T.951; P00086, para.29.

faqe.

E. PËR SHPALLJEN E FAJËSISË NË MËNYRË TË DREJTË NUK ËSHTË E NEVOJSHME NXJERRJA E TË GJITHË DOKUMENTEVE TË PAKETAVE

166. Kjo çështje gjyqësore bazohet në marrjen dhe nxjerrjen e paligjshme nga të akuzuarit të informacionit të ndjeshëm që ata nuk ishin të autorizuar ta kishin. Dhënia e një informacioni të tillë të akuzuarve në kontekstin e këtij procesi sjell gjithmonë rrezikun e ndërmarrjes së veprimeve si ato përmes të cilave të akuzuarit kryen veprat penale të përfshira në Aktakuzë. Kjo është arsyeja pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi mosnxjerrjen e dokumenteve të paketave, varësisht prej masave kompensuese për të siguruar drejtësinë e procesit.⁵⁰⁰ Mbrojtja nuk kërkoi asnjëherë leje për apelimin e këtij vendimi. Më të spikaturat ndër masat kompensuese kundërmasa janë përshkrimet tabelore të paketave të përgatitura nga Pumperi, të cilat janë pranuar si prova nga Trupi Gjyqësues.⁵⁰¹

167. Këto masa kompensuese kanë qenë efektive dhe kanë siguruar drejtësinë e procesit. Mbrojtjes i është dhënë një mundësi e drejtë për të kundërshtuar provat e paraqitura, sidomos duke marrë në pyetje Pumperin dhe shqyrtuar dokumentet e paketave të paraqitura për t'u pranuar si prova. Pas nxjerrjes së fundit të materialeve në këtë çështje sipas rregullës 102(3), Trupi Gjyqësues madje lejoi që Pumperi dhe Jukiqi të rithirreshin, në mënyrë që Mbrojtjes t'i jepej mundësia të trajtonte të gjitha aspektet lidhur me dorëzimin e paketave të cilat i gjykonte të nevojshme.⁵⁰²

168. Me gjithë protestat për të kundërtën përpara fillimit të gjykimit, në përfundim

⁵⁰⁰ Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve të Sekuestruara nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, KSC-BC-2020-07/F00141/RED, 23 shkurt 2021 (versioni i redaktuar publik doli më 15 korrik 2021), para. 39, 45; Version me më Pak Redaktime i Vendimit për Mosnxjerrjen e Informacionit të Kërkuar nga Mbrojtja, KSC-BC-2020-07/F00171/CONF/RED2, 1 prill 2021, konfidencial (versioni me më pak redaktime u vu në dispozicion më 22 qershor 2021).

⁵⁰¹ P00090; P00091.

⁵⁰² Pumper, T.2622-26; Jukić, T.2627-35.

të tij duket se nuk ka as shumë kundërshtime lidhur me autenticitetin e dokumenteve të paketave. Këmbëngulja e Mbrojtjes se të akuzuarit kishin vepruar si sinjalizues në 'interes publik', nënkupton si pikënisje se ata besonin se po shpërndanin informacion të besueshëm,⁵⁰³ që në këtë rast ishin dokumentet në fjalë që kishin të bënin me hetimet e TFHS/ZPS-së. Të akuzuarit pranuan publikisht gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat se paketat ishin autentike,⁵⁰⁴ duke ruajtur kopje që t'i merrte ZPS-ja në mënyrë që të merrnin konfirmimin se informacioni ishte i vërtetë.⁵⁰⁵

169. Akuzat penale mund të provohen në mënyra të ndryshme. ZPS-ja nuk kishte detyrimin të nxirrte të gjitha dokumentet e paketave për të provuar çfarë kishin bërë të akuzuarit me to, në mënyrë të paligjshme. Ekziston një numër shumë i madh provash se të akuzuarit kishin dijeni të plotë për çka përmbanin paketat dhe për autenticitetin e dokumenteve, dhe asnjë argument logjik nuk mund të jepet se Mbrojtja u pengua të kundërshtonte provat për shkak të urdhrave për mosnxjerrjen e materialeve të lëshuara në këtë çështje.

F. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE

1. Të akuzuarit bënë kërcënime të rënda të cilat penguan personat zyrtarë të DHSK/ZPS-së

170. Të akuzuarit ishin plotësisht të vetëdijshëm se Paketat përmbanin informacion

⁵⁰³ Kjo pranohet në përkufizimin e dhënë nga vetë eksperti i Mbrojtjes së Haradinajt. Myers, T.3112 (që e përkufizoi sinjalizuesin si 'një person i cili jep një informacion që ai ose ajo, në kohën kur e nxjerr atë, ka arsye të besojë se është i vërtetë [...]'), 3130-32, 3180; Myers, 2D00006, para.34. *Shih gjithashtu Guja*, 14277/04, para.75; ECtHR, *Heinisch*, 28274/08, para.80. Majers në fakt e citoi gabim përkufizimin e raportuesit të posaçëm nga i cili nxori përkufizimin e saj (Myers, T.3140-41), por e citoi saktë atë në lidhje me vërtetësinë e informacionit në fjalë.

⁵⁰⁴ P00021ET, f.4 (Haradinaj: 'për sa kemi pa na, është material taman'); P00011ET, f.47; P00019ET, f.2.

⁵⁰⁵ P00002ET, f.9 (Haradinaj: 'Le të vinë le t'i marrin materialet qysh janë [...] se për vërtetësi i duam'); P00035ET, f.7 ('GAZETARI: A do t'ia dorëzoni këto dosje hetuesve nëse vine me i marrë prapë? Z. Haradinaj: Ne dojm me ua ruajt, veç me konfirmu saktësinë sikur e kanë konfirmu për ato të dyja. Që mos me mujt me spekul, jo janë, jo s'janë'). Haradinaj u mundua të distancohej nga këto fjalë të fundit të cituara. Haradinaj, T.2753-54, 2812-13, 2954-57.

konfidencial në lidhje me hetimet e DHSK/ZPS-së. Ata ia bënë të njohura paketat medias në një përpjekje për të nxjerrë në shesh sekretet e DHSK/ZPS-së.⁵⁰⁶ Këto nxjerrje të dokumenteve, së bashku me deklaratat e tyre publike, shtjellohen në vijimësi më poshtë, në nënpjesën që ka lidhje me frikësimin. Siç është konfirmuar nga dëshmitari Rid, rrjedhja e informacionit në lidhje me dëshmitarët në Kosovë do ta bënte shumë të vështirë përmbushjen e mandatit të prokurorit:

Rrjedhja e informacionit është e dëmshme për çështjen e prokurorisë. Rrjedhja e informacionit të dëshmitarit është dyfish e dëmshme, pasi jo vetëm që ndikon në potencialin e çështjes suaj, por ndikon edhe në psikologjinë e një dëshmitari të caktuar. Dhe nëse kjo zbulohet – nëse komuniteti ku jeton dëshmitari mëson për këtë gjë, kjo ndikon edhe tek dëshmitarët e tjerë.

Pra, kuptohet, nëse dhjetë dëshmitarë të tjerë e marrin vesh këtë gjë, kjo ka një ndikim të madh në çështje. Shqetësimi nuk është vetëm për një dëshmitar. Nëse informacioni rrjedh dhe bëhet i njohur publikisht, atëherë janë dhjetë deri, të themi, 15 deri 20 dëshmitarë mbi të cilët ndikon kjo gjë.⁵⁰⁷

171. Dëshmitarët janë pjesë thelbësore e çdo hetimi penal.⁵⁰⁸ Siç shtjellohet më tej në pjesët që kanë lidhje me veprën e frikësimit të kësaj dosjeje, dëshmitarët u frikësuan pas nxjerrjes së paketave⁵⁰⁹ dhe, kur u thirrën nga ZPS-ja, ishin shumë të shqetësuar.⁵¹⁰ Disa madje thanë ‘mos më kontaktoni më’.⁵¹¹

172. Sjellja e të akuzuarve përmbush kriteret e kërcënimeve të rënda në kuptim të nenit 401 të KPK-së. Kërcënimet e rënda në fjalë nuk është nevoja të jenë kërcënime

⁵⁰⁶ P00017ET, p.6 (‘ndonjë sekret, d.m.th. që a mbetet pa dalë, s’ka mbetet’).

⁵⁰⁷ Reid, T.3360-61.

⁵⁰⁸ Jukić, T.1702 (‘për zyrën tonë të mbrojtjes së dëshmitarëve, siguria e dëshmitarëve është prioriteti kryesor. Ne e dimë nga përvoja se pa dëshmitarë nuk mund të kesh një çështje gjyqësore’); Gucati, T.2374.

⁵⁰⁹ Jukić, T.1693, 1703; Pumper, T.1012 (‘Pyetje. Hetuese, ju lutem, a mund të na thoni se çfarë ju thanë dëshmitarët që ju keni kontaktuar? Përgjigje. N.q.s mund ta përsëris. Një dëshmitar konkretisht ishte shumë i trembur dhe dëshmitari shpjegoi se ishte djegur, në kuptimin që identiteti i tij ishte bërë i njohur nëpërmjet nxjerrjes së dokumenteve. Ai më kërkoi që të kthehesha në gjykatë dhe t’iu lutesha atyre që atë të mos e thërrisnin si dëshmitar sepse ai kishte frikë për jetën e tij dhe të familjes së tij. Dhe ai arriti deri në atë shkallë sa më kërkoi nëse thjesht mund t’i thosha gjykatës se nuk kisha mundur ta gjeja atë.’).

⁵¹⁰ Jukić, T.1703.

⁵¹¹ Jukić, T.1703.

për përdorim force.⁵¹² Kërcënimet e rënda gjithashtu nuk është nevoja të bëhen ndaj vetë personave zyrtarë – ato mund të bëhen ndaj personave të tjerë apo edhe objekteve të cilat kanë fuqinë të pengojnë ose të tentojnë të pengojnë personin zyrtar.⁵¹³

173. Nxjerrja e dokumenteve të paketave e detyroi ZPS-në të përqendronte kapacitetet e veta për t'i kontaktuar dhe mbrojtur ata.⁵¹⁴ Sipas fjalëve të Jukiqit, pas konferencës së tretë për shtyp kontaktimi i dëshmitarëve të prekur u bë 'prioriteti më kryesor i zyrës sonë'⁵¹⁵ dhe ai nuk u mor me asnjë punë tjetër të planifikuar gjatë kësaj periudhe.⁵¹⁶ ZPS-së iu desh t'u sigurote dëshmitarëve numra të rinj telefoni ose pajisje të reja telefonike për komunikim të sigurt.⁵¹⁷ U desh të përgatiten plane të menaxhimit të rrezikut në raste urgjencash.⁵¹⁸ Për njëzet deri në tridhjetë dëshmitarë u morën masa sigurie ose mbrojtëse për t'i ndihmuar ata pas veprimeve të të akuzuarve.⁵¹⁹ Dy dëshmitarë u zhvendosën jashtë Kosovës, një masë që përdoret si mjet i fundit në përpjekjet e ZPS-së për të mbrojtur dëshmitarët përballë një niveli të lartë kërcënimi.⁵²⁰

174. Hetimi në Kosovë është padyshim thelbësor për përmbushjen e mandatit të ZPS-së,⁵²¹ dhe veprimet e të akuzuarve rrezikuan së tepërmi aftësinë e ZPS-së për ta bërë këtë.

⁵¹² Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para.8.

⁵¹³ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.68; Salihu dhe të tjerët, Komentari mbi Kodin Penal të Republikës së Kosovës ('Komentari i Salihut'), f.1165-66 ('kanosja duhet t'i drejtohet personit zyrtar me qëllim të pengimit të veprimeve zyrtare, po ajo mund t'i drejtohet edhe ndonjë personi tjetër apo ndaj një sendi.').

⁵¹⁴ Jukić, T.1694, 1698, 1761 ('ne bëjmë rreth 200 telefonata'), 1907; Pumper, T.1009-10.

⁵¹⁵ Jukić, T.1700.

⁵¹⁶ Jukić, T.1701, 1837. Kontaktimi i dëshmitarëve përfundoi në mesin e dhjetorit 2020. Jukić, T.1832.

⁵¹⁷ Jukić, T.1707-08.

⁵¹⁸ Jukić, T.1707-08, 1760-63.

⁵¹⁹ Jukić, T.1763.

⁵²⁰ Jukić, T.1707-09, 1760-61, 1888-93, 1901-02 (ku nuk tregohet asnjë mospërputhje ndërmjet shënimit përgatitor të dëshmitarit dhe dëshmisë së dëshmitarit për këtë pikë), 1905-06.

⁵²¹ *Shih në përgjithësi* Neni 35; Kapitulli 3 i Rregullores.

2. Të akuzuarit synonin të pengonin DHSK/ZPS-në në kryerjen e detyrave zyrtare

(a) Të akuzuarit kundërshtonin mandatin e DHSK/ZPS-së

175. Të akuzuarit kanë shprehur qartë se ata janë kundër mandatit të DHSK/ZPS-së.⁵²² DHSK-ja është 'njëetnike' dhe 'raciste'.⁵²³ Ajo bën 'drejtësi selektive' sepse nuk ndjek penalisht krimet serbe gjatë luftës së Kosovës.⁵²⁴ Ajo mbështetet nga çdo 'tradhtar' dhe 'spiun'.⁵²⁵ Ajo thërret dëshmitarë që janë 'bashkëpunëtorë' të armikut,⁵²⁶ duke 'kriminalizue Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës'.⁵²⁷ Drejtësia e saj është 'marrë nga aparati i Millosheviqit'.⁵²⁸

176. Nuk qëndron dëshmia se të akuzuarit nuk donin të shfuqizonin DHSK-në, por vetëm ta ndryshonin atë.⁵²⁹ Të akuzuarit konfirmuan se ata mbështesnin shfuqizimin e DHSK-së, nëse ajo nuk mund të ndryshohej,⁵³⁰ ndërsa pranuan se përpjekjet e tyre për ta ndryshuar këtë institucion nuk kishin dhënë rezultat.⁵³¹ Gjithashtu, të akuzuarit

⁵²² Gucati, T.2263-64; Gucati, 1D00003ET, para.67; P00021ET, f.3-5; P00004ET, f.8; P00002ET, f.3, 6-7; P00007ET, f.2-3; P00028ET, f.8-9; P00049ET, f.13-14; P00039ET, f.2; P00038ET, f.2.

⁵²³ Haradinaj, T.2714, 2735; P00030ET, f.15; P00021ET, f.4; P00018ET, f.2.

⁵²⁴ Gucati, 1D00003ET, para.58; Haradinaj, 2D00001ET, para. 18, 22, 30.

⁵²⁵ P00037ET, f.5 (...dhe çdo anti-UÇK dhe çdo bashkëpunëtor dhe çdo kuisling dhe çdo tradhtar e spiun dhe çdo rob spiuni ka me qenë pro kësaj gjykate, në këtë kuptim, të kësaj gjykate të ktij lloji po flas. Ndërsa ne e kemi thënë haptazi'); Haradinaj, T.2885-89.

⁵²⁶ P00040, f.2; P00083ET, f.59-62. *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2749 ('Ti akuzosh që "ti je bashkëpunëtor i shërbimit serb", unë mendoj nuk ka fyerje më të rëndë'), T.2890-93.

⁵²⁷ Haradinaj, T.2714.

⁵²⁸ P00018ET, f.5-6; P00019ET, f.4; Haradinaj, T.2874-79.

⁵²⁹ Haradinaj, T.2716, 2858-63; Haradinaj, 2D00001ET, para.17. Në lidhje me këtë pikë, deklarata me shkrim e Haradinajt ka madje mospërputhje të brendshme. *Krahaso* Haradinaj, 2D00001ET, para.17 ('duhet të qartësoj që ne nuk po kërkonim shfuqizimin apo mbylljen e DHSK-së') me para.37 ('synimi ynë ka qenë të përpiqemi të ndryshojmë ligjet ekzistuese që kanë të bëjnë me DHS/ZPS ose ta shfuqizojmë atë').

⁵³⁰ Haradinaj, T.2861 ('po të ishin në dorën time të kisha shfuqizu njëqind herë me ket lloj drejtimi që ke ti. Dhe po të them edhe sot po nuk ka qen n'mandatin tim prandaj më asht dasht mu me mbledh asi, me mbledh deputetë, me mbledh nënshkrime. Po të ishte ti në mandatin tim pikërisht për hir të drejtësisë të njëanshme që je ka bën, sot do të kisha shfuqizu në ket formë.');

⁵³¹ Gucati, 1D00003ET, para.67; Haradinaj, T.2715-17 (nga 2716: 'Qeveria e Kosovës i shtini vesht në lesh').

nuk do të pranoin bashkëpunimin me Serbinë, nëse Serbia nuk do të ishte krejtësisht e ndryshme nga ajo që është sot.⁵³²

177. Të akuzuarit nuk mund ta fshehin përbuzjen e tyre për institucionin.⁵³³ Gatishmëria e tyre për të pranuar se kundër UÇK-së mund të bëheshin akuza për krime lufte, ishte e pasinqertë,⁵³⁴ duke pasur parasysh përgjigjet e tyre të mjegullta kur u vunë përballë deklaratave të tyre publike të bëra në të kaluarën se UÇK-ja nuk kishte apo nuk mund të kishte kryer krime.⁵³⁵

178. Kur mjetet ligjore për të ndryshuar institucionin dështuan dhe paketat ofruan një mundësi 'ëndrre',⁵³⁶ të akuzuarit vendosën të vepronin me iniciativën e tyre për të

⁵³² Haradinaj, T.2988-89; Haradinaj, 2D00001ET, para.32; Gucati, 1D00003ET, para.68 ('Unë e kundërshtoj që DHSK/ZPS-ja bashkëpunon me serbët').

⁵³³ Haradinaj, T.2876-77 ('Pyetje. Pyetja ime është, a do ta pengoni drejtësinë e DHSK-së gjatë gjithë jetës suaj? A është "po" përgjigja për këtë pyetje? Përgjigje. Nëse ju punoni me të dhënat e Millosheviqit, po. Po, po. Pyetje. Dhe kjo është ajo që ju besoni, apo jo? Përgjigje. Kështu po reflektoni, dhe ma keni kriju bindjen, ju, sjelljet e juve. Dhe jo vetëm mu. Nuk po du me e zgjanu mendimin për me e zbutë, po qoftë edhe vetëm mu.'). P00029ET, f.1; P00039ET, f.4; P00028ET, f.11; P00083ET, f.SPOE00222243 ('/koment në Facebook/ Nasim Haradinaj 'Specialja duhet të bie!! Dhe do bie!!!'). *Shih gjithashtu* Paraqitja e parë e Haradinajt, T.18 ('Mendimin për gjykatën edhe në 1 milion vjet, 500 milion vjet, s'muj të ma hekni mu, as 500 mijë njerëzve që mendojnë si unë').

⁵³⁴ Haradinaj, T.2903-15; Gucati, 1D00003ET, para.21; Haradinaj, 2D00001ET, para.41. Haradinaj tradhton ndjenjat e tij të vërteta kur, pasi ballafaqohet me një deklaratë se 70% e dëshmitarëve në gjyqet kundër UÇK-së në Kosovë 'janë blerë dhe janë paguar', përgjigjet se përqindja ishte në fakt më e lartë se aq. Haradinaj, T.2896-98.

⁵³⁵ P00039ET, f.4 (Haradinaj, me theksim të shtuar: ('kështu që nuk ish e lehtë atëherë të bindet faktori ndërkombëtar se duhet të ndërhyjë ndaj një kasapi, i cili bëri gjenocid dhe sot të çohen shqipfolsat të mundohen që për gjenocidin serb të na fajsojnë deri në krime bile edhe ma t'vogla se vet mundësia që ka pas UÇK-ja me bo krime. *Sepse ne edhe po të kishim dashtë ne nuk patëm mundësi me bo krime. Dihet kush ka pat mundësi me bo krime – aparati shtetnor i /Sllobodan/ Millosheviqit i cili krijoi katër lufta në Ballkan.*'); P00025ET, f.10; P00049ET, f.16; Gucati, T.2369 (lidhur me atë se nga e dinte ai se deklaratat e dëshmitarëve në Paketa ishin gënjeshtër dhe fabrikime: 'Po këtë përfundim e nxorra për arsye se UÇK-ja nuk ka pas shanc teorike të bëjë asnjë masakër, asnjë vrasje ndaj qytetarëve serb apo ndaj dikuj. Nuk ka pas teori e këto i din mir edhe forcat e NATO-s dhe të gjithë e dinë ndërkombëtarët që UÇK-ja nuk ka pas teori as praktikë as forcë që të bëjë një gjë të tillë. Kjo është. Për ashtu unë kam ardhë në përfundim që kjo është një gënjeshtër. Kjo është'; P00036ET, f.1 (Gucati: 'Shqiptarëve ku ka një pjesëtarë të UÇK-së, apo në traditat kombëtare shqiptare nuk ka ndodhur që të vret fëmijën dikush apo të vret një femër. Tana luftrat që kanë jetu shqiptarët!'); P00042ET, f.1.

⁵³⁶ Gucati, T.2288 ('Jo që i kisha parë, po as që i kisha mendu ndonjëherë në jetën time që do të vijnë këto dokumentacione në zyrën time. Jo, s'kam pa kurrë para 7 shtatorit. Kjo ka qenë një ëndërr. Po them sinqerisht, ka qenë një ëndërr kur kanë ardhur në zyrën tonë. Jo, para 7 shtatorit s'kam pa, as kam

diskredituar DHSK/ZPS-në.⁵³⁷

(b) *Të akuzuarit donin të ndalonin përmbushjen e mandatit të DHSK/ZPS-së*

179. Të akuzuarit ishin dhe janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për ta ndaluar DHSK/ZPS-në të përmbushë mandatin e vet. Qëllimet e deklaruara të nxjerrjes së dokumenteve të paketave ishin diskreditimi i hetimeve të TFHS/ZPS-së, për të detyruar DHSK-në të ndryshonte ose të mbyllej.⁵³⁸ Sipas fjalëve të Haradinajt, ai parashikonte se DHSK-ja 'ka me u rrëzuar krejt, sepse tash edhe dëshmitarët po e dinë që po dihen'.⁵³⁹ Përpjekjet e tyre për t'u distancuar nga këto qëllime⁵⁴⁰ nuk janë të besueshme, duke pasur parasysh provat e shumta për të kundërtën.

180. Synimet e të akuzuarve më së shumti zbulohen gjatë rasteve të shumta kur, gjatë periudhës që përfshijnë akuzat, përfaqësues të mediave iu bënë të ditur të

dëgjuar kurrë. S'kam dëgjuar, as kam pa'). Në mënyrë të ngjashme, Haradinaj e përshkroi mbërritjen e Paketës 3 si një 'mrekulli'. P00030ET, f.2.

⁵³⁷ P00002ET, f.2-4.

⁵³⁸ Gucati, T.2430-32; P00007ET, f.6 (Haradinaj: 'duam t'i nxjerrim këto në mënyrë që t'i tregojmë gjyqtarëve se puna që ju keni bërë është zero'); P00002ET, f.4; P00028ET; P00007ET, f.11-12 (theksimi është shtuar: 'MODERATORJA: Në këtë rast, a do të duhet të binin poshtë të gjitha aktakuzat e ngritura nga Gjykata Speciale? Z. GASHI: Tani duhet...duhet që Gjykata Speciale të mendojë edhe njëherë. Tash është në duart e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe besoj që pas këtij skandali të Gjykatës Speciale, jo të OVL-UÇK-së, apo të individëve apo shqiptarëve....MODERATORJA: Kjo është e ditur. Z.. GASHI: Ata duhet edhe një herë të mendojnë që a t'i konfirmojnë ato aktakuza apo jo. [...] Z. Haradinaj: Sepse derisa degjenerohet një gjykatë, nuk mund të pritët fort me mjetet e degjenerume njëherë me ngrit aktakuzë. Mirë e tha avokati Tomë. Unë besoj që ai duhet të mendojë pak tash. '); P00035ET, f.3 (çdo gjë që vjen në favor të asaj që demanton këtë aktakuzë a këto aktakuza që po dojn me i ngrit, ne do ta publikojmë'); P00015ET, f.2 (Haradinaj, disa momente para arrestimit të tij më 25 shtator 2020: 'mane mend kte, sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund. Detyra e tyne është t'i rujn sekretet e veta. Nuk i kam faj unë atje pse kanë shti ata njerëz pa shkollë, kanë shti naiva, dhe kan rrejt kta naivat tonë që ne e mbajmë sekretin. Asht dasht me i rujt arkivat e veta. '); P00018ET, f.1-2; P00004ET, f.3; P00034ET, f.2; P00008ET, f.26, 30-31; P00025ET, f.1-2, 9-10; P00029ET, f.2; P00030ET, f.17-18. *Shih gjithashtu* P00080ET (nga faqja e Haradinajt në Facebook, ku përshëndet dorëzimin e Paketës 1 dhe komenton ('More nuk mund i zhdukin ata ato më kurr ... !'); P00060ET, f.SPOE00220748.

⁵³⁹ P00008ET, f.31.

⁵⁴⁰ Gucati, T.2432-33; Haradinaj, T.2918-19.

akuzuarve se veprimet e tyre mund të ishin të paligjshme.⁵⁴¹ Haradinaj në veçanti e shtrembëroi kuptimin e qartë të pyetjeve që iu drejtuan, duke deklaruar se nuk kishte bërë asgjë të gabuar,⁵⁴² por të dy të akuzuarit e bënë të qartë se edhe nëse ajo që kishin bërë ishte e gabuar, ata gjithsesi do ta bënë prapë.⁵⁴³ Gucati tha se do të vazhdonte të publikonte materialet pasi t'i merrte dhe se do të ishte i gatshëm të shkonte në burg për pesë vjet nëse ishte e nevojshme.⁵⁴⁴ Haradinaj deklaroi në mënyrë edhe më kategorike se edhe 300 vjet në burg nuk do ta ndalonin atë dhe se ata ishin të gatshëm të vdisnin për t'i dhënë publikut informacione si ato që përmbanin paketat.⁵⁴⁵ Kur u pyet nëse DHSK-ja mund të ndiqte penalisht në mënyrë të përligjur një anëtar të UÇK-së, përgjigjja e Haradinajt ishte e prerë: '[...] Dhe nëse ju e keni me të vërtetë qat qëllim sikur the ti që t'vazhdoni rrugën e Millosheviqit, unë jam kundërshtari yt haptaz, tash edhe tana herët. Nëse ty s'të vjen turp mu me m'jep qasi nënkuptimi, vazhdo ti, unë jam kundërshtari yt'.⁵⁴⁶

181. Të dy të akuzuarit i përsëritën këto deklaratat gjatë dëshmimeve të tyre. Asnjë prej tyre nuk tregoi pendim për veprimet e veta dhe ata bënë të qartë se do ta bënë këtë përsëri nëse u jepej mundësia.⁵⁴⁷ Të akuzuarit e konsiderojnë si mision të tyre

⁵⁴¹ P00011ET, f.38, 64-65; P00007ET, f.8-9; P00006ET, f.15; P00018ET, f.5-6; P00028ET, f.1-2; P00034ET, f.3 (ku Haradinaj thotë se dëshmitarët nuk janë kërcënuar nga nxjerrja e Paketës 1 sepse ata i kanë dhënë nën presion deklaratat e tyre fillestare për luftën). Si një shembull tjetër, një ditë para arrestimit të akuzuarve, gazetari Vehbi Kajtazi i tha Faton Klinakut në një program në media se anëtarët e OVL-UÇK-së duhet të jenë në Hagë për shpërndarjen e dosjeve. P00023ET, f.4. Kur të nesërmen Haradinajn po e arrestonin, ai dëgjohet tek thotë 'Të shohim! Do takohena me Vehbiun. Ai me [përmend emrin e një zyrtari serb] dhe Vuçiqin. Unë ktej'. P00014ET, f.3.

⁵⁴² Haradinaj, T.2834-37, 2840-45, 2847-58, 2969-74.

⁵⁴³ P00035ET, f.12-13; P00026ET, f.2, 4-5; P00021ET, f.4; P00024ET, f.7-8 ('z. Haradinaj: Shkelje...edhe nëse ashtë shkelje ne e kem detyrë që do të bajm çdo gja që e demanton korrektësinë e kësaj gjykate sepse është raciste, është selektive dhe ja u vërtetue'). *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2866-73 (ku përpiqet të distancohet nga kuptimi i qartë i këtij citimi).

⁵⁴⁴ P00028ET, f.12.

⁵⁴⁵ P00035ET, f.13.

⁵⁴⁶ Haradinaj, T.2915.

⁵⁴⁷ Gucati, T.2218-19, 2221-22 (nga 2222: 'Shumë më vjen keq, po mendon se jam tuj u frigu. Jo. Thashë s'jam tuj u frigu prej punës time ça kam bo. Unë e thashë, çdo dokumentacion që vjen në zyrën time, në dëm të vendit tim, unë do ta bëj publike.'). 2401; Haradinaj, T.3021-24 (nga 3024: 'Po qe se i bien, të njëjtë do të veprojnë se hala kam mendimin e njëjtë. Për q'aq sa kam vepru që kam bo drejtë dhe kam bo

destabilizimin e DHSK/ZPS-së dhe të gjitha pohimet e tyre se nuk synonin të krijonin pengesa për to, tradhëtohen në çdo hap nga fjalët dhe veprimet e tyre.

182. Të akuzuarit u përpoqën të justifikonin mbajtjen e konferencave për shtyp me arsyetimin se ishin të shqetësuar se një organ tjetër mund t'i publikonte paketat dhe se OVL-UÇK-ja nuk dëshironte të akuzohej për vjedhje ose fabrikim të dokumenteve.⁵⁴⁸ Por nëse ky do të ishte motivi i vërtetë, të akuzuarit mund ta kishin mohuar vjedhjen ose krijimin e paketave pa i bërë publike ato. Kur u ballafaqua me këtë mundësi, Gucati pranoi se ai ishte motivuar nga interesa të tjera: 'ne kemi mendu për ta bind edhe shtypin por edhe opinionin kosovar, tju tregojm se këto janë fakte'.⁵⁴⁹

3. Të akuzuarit ishin të vetëdijshëm nga urdhrat e dorëzuara OVL-UÇK-së se veprimet e tyre po pengonin punën e DHSK/ZPS-së

183. Marrja nga ZPS-ja e secilës prej paketave u shoqërua me një urdhër që autorizonte sekuestrimin.⁵⁵⁰ Urdhrrat bënë të qartë se OVL-UÇK-ja nuk lejohej të shpërndante një informacion të tillë dhe se materialet në zotërim të saj duhej të ktheheshin menjëherë.⁵⁵¹ Nga lloji i materialeve ishte e qartë se të akuzuarve nuk u lejohej shpërndarja e tyre, dhe këto urdhra e zyrtarizonin këtë gjë.

në interes të transparencës dhe informimit publik. Hiç mos e bë. Përderisa mendoj kështu, vetëm kaq hiç ma shumë as ma pak sepse bindja jeme që është dashtë.').

⁵⁴⁸ Gucati, T.2169-70, 2179-80, 2404-05, 2426-28; Gucati, 1D00003ET, para. 25-26; Haradinaj, T.2728; 2D00001ET, para. 45, 52 (shih në mënyrë të ngjashme para.135).

⁵⁴⁹ Gucati, T.2405-06. *Shih gjithashtu* P00035ET, f.8 (theksimi është shtuar: 'GAZETARI: Unë po mendoj që ai mundet me pru diçka që mundet me ju rreziku juve, d.m.th. si Organizatë, se qe tri herë [folës që flasin njëkohësisht]?. Z. Haradinaj: Që ky po na rrezikon ne a? Jo! *Ky na ka rrezikon?*. [të qeshura] [folës që flasin njëkohësisht]'); P00028ET, f.11 (Gucati: 'Unë nuk e besoj se kjo munet edhe të jet bë me ran prej neve apo për pjestart ton të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovs').

⁵⁵⁰ P00054 (ku urdhërohet Hysni Gucati dhe/ose OVL-UÇK-ja që '1. të dorëzojnë menjëherë të gjitha dokumentet dhe të dhënat e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke përfshirë materialin e brendshëm të punës; dhe 2. të mos incizojnë ose kopjojnë në çfarëdo forme dhe të mos shpërndajnë më tej, me çfarëdo mjeti komunikimi, dokumentet ose përmbajtjen e tyre.').

⁵⁵¹ P00052; P00053; P00054.

184. Të akuzuarve iu bënë të ditura kushtet kryesore të urdhrave.⁵⁵² ZPS-ja e bëri të qartë se materialet ishin sekrete dhe nuk duhej t'u jepeshin mediave.⁵⁵³

185. Pavarësisht se ka dëshmuar se nuk i kujtohet të ketë marrë një urdhrë gjyqësor,⁵⁵⁴ në një intervistë të datës 17 shtator 2020, Gucati shihet duke treguar urdhrin e dytë para kamerave të medias.⁵⁵⁵ Më pas Gucati tha se 'ata mu më thanë në ren, që s'është mire këto dokumentacione të shumëzohen, të shpërndahen, apo të publikohen emnat e dëshmitarëve, siç tha edhe avokati. Na i thamë se nuk jemi të interesu me i shumëzuar'⁵⁵⁶ Pretendimi i Gucatit se nuk e kishte kuptuar dokumentin e shkruar të cilin po e tregonte para kamerës ndërkohë që bënte një përmbledhje të saktë të përmbajtjes së tij, nuk është i besueshëm, veçanërisht duke pasur parasysh se në të njëjtën intervistë ai bëri një përshkrim të mëtejshëm të asaj që i ishte dhënë: 'Ftesa është në emnin tim personal. Unë si kryetar i Veteranëve të Luftës, që m'i dërgojnë disa rregulla ata mu për këto dëshmitë që kanë ardh në Organizatën e Veteranëve.'⁵⁵⁷

186. Haradinaj postoi një fotografi të urdhrin të parë në faqen e tij në *Facebook*.⁵⁵⁸ Haradinaj tregoi gjithashtu urdhrin e dytë në kamera dhe, ndonëse vuri në dukje se urdhri ishte në gjuhën angleze, tha se e dinte që ai përmbante 'obligimet që ata na shtijnë në obligime'.⁵⁵⁹

⁵⁵² P00092, para. 3-6; P00017ET, f.6.

⁵⁵³ Gucati, T.2195; Gucati, 1D00003ET, para.39; Haradinaj, 2D00001ET, para.87; P00006ET, f.18-19, 35.

⁵⁵⁴ Gucati, T.2289-96.

⁵⁵⁵ P00004ET, f.1.

⁵⁵⁶ P00004ET, f.8.

⁵⁵⁷ P00004ET, f.3 (theksimi është shtuar). *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2936 (nga 2936, me theksim të shtuar: 'Pyetje. Po, është pyetje për ju. Ju e keni ditur që ZPS-ja nuk donte që ju ta ndanit këtë informacion. Përgjigje. Tash unë po e tregoj për Gjykatën se çka unë kam ditur dhe di edhe sot dhe çka kam kuptuar. Ne e kemi kuptuar se ne nuk do të ketë material me e shumu, me e shpërnda, me e publiku, dhe asnjë nga këto nuk i kemi bërë. Këtë e kam ditur unë, dhe këtë e di edhe sot.').

⁵⁵⁸ P00083, f.1. *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2927-29.

⁵⁵⁹ P00017, min.13:13-13:46; P00017ET, f.6. *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2930-32 (ku jep një përgjigje të mjegullt lidhur me nëse pranonte se e kishte ditur që Urdhri i Dytë udhëzonte që paketat nuk duhej të publikoheshin).

187. Të thuash se të akuzuarit nuk i kuptuan kushtet e urdhrave, thjesht nuk është e besueshme, duke pasur parasysh veprimet/deklaratat në lidhje me to, marrjen në mënyrë zyrtare prej tyre të urdhrit të dytë dhe të tretë,⁵⁶⁰ dhe nivelin e lartë të koordinimit që të akuzuarit kishin me Faton Klinakun - të cilit iu dorëzua urdhri i parë – gjatë gjithë periudhës kohore që përfshin Aktakuza.⁵⁶¹

188. Këto urdhra dhe deklaratat shpjeguese të ZPS-së, u bënë qartësisht të ditur të akuzuarve se ajo çka ata po bënin me paketat po dëmtonte DHSK/ZPS-në si institucion. Të akuzuarit i shpërfillën këto urdhra dhe udhëzime, duke e bërë të qartë se ata nuk do të kontaktonin me ZPS-në kur të vinin paketat.⁵⁶² Ata ishin të qartë në shpjegimin e tyre se pse nuk kontaktuan me ZPS-në, duke e ditur se nëse ZPS-ja do të informohej, ajo do t'i sekuestronte paketat përpara se ato t'i jepeshin medias.⁵⁶³ Praktika e mbajtjes së konferencave për shtyp për të nxjerrë informacionin konfidencial u ndërpre vetëm pas arrestimit të të akuzuarve.

4. Teoria e çështjes gjyqësore – Pikat 1 dhe 2

(a) *Pengim i personave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë (Pika 1)*

189. Të akuzuarit janë përgjegjës për pengim me anë të kërcënimit të rëndë sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 1). Provat vërtetojnë se më së paku, midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit penguan ose tentuan të pengonin zyrtarët e DHSK/ZPS-së me anë të kërcënimit të rëndë. Këto kërcënime u bënë, ndër të tjera: (i) duke shpërndarë informacion konfidencial,⁵⁶⁴ ku përfshiheshin emrat dhe dëshmitë e

⁵⁶⁰ P00058; Gucati, T.2288-89.

⁵⁶¹ *Shih, p.sh.*, Haradinaj, 2D00001ET, para.87.

⁵⁶² P00035ET, f.6 (Haradinaj: 'Jo vallahi ata për qejf. S'kanë qejf me ju lajmëru hiç. Bile ata na kanë thanë me jua dorëzu atyne, po ne ju kemi kallzu që na nuk bashkëpunojmë me ta. Po na kanë thanë, po ne nuk i kemi ngu. S'kemi me i ngu. Ata që e kanë plan me i ngu bëjeni! Edhe ju në dashti me i ngu.');

P00030ET, f.9; Haradinaj, 2D00001ET, para.54.

⁵⁶³ P00035ET, f.6; P00006ET, f.17, 19.

⁵⁶⁴ Dokumentet konfidenciale dhe jopublike që u shpërndanë gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë në vazhdim do të quhen 'informacion konfidencial'.

dëshmitarëve;⁵⁶⁵ (ii) duke deklaruar se identitetet e të gjithë atyre që kishin bashkëpunuar me TFHS/ZPS-në do të bëheshin të njohura publikisht, dhe duke i akuzuar ata, ndër të tjera, si gënjeshtarë, spiunë dhe tradhtarë;⁵⁶⁶ (iii) duke deklaruar ose ndryshe duke bërë të qartë se me shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe veprimet e tjera në lidhje me të, ata kishin për qëllim pengimin e procedurave të DHSK-së;⁵⁶⁷ dhe (iv) duke kërcënuar në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin të shpërndanin informacionin e hetimeve konfidenciale, përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe do të pengonin mandatin e DHSK/ZPS-së.⁵⁶⁸ Për shkak të këtyre kërcënimeve të rënda: (i) u rrezikua siguria dhe mirëqenia e dëshmitarëve dhe dëshmitarët u frikësuan;⁵⁶⁹ dhe (ii) ZPS-ja i devijoi kapacitetet dhe kohën e vet në trajtimin e pasojave reale dhe të mundshme të veprimeve të të akuzuarve, ndër të tjera për dëshmitarët dhe procedurat e DHSK-së.⁵⁷⁰

190. Aftësia e ZPS-së për hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të krimeve, përfshirë nëpërmjet mbledhjes së provave të rëndësishme, duke garantuar në të njëjtën kohë sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve, u pengua rëndë, duke marrë parasysh, ndër të tjera: (i) domosdoshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve për kryerjen e hetimeve dhe gjykimeve penale; (ii) interesin dhe detyrimin ligjor të DHSK/ZPS-së për të mbrojtur sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve;⁵⁷¹ dhe (iii) qëllimin e deklaruar të të akuzuarve. Kërcënimet e rënda dhe publike të të akuzuarve për sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve përfshihen qartësisht në kuptimin e nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, pasi këto kërcënime u bënë për të penguar zyrtarët e DHSK/ZPS-së në vazhdimin e kryerjes së hetimeve dhe procedurave penale duke

⁵⁶⁵ Para. 32, 37-39, 46-49, 54-57, 63-64, 66, 68-69, 72, 78, 82, 89, 92, 94-97, 102, 106-111, 116, 120 më lart.

⁵⁶⁶ Para. 31, 33-35, 40-41, 69, 80-81, 87, 93, 100 më lart.

⁵⁶⁷ Para. 34-35, 52, 59, 68, 70, 74-76, 80-81, 84, 87-88, 104, 115, 117, 119-120, 123-124 më lart.

⁵⁶⁸ Para. 52, 58, 65, 73, 75, 79, 83, 87-88, 99, 115, 123-124 më lart.

⁵⁶⁹ Para. 125, 127-128, 130 më lart.

⁵⁷⁰ Para. 125-127, 131-134 më lart.

⁵⁷¹ *Shih, p.sh.*, Nenet 23, 35(2)(f), 39(11), 40(6)(f), 58 dhe rregullat 30(2)(a), 80, 81, 105, 108.

kërcënuar se, në të kundërtën, do të rrezikohej rëndë siguria dhe mirëqenia e dëshmitarëve.

191. Dëshmitarët shprehën zemërim, shqetësim dhe frikë dhe u ndien të kërcënuar dhe/ose të frikësuar si rezultat i veprimeve të të akuzuarve.⁵⁷² Dëshmitarët shprehën gjithashtu një mosgatishmëri për të vazhduar bashkëpunimin e tyre me ZPS-në,⁵⁷³ dhe ZPS-ja i devijoi kapacitetet dhe kohën e vet e ua kushtoi trajtimit të pasojave reale dhe të mundshme, ndër të tjera për dëshmitarët dhe procedurat e DHSK-së.⁵⁷⁴

192. Këto kërcënime të rënda penguan zyrtarët e ZPS-së në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, ndër të cilët prokurorët, hetuesit dhe anëtarët e tjerë të personelit, sipas kuptimit të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së.

193. Gjithashtu, provat vërtetojnë synimin e të akuzuarve në lidhje me Pikën 1. Midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit shprehën publikisht dhe tepër qartë kundërshtimin e tyre ndaj DHSK-së dhe synimin për të penguar punën e DHSK/ZPS-së.⁵⁷⁵ Të akuzuarit deklaruan se veprimet e tyre synonin pengimin e punës së DHSK/ZPS-së, pasi ata e konsiderojnë atë një gjykatë raciste dhe të njëanshme, të cilën ata nuk e njohin.⁵⁷⁶

(b) *Pengim i personave zyrtarë duke vepruar bashkërisht*

194. Të akuzuarit dhe anëtarë e përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së (bashkërisht: 'bashkëpunëtorët') janë gjithashtu përgjegjës për pengim me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas nenit 401(2)(3) dhe (5) të KPK-së (Pika 2).

⁵⁷² Para. 125, 127-128, 130 më lart.

⁵⁷³ Para.127 më sipër.

⁵⁷⁴ Para. 125-127, 131-134 më lart.

⁵⁷⁵ Para. 34-35, 52, 59, 68, 70, 74-76, 81, 84, 87-88, 104, 115, 117, 119-120, 123-124 më lart. *Shih, në veçanti*, P00001ET, f.1-3, 6 P00004ET, f.3, 8; P00013ET, f.1; P00021ET, f.3-5; P00006ET, f.25-26; P00002ET, f.2-4, 6-7; P00007ET, f.3-5, 16-17; P00008ET, f.7; P00029ET, f.2; P00012ET, f.2, 4-5; P00026ET, f.2, 4-5; P00015ET, f.2; P00018ET, f.1-2; P00034ET, f.2; P00011ET, f.3, 56; P00028ET, f.2-3, 7-9, 11.

⁵⁷⁶ Para. 23, 58-59, 68, 74-75, 79, 87-88, 117, 119, 124 më lart.

Provat vërtetojnë se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit morën pjesë në një grup personash, të përbërë nga të akuzuarit, Klinaku, Tomë Gashi dhe të tjerë, ndër të cilët anëtarë dhe përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, veprimet e përbashkëta të të cilëve penguan ose tentuan të pengonin një apo më shumë persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Provat tregojnë se, në cilësinë e tyre përkatësisht si kryetar dhe nënkryetar të OVL-UÇK-së,⁵⁷⁷ Gucati dhe Haradinaj udhëhoqën dhe organizuan grupin në ndërmarrjen e këtyre veprimeve, të cilat u kryen kundër zyrtarëve të ZPS-së, ndër të cilët ishin prokurorët, hetuesit dhe anëtarët e tjerë të personelit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, konkretisht gjatë hetimeve penale në vazhdim të ZPS-së.⁵⁷⁸

195. Në veçanti, provat tregojnë se të akuzuarit, Klinaku dhe të tjerët u përfshinë në këqyrjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë.⁵⁷⁹ Të akuzuarit dhe të tjerë morën pjesë në organizimin e konferencës së parë, të dytë dhe/ose të tretë për shtyp, në të cilat ata bënë publike dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë.⁵⁸⁰ Të akuzuarit folën në këto konferenca shtypi, në të cilat morën pjesë edhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së që qëndronin të ulur pranë tyre në kohën që ata u drejtoheshin të pranishmëve.⁵⁸¹ Një ose më shumë nga të akuzuarit, Klinaku dhe Tomë Gashi, e nganjëherë të gjithë së bashku, përfaqësuan OVL-UÇK-në në mbi pesëdhjetë paraqitje mediatike që u mbajtën në lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe/ose të tretë,⁵⁸² përfshirë paraqitjet e të akuzuarve në

⁵⁷⁷ Para.19 më lart.

⁵⁷⁸ Neni 401(2) dhe (5) i KPK-së.

⁵⁷⁹ Para. 25-26, 29, 38, 61, 86, 92, 94 më lart. *Shih, në veçanti*, P00001ET, f.1-3; P00021ET, f.3-5; P00008ET, f.9; P00035ET, f.1-2; P00007ET, f.3-5.

⁵⁸⁰ Para. 27-28, 62, 94 më lart.

⁵⁸¹ Para. 29-35, 63-65, 95-101 më lart.

⁵⁸² Para. 38-41, 51, 56-59, 68-69, 73-77, 79-81, 83-88, 113-124 më lart, *në lidhje me* P00009ET; P00009; P00013ET; P00013; P00024ET; P00024; P00021ET; P00021; P00018ET; P00018; P00004ET; P00004; P00033ET; P00033; P00019ET; P00019; P00007ET; P00007; P00017ET; P00017; P00008ET; P00008; P00012ET; P00012; P00011ET; P00011; P00030ET; P00030; P00023ET; P00023; P00027ET; P00027; P00026ET; P00026.

rastet kur informacioni konfidencial u shpërnda më tej.⁵⁸³

196. Të akuzuarit dhe Tomë Gashi lavdëruan publikisht burimet e paidentifikuara të cilat sollën dokumentet në OVL-UÇK dhe/ose u shprehën se do të mirëprisnin sjelljen e dokumenteve të tjera nga këto burime në të ardhmen.⁵⁸⁴ Më tej, të akuzuarit kërcënuan në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin shpërndarjen e informacionit të hetimeve konfidenciale, duke përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe se do të pengonin mandatin e DHSK/ZPS-së.⁵⁸⁵ Të akuzuarit dhe Tomë Gashi bënë komente frikësuese dhe/ose kërcënime në adresë të dëshmitarëve.⁵⁸⁶

197. Provat vërtetojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të merrnin pjesë në një grup me qëllim që të pengonin personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare; si alternativë, të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se pjesëmarrja e tyre në këtë grup mund të shkaktonte këtë pasojë të ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasaje të ndaluar me ligj. Klinaku⁵⁸⁷ dhe Tomë Gashi⁵⁸⁸ gjithashtu bënë të qartë se synimi i tyre ishte i njëjtë me atë të të akuzuarve.

G. FRIKËSIMI

1. Të akuzuarit donin t'i frikësonin dëshmitarët – dhe e bënë këtë

198. Mesazhi i qartë i të akuzuarve për dëshmitarët e Paketave është se ata nuk mund të mbroheshin dhe tani ishin të njohur:

Shpresoj që ju mediat po edhe ata të cilët janë marre si shume me këto analiza, tash kanë me çka me u marre. çmimin mendoj që duhet ta paguaj kjo Gjykate. Sepse të thuash që e ka në konfidenciale dhe e kanë Top Sekrete dhe t'i rrjedhin këto shënime, pa marre parasysh se kush i

⁵⁸³ Para. 38, 57, 68-69, 120 më lart. *Shih veçanërisht* P00009ET, f.5-8; P00024ET, f.8; P00018ET, f.2-3; P00033ET, f.1-2; P00011ET, f.29-30.

⁵⁸⁴ Para. 52, 58, 75, 79, 83, 87, 115, 123 më lart.

⁵⁸⁵ Para. 65, 73, 79, 88, 99, 114, 124 më lart.

⁵⁸⁶ Para. 31, 33-35, 40-41, 69, 80-81, 87, 93, 100 më lart. *Shih veçanërisht* P00001ET, f.2-6; P00009ET, f.10-14; P00008ET, f.7, 26; P00007ET, f.5-6.

⁵⁸⁷ Para. 51, 122 më lart.

⁵⁸⁸ Para. 80-81, 113-114 më lart.

ka marre, unë mendoj se kjo kallëzon me tepër se skandaloze dhe është turp, nëse ajo veç e përmend emni, me s'e ekziston. Dhe aq me keq kur i merr ne qafe edhe dëshmitarët kur ju thonë qe datë jeni ne mbrojtje. [Hap me dore fletët ne tavoline] *Dhe këto shënime, këta emna, këta mbiemna, tash le ta dine se janë emna te lexun dhe nuk po del këtu diçka qe është dikush i fshehte. Se ka vendin e sakte, thirrjen e sakte, deklaratën kur e ka dhënë, rideklaratën tjetër kur e ka marre.*⁵⁸⁹

199. Edhe eksperti hetimor i Mbrojtjes së Haradinajt pranoi se një deklaratë e tillë mund të krijonte efekt frikësues te dëshmitarët.⁵⁹⁰

200. Të akuzuarit donin t'i bënin dëshmitarët të kuptonin se, nëse flisnin me ZPS-në, kjo do të rezultonte në zbulimin publik të identitetit të tyre dhe se nuk do të mbroheshin. Kjo dëshmohet nga terminologjia e tyre, ku dëshmitarët bashkëpunues u quajtën spiunë, tradhtarë, bashkëpunëtorë, kriminelë dhe gjakpirës.⁵⁹¹ Gucati i akuzoi dëshmitarët për bashkëpunim me qëllim që të fitonin dokumente për azil.⁵⁹² Nga fjalët e Haradinajt është e qartë si drita e diellit se të akuzuarit synonin që t'u jepnin mesazh dëshmitarëve se, ashtu siç kishte ndodhur në të kaluarën, personat që bashkëpunonin me autoritetet gjyqësore tani do të vriteshin, diskreditoheshin ose përqesheshin.⁵⁹³

201. Në një pjesë veçanërisht të mjegullt të dëshmisë së tij, Haradinaj tentoi të distancohej nga referimi ndaj dëshmitarëve si 'O qyqona, o budalla, o spiuna te lind, o spiuna' dhe ku u thotë 'mos mendoni qe ju mbron kush' duke pretenduar se këto i kishte thënë në një program televiziv humoristik dhe se kishte folur për bashkëpunëtorët nga pikëpamja historike.⁵⁹⁴ Një interpretim i tillë është jobindës duke

⁵⁸⁹ P00001ET, f.3 (theksimet janë shtuar). *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2819 ('Unë pajtohem plotësisht me çfarë kam thënë'); Gucati, T. 2379-81. Haradinaj thotë se komenti i tij i adresoj vetëm prokurorisë (Haradinaj, T.2820, 2824-25), por sintaksa e pjesës së theksuar konfirmon se komenti ishte drejtpërdrejt për dëshmitarët.

⁵⁹⁰ Reid, T.3310.

⁵⁹¹ P00008ET, f.7, 26; P00025ET, f.7 ('[...] ata që jepin deklarat shpifse në ngrit një Aktakuz, kurdo që të jesh, ather, bashkëpunëtor të Serbis. Dhe tash nuk o përgjegjësia jon, është përgjegjësia atij që ka pranuar mu kon i manipulim, i spekulim edhe i shantazh.'); P00037ET, f.5; P00033ET, f.1-2; P00009ET, f.12.

⁵⁹² P00009ET, f.10-12; P00009, min.01:06:42-01:09:36; *Shih gjithashtu* P00044ET, f.1; P00044 min.08:01-08:54.

⁵⁹³ P00008ET, f.26; P00008, min.00:50:33-00:51:07.

⁵⁹⁴ Haradinaj, T.2881-86, duke iu referuar P00008ET, f.26.

pasur parasysh se: (i) sjellja e folësve dhe tema që trajtonin përjashton çfarëdo qëllimi satirik; dhe (ii) citimi qartësisht u referohet individëve në Paketën 1 e jo rolit historik të bashkëpunëtorëve dhe spiunëve.

202. Fjalët e të akuzuarve duhet të kuptohen duke pasur parasysh atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve që mbretëron në Kosovë. Edhe dëshmitarët e ZPS-së edhe të Mbrojtjes e përshkruan këtë klimë.⁵⁹⁵ Jukiqi tha se '[k]a pasur shumë incidente që u kanë ndodhur dëshmitarëve dhe nga përvoja ime e di se kanë ndodhur disa incidente edhe gjatë kohës së UNMIK-ut dhe EULEX-it, ku disa dëshmitarë janë kërcënuar.'⁵⁹⁶ Rid e krahasoi të qenit dëshmitar në Kosovë me të qenit të konsideruar 'tradhtar i kauzës',⁵⁹⁷ dhe e vërtetoi deklaratën e tij nga një intervistë e videoincizuar e mëhershme ku kishte thënë:

Kërcënimi i dëshmitarëve në gjykimet e Kosovës, nuk kam parë asnjëherë ndonjë gjë të tillë dhe kam qenë polic për 20 vjet, kam punuar 23 vite dhe nuk kam pas ndonjëherë frikësim të atij niveli. Ishte vërtetë frikësues. Dhe nuk është se dua ta lidh këtë ndonjë individ apo organizatë, por thjesht e kam fjalën për frikën që ekzistonte, që ishte e brumosur në shoqëri. As në rastet e krimit të organizuar, nuk kam parë një frikë të një niveli të tillë.⁵⁹⁸

203. Edhe pse Gucati nuk ishte i gatshëm të deklaronte se ekzistonte 'klima e frikësimit të dëshmitarëve' në Kosovë, ai pranoi se ishte e pamundshme për dikë që jetonte në Kosovë të mos ishte i vetëdijshëm për gjykimet kundër anëtarëve të UÇK-së.⁵⁹⁹

204. Është e qartë se veprimet dhe fjalët e të akuzuarve në një atmosferë të tillë do të ishin frikësuese. Akuza e frikësimit në këtë çështje gjyqësore është krim përmes sjelljes, që do të thotë nuk ka nevojë të vërtetohet asnjë pasojë si rezultat i veprimeve

⁵⁹⁵ *Shih gjithashtu* C00002; P00165.

⁵⁹⁶ Jukić, T.1758.

⁵⁹⁷ Reid, T.3306-07.

⁵⁹⁸ P00165, min.06:55-07:29; P00165ET, f.5; Reid, T.3305-10 (nga 3306 'Dhe nuk e mohoj asnjë fjalë nga ato që sapo thashë'). *Shih gjithashtu* P00166.

⁵⁹⁹ Gucati, T.2343.

të të akuzuarve.⁶⁰⁰ Megjithatë, dëshmitarët u ndien të frikësuar. Këto shqetësime ishin veçanërisht të rënda për viktimat e krimeve, të cilat janë më të cenueshme ose të rrezikuar nga kërcënimet ose dëmtimet.⁶⁰¹

205. Dëshmitarët ishin të frikësuar dhe disa nuk dëshironin të flisnin më me ZPS-në pas publikimit të Paketave.⁶⁰² Vlerësimi profesional i Jukiqit se dëshmitarët ishin të kërcënuar pas publikimit bazohej në çfarë i kishin thënë ata gjatë kontakteve me ta, siç ilustron këta shembuj:

- i. Një dëshmitar tha se nuk ndihej aspak i sigurt dhe se mund t'i ndodhte çdo gjë.⁶⁰³
- ii. Një dëshmitar ishte në panik dhe i brengosur për sigurinë e vet dhe të familjes. Ai ishte larguar nga Kosova dhe kishte frikë të shkonte në punë.⁶⁰⁴ Dëshmitari ishte qetësuar kur kishte mësuar se emri i tij nuk ishte në Paketa,⁶⁰⁵ por ishte domethënës vetë fakti se ishte frikësuar nga vetë mundësia që të zbulohet.
- iii. Një dëshmitar kishte pësuar sulm të panikut dhe përfundoi në spital. Ai kishte qenë nën stres të madh për shkak të rrjedhjes së dokumenteve në media.⁶⁰⁶
- iv. Një dëshmitar ishte pak i brengosur për shkak të situatës së përgjithshme të sigurisë dhe veçanërisht për shkak të njoftimit nga veteranët e UÇK-së. Dëshmitari donte të dilte para gjykatës dhe të tregonte të vërtetën, por mendonte se ZPS-ja duhet ta mbështeste dhe ta ndihmonte.⁶⁰⁷
- v. Gjatë një bisede me ZPS-në, një dëshmitar ishte shumë i shqetësuar dhe i zemëruar. Ai tha se donte që familja e tij të zhvendosej menjëherë nga Kosova. Ai i shprehu disa herë shqetësimet serioze sa i përket familjes, duke thënë se mund të vriteshin dhe se nuk do të bashkëpunonte me ZPS-në nëse nuk do t'ia zhvendosnin familjen.⁶⁰⁸
- vi. Një dëshmitar shprehu shqetësime sepse gjendja në Kosovë në përgjithësi është e keqe dhe u shpreh se ishte ndier shumë keq ditën që dosjet kishin dalë në media.⁶⁰⁹
- vii. Një dëshmitar dëshmoi se e kishin informuar miqtë se emri i tij ishte në dokumentet

⁶⁰⁰ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.62; Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para.20.

⁶⁰¹ Jukić, T.1759.

⁶⁰² Jukić, T.1703, 1706-07.

⁶⁰³ Jukić, T.1712. *Shih gjithashtu* P00130.

⁶⁰⁴ Jukić, T.1714-15, 1721. *Shih gjithashtu* P00131, para.4.

⁶⁰⁵ P00131, para.4.

⁶⁰⁶ Jukić, T.1721-22. *Shih gjithashtu* P00132.

⁶⁰⁷ Jukić, T.1723-25. *Shih gjithashtu* P00134.

⁶⁰⁸ Jukić, T.1725-27. *Shih gjithashtu* P00135, para.2.

⁶⁰⁹ Jukić, T.1731. *Shih gjithashtu* P00137.

konfidenciale dhe se kishte marrë menjëherë masa që ta rriste sigurinë e fëmijëve. Ai vuri në dukje se kishte filluar të ndihej sikur njerëzit po e izolonin atë dhe familjen e tij dhe dukej se njerëzit nuk bënë dallime midis dëshmitarëve dhe spiunëve, duke shtuar se mendonte se familja e tij ishte e rrezikuar.⁶¹⁰

- viii. Një dëshmitar tha se i kishte besuar ZPS-së e tani emri i tij ishte bërë publik dhe familja e tij ishte në rrezik. Dëshmitari i tha Jukiqit se 'E di shumë mirë se çfarë i ndodhte dëshmitarëve në Kosovë'.⁶¹¹

206. Të gjitha këto u diskutuan nga Jukiqi në gjykatë. Koha kur ishin futur këto shënime nga kontaktet që pasqyrojnë këto përvoja⁶¹² në sistemin e brendshëm të ZPS-së për menaxhimin e provave nuk e zvogëlon frikën e shprehur nga Jukiqi në të cilën bazoheshin vlerësimet e tij mbi kërcënimet me të cilat ballafaqohen dëshmitarët.

207. Oficerët e sigurisë së dëshmitarëve morën mesazhe të ngjashme gjatë telefonatave me dëshmitarë.⁶¹³ Në përgjithësi, dhjetëra dëshmitarë e informuan ZPS-në se ndiheshin të brengosur, të stresuar, të pasigurt dhe/ose të frikësuar pas publikimeve.⁶¹⁴ Dy dëshmitarë u zhvendosën sepse si rezultat i veprimeve të të akuzuarve nuk ishte më e sigurt të jetonin në Kosovë.⁶¹⁵

208. Të akuzuarit ishin plotësisht të vetëdijshëm se zbulimi i emrave të dëshmitarëve do t'i dëmtonte në këto mënyra. Duke vazhduar me kontradiktat e shumta, të akuzuarit këmbëngulin në mbështetje të sjelljes së tyre, të akuzuarit njëkohësisht këmbëngulin se: (i) ZPS-ja po i dëmton dëshmitarët e saj duke mos i mbrojtur identitetet e tyre;⁶¹⁶ por (ii) të akuzuarit nuk po i dëmtojnë dëshmitarët e ZPS-

⁶¹⁰ Jukić, T.1747-50.

⁶¹¹ Jukić, T.1704, 1758, 1881.

⁶¹² P00130; P00131; P00132; P00134; P00136; P00137.

⁶¹³ Jukić, T.1705, 1750-53.

⁶¹⁴ Jukić, T.1719.

⁶¹⁵ Jukić, T.1707-09, 1760-61, 1888-93, 1901-02, 1905-06.

⁶¹⁶ *Shih* P00001ET, f.4-5 (nga f.5: 'Si ju garantohet dëshmitarëve, kur ketu sot mund të lexon gjithkush'); P00011ET, f.3, 37-38; Haradinaj, T.2818-20; Haradinaj, 2D00001ET, para.101 ('ZPS-ja nuk mbrojt as dëshmitarët e cileve iu premtoi mbrojtje'); Gucati, T.2180-81, 2390 ('Të lutem në nuk kemi shpërndarë. Ne jemi -- i kemi lënë në tavolinë -- në vetëm kemi tregu. Kanë dalë disa dokumente nga Gjykata Speciale që për ne ka qenë një befasi, se të dalin ato dokumente nga zyrat e juve. Më përpara, te ne thotë një fjalë popullore: "Kisha menduar vdekjen se sa të dalin dokumentacionet nga ju". Kjo është fjalë

së sepse ata nuk i kanë zbuluar emrat e tyre. Këto dy bindje janë të papërputhshme, sepse e vetmja arsye që nuk është mbrojtur identiteti i dëshmitarëve në posedim të të akuzuarve është se ata ua bënë të njohur mediave.

209. Duke u përqendruar në synimet e të akuzuarve, këto bindje – sado kontradiktore që janë – tregojnë se të akuzuarit ishin plotësisht të vetëdijshëm se zbulimi i emrave të dëshmitarëve të mbrojtur në Paketa do t'i dëmtonte ata. Të akuzuarit madje dëshmuan se ishin të vetëdijshëm për këtë, edhe pse e bënë këtë me bishtnime dhe pa pranuar se kishin bërë ndonjë shkelje.⁶¹⁷ Gucati pranoi se zbulimi i emrave të dëshmitarëve do t'i dëmtonte ata:

Py. Dhe pajtoheni se nxjerrja e emrave të dëshmitarëve për publikun do të vendoste në rrezik sigurinë e dëshmitarëve? A pajtoheni me këtë?

Pë. Unë po them prapë. Nëse është nxjerrë ndonjë emër nga unë apo nga kryesia apo nga gazetarët me siguri që ndoshta do të kish frikë ai dëshmitar. Por ne nuk kemi nxjerrë asnjë emër, asnjë deklaratë të një dëshmitari. Dhe nuk ka pse ta ndejnë veten të rrezikum ata, përderisa ne s'kemi nxjerrë emër, as mbiemër. Kjo është që po them unë. Po është e ndalume kjo rreptësisht.⁶¹⁸

210. Haradinaj konfirmoi se kishte thënë sa vijon në përmbledhjen paraprake të dëshmisë së tij:

Ky është një shqetësim i madh që këto dosje të nxjerra përmbanin emrat e dëshmitarëve. Ky është një shqetësim i madh se ky informacion në qoftë se do të nxirrej, mund të shkaktonte vdekjen e tyre ose mund t' i frikësonte për vdekje. Këta dëshmitarë, pra nxjerrja e emrave të këtyre dëshmitarëve dhe e këtij informacioni ndërkohë që ata mendonin se këto emrat emra nuk do të nxirreshin asnjëherë.⁶¹⁹

popullore që përdoret te ne. Edhe unë po ju them. Më përpara kisha mendu të vdes pesë herë se sa të dalin këto dokumentacione t'juvet dhe të na vijnë në zyrat tona.); P00008ET, f.26.

⁶¹⁷ *Shih* Gucati, T.2264-65, 2308-09; Haradinaj, T.2844 ('Py. Zoti Haradinaj, nuk iu përgjigjët pyetjes sime. Do ta bëj edhe njëherë pyetjen. Do të ishte e vërtetë që nëse do të përmendeshin emrat atëherë do të ishte intimidim? Pë. Ata po i referohen opinionit që një ka marrë prej tjetër, kështu e kanë thonë, me këtë jam pajtu dhe këtë e kemi thonë edhe na, e kemi përsërit. Ka qenë një opinion që e kemi marrë prej njerëzve që janë ma kompetentë se na dhe këtë e kemi përsërit edhe na. Po s' ka qenë mendim i yni, saktë i yni. Nuk ka buruar prej mendimit tonë, ka buruar prej ndikimit dhe mendimeve të njerëzve që besojmë që i kanë ditë këto gjana ma mirë se na. '), 2852.

⁶¹⁸ Gucati, T.2309. *Shih gjithashtu* Haradinaj, T.2831-33 (duke u pajtuar me deklaratën ndërsa tenton t'i distancojë të dy të akuzuarit nga pasojat), 2845.

⁶¹⁹ Haradinaj, T.2827.

211. Pasi fillimisht kishte pretenduar se kjo ishte vetëm shprehje e opinionit të mediave,⁶²⁰ ai më vonë pranoi se kjo ishte gjithashtu edhe pikëpamja e tij.⁶²¹

212. Kur Gucati u pyet nëse i kishte konsideruar pasojat që do të kishin fjalët/veprimet e tij për dëshmitarët që i kishin dhënë deklarata TFHS-së/ZPS-së, krahas mohimit se i kishte zbuluar emrat e tyre ai shtoi se 'ata të cilët kundër vendit tim dhe ata të cilët kanë protestu kundër NATO-s që ka bombardu caqet serbe, për mu nuk mund të jetë tjetër send veç jenë armik të vendit tim, dhe unë këtë e kam mendu shumë mirë dhe shumë mirë po e tregoj'.⁶²² Gucati mund të thotë se nuk synonte t'i kërcënonte dëshmitarët,⁶²³ por kjo deklaratë tregon se ai gjithashtu dëshironte t'i ndëshkonte si armiq të Kosovës ata që folën me TFHS-në/ZPS-në.⁶²⁴

213. Komenti i Gucatit se 'mund të ndodhin edhe gjëra' dëshmitarëve kur të zbuloheshin të dhënat e tyre personale⁶²⁵ duhet të kuptohet në këtë kontekst më të gjerë. Në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve, është e qartë se çfarë do të mund të 'ndodhte' do të ishte e dëmshme për personat në fjalë. Gucati tha gjatë gjykimit se nuk i kujtohej ta kishte bërë këtë deklaratë ose se kishte thënë diçka të ndryshme,⁶²⁶ e gjitha kjo pasi Mbrojtja e Gucatit e kundërshtoi transkriptimin dhe Zyra Administrative e konfirmoi se Gucati në fakt i kishte thënë ato fjalë.⁶²⁷ Fjalët e Gucatit e pasqyrojnë

⁶²⁰ Haradinaj, T.2828-29.

⁶²¹ Haradinaj, T.2844 ('Py. Pra në përmbledhjen paraprake kur flisnit për opinionin publik të dëshmitarëve që ishin të frikësuar për vdekje, ky ishte një opinion publik me të cilin ju pajtoheshit apo jo? Pë. Po kush nuk pajtohet nëse është pengim, në të vërtetë kush nuk pajtohet. Nëse është e vërtetë ashtu pse mos me u pajtu, çka ka të keqe nëse pajtohem për dikënd që mundohet me pengu një drejtësi. Unë jam për drejtësi zoti Prokuror.').

⁶²² Gucati, T.2371.

⁶²³ Gucati, T.2372-73.

⁶²⁴ *Shih ngjashëm* P00035ET, f.2 (Gucati, në lidhje me Paketën 3: 'Do të tregojme nje te vërtetë që ketu kanë mundu edhe po mundohen me çdo kusht që Ushtrinë çlirimtare te Kosovës ta zhveshin. Që s'kanë me mujt! Se të gjithë ata dëshmorë qe kanë ra, të gjithë ata martirë qe kanë ra për këtë vend, ata e kanë te kotë me të gjitha këto falsifikime të veta që i kanë bë.').

⁶²⁵ P00009ET, f.8.

⁶²⁶ Gucati, 1D00003ET, para.63.

⁶²⁷ *Shih* Memorandum mbi Verifikimin e Saktësisë së Pjesës së Transkriptit, 30 korrik 2021, 102483-102484.

kuptimin e tij të pasojave të zbulimit të emrave të dëshmitarëve, dhe ai shprehu dijeni gjatë periudhës që mbulon Aktakuza se në gjykimet e kaluara lidhur me UÇK-në ishin vrarë dëshmitarë.⁶²⁸ Gjatë gjykimit, Gucati gjithashtu përsëriti se '[p]o të kishim nxjerrë ne emra, është e vërtetë se ndoshta e kish ndi veten të friksur ' .⁶²⁹ Nuk duhet të tolerohen tentimet e tij për t'u distancuar nga ky koment.

214. Përtej anashkalimit të justifikimeve semantike të të akuzuarve – sepse në fakt të akuzuarit i zbuluan emrat e dëshmitarëve duke ua dhënë ata emra mediave, pavarësisht se a i kanë thënë me zërin e tyre apo jo – është e qartë se ata ishin plotësisht të vetëdijshëm se sjellja e tyre do të rezultonte në frikësimin e dëshmitarëve. Dijenia për këtë qartësi faktike është plotësisht brenda kriterit alternativ që të akuzuarit të veprojnë me synim të drejtpërdrejtë apo eventual sipas KPK-së.⁶³⁰

2. Teoria e çështjes – Pika 3

215. Provat vërtetojnë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit përdorën kërcënime të rënda që të nxisnin ose të tentonin të nxisnin persona që të mos jepnin deklaratave ose të jepnin deklaratë të rreme për ZPS-në dhe/ose DHSK-në (Pika 3).

216. Në veçanti, provat tregojnë se të akuzuarit deklaruan se dokumentet përfshirë emrat, të dhënat personale dhe deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve të ZPS- ishin bërë të disponueshme për shtypin.⁶³¹ Ata përmendën me emra dëshmitarë konkretë dhe punën që kishin, së bashku me të dhëna të tjera personale dhe vendet e krimeve për të cilat u pyetën.⁶³² Ata bënë të qartë se tani publiku do të mësonte se kush ishin

⁶²⁸ P00083ET, f.SPOE00222264.

⁶²⁹ Gucati, T.2309.

⁶³⁰ KPK, neni 21; Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.82.

⁶³¹ Para. 31-34, 38-39, 49, 59, 73, 77, 90, 93, 97, 100, 116, 118 më lart.

⁶³² Para. 32, 63-64, 68-69, 96-97, 120 më lart.

dëshmitarët e ZPS-së.⁶³³

217. Deklaratat publike të të akuzuarve se i kishin njohur disa emra që përmbanin dokumentet⁶³⁴ synonin qartë që të paralajmëronin çdokënd që kishte bashkëpunuar me TFHS-në/ZPS-në se tani dihej bashkëpunimi i tyre. Të dy të akuzuarit bënë komente nënçmuese dhe akuzime kundër dëshmitarëve, përfshirë Gucatin duke iu referuar atyre si 'tradhtar[ë]' që gënjejnë,⁶³⁵ dhe Haradinajn duke i përshkruar si 'kriminelë, gjakpirës' dhe spiunë që e tradhtuan popullin e tyre.⁶³⁶

218. Sjellja e të akuzuarve përbën kërcënim të rëndë, që mund të nxisë persona që të mos japin deklaratë ose që të japin deklaratë të rreme apo të mos i japin informacion të vërtetë në ndonjë mënyrë tjetër, ZPS-së dhe/ose DHSK-së, siç kërkohet në nenin 387 të KPK-së. Forca frikësuese e fjalëve dhe veprimeve të të akuzuarve bëhet edhe më e qartë kur merret parasysh në kontekst të së kaluarës së frikësimit të dëshmitarëve në procese penale kundër anëtarëve të UÇK-së.⁶³⁷

219. Provat vërtetojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për, dhe dëshironin të nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratë, ose të jepnin deklaratë të rreme apo të mos i jepnin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose DHSK-së. Vetë të akuzuarit shprehimisht i pranuan motivet e veprimeve të tyre, përfshirë dëshirën e tyre që të dëmtojnë procesin gjyqësor të DHSK-së/ZPS-së.⁶³⁸ Si alternativë, të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se, si rezultat i veprimeve të tyre, mund të ndodhte kjo pasojë e ndaluar me ligj dhe u pajtuan që kjo pasojë e ndaluar me ligj të ndodhte.

H. HAKMARRJA

⁶³³ Para. 31, 33, 87 më lart.

⁶³⁴ Para. 40, 97, 120 më lart.

⁶³⁵ Para.40 më lart.

⁶³⁶ Para.87 më lart.

⁶³⁷ Para.128, 202-203 më lart.

⁶³⁸ Para. 34-35, 52, 59, 68, 70, 74-76, 80-81, 84, 87-88, 104, 115, 117, 119-120, 123-124 më lart.

3. Të akuzuarit ndërmorën veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve

220. Zbulimi i emrave të dëshmitarëve konsiderohet veprim i dëmshëm i ndërmarrë nga të akuzuarit brenda kuptimit të këtij krimi,⁶³⁹ veçanërisht në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë. Siç është shpjeguar më lart në akuzat e pengimit dhe frikësimit, të akuzuarit donin njëherazi t'i dekurajonin dëshmitarët e rinj që të flisnin me DHSK-në/ZPS-në dhe t'i dënonin ata që tashmë ishin duke bashkëpunuar.

221. Sa i përket kategorisë përkatëse të individëve për këtë akuzë, ajo përfshin të gjithë personat që përkufizohen si 'dëshmitarë' brenda kuptimit të Aktakuzës.⁶⁴⁰ Dëshmitarët kundër të cilëve kryhet hakmarrje brenda kuptimit të kësaj akuze përfshijnë: (i) personat që i dhanë ZPS-së intervista si dëshmitarë; (ii) personat që u dhanë intervista organeve të tjera të rendit dhe ligjit dhe të cilët ZPS-ja kërkonte t'i intervistonte; dhe (iii) autoritetet shtetërore që dhanë dokumentacion që vërtetonte krimet/kryesit përkatës ose mundësuan kontakte me ata që kishin informacion të tillë.

222. Për hakmarrje nevojitet veprimi i dëmshëm; shkaktimi i dëmit konkret nuk është element i kësaj vepre penale.⁶⁴¹ Megjithatë, dëshmitarët u dëmtuan nga sjellja e të akuzuarve. Dëshmitarët u frikësuan dhe e humbën besimin se ata dhe familjet e tyre do të mbroheshin.⁶⁴² Disa dëshmitarë u përballën me rrezik aq të madh sa që u nevojit zhvendosja e tyre.⁶⁴³

4. Të akuzuarit synonin të hakmerreshin kundër dëshmitarëve për dhënien e informacionit të besueshëm

⁶³⁹ KPK, neni 388(1).

⁶⁴⁰ Aktakuza, KSC-BC-2020-07/F00251/A01/RED, para.4; Parashtrime për termin "dëshmitar", KSC-BC-2020-07/F00281, para.3.

⁶⁴¹ Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para. 23-24.

⁶⁴² Jukić, T.1703, 1706-07.

⁶⁴³ Jukić, T.1707-09, 1760-61, 1888-93, 1901-02, 1905-06.

223. Për hakmarrje, i akuzuari duhej të vepronte me synimin konkret të hakmarrjes kundër dëshmitarëve për dhënien e informacionit të besueshëm dhe gjithashtu duhej ta dinte se ky informacion mund të ishte i vërtetë.⁶⁴⁴ Nuk ekziston kriter që të akuzuarit duhet ta dinë identitetin e saktë të dëshmitarit kundër të cilit kryhet hakmarrja për shkak të sjelljes së tyre, duke vënë në dukje se dispozita vlen për veprimin e dëmshëm të ndërmarrë kundër 'cilitdo person'.⁶⁴⁵ Të njëjtët elemente që tregojnë se të akuzuarit synonin frikësimin e dëshmitarëve demonstronjë synimin konkret të nevojshëm.

224. Nuk nevojitet të dihet nëse të akuzuarit dinin se informacioni ishte objektivisht i vërtetë, pasi informacioni i besueshëm përmendet vetëm në kontekst të elementeve subjektive të krimit.⁶⁴⁶ Interpretimi i kundërt do të rezultonte në hetime disproporcionale, pasi çdo gjykim në lidhje me hakmarrjen në Kosovë do të përfshinte gjykim anësor mbi besueshmërinë dhe bazueshmërinë e informacionit të dhënë fillimisht në një proces tjetër.

225. Duke sulmuar këdo që bashkëpunonte me TFHS-në/ZPS-në, të akuzuarit, si rregull, sulmuan çdo dëshmi të besueshme. Të akuzuarit i cilësuan këta dëshmitarë si 'gënjeshtarë'⁶⁴⁷ vetëm për t'i diskredituar dhe njollosur dëshmitarët që jepnin dëshmi për krimet e pretenduara të kryera nga anëtarë të UÇK-së. E vërteta është se të akuzuarit ishin mjaft të qartë se nuk ishin përpjekur që të qartësonin të vërtetën ose falsitetin e informacionit që iu ishte dhënë.⁶⁴⁸ Të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se

⁶⁴⁴ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 55-57, 136. *Shih gjithashtu* Parashtrime sipas Rregullës 130, KSC-BC-2020-07/F00447/RED, para.49; Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para. 25-26.

⁶⁴⁵ KPK, neni 388(1).

⁶⁴⁶ Neni 388(1) i KPK-së (në pjesët përkatëse, me theksimet e shtuara: '[k]ushdo që ndërmerri ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person, përfshirë ndërhyrjen në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës së ndonjë personi, me qëllim të hakmarrjes për shkak të dhënies së informatave të vërteta policisë, hetuesit, prokurorit apo gjyqtarit të autorizuar lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale').

⁶⁴⁷ Gucati, T.2367-69; Gucati, 1D00003ET, para. 23, 70.

⁶⁴⁸ Gucati, T.2371, 2438; Haradinaj, T.2997-98.

informacioni që kishin në posedim – përfshirë informacionin e dhënë zyrtarisht nga dëshmitarët për prokurorinë – mund të ketë qenë i vërtetë, duke vënë në dukje në shumë momente gjatë periudhës së Aktakuzës pohimet e tyre se Paketat ishin autentike.⁶⁴⁹ Deklaratat e Mbrojtjes se të akuzuarit e dhanë këtë informacion si sinjalizues në interesin publik gjithashtu nënkupton se besohej se vetë informacioni ishte i vërtetë.⁶⁵⁰

5. Teoria e çështjes – Pika 4

226. Së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit ndërmorën veprime ose tentuan të ndërmerrnin veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve me qëllim për t'u hakmarrë për dhënien e informacionit të besueshëm ZPS-së në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale (Pika 4).

227. Provat tregojnë se të akuzuarit shpërndanë në mënyrë të përsëritur identitetet, të dhënat personale dhe dëshmi të dëshmitarëve dhe personave të tjerë që kishin bashkëpunuar me TFHS-në/ZPS-në dhe i bënë të njohura publikisht këto shpërndarje.⁶⁵¹ Ata inkurajuan në mënyrë të përsëritur të tjerë që të shpërndanin këtë informacion,⁶⁵² në mënyrë të pakufizuar. Kjo sjellje përbënte shkelje të të drejtave të dëshmitarëve për privatësi dhe krijoi rreziqe për sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

228. Të akuzuarit nuk bënë, dhe as nuk ishin në gjendje ta bënin, dallimin midis personave që kishin dhënë informacion të besueshëm ose jo të besueshëm për TFHS-

⁶⁴⁹ P00009ET, f.7 (Gucati duke thënë më 22 shtator 2020 se ZPS-ja kishte konfirmuar zyrtarisht se Paketat u përkisnin atyre); P00029ET, f.1; P00019ET, f.2 (theksimet janë shtuar: 'Unë mendoj se këtu është ajo misteriozja, këtu është ajo e keqja. Ndërsa dokumentet e dinë ata se janë të tyre dhe këtu nuk ka teori. Edhe ne, filluam, të parën herë kemi dyshu, por jo, dokumentet shihen që janë origjinale dhe dokumentet e tyre. Shënojnë "Top Secret". Këta dokumente, as s'kish ditë kush me i mbarue, pa konë aty.'). Haradinaj përsëri është i mjegullt kur kundërshtohet në lidhje me shkëmbimin e fundit të cituar, duke refuzuar të pranojë çfarë kishte thënë më parë. Haradinaj, T.2950-54. *Shih gjithashtu* P00012ET, f.2.

⁶⁵⁰ Myers, T.3112, 3130-32, 3180; Myers, 2D00006, para.34.

⁶⁵¹ Para. 31-34, 38-39, 49, 59, 73, 77, 90, 93, 97, 100, 116, 118 më lart.

⁶⁵² Para. 56, 58, 65, 69, 74, 77, 97-100, 119 më lart.

në/ ZPS-në, në mesin e qindra identiteteve dhe të dhënave personale që kishin shpërndarë. Rrjedhimisht, nuk ka dyshim se ata ishin të vetëdijshëm se këto dëshmi mund të ishin të vërteta dhe kishin qëllim të hakmerreshin kundër dëshmitarëve për dhënien e informacionit të besueshëm.⁶⁵³

229. Të akuzuarit ndërmorën veprime të dëmshme duke ditur së paku se po zbulonin të dhëna personale konfidenciale të dëshmitarëve⁶⁵⁴ dhe cenonin të drejtën e tyre për privatësi. Gjithashtu, të akuzuarit ishin plotësisht të vetëdijshëm se zbulimi i identiteteve të dëshmitarëve do të shkaktonte shqetësime për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.⁶⁵⁵ Të akuzuarit synonin të shkaktonin këtë dëm. Veprimet e dëmshme të nevojshme sipas nenit 388(1) të KPK-së kanë të bëjnë me vetë sjelljen, dhe nuk do të thotë se dëmi i synuar duhet të ketë ndodhur. Sidoqoftë, provat tregojnë se veprimet e të akuzuarve ishin faktikisht të dëmshme për dëshmitarët.⁶⁵⁶

I. SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS

6. Paketat ishin të fshehta

230. Paketat kishin tregues të qartë të konfidencialitetit dhe përmbanin informacion që nuk ishte zbuluar më parë.⁶⁵⁷ Të akuzuarit e dinin këtë.⁶⁵⁸ Në veçanti, akuzat e tyre se informacioni duhet të ketë 'rrjedhur' nga DHSK-ja/ZPS-ja gjithashtu ka kuptim vetëm nëse të akuzuarit e dinin se informacioni ishte konfidencial.⁶⁵⁹

231. Paketa 1 përmban korrespondencën me Serbinë dhe është shënuar si konfidenciale në tërësinë e saj.⁶⁶⁰ Edhe pse Paketa 2 përmban kryesisht dokumente

⁶⁵³ KPK, nenet 21, 388(1).

⁶⁵⁴ Para. 31-34, 39, 49, 59, 73, 77, 90, 93, 97, 100, 116, 118 më lart.

⁶⁵⁵ Para. 31-34, 41, 87, 93 më lart.

⁶⁵⁶ Para. 125, 127-128, 130.

⁶⁵⁷ Pumper, T.1058-59, 1086-87; P00086, para.12; P00088.

⁶⁵⁸ Gucati, T.2418; P00019ET, f.2; P00059ET, f.081983-081986; P00015ET, f.2.

⁶⁵⁹ Gucati, T.2264, 2288, 2373; Haradinaj, 2D00001ET, para.35.

⁶⁶⁰ Pumper, T.874-76, 1472-74; P00090, Shtojca 2.

publike, gjashtë faqe të korrespondencës serbe gjithashtu janë në Paketën 1.⁶⁶¹ Të akuzuarit konfirmuan se e dinin që faqe të njëjta me ato në Paketën 1 i përmbante edhe Paketa 2⁶⁶² - edhe duke i treguar ato faqe para kamerave gjatë konferencës së dytë për shtyp⁶⁶³ - dhe tashmë e kishin marrë në dorëzim Urdhrin e Parë që i udhëzonte të mos shpërndanin materialin e Paketës 1. Paketa 3 ishte shënuar qartë gati në çdo faqe se ishte material i brendshëm pune i ZPS-së.⁶⁶⁴

232. Materiali tepër i ndjeshëm në Paketa – që përmbante kërkesa për bashkëpunim me autoritete shtetërore, deklarata të dëshmitarëve të dhëna autoriteteve të prokurorisë dhe materiale të brendshme pune – trajtoheshin si konfidenciale nga TFHS-ja/ZPS-ja dhe nuk do të ishin publikuar kurrë po të mos ishte sjellja e të akuzuarve.⁶⁶⁵ Pjesët konfidenciale të këtyre Paketave nuk janë deklasifikuar ose riklasifikuar nga TFHS-ja/ZPS-ja apo autoritetet serbe.⁶⁶⁶ Publikimet e para të këtyre faqeve ndodhën në datat e mbajtjes së konferencave për shtyp të OVL-UÇK-së.⁶⁶⁷ Këto publikime janë të pakthyeshme dhe fakti që artikujt që kanë bërë publik material nga Paketat janë ende në internet⁶⁶⁸ është i parëndësishëm për klasifikimin e këtyre

⁶⁶¹ P00090, Shtojca 4; P00086, para.2; Pumper, T.915-17.

⁶⁶² Gucati, T.2266-73 (nga 2266: 'Mu më ka interesu paketa e parë dhe jam bind që jeni duke bashkëpunuar me gjykatën serbe, kjo ka qenë gjithçka. Është shumë reale që prapë edhe në paketën e dytë ka pasë dokumentacione që keni bashkëpunu me gjykatën serbe.');

Haradinaj, 2D00001ET, para.76.

⁶⁶³ P00002ET, min.00:50-01:06.

⁶⁶⁴ P00086, para.35; P00090, shtojca 5. *Shih gjithashtu* Pumper, T.931-32, 1059, 1062 (pyetjet e mbrojtësit drejtuar dëshmitarit).

⁶⁶⁵ *Shih* P00001ET, f.4, 8 (nga f.4: 'Nje e dime, çdo material qe rrjedh prej qesaj Organizate a qetu, qetu duhet dikush me i marre te na materialet, se nuk muj e merr tjeterkush'); P00006ET, f.19, (theksimet janë shtuar: 'Z. HARADINAJ : Ti d'I kishe publiku hiç mos me të pat thirr unë. E ma ja pas çu gjykatës, qysh po thu ti, ti s'i kishe publiku, se gjykata s'ti kishte kallxu hiç ty. Z. SHABANI: Ato me mos pas me i publiku, me mos pas i nxjerr ju në konferencë për media do të thotë nuk kish pas kurrë mundësi me i marr. Z. HARADINAJ: Aty më rri. E dyta, me i pas çu në gjyukatë siç po thu ti, s'i kishe pa hiç'); Haradinaj, T.2942-45; Gucati, T.2285-88; Pumper, T.1470-71, 1474.

⁶⁶⁶ *Shih* Reid, T.3278, 3280 (të dhënat e hetimit dhe deklaratat e dëshmitarëve në hetime penale trajtohen si konfidenciale deri kur prokuroria përmbush detyrimin e nxjerrjes së materialeve), T.3285-87 (edhe analizat paraprake të provave konfidenciale klasifikohen si konfidenciale).

⁶⁶⁷ *Shih* Pumper, T.1475; P00024ET, f.3 (Haradinaj, duke iu referuar Paketës 1: 'na e kemi bo permes mediave, e kemi bo publike.').

⁶⁶⁸ 1D00010.

materialeve ose për përgjegjësinë e të akuzuarve për publikimin e tyre të paligjshëm.

7. Nuk ka rëndësi materiale nëse të akuzuarit e konsideronin klasifikimin e Paketave të arsyeshëm

233. Në momente të ndryshme gjatë gjyqimit, Mbrojtja dhe/ose të akuzuarit kanë sugjeruar se informacioni në Paketa është klasifikuar gabimisht si konfidencial ose se përndryshe nuk ishte sekret.⁶⁶⁹ Këto pohime nuk kanë aspak rëndësi materiale.

234. Në kontekstin e Pikave 5-6, informacioni i mbrojtur është më shumë se informacioni i nxjerrë në procese ose të deklaruar sekret nga gjykatat.⁶⁷⁰ Kjo vlen gjithashtu edhe për informacionin i cili 'sipas ligjit nuk mund të zbulohet', dhe për këtë arsye përfshin të gjithë informacionin e mbrojtur sipas kornizës ligjore të DHSK-së.⁶⁷¹ TFHS-ja/ZPS-ja i klasifikon të dhënat e saja të hetimeve penale si konfidenciale,⁶⁷² dhe korniza ligjore e DHSK-së konfirmon se materiale të tilla nuk duhet të konsiderohen si dokumente publike.⁶⁷³

235. Këto klasifikime konfidenciale mund të ndryshohen në mënyrë gjyqësore në DHSK,⁶⁷⁴ por jo me mbërritjen e Paketave në OVL-UÇK apo me vendimin e njëanshëm të të akuzuarve. Po të ishte ndryshe, atëherë konfidencialiteti i informacionit kyç do të humbte mbrojtjen çdo herë që dikush do të vendoste në mënyrë subjektive se nuk e meritonte klasifikimin.

⁶⁶⁹ Haradinaj, T.2945; Gucati, 1D00003ET, para.72; Haradinaj, 2D00001ET, para.134 ('DHS/ZPS po përpiqen të fshehin bashkëpunimin e tyre me autoritetet serbe, dhe sikletin që kjo u shkakton, duke klasifikuar disa aspekte të hetimeve të tyre si konfidenciale. Ata nuk duhet të lejohen ta bëjnë këtë.');

⁶⁷⁰ *Shih* Transkript, 8 shtator 2021, f.651-52, 677.

⁶⁷¹ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.37.

⁶⁷² Pumper, T.861-62.

⁶⁷³ Neni 62.

⁶⁷⁴ Rregulla 82(5).

8. Paketat përmbanin identitetet dhe informacion të dëshmitarëve të mbrojtur

236. Të akuzuarit konfirmuan se materialet në posedim ishin jopublike dhe përfshinin emrat e dëshmitarëve të TFHS-së/ZPS-së.⁶⁷⁵ Këmbëngulja e tyre e përsëritur se nuk do të përmendnin asnjë emër të dëshmitarëve konfirmon se i kishin parë në Paketat që kishin marrë në dorëzim.⁶⁷⁶

237. Që në konferencën e parë për shtyp, të akuzuarit bënë më se të qartë se e dinin që Paketat përfshinin dëshmitarë të mbrojtur.⁶⁷⁷ Ishte lehtësisht e qartë se Paketat përfshinin njerëz të mbrojtur.⁶⁷⁸ Vetëm në Paketën 3 përmenden afërsisht 150 dëshmitarë të ZPS-së.⁶⁷⁹

238. Pumper mundi të verifikonte se këta dëshmitarë në atë kohë ishin objekt i urdhrave për mosnxjerrje të informacionit – ose kërkesave në shqyrtim e sipër për urdhra të tillë – në DHSK⁶⁸⁰ dhe në Kosovë.⁶⁸¹ Për kërkesat/urdhurat që janë bërë në çështjet gjyqësore të kësaj gjykate, në kohën e konferencave për shtyp këto kërkesa/urdhura kishin klasifikim rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* dhe nuk ishin

⁶⁷⁵ Gucati, T.2240-42, 2256-63, 2297-2303, 2417-18 (duke pranuar se Paketa 1 ishte e ndjeshme dhe përmbante emra të dëshmitarëve), 2420-21; Gucati, 1D00003ET, para.14 (në lidhje me Paketën 1: 'Ishim duke shikuar dokumentat dhe konstatuam se dokumentat ishin nga Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK). Ne kuptuam se ishin dokumente zyrtare por aty kishte dhe dokumente nga Serbia. Ne e kuptuam se ishin dokumenta me rendesi dhe ishte në interesin tonë që të kuptojmë se si kanë ardhur dokumentat në zyrat tona'); P00035ET, f.12; P00021ET, f.4-5; P00009ET, f.9-12 (Gucati pa emrat e 'shumë gjin që na kemi besu n'ta', duke treguar se i njihje emrat).

⁶⁷⁶ Për shembull Gucati, 2297-2303; Haradinaj, T.2758-59.

⁶⁷⁷ P00001ET, f.2 ('Çka është ma e keqja - shkarazi po thom [Tregon me dorë letrat në tavoline] ketu janë emrat e të gjithë dëshmitarëve që ata thone i kemi në mbrojtje. Të gjithëve!'), *konfirmuar nga* Haradinaj, T.2963.

⁶⁷⁸ Pumper, T.873, 884-87, 949; P00086, para.11; P00088, para.12, *lexuar me* P00087, f.1 (Paketa 1 përmban mbi 35 deklarata ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve që ishin marrë nga autoritetet serbe).

⁶⁷⁹ Pumper, T.950, 1317-18, 1342; P00086, para.31.

⁶⁸⁰ Pumper, T.953-59, *i referohet* P00152 (lëshuar më 12 qershor 2020); P00151 (lëshuar më 12 qershor 2020) P00154 (protokolluar më 28 maj 2020). Është parashtrimi origjinal i protokolluar, jo data e versionit të redaktuar publik, që klasifikon informacionin e dëshmitarit në fjalë.

⁶⁸¹ Pumper, T.961-64, 1007-08, 1329-33, *i referohet* P00161.

mbajtur paraqitjet e para në ato çështje.⁶⁸² Pumper gjithashtu mundi të verifikonte se Paketa 3 përfshinte informacion nga organizata ndërkombëtare me kufizime të bashkëngjitura për nxjerrjen e informacionit.⁶⁸³

239. Nuk është e domosdoshme që të akuzuarit të jenë në dijeni të ligjit ose urdhrat konkret që i jep mbrojtje dëshmitarit në fjalë; ky nuk është element i veprave penale sipas Pikave 5 ose 6. Një kriter i tillë do të ishte i paarsyeshëm, duke pasur parasysh se urdhrat për mosnxjerrje të informacionit – nga vetë natyra e tyre – nuk do t'i shërbenin qëllimit për të cilin lëshohen nëse hartohen në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin publik të informacionit konkret që trajtojnë. Mjafton që të akuzuarit të jenë në dijeni se informacioni i dëshmitarit në fjalë është i mbrojtur ose mund të jetë i mbrojtur.⁶⁸⁴

240. Në këtë aspekt, thjesht fakti se këta dëshmitarë ishin të përfshirë në materialet konfidenciale ose të brendshme të TFHS-së/ZPS-së, mjafton në vetvete që këtyre personave t'u jepet statusi i mbrojtur sipas ligjit.⁶⁸⁵ Të akuzuarit nuk bënë asnjë përpjekje që të redaktonin informacionin që kishin parë, duke i zbuluar të gjitha faqet e Paketave për shtypin pa kurrfarë ndryshimesh. Pumper përshkroi në hollësi se cilat faqe të Paketës 1 përfshinin informacion të dëshmitarëve.⁶⁸⁶

241. Aq shumë dëshmitarë janë përmendur sa që nuk ka dyshim se të akuzuarit e dinin se në Paketa ishin emra të personave të mbrojtur. Pavarësisht se sa shumë të akuzuarit i kishin rishikuar Paketat para konferencave për shtyp – dhe anëtarët e OVL- UÇK-së dhanë përgjigje të ndryshme në këtë aspekt⁶⁸⁷ – ata kishin njohuri të

⁶⁸² I akuzuari i parë i DHSK-së që doli para gjykatës – Salih Mustafa – u arrestua më 24 shtator 2020. *Shih* P00031ET.

⁶⁸³ Pumper, T.967-70, *i referohet* 094674-094675.

⁶⁸⁴ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 47-50.

⁶⁸⁵ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.44.

⁶⁸⁶ P00090, Shtojca 1.

⁶⁸⁷ Çelë Gashi, T.2591-98; Haradinaj, 2725-26, 2744, 2782, 2785, 3003-04; P00024ET, f.7; P00082ET; P00018ET, f.3-4; P00035ET, f.2; P00008ET, f.20, 33.

mjaftueshme se Paketat përfshinin kërkesa për bashkëpunim, emra dëshmitarësh, dhe dëshmi të dëshmitarëve.⁶⁸⁸ Ata donin të zbulonin ato që kishin sa më parë që të ishte e mundshme.⁶⁸⁹

9. Të akuzuarit identifikuan me emër dëshmitarë të mbrojtur

242. Të akuzuarit i mbrojnë veprimet e tyre duke thënë se nuk kishin identifikuar me emër asnjë dëshmitar, duke i ikur realitetit se ata megjithatë kishin zbuluar informacionin e mbrojtur të tyre. Sidoqoftë, të akuzuarit gjithashtu identifikuan dëshmitarë të mbrojtur me emër.

243. Megjithëse të akuzuarit në konferencat e tyre për shtyp identifikuan me emër një zyrtar serb, bashkëpunimi i të cilit me ZPS-në ishte i njohur paraprakisht– Vladimir Vukçević⁶⁹⁰ – ata identifikuan me emër një numër zyrtarësh serbë bashkëpunimi i të cilëve me ZPS-në u zbulua për herë të parë.⁶⁹¹ Këta emra i përmbante në veçanti Paketa 1.⁶⁹² Si shembuj, emrat, adresat e fundit të njohura dhe numrat e telefonit të [REDAKTUAR] – emrat e të cilëve u përmendën gjatë konferencës së parë për shtyp⁶⁹³ – janë përfshirë në shtojca konfidenciale të kërkesave të ndryshme, midis dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të tjerë të cilët TFHS-ja kishte kërkuar t'i intervistonte.⁶⁹⁴

244. Këta persona cilësohen 'dëshmitarë' në Aktakuzë, sepse ata ishin persona që

⁶⁸⁸ P00035ET, f.2, 13; Gucati, T.2243-47; Haradinaj, T.2784; P00033ET, f.2; P00017ET, f.2-3; P00001ET, f.2 (ku analizohet cilësia e deklaratave të dëshmitarëve në Paketën 1); P00006ET, f.26.

⁶⁸⁹ Haradinaj, T.2727 (në lidhje me Paketën 1).

⁶⁹⁰ C00001; Pumper, T.1089-90.

⁶⁹¹ Gucati, T.2255-56 ('Py. A patë deklaratatë të dëshmitarëve serbë zoti Gucati? Pë. Në ato dokumentacione çka kam pa njëherë, kam pa deklaratatë të dëshmitarëve [...]'); Gucati, 1D00003ET, para.22; P00018ET, f.2-3; P00001ET.

⁶⁹² Pumper, T.881-84; P00086, para.10; P00087, f.1.

⁶⁹³ P00001ET, f.2.

⁶⁹⁴ P00086, para.10; P00087, f.1; Pumper, T.884-885.

kishin informacion për krimet brenda juridiksionit të DHSK-së.⁶⁹⁵ Pretendimet në artikuj të mediave që nuk bazoheshin në burime se këta zyrtarë mund të kenë kryer krime gjatë luftës në Kosovë, nuk janë të vërtetuara mjaftueshëm me prova dhe, më thelbësorja, janë të parëndësishme për akuzat.

245. Të akuzuarit gjithashtu identifikuan me emër dëshmitarë shqiptarë në të cilët bazohej ZPS-ja,⁶⁹⁶ [REDAKTUAR].⁶⁹⁷ Emri [REDAKTUAR] u përmend në Paketën 3,⁶⁹⁸ dhe Haradinaj kishte armiqësi të vjetër me të.⁶⁹⁹ Ai ishte i njohur publikisht në atë kohë,⁷⁰⁰ por ZPS-ja nuk kishte konfirmuar asnjëherë nëse ky apo ndonjë person tjetër ishin dëshmitarë në hetimet që zhvilloheshin. Edhe nëse një dëshmitar bën të ditur për publikun se ai/ajo është dëshmitar, kjo nuk do të thotë se ky person e humb mbrojtjen që i takon ose me ligj, ose sipas praktikave të ZPS-së.⁷⁰¹

246. Fakti se ky person u identifikua me emër nga të akuzuarit tregon se interesi i tyre shkonte përtej ekspozimit të bashkëpunimit të korrespondencës me Serbinë për 'interesin publik'. E vetmja arsye për zbulimin e këtij emri ishte destabilizimi i hetimeve të ZPS-së, kërcënimi i personit në fjalë dhe ndryshimi i mendjes së të tjerëve që të mos bashkëpunonin me DHSK-në/ZPS-në.

10. ZPS-ja asnjëherë nuk u tha të akuzuarve se Paketa 1 mund të mbahej deri në një muaj

247. ZPS-ja bëri përpjekje urgjente për të marrë secilën nga tri Paketat. Paketat 1 dhe 2 u morën një ditë pasi të akuzuarit i bënë publike për mediat.⁷⁰² Paketa 3 u mor të

⁶⁹⁵ Parashtrime për termin "dëshmitar", KSC-BC-2020-07/F00281,; Aktakuza, KSC-BC-2020-07/F00251/A01/RED, para.4.

⁶⁹⁶ Haradinaj, T.2775-76, T.2995-97; 2D00002 (emri 29).

⁶⁹⁷ P00035ET, f.3; P00011ET, f.30; Gucati, T.2387-88; Haradinaj, T.2997-98.

⁶⁹⁸ Pumper, T.953.

⁶⁹⁹ P00083ET, p.SPOE00222241.

⁷⁰⁰ Pumper, T.1315.

⁷⁰¹ Jukić, T.1759-60, 1793-95.

⁷⁰² Moberg, T.1943-44; Pumper, T.843, 851-52, 905; P00092.

njëjtën ditë kur u mbajt konferenca e tretë për shtyp.⁷⁰³ Moberg ishte i prerë se nuk ishte thënë asgjë që mund të kuptohej si leje për OVL-UÇK-në për ta mbajtur Paketën 1 për çfarëdo arsye.⁷⁰⁴

248. Provat e Mbrojtjes që sugjerojnë se ZPS-ja i kishte thënë OVL-UÇK-së se mund ta mbante Paketën 1 deri në një muaj janë jopërputhëse dhe jologjike. E para, dëshmitarët e Mbrojtjes nuk pajtohen nëse kjo është thënë në lidhje me Paketën 1 ose Paketën 2. Çelë Gashi pohoi se kjo ishte thënë në lidhje me Paketën 1,⁷⁰⁵ por të akuzuarit që ishin të pranishëm në sallën e gjyqit gjatë këtij shkëmbimi ku Moberg mohoi kategorikisht se kishte bërë deklaratë të tillë, dëshmuan se komenti në fjalë ishte bërë nga një punonjës tjetër i ZPS-së në lidhje me Paketën 2.⁷⁰⁶

249. Edhe po të pranoheshin thëniet e të akuzuarve, asnjëri prej tyre nuk thotë se ZPS-ja i kishte lejuar të mbanin dokumente deri në një muaj. Shkëmbimi me ZPS-në që të akuzuarit pretendojnë se iu kujtohet është në kontekst të kërkesës së OVL-UÇK-së që Paketën 2 të vinte e ta merrte policia e Kosovës, të cilës ZPS-ja i ishte kundërpërgjigjur se ajo nuk do të vinte dhe ZPS-ja do të qëndronte aty edhe një muaj nëse do të ishte nevoja për t'i sekuestruar Paketat.⁷⁰⁷ Sipas tyre, ZPS-ja ishte më se e vendosur që dokumentet mbaheshin në mënyrë të paligjshme nga OVL-UÇK-ja.

11. Teoria e çështjes – Pikat 5 dhe 6

⁷⁰³ P00054; Gucati, T.2201.

⁷⁰⁴ Moberg, T.1936-38, 1948-49, 1951 ('Py. Faleminderit. Unë do t'ju sugjeroja se më datën 8 keni diskutuar dhe sugjeruar që të prisni, duke i lënë dokumentet në posedim të OVL-së së UÇK-së deri në një muaj, ndërsa është marrë parasysh përfshirja e policisë kosovare. [...] DËSHMITARI: Kjo nuk është e saktë.').

⁷⁰⁵ Çelë Gashi, T.2601-04.

⁷⁰⁶ Haradinaj, T.2767-68; Gucati, 1D00003ET, para.42; Haradinaj, 2D00001ET, para.88.

⁷⁰⁷ Gucati, 1D00003ET, para.42 ('Ata donin të mermin të gjitha dosjet nga ne siç bënë më përpara. Ne thamë se do t'ua jepnim dosjet vetëm në prani të policisë së Kosovës. Ata thanë se ne do të presim këtu një muaj por asnjëherë nuk do të bëhet obligim i policisë se Kosovës të merr dosjet. Ata thanë se dosjet janë të tyre dhe se policia e Kosovës nuk është e përfshirë në situatë.'). Fjalja vijuese – 'Kjo linte të kuptohej se ne mund të mbanim dosjet një muaj.' – thjesht nuk shkon pas asaj të përparshme. *Shih gjithashtu* Gucati, T.2196, 2398-99.

250. Provat vërtetojnë se midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit zbuluan pa autorizim të ZPS-së, DHSK-së apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent⁷⁰⁸ informacionin konfidencial, që përfshinte, por nuk kufizohej me, Paketën 1 (së bashku me Paketën 4), Paketën 2, dhe Paketën 3.⁷⁰⁹

251. Të akuzuarit zbuluan informacion konfidencial përmes: (a) shpërndarjes së dokumenteve konfidenciale për pjesëmarrësit e konferencës së parë, dytë dhe të tretë për shtyp;⁷¹⁰ (b) përmendjes publike të përmbajtjes së dokumenteve konfidenciale gjatë mbi 15 paraqitjeve publike apo në rrjete sociale;⁷¹¹ dhe (c) shpërndarjes së përmbajtjes së informacionit konfidencial të publikuar në media.⁷¹²

(a) *Zbulimi i informacionit të mbrojtur (Pika 5)*

252. Dokumentet dhe informacioni i zbuluar nga të akuzuarit kanë të bëjnë me hetimet dhe procedurat penale konfidenciale të TFHS-së/ZPS-së⁷¹³ dhe janë të mbrojtura me kornizën ligjore të DHSK-së.⁷¹⁴ Si rrjedhojë, ky informacion ishte konfidencial brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, pasi 'sipas ligjit nuk mund të zbulohet'. Gjithashtu, urdhri i parë, midis të tjerash, e njëjtte natyrën konfidenciale dhe jopublike të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë (dhe Paketës 1) dhe ndalonte shpërndarjen e mëtejshme të përmbajtjes së dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë

⁷⁰⁸ Është e qartë nga veprimet e menjëhershme të ndërmarra nga DHSK-ja dhe ZPS-ja për të ndaluar shpërndarjen e mëtejshme të informacionit konfidencial se të akuzuarit nuk ishin të autorizuar, as nga ZPS-ja, as nga DHSK-ja e as nga ndonjë autoritet tjetër kompetent të zbulonin informacion të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë. para. 43-44, 53, 70-71, 105. *Shih gjithashtu* Moberg, T.1930, 1931, 1939-40, 1958; P00052 (P00052AT); P00092; P00056; P00057 (P00057ET); P00055; P00053 (P00053AT); P00004ET, f.3; P00006ET, f.4-5, 17-18, 36; P00054; P00058; P00035ET, f.5-6; P00007ET, f.7, 10-11; P00099, P00100.

⁷⁰⁹ Para. 29-36, 38-39, 46-49, 54, 57, 63-64, 66, 68-69, 72, 82, 89, 92, 94-97, 106-111, 120 më lart.

⁷¹⁰ Para. 29-30, 36, 63, 65-66, 94, 102 më lart.

⁷¹¹ Para. 38-41, 56-59, 68-69, 73-77, 79-81, 83-88, 113-124 më lart.

⁷¹² Para. 37-38, 78, 82-85, 89 më lart.

⁷¹³ Para. 46-49, 54, 72, 106-111 më lart. *Shih gjithashtu* neni 376 i KPK-së dhe neni 6(2) i KPPK-së.

⁷¹⁴ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para.37.

(dhe Paketës 1) . Paketa 2 përfshin kopjet e gjashtë faqeve që përmbante Paketa 1⁷¹⁵ dhe për këtë arsye ishte objekt i Urdhrit të Parë.

253. Të akuzuarit synonin të shpërndanin këtë informacion duke qenë të vetëdijshëm se ishte, dhe pikërisht sepse ishte, konfidencial. Konkretisht, provat tregojnë se të akuzuarit pranuan publikisht se i kishin këqyrrur dokumentet para se t'i bënin publike dhe treguan njohuri të gjerë të përmbajtjes së tyre.⁷¹⁶ Këto materiale qartësisht trajtojnë hetime në çështje penale, që zakonisht janë konfidenciale, dhe i referohen TFHS-së/ZPS-së, e cila në kohën e veprimeve të të akuzuarve nuk kishte zhvilluar ende procese publike. Dokumentet të cilat të akuzuarit i bënin publike përmbanin shenja të shumta se ishin konfidenciale dhe/ose ishin material i brendshëm pune.⁷¹⁷ Vetë të akuzuarit i përshkruan si konfidenciale dokumentet të cilat i bënin publike ose ndryshe përdorën fjalë që tregojnë se ata ishin plotësisht të vetëdijshëm për natyrën e ndjeshme të dokumenteve që kishin vendosur t'i shpërndanin.⁷¹⁸ Gjithashtu, urdhrat e DHSK-së dhe ZPS-së të dorëzuara në OVL-UÇK më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 i informuan të akuzuarit se informacioni që po bënin publik ishte i ndjeshëm dhe jopublik, dhe nuk duhej ta shpërndanin më.⁷¹⁹

254. Duke qenë se përmbushen të gjitha kriteret e nenit 392(1) të KPK-së, të akuzuarit janë përgjegjës për shkelje të sekretit të procedurave përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur në Pikën 5.

(b) *Zbulimi i personave të mbrojtur (Pika 6)*

⁷¹⁵ Para. 72 më lart.

⁷¹⁶ Para. 25, 29-35, 61, 63-65, 92, 94-97 më lart.

⁷¹⁷ Para. 46-49, 54, 72, 106-111 më lart.

⁷¹⁸ Para. 26, 31, 33, 56, 68, 73, 75, 77, 79, 83-84, 86, 90, 95, 104, 116 më lart.

⁷¹⁹ Para. 43-44, 50, 71, 84, 105 më lart. *Shih gjithashtu* P00078 (P00078ET); P00079 (P00079ET); P00083, p.SPOE00222202; P00004ET, f.3, 8; P00004, min.00:02:27-00:03:57, 00:16:42-00:17:19; P00033ET, f.1; P00033, min.00:00:19-00:03:50; P00017ET, f.1, 4-5; P00017, min.00:01:38-00:02:06, 00:06:48-00:11:44; P00007ET, f.3; P00007, min.00:01:20-00:01:58, 00:03:22-00:04:38; P00017ET, f.6, P00017, min.00:12:44-00:15:00; P00058.

255. Më tej, provat tregojnë se të akuzuarit kishin synimin e nevojshëm kur zbuluan ose tentuan të zbulonin, identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve në mbrojtje në proceset e DHSK-së dhe rrjedhimisht janë përgjegjës sipas nenit 392(2) të KPK-së, siç akuzohen në Pikën 6.

256. Konkretisht, provat tregojnë se identitetet dhe të dhënat personale të qindra dëshmitarëve të përfshirë në Paketat 1, 2, dhe 3 ishin klasifikuar dhe mbrojtur si konfidenciale nga TFHS-ja/ZPS-ja.⁷²⁰ Dokumentet në Paketat 1, 2, dhe 3 që përfshinin informacion të tillë ishin shënuar si konfidenciale dhe shprehimisht shkruhej se u referoheshin hetimeve konfidenciale,⁷²¹ ku TFHS-ja/ZPS-ja kishin marrë masa për mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe të dhënave të tyre personale me nismën e tyre.⁷²² ZPS-ja gjithashtu kishte kërkuar zyrtarisht urdhra për mosnxjerrjen e informacionit në pajtim me rregullat 88 dhe 105, pas parashtrimit të Aktakuzave konfidenciale dhe *ex parte*.⁷²³ Gjithashtu, ishin miratuar masa mbrojtëse konkrete nga Trupi Gjykses i DHSK-së në lidhje me identitetet dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve para shtatorit 2020, dhe në veçanti më 12 qershor 2020.⁷²⁴ Gjithashtu, gjashtë faqet e Paketës 2 të cilat tashmë i përmbante Paketa 1 përfshijnë të dhëna personale të dëshmitarëve, të cilat gjithashtu ishin të mbrojtura në pajtim me urdhrin e parë.⁷²⁵

257. Paketa 3 gjithashtu përfshin përmendje të emrave, pseudonimeve dhe provave të dëshmitarëve identitetet e të cilëve ishin objekt i masave mbrojtëse të urdhëruara

⁷²⁰ Para. 46-49, 54, 72, 106-111 më lart. Në lidhje me Paketën 1, *Shih gjithashtu* P00086, para. 9-12; P00090, para. 3-4, shtojca 1; P00088, para.12; Pumper, T.860-61, 866, 870-88, Transkript, 26 tetor 2021, f.1470-71, 1474. Në lidhje me Paketën 2, *Shih gjithashtu* P00086, para. 22-27, Pumper, T.915-18; P00090, para. 5-6, shtojca 3. Në lidhje me Paketën 3, *Shih gjithashtu* P00086, para. 31-35; P00090, para. 7-9, Pumper, T.949-50.

⁷²¹ Para. 46-49, 54, 72, 106-111 më lart.

⁷²² Neni 35(2)(f).

⁷²³ Para. 108 më lart.

⁷²⁴ Para. 108 më lart.

⁷²⁵ Para. 43, 72 më lart.

nga gjykatat e Kosovës, përfshirë mosnxjerrjen e identiteteve të dëshmitarëve, caktimin e pseudonimeve dhe mosnxjerrjen e të dhënave të dëshmitarëve.⁷²⁶ Paketa 3 me tej përmend deklarata të dëshmitarëve dhe dokumenteve dhe informacionit tjetër që organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera i kanë dhënë ZPS-së që ishin konfidenciale dhe me përdorim të kufizuar.⁷²⁷

258. Provat vërtetojnë se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për të zbuluar pa autorizim identitetet ose të dhënat personale të dëshmitarëve të mbrojtur në procedurat e DHSK-së dhe në procedurat e mëparshme penale në Kosovë, ose së paku ishin të vetëdijshëm se do të rezultonte kjo pasojë e ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me këtë pasojë të ndaluar me ligj. Veprimet e të akuzuarve midis 7 dhe 25 shtatorit 2020 demonstrojnë qartë se ata shpërndanë në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme informacion konfidencial që përmbante - dhe zbuluan publikisht - identitetet dhe të dhëna personale të dëshmitarëve.⁷²⁸ Të akuzuarit pranuan se dokumentet që kishin shpërndarë, përmbanin identitetet ose të dhënat personale të dëshmitarëve të mbrojtur në procedurat e DHSK-së.⁷²⁹

259. Gjithashtu, janë përmbushur të gjitha kriteret e formës së rëndë të shkeljes së fshehtësisë së procedurave përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas nenit 392(3) të KPK-së. Siç është shpjeguar më lart, zbulimi i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur rezultoi në pasoja të rënda për dëshmitarët e mbrojtur dhe i pengoi rëndë procedurat penale.⁷³⁰ Provat tregojnë se të akuzuarit synonin të shkaktonin pasoja të rënda për dëshmitarët e mbrojtur në procedurat e DHSK-së ose së paku ishin të vetëdijshëm se mund të ndodhte kjo pasojë e ndaluar me ligj, dhe ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasoje

⁷²⁶ Para.110 më lart.

⁷²⁷ Para. 109, 111 më lart.

⁷²⁸ Para. 31-34, 39, 49, 59, 73, 77, 90, 93, 97, 100, 116, 118 më lart.

⁷²⁹ Para. 31-34, 59, 90, 93, 97, 120 më lart.

⁷³⁰ Para. 125-134 më lart.

të ndaluar me ligj.⁷³¹

J. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

12. Të akuzuarit i kryen veprat penale të paraqitura në Aktakuzë drejtpërdrejt dhe/ose së bashku me të tjerë

260. Të akuzuarit penguan zyrtarët e DHSK-së/ZPS-së, frikësuan/u hakmorën ndaj dëshmitarëve dhe shkelën sekretin e procedurës edhe individualisht edhe së bashku. Secili i akuzuar në mënyrë të pavarur i përmbush të gjitha elementet e krimeve të përfshira në Aktakuzë, dhe për rrjedhojë mund të ndëshkohet si kryes individual. Për Pikën 2 në veçanti, e cila ka një element të veprës së përbashkët, të akuzuarit domosdoshmërisht do të përmbushin elementet e veprave penale së bashku me të tjerë.

261. Provat gjithashtu tregojnë se të akuzuarit vepruan në pajtim me vendimet që i miratuan si pjesë e udhëheqjes së OVL-UÇK-së dhe së bashku me të.⁷³² Në dëshmitë e tyre, të gjithë dëshmitarët e Mbrojtjes pajtohen se çfarë bënë të akuzuarit me dokumentet ishte pjesë e përpjekjeve grupore të udhëheqjes së OVL-UÇK-së.⁷³³ Kjo përfshinte të dy të akuzuarit, Faton Klinakun, Pren Marashin, Metush Kryeziun, dhe Çelë Gashin.⁷³⁴

262. Këta të akuzuar dhe ndihmësit e tyre i këqyrën bashkërisht Paketat, vendosën të thërrisnin konferencat për shtyp, dhe vendosën se si të vepronin kur erdhi ZPS-ja për t'i sekuestruar materialet.⁷³⁵ Haradinaj përshkroi vendimmarrjen e përbashkët pas

⁷³¹ Para. 31-34, 41, 87, 93 më lart.

⁷³² P00009ET, f.8; P00033ET, f.1; Gucati, 1D00003ET, para. 17, 35, 47; Kryeziu, 1D00008ET, para.9; Haradinaj, 2D00001ET, para. 52, 66, 73, 107.

⁷³³ Gucati, T.2169, 2190-91, 2215-16; Haradinaj, T.2727, 2783.

⁷³⁴ Gucati, T.2197, 2410-11; Gucati, 1D00003ET, para.17; Marashi, T.2524-27; Marashi, 1D00007ET, para.12.

⁷³⁵ Gucati, T.2407 (ku diskuton se si Haradinaj qëndroi brenda parametrave të organizatës dhe të ligjit me ato që tha në konferencat për shtyp); Marashi, 1D00007ET, para. 12-13, 19; Haradinaj, T.2743.

arritjes së Paketës 1 si në vijim:

[...] Ata donin të mermin te gjitha dosjet nga ne siç bënë me përpara. Ne thamë se do t'ua jepim dosjet vetëm në prani të policisë se Kosovës. Ata thanë se ne do të presim këtu një muaj por asnjëherë nuk do të bëhet obligim i policisë se Kosovës të merr dosjet. Ata thanë se dosjet janë të tyre dhe se policia e Kosovës nuk është e përfshire në situatë me i thirrre mediat. E vetmja kërkesë ka qenë që sa më shpejt me i thirr mediat.⁷³⁶

263. Vendimi i përbashkët i marrë ishte saktësisht çfarë ndodhi me Paketat 2 dhe 3. Përgjigjja e Hysni Gucati se si Paketa 2 ishte diskutuar së brendshmi para konferencës së dytë për shtyp tregon nivelin e koordinimit kur kishin vendosur që t'i kryenin krimet e paraqitura në Aktakuzë:

Py. A e diskutuat me persona të tjerë në OVL të UÇK-së se çfarë do bënit lidhur me këto dokumente?

Për. Po. Gjithmonë se ne bisedojmë me kryesinë e ngushtë. Që do të thotë edhe pse jam kryetar në kuvend, unë më autorizon kuvendi shumë vendime t'i marr vet, po unë nuk marr vendime kështu kokë më vete. *Po unë nuk marr vendime kështu kokë më vete pa këshillat e shokëve.* Kemi bisedu dhe kemi marrë të njëjtin veprim për të njëjtat arsye që thashë paradite.⁷³⁷

264. Faton Klinaku dhe Tomë Gashi shprehën të njëjtin qëndrim si të akuzuarit çdo herë që u diskutuan Paketat.⁷³⁸

265. Konkretisht, gjatë periudhës kohore të akuzave, Klinaku, midis të tjerash: (i) përfaqësoi OVL-UÇK-në, përfshirë në kontaktet me ZPS-në,⁷³⁹ dhe gjatë programeve televizive;⁷⁴⁰ (ii) mori pjesë dhe/ose kishte dijeni për shpërndarjen e së paku dokumenteve të nxjerrë gjatë herës së parë për mediat, dhe në inkurajimin e këtyre mediave për shpërndarjen e mëtejshme të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë;⁷⁴¹ (iii) deklaroi publikisht se, sa i përket atij dhe të tjerëve, DHSK-ja nuk ekziston

⁷³⁶ Haradinaj, T.2746.

⁷³⁷ Gucati, T.2190 (theksimet janë shtuar).

⁷³⁸ P00013ET, f.1; P00007ET, f.4-5; P00012ET, f.7; P00023ET, f.7; P00076ET; P00022ET (intervista e Klinakut, të cilën Haradinaj e lavdëroi në P00077ET).

⁷³⁹ P00092, para.7; P00089, para.10; P00057 (P00057ET).

⁷⁴⁰ P00013ET; P00023ET.

⁷⁴¹ P00092, para.7; P00013ET, f.1; P00013, min.00:12:22-00:12:49; P00023ET, f.6; P00023, min.00:10:04-00:10:07.

dhe se ai dhe të tjerët nuk e kishin pranuar kurrë;⁷⁴² dhe (iv) mori pjesë në organizimin e tri konferencave për shtyp.

266. Tomë Gashi, midis të tjerash: (i) deklaroi publikisht se shpresonte që dokumentet e nxjerra do të ndihmonin që Aktakuza kundër Presidentit Thaçi të mos konfirmohej kurrë;⁷⁴³ dhe që dokumentet do të mund të përdreshin për të sulmuar besueshmërinë e DHSK-së;⁷⁴⁴ (ii) kërcënoi dëshmitarët gjatë paraqitjeve në televizion duke thënë se po konfirmohej teoria se dëshmitarët nuk mund të mbroheshin në Kosovë dhe duke pyetur se a po mbroheshin me të vërtetë dëshmitarët në Hagë, duke vënë në dukje se ai dhe të tjerë dinin se dokumentet mund të përdreshin për të frikësuar persona të caktuar;⁷⁴⁵ (iii) i lavdëroi veprimet e personit të panjohur i cili i çoi dokumentet në OVL-UÇK;⁷⁴⁶ dhe (iv) theksoi publikisht synimet e të akuzuarve dhe të OVL-UÇK-së që të zbulonin çfarëdo informacioni që iu sillej, përfshirë për arsye se ata ishin kundër DHSK-së.⁷⁴⁷

267. Të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre kryen bashkërisht veprat penale të përfshira në Aktakuzë, ose kontribuan thelbësisht në kryerjen e tyre brenda kuptimit të nenit 31 të KPK-së. Duke vënë në dukje se të akuzuarit cilësohen si bashkëkryes në lidhje me çfarëdo teorie themelore të kryerjes,⁷⁴⁸ nuk është e domosdoshme që të bëhet dallimi teorik midis kryesve të drejtpërdrejtë dhe ndihmësve për të bërë këtë konstatim.

13. Të akuzuarit nxitën mediat që t'i kryenin veprat penale

268. Është meritë e mediave kosovare që dëmi i shkaktuar nga të akuzuarit nuk u

⁷⁴² P00013ET, f.1; P00013, min.00:12:22-00:12:49; *Shih gjithashtu* P00023ET, f.7; P00023, min.00:10:57-00:11:04.

⁷⁴³ P00007ET, f.16-17; P00007, min.00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22; P00012ET, f.2-3; P00012, min.00:01:31-00:04:33, 00:04:42-00:06:21.

⁷⁴⁴ P00007ET, f.3-5; P00007, min.00:04:59-00:09:47.

⁷⁴⁵ P00007ET, f.5, 8-9; P00007, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08.

⁷⁴⁶ P00007ET, f.4-5; P00007, min.00:08:26-00:09:47.

⁷⁴⁷ P00012ET, f.2-5; P00012, min.00:01:31-00:06:21, 00:09:45-00:13:18.

⁷⁴⁸ *Shih në përgjithësi* Komentari i Salihut, neni 31, para.18.

përhap më shumë.⁷⁴⁹ Të akuzuarit donin që mediat të publikonin plotësisht Paketat.⁷⁵⁰ Sipas të akuzuarve, organet e mediave që publikuan materialin ishin të guximshëm.⁷⁵¹ Mirëpo të akuzuarit bënë presion mbi mediat që nuk i publikuan Paketat, duke i akuzuar se nuk po bënë detyrën e tyre kur nuk e publikuan materialin.⁷⁵² Mohimet e të akuzuarve gjatë gjykimit⁷⁵³ nuk përputhen me veprimet e tyre të vërteta gjatë periudhës kohore të Aktakuzës.

269. Trajtimi i gazetës 'Infokus' – organ i medias për të cilin punonte Berisha – nga të akuzuarit është veçanërisht tregues. Të akuzuarit e lavdëruan gazetën 'Infokus' për marrjen e një kopje të plotë të Paketës 1 (e njohur si Paketa 4), e pastaj thanë ata duhej 'të vuanin' pasi ia kthyen ZPS-së.⁷⁵⁴ Kritikat e bëra nga të akuzuarit kundër *Infokusit* – që bëri këqyrje të brendshme të materialit, bëri publike pjesë të kufizuara të tij me redaktime domethënëse dhe ia ktheu të gjithin ZPS-së⁷⁵⁵ – tregon qartë se sa i gabuar

⁷⁴⁹ *Shih në përgjithësi* Zyra e Prokurorit të Specializuar, Deklaratë për Shtyp, 22 shtator 2020, mund të lexohet në <https://www.scp-ks.org/en/press-statement-0> (ku përmend 'profesionalizmin e lavdërueshëm dhe integritetin etik të gazetarëve të Kosovës dhe komentatorëve të tjerë publikë, shumë prej të cilëve kanë folur qartë se si aktivitete të tilla minojnë sundimin e ligjit dhe kursin e drejtësisë').

⁷⁵⁰ P00001ET, f.5 (Haradinaj: 'Edhe pse nje kopje na e kemi, ne emen te Zotit e ruajme edhe juve ju japim kopje sa te doni. Sa te guxonit me lexu ju emna ketu keni. '); P00024ET, f.3, 6, 10; P00033ET, f.3; P00004ET, f.8; P00019ET, f.2; P00030ET, f.20-21; Berisha, T.1521-22 (ku kujtohet një bisedë me Nasim Haradinajn, nga T.1521: 'Py. A të ka dhënë ndonjë njeri ndonjë udhëzim lidhur me çfarë duhet të bëje me këto dokumente? Pë. Udhëzim nuk ka pasë, përveç asaj që më është thënë: Nëse kërkojnë dokumente prej mediave të tjera, atëherë mundësisht me bashkëpunuar. '), 1586, 1634. Haradinaj tha se nuk pajtohej se i kishte thënë Berishës të bëjë kopje për gazetarë të tjerë (Haradinaj, T.2732-33; Haradinaj, 2D00001ET, para.60), por pjesa e cituar tregon se Berisha nuk i kishte thënë ato fjalë në dëshminë e tij.

⁷⁵¹ P00024ET, f.4-5, 10; P00035ET, f.13-14 (Gucati: 'A dashtë edhe një përgjigje këtu. Ju jeni ato mediat që i keni bo publike veteranët fallco me emën e mbiemën.[...] Ju merreni qat guxim njejtë, si guximin e veteranëve. '); P00027ET.

⁷⁵² P00035ET, f.5 (Haradinaj tentoi t'i ikte kuptimit të qartë të asaj që kishte thënë - Haradinaj, T.2975-80); P00006ET, f.11, 35; P00030ET, f.6; P00011ET, f.29; P00024ET, f.3.

⁷⁵³ Guçati, T.2222-33; Guçati, 1D00003ET, para.62; Haradinaj, T.2813; Haradinaj, 2D00001ET, para.129.

⁷⁵⁴ P00006ET, f.16 ('Moderatori: zotëri, Fokusi ka publiku diçka. Z. HARADINAJ: Fokusi, po. Shumë i mirë. Ma i mirë jon kon. Më i miri se në fakt ky ka pranë, ky ka pranë me i marrë se ata kan mujt edhe të tjerët, por shumë mirë ka bo. Ky e ka kry detyrën e et. PO tash po don me ju dal të tjerëve zot, tash let ta vuaj... se ky po sulmon me grup. '); Haradinaj, T.2938-40 (ku diskutohet se si kishte menduar vuajtje më në përgjithësi, edhe pse në pjesën e cituar ishte lëre 'atë' të vuaj). *Shih gjithashtu* Berisha, 1531-32.

⁷⁵⁵ Berisha, T.1525, 1528-30, 1539-41, 1561, 1620-21, 1627; P00098, p.091917 (ku informohet ZPS-ja: 'dëshirojmë t'ju informojmë se një kopje e këtyre dokumenteve na është dhënë nga kjo zyrë në atë

është krahasimi i veprimeve të Berishës me veprimet e të akuzuarve. Sa i përket në veçanti këtyre redaktimeve, dhe në dallim nga të akuzuarit, Berisha dëshmoi se 'çdo dokument që e kemi publiku, jemi mundu me u siguru që mos me dalë asnjë e dhënë që mundet me qenë konfidenciale ose me identifiku diçka. [...]'.⁷⁵⁶

270. Megjithatë, për aq sa të akuzuarit ushtruan ndikim psikologjik për të nxitur njëri-tjetrin, ndihmësit, dhe të tjerë që të kryejnë vepra penale me Paketat, ata janë fajtorë për nxitjen e krimeve në Aktakuzë.⁷⁵⁷ Nxitja paraqitet në disa mënyra si akuzë me qëllim që të akuzuarit të mund të shpallen fajtorë për nxitjen e krimeve edhe nëse nuk janë kryer ose tentuar kurrë.⁷⁵⁸

14. Janë vërtetuar të gjitha format e përgjegjesisë penale të përfshira në Aktakuzë

271. Siç është përcaktuar më lart, janë përmbushur të gjitha elementet e krimeve dhe formave të përgjegjesisë penale për kryerjen e drejtpërdrejt, bashkëkryerjen dhe/ose nxitjen. Janë vërtetuar edhe disa forma alternative të përgjegjesisë, nëse Trupi Gjykses do t'i cilësojë ndryshe veprimet kriminale.⁷⁵⁹

272. ZPS-ja nuk ka ngritur akuzë kundër ndihmësve ose personave të tjerë për kryerje të krimeve në lidhje me Paketat. Në qoftë se Trupi Gjykses konsideron se krime të tilla mund të jenë kryer nga këta persona, të akuzuarit mund të dënohen më tej për ndihmën e atyre krimeve.⁷⁶⁰

konferencë për shtyp, ashtu siç i është dhënë edhe përfaqësuesve të mediave të tjera. Duke ditur rëndësinë e këtyre dokumenteve dhe të përmbajtjes së tyre, kemi qenë shumë të kujdesshëm deri më tani dhe nuk i kemi publikuar. Kështu, i kemi kyçur dokumentet në vend të sigurt dhe duam t'ju informojmë për këtë.').

⁷⁵⁶ Berisha, T.1597.

⁷⁵⁷ Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 88-90.

⁷⁵⁸ Aktakuza, KSC-BC-2020-07/F00251/A01/RED, para. 41-43; neni 32 i KPK-së. Duhet mbajtur parasysh se versioni i nxitjes sipas nenit 32(3) të KPK-së vlen vetëm për Pikat 1-3 dhe 6 në këtë çështje.

⁷⁵⁹ Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para. 34-37.

⁷⁶⁰ *Shih* Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 91-92.

273. Për shkak se të akuzuarit e përmbushin kriterin e synimit kriminal të nevojshëm për të gjitha krimet në Aktakuzë, të akuzuarit janë fajtorë për tentim nëse Trupi Gjykses gjykon se mungon për çfarëdo arsye cilido nga elementet objektive të veprave penale.⁷⁶¹

274. Në fund, për të njëjtat arsye të diskutuara për bashkëkryerje, vetë marrëveshja e arritur nga të akuzuarit që të thërrisnin konferencë për shtyp dhe t'i publikonin Paketat është kriminale. Të akuzuarit duhet të ndëshkohen sepse janë pajtuar që të kryejnë krimet e paraqitura në Aktakuzë edhe nëse Trupi Gjykses përcakton se ato as nuk u kryen e as nuk u tentuan.⁷⁶²

15. Teoria e çështjes – përgjegjësia penale individuale

275. Për të gjitha format e përgjegjesisë penale të paraqitura në Aktakuzë, veprimet dhe deklaratat e qëllimshme të të akuzuarve, ndër të tjera shpërndarja e informacionit konfidencial,⁷⁶³ akuzat kundër dëshmitarëve,⁷⁶⁴ indiferenca ndaj sigurisë së dëshmitarëve,⁷⁶⁵ deklaratat ku pranohet natyra konfidenciale e informacionit konfidencial,⁷⁶⁶ dhe qëllimi i qartë për ta penguar DHSK-në/ZPS-në,⁷⁶⁷ vërtetojnë se të akuzuarit synonin të kryenin krimet e përshkruara më lart dhe të nxisnin dhe ndihmonin kryerjen e atyre krimeve. Sa u përket disa formave të përgjegjesisë penale, këto synime i kishin edhe: (i) Faton Klinaku, Tomë Gashi, dhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së; dhe (ii) dhe personat të cilët, nga distanca ose personalisht, morën pjesë, vëzhguan, ose u informuan në mënyra të tjera për tri konferencat për shtyp dhe deklaratat publike të të akuzuarve; dhe (iii) disa përfaqësues të shtypit ose persona që

⁷⁶¹ *Shih* Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 95-97. Kjo vlen vetëm për Pikat 1-4 dhe 6 në këtë çështje.

⁷⁶² *Shih* Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 93-94.

⁷⁶³ Para. 32, 37-39, 46-49, 54-57, 63-64, 66, 68-69, 72, 78, 82, 89, 92, 94-97, 102, 106-111, 116, 120 më lart.

⁷⁶⁴ Para. 40, 69, 87 më lart.

⁷⁶⁵ Para. 31-34, 41, 59, 68 më lart.

⁷⁶⁶ Para. 31, 33, 68, 73, 75, 77, 79, 83-84, 86, 90, 95, 104, 116 më lart.

⁷⁶⁷ Para. 34-35, 52, 59, 68, 70, 74-76, 80-81, 84, 87-88, 104, 115, 117, 119-120, 123-124 më lart.

posedonin ose kishin qasje në informacionin konfidencial dhe jopublik që kishte të bënte me procedurat e DHSK-së ('personat e tjerë').

276. Si alternativë, siç është demonstruar nga veprimet e qëllimshme dhe deklaratat, të akuzuarit – dhe ndihmësit e tyre dhe personat e tjerë – ishin të vetëdijshëm se krimet e përshkruara më lart mund të ndodhnin si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre dhe u pajtuan me kryerjen e tyre.

(c) *Kryerja dhe tentimi*

277. Përmes këtyre veprimeve, mosveprimeve, dhe synimeve të përshkruara më lart,⁷⁶⁸ të akuzuarit kryen krimet e përfshira në Aktakuzë. Si alternativë, për të gjitha krimet e përfshira në Aktakuzë përveç Pikës 5, të akuzuarit tentuan t'i kryenin këto krime sepse këto veprime/mosveprime përbëjnë ndërmarrje të veprimeve për kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë.

(d) *Bashkëkryerja dhe marrëveshja për të kryer veprë penale*

278. Siç është demonstruar nga qëllimi i tyre për të penguar DHSK-në/ZPS-në⁷⁶⁹ dhe nga veprimet e bashkërenduara për realizimin e qëllimit të përbashkët, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre i kryen krimet në bashkëkryerje dhe/ose u morën vesh t'i kryenin ato. Të akuzuarit kontribuan në mënyrë thelbësore dhe ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e krimeve për realizimin e qëllimit ose marrëveshjes së përbashkët, ndër të tjera përmes:

- i. këqyrjes së informacionin konfidencial;⁷⁷⁰
- ii. marrjes së vendimeve ose pjesëmarrjes në vendimmarrje nëse duhej shpërndarë dhe mënyrën e shpërndarjes;⁷⁷¹

⁷⁶⁸ Para. 189-197, 215-219, 226-229, 250-259 më lart.

⁷⁶⁹ Para. 34-35, 52, 59, 68, 70, 74-76, 80-81, 84, 87-88, 104, 115, 117, 119-120, 123-124 më lart.

⁷⁷⁰ Para. 25-26, 38, 61, 86, 92, 94 më lart.

⁷⁷¹ Para. 27, 62 më lart.

- iii. organizimit të aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në to, ndër të cilat konferenca për shtyp dhe paraqitje publike, ku informacioni konfidencial u shpërnda dhe u diskutua publikisht;⁷⁷²
- iv. shpërndarjes së informacionin konfidencial;⁷⁷³
- v. zbulimit të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve, përfshirë dëshmitarë të mbrojtur;⁷⁷⁴
- vi. akuzimeve kundër dëshmitarëve dhe komente poshtëruese për ta;⁷⁷⁵
- vii. inkurajimit dhe këshillimit të personave me qasje në informacion konfidencial lidhur me procedurat e DHSK-së që të vazhdonin t'i jepnin atë informacion OVL-UÇK-së dhe premtimit për të vazhduar me shpërndarjen e këtij informacioni konfidencial;⁷⁷⁶ dhe/ose
- viii. inkurajimit, udhëzimit dhe këshillimit të përfaqësuesve të mediave dhe të publikut që të merrnin ose incizonin dhe shpërndanin më tej informacionin konfidencial.⁷⁷⁷

(e) *Aktakuza*

279. Përmes një apo më shumë veprimeve të përshkruara në nënpjesën e Bashkëkryerjes/Marrëveshjes,⁷⁷⁸ të akuzuarit ushtruan ndikim psikologjik ndaj njëri tjetrit, ndihmësve dhe personave të tjerë me qëllim të krijimit ose fuqizimit të vendimit të personit tjetër për të kryer vepër penale. Rrjedhimisht, ata nxitën kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë.

280. Si alternativë, përmes një apo më shumë prej këtyre veprimeve të njëjta, të akuzuarit nxitën njëri-tjetrin, ndihmësit dhe personat e tjerë të kryenin krimet të përfshira në Pikat 1-6 dhe u tentua të kryheshin këto krime.

281. Gjithashtu ose si alternativë, përmes një apo më shumë prej këtyre veprimeve

⁷⁷² Para. 27, 38-41, 56-59, 62, 68-69, 73-77, 79-81, 83-88, 94, 113-121, 123-124 më lart.

⁷⁷³ Para. 32, 37-39, 46-49, 54-57, 63-64, 66, 68-69, 72, 78, 82, 89, 92, 94-97, 102, 106-111, 116, 120 më lart.

⁷⁷⁴ Para. 31-34, 39, 49, 59, 73, 77, 90, 93, 97, 100, 116, 118 më lart.

⁷⁷⁵ Para. 40, 69, 87 më lart.

⁷⁷⁶ Para. 52, 58, 65, 73, 75, 79, 83, 87-88, 99, 114-115, 123-124 më lart.

⁷⁷⁷ Para. 35, 56, 58, 65, 69, 74, 77, 97-100, 119 më lart.

⁷⁷⁸ Para.278 më lart.

të njëjta, të akuzuarit nxitën njëri tjetrin, ndihmësit dhe personat e tjerë të kryenin krimet e përfshira në Pikat 1-3 dhe 6, dhe këto krime as nuk u kryen e as nuk u tentua kryerja e tyre.

(f) *Ndihma*

282. Përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në nënpjesën për Bashkëkryerje/Marrëveshje,⁷⁷⁹ të akuzuarit i dhanë ndihmë njëri-tjetrit, ndihmësve dhe personave të tjerë në kryerjen e krimeve të përshkruara më lart.

K. MBROJTJET

16. Nuk ka bazë ligjore për asnjërën nga mbrojtjet e pretenduara

283. Mbrojtja i jep rëndësi të madhe shtytjes dhe interesit publik, duke i përkufizuar si mbrojtje afirmuese.

284. Ato nuk janë të tilla. Ligji është i qartë se vetëm ato pjesë të KPK-së që janë shprehimisht të përfshira në Ligj kanë efekt detyrues mbi DHSK-në.⁷⁸⁰ Nuk është cituar asnjë dispozitë e KPK-së që rregullon 'shtytjen' apo 'interesin publik'.⁷⁸¹ Asnjëra mbrojtje nuk është përfshirë në listën e mbrojtjeve në rregullën 95(5), as Mbrojtja nuk ka ofruar asnjë burim ligjor detyrues përkatës për zbatimin e cilësdo prej këtyre mbrojtjeve në këtë çështje gjyqësore.

285. Në veçanti, pretendimet për të drejtat e njeriut nuk mund ta zëvendësojnë

⁷⁷⁹ Para.278 më lart.

⁷⁸⁰ Neni 3(2)(c).

⁷⁸¹ Fjalët 'shtyj' apo 'shtytje' nuk paraqiten askund në KPK. Nxjerrja e informacionit në 'interesin publik' është mbrojtje ligjore ndaj nxjerrjes së paautorizuar të informacionit konfidencial sipas nenit 200 të KPK-së. Asnjë formulim i tillë nuk ekziston në asnjë prej akuzave në këtë çështje, sidomos në shkëlqen e fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392 të KPK-së. As neni 200 nuk është përfshirë shprehimisht, as në Ligj e as në Rregullore.

mungesën e qartë të bazës ligjore. E drejta njerëzore e lirisë së shprehjes në KEDNJ, për shembull, mund të jetë objekt i kufizimeve ose dënimeve të përcaktuara me ligj dhe ato janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.⁷⁸² Abuzimi me të drejtën e lirisë së shprehjes gjithashtu nuk gëzon të drejtën e mbrojtjes sipas GJEDNJ-së.⁷⁸³ Abuzime të tilla nuk janë të kufizuara vetëm te nxitja për dhunë, por në ‘manifestimet bezdisëse të papërgjegjësive dhe qëndrimit joserioz ndaj Gjykatës’, që përbën mosbindje, mund të çojnë në rrëzimin e kërkesës prej GJEDNJ-së si abuzive.⁷⁸⁴

286. ZPS-ja nuk i akuzon të akuzuarit për krimin e fjalës si të tillë. Ajo i akuzon sipas KPK-së, i cili ndalon të akuzuarit që të pengojnë personat zyrtarë, frikësojnë/hakmerren kundër të tjerëve dhe të shkelin sekretin e procedurave. Këto krime përmenden shprehimisht në Ligj.⁷⁸⁵

17. I akuzuari nuk vepronte për shkak të lajthitjes faktike ose juridike

287. Mbrojtja përmendi shkurtimisht në Dosjet e veta të Procedurës Paraprake mundësinë që të akuzuarit të kenë vepruar për shkak të lajthitjes faktike ose juridike.⁷⁸⁶ Duke vënë në dukje se Ligji shprehimisht përfshin secilin nen të KPK-së nga 21 deri në 40, përveç neneve 25-26⁷⁸⁷ - që janë dispozitat që trajtojnë lajthitjet faktike dhe

⁷⁸² Neni 10(2) i KEDNJ-së.

⁷⁸³ Nenet 17 dhe 35(3) të KEDNJ-së.

⁷⁸⁴ ECtHR, *Zhdanov and others v. Russia*, Judgment, 12200/08 and others, 16 July 2019, para. 81-86 (nga 85: ‘Gjykata konsideron se duke vazhduar me publikimin e fyerjeve për Gjykatën dhe gjykatësit e saj pas paralajmërimit, paraqitësi i kërkesës ka treguar mosrespektim të vetë institucionit të cilit i ka kërkuar mbrojtje të drejtave të tij. Faktikisht, është e papranueshme që të kërkohet mbrojtje nga gjykata për të cilën paraqitësi i kërkesës e ka humbur besimin. Veprimet e tij përbëjnë “manifestim shqetësues të papërgjegjësive dhe qëndrim joserioz ndaj Gjykatës”, që përbën mosbindje [...], dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me qëllimin e të drejtës për kërkesë individuale, siç përcaktohet në nenet 34 dhe 35 të Konventës. Kjo përbën abuzim të drejtës për kërkesë sipas kuptimi të nenit 35 § 3 (a) të Konventës.’); ECtHR, *Petrović v. Serbia*, Admissibility Decision, 56551/11 and others, 18 October 2011.

⁷⁸⁵ Neni 15(2).

⁷⁸⁶ Parashtrim i Redaktuar Publik i Dosjes Paraprake të Përkohshme të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt, KSC-BC-2020-07/F00260/RED, 12 korrik 2021 (versioni i redaktuar u njoftua më 2 shtator 2021), para. 282-83.

⁷⁸⁷ Neni 16(3).

juridike sipas KPK-së – përpiluesit me qëllim e kanë përjashtuar zbatimin e dispozitave të KPK-së të lajthitjes faktike/juridike në DHSK. Edhe nëse këto lajthitje do të mund të zbatoheshin në këtë çështje sipas rregullës 95(5), nuk ka prova se në këtë rast është e zbatueshme lajthitja juridike ose faktike.

288. Mosnjohja e ligjit përgjithësisht nuk është justifikim, dhe lajthitja juridike mund të jetë e zbatueshme vetëm nëse në ndonjë mënyrë do të eliminonte elementin mendor të krimeve të përfshira në Aktakuzë.⁷⁸⁸ Mospajtimi i të akuzuarve se veprimet e tyre nuk duhet të klasifikohen si të kundërligjshme⁷⁸⁹ nuk është aspak i njëjtë me veprimin si lajthitje juridike. Të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për paligjshmërinë e mundshme të veprimeve të tyre gjatë tërë periudhës së akuzave.⁷⁹⁰ Ata ishin të gatshëm të pranonin të gjitha pasojat si rezultat i veprimeve të tyre, dhe këmbëngulën se asgjë nuk do t'i ndalte nga publikimi i materialeve të tjera.⁷⁹¹ Këshilla ligjore e Tomë Gashit nuk ka ndikim në këtë aspekt, duke vënë në dukje se: (i) ai nuk u emërua deri pas konferencës së dytë për shtyp; dhe (ii) çfarëdo këshille ligjore që kishte dhënë, ai thjesht i mbështeti të akuzuarit lidhur me çfarë ishin duke bërë me materialet.⁷⁹²

289. Në mënyrë të ngjashme, lajthitja faktike do të ishte e zbatueshme nëse do të eliminonte krimet e paraqitura në Aktakuzë.⁷⁹³ Të akuzuarit kanë synimin kriminal të

⁷⁸⁸ *Shih ngjashëm Jović* AJ, IT-95-14 & IT-95-14/2-R77-A, para.27 (kur një person është objekt i juridiksionit të Tribunalit Ndërkombëtar, ai duhet t'i bindet urdhrave të tij 'pavarësisht nga pikëpamjet e tij personale për ligjshmërinë e atyre urdhrave'); *Hartmann* TJ, IT-02-54-R77.5, para.65; neni 32 (2) i Statutit të GJPN-së, ICC, *Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo, Decision on the confirmation of charges*, ICC-01/04-01/06-803-tEN, 29 January 2007, para.315.

⁷⁸⁹ Gucati, 1D00003ET, para. 59-60; Haradinaj, 2D00001ET, para. 126-31.

⁷⁹⁰ P00011ET, f.38, 64-65; P00007ET, f.8-9; P00006ET, f.15; P00018ET, f.5-6; P00028ET, f.1-2. Edhe pse jo i zbatueshëm, neni 26(1) i KPK-së lejon lajthitje ligjore nëse i akuzuari, për shkaqe të arsyeshme 'nuk e dinte ose nuk mund ta dinte se veprimi ishte i ndaluar'.

⁷⁹¹ Gucati, T.2218-19, 2221-22, 2401; Haradinaj, T.3021-24; P00024ET, f.7-8; P00026ET, f.2, 4-5; P00021ET, f.4; P00035ET, f.12.

⁷⁹² Gucati, T.2389-94; Haradinaj, 2D00001ET, para.89. Në këtë aspekt, *Shih gjithashtu Jović* AJ, IT-95-14 & IT-95-14/2-R77-A, para.27 (i akuzuari nuk mund të përdorë lajthitjen ligjore si mbrojtje për shkeljen me vetëdije të një urdhri të Tribunalit Ndërkombëtar në bazë të asaj se gabimi ishte bazuar në këshilla ligjore).

⁷⁹³ *Shih ngjashëm* neni 32(1) i Statutit të GJPN-së.

nevojshëm për të gjitha krimet e përfshira në Aktakuzë. Pikat e çështjes për të cilat të akuzuarit pretendojnë se nuk kanë dijeni – siç është vërtetësia apo pavërtetësia e dëshmive të dëshmitarëve në Paketa – nuk e ndryshojnë aspak këtë. Gjithashtu, sa i përket asaj që të akuzuarit këmbëngulin se kishin vepruar në interesin publik, nuk është e qartë se çfarë ‘lajthitje faktike’ mund të kenë pasur të akuzuarit sa i përket përmbajtjes së Paketave.

18. Bashkëpunimi i DHSK-së/ZPS-së me Serbinë kishte qenë i njohur për publikun kur mbërritën Paketat

290. Paketat 1 dhe 2 përmbanin informacion për dëshmitarë të mbrojtur në kontekst të bashkëpunimit të ZPS-së me Republikën e Serbisë. Siç e pranojnë vetë të akuzuarit, bashkëpunimi i ZPS-së me Serbinë ishte i njohur publikisht para se të arrinte cilado prej Paketave në OVL-UÇK.⁷⁹⁴

291. Fakti se ZPS-ja kishte korrespondencë me Serbinë ishte tashmë i njohur, dhe ky është faktor që ka lidhje me shqyrtimin nëse një zbulim informacioni është faktikisht në interesin publik.⁷⁹⁵ I vetmi informacion i ri i zbuluar nga veprimet e të akuzuarve ishin të dhënat konfidenciale hetimore dhe të dëshmitarëve të mbrojtur. Refuzimi i tyre i vendosur për redaktimin e të dhënave të dëshmitarëve në Paketa tregon se të akuzuarit e konsideronin thelbësor zbulimin e të dhënave të dëshmitarëve.

19. Nuk ka prova se bashkëpunimi i DHSK-së/ZPS-së me Serbinë ishte i papërshtatshëm

292. Trupi Gjykses tashmë ka bërë përcaktimin paraprak se nxjerrja e provave për bashkëpunimin me Serbinë në ‘interesin publik’ mund të bëhej vetëm nëse do të kishte

⁷⁹⁴ Gucati, T.2174; P00059ET, f.3; P00028ET, f.10; Haradinaj, T.2709-10, 2713-14.

⁷⁹⁵ Myers, T.3158-59.

tregues se bashkëpunimi ishte në ndonjë mënyrë i papërshtatshëm.⁷⁹⁶ Korniza ligjore thjesht lejon ZPS-në të bashkëpunojë me shtete të treta si Serbia.⁷⁹⁷ Kërkesat e TFHS-së/ZPS-së drejtuar autoriteteve serbe në Paketën 1 ishin pjesë e praktikave hetimore standarde.⁷⁹⁸ Edhe eksperti i Mbrojtjes për standardet hetimore ndërkombëtare vuri në dukje se TPNJ-ja kishte bërë përpjekje të bashkëpunonte me Serbinë gjatë hetimeve të ZP-së së TPNJ-së lidhur me Kosovën.⁷⁹⁹

293. Nuk ia vlen të përmendet se ZPS-ja nuk ka ndikim se cilët zyrtarë nga Republika e Serbisë do të kontaktojnë me të. Fakti se këta persona mund të kenë emër të keq në Kosovë tregon se pse mediat ishin të prira të botonin shkëmbimet e TFHS-së/ZPS-së me ta,⁸⁰⁰ por kjo ndryshon themelësisht nga fakti se të akuzuarit mund të mbështeten në mënyrë të suksesshme në 'mbrojtje të bazuar në interesin publik', për veprime kriminale të paturpshme. Po të ishte ndryshe, atëherë personat do të mund të pengonin lirshëm forcat e ligjit dhe të frikësonin dëshmitarët e mbrojtur vetëm pse kjo ishte në interesin publik.

294. Provat tregojnë qartë se të akuzuarit e konsiderojnë bashkëpunimin me Serbinë vetvetiu jolegjitim.⁸⁰¹ Kjo është bindje politike e cila nuk ka lidhje me (pa)përshtatshmërinë e bashkëpunimit në fjalë.

20. Të akuzuarit nuk mund të konsiderohen sinjalizues

⁷⁹⁶ Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Propozuar të Mbrojtjes, KSC-BC-2020-07/F00470, 3 dhjetor 2021, para.61 ('interesi publik' në lidhje me të cilin mund të lejohet të nxirren prova të rëndësishme është i kufizuar në provat që do të sugjeronin se një pjesë e materialit që pretendohet të jetë nxjerrë nga të akuzuarit përmban shenja të veprimeve të palejueshme që kanë ndodhur në kontekst të bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe TFHS-së/ZPS-së që do të kishte ndikuar në pavarësinë, paanësinë dhe integritetin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së').

⁷⁹⁷ Neni 55.

⁷⁹⁸ Pumper, T.866.

⁷⁹⁹ Reid, T.3361-63.

⁸⁰⁰ *Shih* Berisha, T.1584.

⁸⁰¹ *Shih* Haradinaj, T.2988-89; Haradinaj, 2D00001ET, para.32; Gucati, 1D00003ET, para.68.

295. Mbrojtja paraqet argumente për sinjalizim së bashku me pretendimet për 'interes publik'. Përsëri, nuk ka bazë ligjore për mbrojtje të tillë në këtë çështje.⁸⁰² Ligji i Kosovës lidhur me sinjalizuesit nuk vlen para DHSK-së dhe, edhe sikur të vlente, nevojitet marrëdhënia e punës që qartësisht nuk zbatohet lidhur me faktet e çështjes aktuale.⁸⁰³ GJEDNJ-ja gjithashtu konsideron se statusi i sinjalizuesit domosdoshmërisht nënkupton marrëdhënie të bazuar në punësim.⁸⁰⁴

296. Raporti i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së që mbështet një përkufizim më të gjerë të sinjalizimit⁸⁰⁵ nuk përbën bazë ligjore të mirëfilltë në një gjykatë. Edhe sipas standardeve të këtij raporti: (i) shteti përsëri mund të provojë se nxjerrja e informacionit vërtet dëmton një interes shtetëror të përcaktuar,⁸⁰⁶ që është saktësisht çfarë përpiqet të bëjë ZPS-ja përmes krimeve të paraqitura në Aktakuzë, dhe (ii) kufizimet e mbrojtjes së burimeve të informacionit konfidencial mund të zbatohen nga autoritetet gjyqësore në situata të jashtëzakonshme, përfshirë hetimet e krimeve më të rënda dhe mbrojtjen e jetës së të tjerëve.⁸⁰⁷

297. Ekspertja lidhur me sinjalizimet e Mbrojtjes së Haradinajt – Ana Majers – ishte e sinqertë kur pranoi se nuk kishte njohuri për ligjin përkatës ose prova të vlefshme në këtë çështje.⁸⁰⁸ Argumentimi ligjor i Majersit për përkufizim më të gjerë të sinjalizimit të mbrojtur me ligj nuk është aspak mbrojtje ligjore për krimet e paraqitura në Aktakuzë.

298. Edhe sipas dëshmisë së vet Majersit, veprimet e të akuzuarve nuk i plotësojnë

⁸⁰² Nenet 3(2)(c), 15(2), and 16(3). *Shih gjithashtu* Myers, T.3142-48.

⁸⁰³ 2D00010, art.3(1)(1.1). *Shih gjithashtu* Myers, T.3149-52. Majers gjithashtu nuk ishte në gjendje të tregonte edhe një rast të vetëm, në nivel vendor apo ndërkombëtar, ku ishte miratuar përkufizimi i sinjalizuesit që vlen për persona jashtë marrëdhënies së punës. Myers, T.3169-70, 3175-77.

⁸⁰⁴ *Guja*, 14277/04, para.70.

⁸⁰⁵ 2D00011, para. 28-31.

⁸⁰⁶ 2D00011, para.58.

⁸⁰⁷ 2D00011, para. 21, 62.

⁸⁰⁸ Myers, T.3142-45 (nga 3142: 'Kërkoj ndjesë që nuk kam ditur saktësisht se çfarë është e zbatueshme para kësaj gjykate'), 3151.

kriteret e sinjalizimit të lejueshëm. Nxjerrja e identiteteve të dëshmitarëve ose të informatorëve të policisë përgjithësisht nuk konsiderohet sinjalizim.⁸⁰⁹ Sinjalizuesit duhet të ndërmarrin masa që të evitojnë dëmin e panevojshëm gjatë nxjerrjes së informacionit,⁸¹⁰ por të akuzuarit nuk ndërmorën asnjë hap të tillë kur i dhanë mediave Paketat.⁸¹¹ Në përgjithësi, nga sinjalizuesit kërkohet që t'i informojnë autoritetet përkatëse para se ta bëjnë publik nxjerrjen e informacionit,⁸¹² por të akuzuarit nuk e informuan drejtpërdrejt ZPS-në para se t'i nxirrnin Paketat.⁸¹³ Edhe nëse të akuzuarit supozuan se ZPS-ja nuk do ta ndryshonte qëndrimin nëse do të kontaktohej, të akuzuarit nuk informuan as policinë e Kosovës, DHSK-në,⁸¹⁴ apo ndonjë autoritet ligjor apo gjyqësor vendor para se të zgjidhnin atë që Majers e quajti 'opsion nuklear' të nxjerrjes së plotë publike.⁸¹⁵

299. Nuk diskutohet se sinjalizuesit mund të kryejnë shërbim të çmueshëm publik. Sidoqoftë krahasimi i këtyre të akuzuarve me sinjalizues legjitimë është i pathemeltë. I vetmi interes publik që duhet ruajtur në këtë rast është mbrojtja e dëshmitarëve dhe ruajtja e konfidencialitetit të hetimeve penale në zhvillim e sipër të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.⁸¹⁶

21. Nuk ka prova se ZPS-ja i shtyu të akuzuarit

300. Ligji nuk ofron asnjë mbrojtje të bazuar në shtytje. Edhe po të ekzistonte, asgjë nuk e mbështet atë dhe provat e paraqitura nga vetë të akuzuarit përfundimisht e përjashtojnë këtë.

⁸⁰⁹ Myers, T.3173.

⁸¹⁰ Myers, T.3161-63. *Shih gjithashtu Guja*, 14277/04, para.77.

⁸¹¹ Haradinaj, T.2966-69.

⁸¹² Myers, T.3160-61. *Shih gjithashtu Guja*, 14277/04, para.73.

⁸¹³ Haradinaj, T.2990-92; Haradinaj, 2D00001ET, para.54; P00030ET, f.9.

⁸¹⁴ Të akuzuarit kanë qenë më se të gatshëm të bëjnë dallimin midis DHSK-së dhe ZPS-së në këtë gjykim. *Shih Haradinaj*, T.2729.

⁸¹⁵ Myers, T.3120, 3160. *Shih gjithashtu Haradinaj*, T.2995; Qalaj, T.3076-77.

⁸¹⁶ *Shih Myers*, T.3172. *Shih gjithashtu Guja*, 14277/04, para.76.

301. GJEDNJ-ja bën dallimin midis kriterit material për shtytje dhe kriterit procedural për shtytje.⁸¹⁷ Aspektet procedurale janë trajtuar gjatë gjykimit, ku Trupi Gjykues i ka dhënë Mbrojtjes të gjitha mundësitë që të paraqesë mbrojtjen të bazuar mbi shtytje. I gjithë informacioni që do të mund të kishte ndonjë rëndësi në përfshirjen e ZPS-së në dërgimin e Paketave iu zbulua të akuzuarve.⁸¹⁸ Nga materialet e dhëna që u paraqitën nga Mbrojtja, është: (i) një raport që, ndër të tjera, 'nuk zbuloi prova që pjesëtarët e personelit të ZPS-së e zbuluan qëllimisht [Paketën 3]';⁸¹⁹ dhe (ii) materiale të ndryshme që kanë të bëjnë me vëzhgimin e pretenduar⁸²⁰ midis të cilave dhe ZPS-se provat nuk vërtetojnë lidhje.

302. Sa i përket kriterit material për shtytje, dhe sipas çfarëdo përkufizimi të pranuar gjerësisht, shtytja përfshin një person zyrtar që ndikon te të akuzuarit të kryejnë veprë penale.⁸²¹ Si hap i parë duhet të përcaktohet nëse vepra penale do të kryhej pa ndërhyrjen e autoriteteve.⁸²²

303. Nuk ka prova se ndonjë person zyrtar i ka shtyrë të akuzuarit, qoftë ai 'element keqbërës' apo ndonjë tjetër. Provat janë të qarta se të akuzuarit nuk e dinin se kush i kishte dërguar Paketat te të akuzuarit,⁸²³ as nuk ka tregues se dikush nga ZPS-ja u

⁸¹⁷ *Yakhymovych*, 23746/15, para. 33-45; *Bannikova*, 18757/06, para. 37-61; *Matanović*, 2742/12, para. 122-130; ECtHR, *Tchokhonelidze v Georgia*, 31536/07, 28 September 2018, para.44; ECtHR, *Lagutin and others v. Russia*, 6228/09, 19123/09, 19678/07, 52340/08 and 7451/09, 24 July 2014, para. 107-123; *Kuzmina and others*, 66152/14 and 8 others, para. 87-94; ECtHR, *Akbay and others v. Germany*, 40495/15 and 2 others, 15 January 2021, para. 111-124; ECtHR, *Furcht v. Germany*, 54648/09, 23 January 2015, para. 48-53.

⁸¹⁸ *Shih* Vendimi i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3), KSC-BC-2020-07/F00413/RED, 3 nëntor 2021 (versioni i redaktuar doli më 16 dhjetor 2021).

⁸¹⁹ 1D00033, f.3.

⁸²⁰ 1D00031; 1D00032; 1D00034.

⁸²¹ *Ramanauskas*, 74420/01, para.55. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Teixeira de Castro v Portugal*, 25829/94, 9 qershor 1998, para.38; ECtHR, *Malininas v Lithuania*, 10071/04, 1 October 2008, para.35; ECtHR, *Eurofinacom v. France*, 58753/00, 24 June 2003, f.15.

⁸²² *Yakhymovych*, 23746/15, para.33; *Kuzmina and others*, 66152/14 and 8 others, para.87; *Matanović*, 2742/12, para.123; *Bannikova*, 18757/06, para.37.

⁸²³ Haradinaj, T.2726 ('por që ne na ka shokuar, sidoqoftë. Për ne ishte e papritur që mund të ndodhte diçka e tillë'); Gucati, T.2165-66, 2187-88, 2197-99, 2211-13, 2215; Gucati, 1D00003ET, para. 13, 34, 46. *Shih gjithashtu* Taibe Miftari, T.2462-64.

takua, kontaktoi, ndërveproi apo kishte lidhje me ndonjë person që i dërgoi Paketat.⁸²⁴

Gjithashtu nuk ka tregues se ZPS-ja kishte ndonjë njoftim paraprak se kur do të arrinin Paketat në OVL-UÇK.⁸²⁵ Sa u përket Paketave 1 dhe 2, ZPS-ja nuk kishte në posedim të gjitha faqet e tyre që t'ia jepte ndonjë personi tjetër.⁸²⁶

304. Gjithashtu nuk ka prova se të akuzuarit u ndikuan nga ZPS-ja apo dikush tjetër në veprimet që ndërmorën. Dëshmia e Gucatit është treguese në këtë aspekt:

Py. Dhe askush nuk ju detyroi juve që të thërrisnit konferencat për shtyp dhe t'i ndanit dokumentet me median, a është e saktë kjo?

Pë. Vetëm Zoti mund të më detyron mua. Se unë jam Kryetar i asaj Organizatës të Vetëneve të Luftës. Asnjë njeri fuqi që ka, që më detyron mua që të mbaj konferencë për media për një punë të caktuar. Këto nuk mundet, vetëm Zoti. Nëse besoni në Zot, kështu është mendimi jem dhe asnjë njeri tjetër.⁸²⁷

305. Mungesa e çdo shtytjeje të mundshme ilustron qartë nga mënyra se si reagon anëtarët e OVL-UÇK-së kur mbërritën Paketat. Kishte shumë shqetësime se mos Paketa 1 ishte bombë kur mbërriti në fillim,⁸²⁸ duke e traumatizuar receptionisten e OVL-UÇK-së, Taibe Miftarin.⁸²⁹

306. Çdo detyrim i ZPS-së që të hedhë poshtë ekzistencën e shtytjes varet nga fakti nëse pretendimet e të akuzuarve nuk janë tërësisht të pamundshme.⁸³⁰ Ky kriter fillestar nuk është përmbushur asnjëherë në këtë çështje, dhe sidoqoftë është rrëzuar

⁸²⁴ Pumper, T.1478; Moberg, T.1953, 1957-58; Berisha, T.1574; Jukić, T.1899. *Shih* Gucati, 1D00003ET, para.73.

⁸²⁵ Haradinaj sugjeroi se e kishte parë Pumperin jashtë OVL-së së UÇK-së para se të mbërrinte Paketa 3 më 22 shtator (Haradinaj, T.2779, 3016-19; Haradinaj, 2D00001ET, para.102), por: (i) në atë kohë ai nuk e kishte parë atë më parë; (ii) ai e pa gruan në kalim nga distanca; (iii) gruaja mbante maskë; dhe (iv) vetë Haradinaj nuk ishte i sigurt se e kishte Pumperin. Pumper konfirmoi se nuk kishte qenë e pranishme te OVL-ja e UÇK-së më 22 shtator 2020. Pumper, T.1211. Identifikimi i Haradinajt thjesht nuk është i besueshëm, dhe asnjë provë nuk tregon se Pumper kishte dijeni paraprake se Paketat do të mbërrinin.

⁸²⁶ *Shih* Pumper, T.1208.

⁸²⁷ Gucati, T.2216.

⁸²⁸ Taibe Miftari, T.2461; Gucati, T.2165-66; Haradinaj, T.2721-23.

⁸²⁹ 1D00004ET, para. 6, 12, 25, 30, 39; Çelë Gashi, T.2588.

⁸³⁰ Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet Kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit, KSC-BC-2020-07/IA005/F00008/RED, 29 korrik 2021, para.52, *duke cituar Ramanauskas*, 74420/01, para.70.

me prova.

307. Të akuzuarve iu duheshin Paketat për kryerje e krimeve të paraqitura në Aktakuzë, dhe kushdo që i dorëzoi ato në OVL të UÇK-së pretendohet se donte që të akuzuarit t'i bënin publike. Sidoqoftë, nuk ka prova se ZPS-ja ishte përfshirë në ndonjë mënyrë në dorëzimin e Paketave.

308. Mbrojtja e Gucatit nuk ishte në gjendje të paraqiste asnjë provë që dëshmonte të kundërtën as para ose gjatë gjykimit dhe sigurisht as tani. Trembëdhjetë treguesit e Mbrojtjes së Gucatit për shtytje që u paraqitën në konferencën për përgatitjen e gjykimit⁸³¹ zbulojnë absurditetin e deduksionit të propozuar. Deklarata për shtyp e ZPS-së e 24 qershorit 2020 ishte e autorizuar nga gjykata me anë të një vendimi tashmë publik⁸³² – pretendimi se kjo është provë se ZPS-ja ka bërë publik informacion për qëllime taktike është thjesht gabim.⁸³³ ZPS-ja asnjëherë nuk tha se OVL-UÇK-ja mund ta mbante Paketën 1 deri në një muaj.⁸³⁴ Provat se të akuzuarit ishin nën vëzhgimin e ZPS-së apo se Ballhazhi kishte informacion të rëndësisë materiale për t'ia dhënë ZPS-së përveç videoincizimit të saj publik, nuk mbështetet nga dëshmitë e dëgjua në gjykim.⁸³⁵

309. Mbrojtja e Gucatit argumenton se pjesa në vijim e urdhrit të tretë sugjeron se

⁸³¹ Versioni i Redaktuar Publik i Parashtrimeve me Shkrim në emër të Hysni Gucatit për Konferencën për Përgatitjen e Gjykimit dhe Çështje të Lidhura me to me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, 27 gusht 2021 (versioni i redaktuar doli më 2 shtator 2021) ('Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit'), para.20.

⁸³² *Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve*, Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorit të Specializuar, KSC-BC-2020-06/F00009, 23 qershor 2020 (riklasifikuar më 20 nëntor 2020).

⁸³³ *Shih* Parashtrimet e Përgatitjes së Gjykimit të Gucatit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(i).

⁸³⁴ Moberg, T.1936-38, 1948-49, 1951. *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit të Gucatit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(iv).

⁸³⁵ *Shih në veçanti* Ballhazhi, T.2509 ('Py. Kur thoni që mendoni që dokumente kanë rrjedhur nga ZPS-ja, çfarë prove ke ti këtë ti për këtë prezumim tuajin, në qoftë se ke ndonjë? Pë. Ky është mendimi im si gazetarë. Py. Çfarë faktesh e mbështesin këtë opinion tuaj? Py. Është mendimi i lirë i imi si gazetarë.'). *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(vi), (ix)-(x).

ZPS-ja e dinte që me 9 shtator 2020 se do të vinte Paketa 3:⁸³⁶

22 *The date changed*
The Hague 9 September 2020

310. Paraqitja e korrigjimit të një gabimi shtypi nga hetuesi i ZPS-së si provë të njohurisë paraprake për mbërritjen e Paketës 3 është një deduksion kaq i pabesueshëm sa që pasqyron dëshpërimin e qëndrimit të Mbrojtjes.

311. Fakti që Paketat përmbanin informacion konfidencial në ruajtje të ZPS-së përbën bazën e akuzave penale në këtë çështje dhe në vetvete nuk tregojnë asgjë për shtytjen.⁸³⁷ Fakti që dërguesit e Paketave janë të panjohur shpjegojnë pse nuk janë ngritur akuza të tjera penale.⁸³⁸ Pretendimi nga të akuzuarit se ZPS-ja nuk kishte pranuar të ndërmernte veprime hetimore është i tepruar⁸³⁹ dhe, edhe po të ishte i saktë, është qartësisht brenda kompetencës së një hetuesi të pavarur.⁸⁴⁰ Dhe, në fund, çdo pretendim se ZPS-ja kishte motiv për rrjedhjen e materialit është i pabazë dhe kundërshtohet tërësisht nga provat e paraqitura për pengim.⁸⁴¹

312. Sipas argumenteve të Mbrojtjes, gjatë tërë gjykimit, mungesa e provave që demonstrojnë shtytjen tregon mungesën e zellit të ZPS-së për t'i gjetur ato prova, duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se shtytja kishte ndodhur. Me fjalë të tjera, shtytja do të vërtetohet pavarësisht nëse provat që e mbështesin ekzistojnë apo jo.

⁸³⁶ Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(xi), referencë ndaj P00054.

⁸³⁷ *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(ii).

⁸³⁸ Deklarata Hyrëse e ZPS-së, 7 tetor 2021, T.790. *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(iii).

⁸³⁹ *Shih* Moberg, T.1933-34; P00092, para.8 (ku konfirmohet se ZPS-ja donte ta shikonte incizimin e kamerave të sigurisë së OVL-së së UÇK-së gjatë sekustrimit të Paketës 1); Gucati, 1D00003ET, para.41 (në lidhje me Paketën 2); Haradinaj, 2D00001ET, para.116 (në lidhje me Paketën 3).

⁸⁴⁰ *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(v), (viii).

⁸⁴¹ *Shih* Parashtrimet e Gucatit për Përgatitjen e Gjykimit, KSC-BC-2020-07/F00288/RED, para.20(c)(xii)-(xiii).

Pranimi i kësaj premise do ta bënte shtytjen mbrojtje të pashmangshme në çdo çështje. Kjo lajthitje logjike nuk duhet të merret parasysh.

313. Mbrojtja e Gucatiit premtoi para fillimit të paraqitjes së provave të saj se 'do të ketë prova të qarta të nxitjes'.⁸⁴² Prova të tilla nuk ekzistonin dhe nuk u paraqitën asnjëherë. Kjo mbrojtje ishte e gabuar dhe e pambështetur në prova që nga fillimi deri në fund, dhe është e pabazuar në fakte dhe në ligj.

22. Kryerja e hetimeve të ZPS-së nuk ka të bëjë me shtytjen

314. Përprjekjet e ZPS-së për t'i shtënë në dorë Paketat ishin të menjëhershme dhe efektive. Të tri Paketat me materiale u morën shpejt, ashtu si edhe Paketa 4. ZPS-ja veprroi profesionalisht dhe në pajtim me mandatin e saj gjatë tërë periudhës së Aktakuzës.⁸⁴³ Pumper gjithashtu shpjegoi në hollësi kujdesin që tregoi ZPS-ja gjatë kontrollimit të 25 shtatorit 2020 të OVL-UÇK-së në përgjigje të pyetjeve të Mbrojtjes.⁸⁴⁴ Gjithashtu vihet në dukje se materiali i vetëm që u mor gjatë kontrollimit të 25 shtatorit dhe i cili është paraqitur si provë është incizimi prej kamerave të sigurisë, që është i pakundërshtuar.⁸⁴⁵

315. Hetimi ka vërtetuar përfundimisht përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarve. Nuk ka prova se gjithsesi ZPS-ja e hetoi në masë të pamjaftueshme dërgesën e Paketave në një mënyrë që sugjeron shtytje ose ndonjë gjë tjetër që do të mund të lehtësonte përgjegjësinë e të akuzuarve. Të gjitha argumentet e Mbrojtjes në

⁸⁴² Transkript i Seancës, 27 tetor 2021, T.1641.

⁸⁴³ Gucati, T.2251 (ku lavdërohet hetuesi i ZPS-së që sekuestroi Paketat 2 dhe 3).

⁸⁴⁴ Pumper, T.1391-1407, 1485 (nga T.1485: 'Do të doja të thoja së pari që z. Klinaku ishte përfaqësues i OVL-së në mungesë të z. Gucati dhe ai më tha personalisht që unë e kisha bërë misionin tim shumë mirë, pra kisha kontrolluar dhe kisha sekuestruar shumë mirë. Dhe z. Gashi që ishte përfaqësuesi ligjor i OVL-së, në një pikë më tha që, "Boll bëtë zhurmë. E dini që po bëni siç duhet këtë punë, por po e bëni më mirë sesa ç'duhet". Ndërkohë që unë ju përgjigja që, "Ky është kontroll. Duhet të bëhet sipas kërkesave ligjore", dhe kështu vijuan. Kështu që do të çuditesha shumë n.q.s. do të dëgjonim të kundërtën.').

⁸⁴⁵ 1D00019; 1D00020; 1D00021; 1D00022; 1D00023; 1D00024; 1D00025; 1D00026; 1D00027; 1D00028; 1D00029; 1D00030; P00163; P00164.

këtë aspekt përqendrohen në hetime më të gjera të ndryshme nga ato që çuan deri te ngritja e akuzave për krimet në Aktakuzë.

316. Praktika hetimore e ZPS-së varet nga përparësitë e hetimit dhe kapacitetet në disponim.⁸⁴⁶ Zgjedhjet hetimore gjithashtu varen nga rrethanat individuale,⁸⁴⁷ dhe vendimet hetimore më të gjera për të mësuar se kush i dorëzoi Paketat kanë të bëjnë me aspekte jashtë kësaj çështjeje gjyqësore dhe provave të pranuar në të.⁸⁴⁸

317. Eksperti i Mbrojtjes së Haradinajt, Rid, shprehu mendimin se ZPS-ja nuk mblodhi prova në pajtim me praktikat më të mira, por edhe ai vetë pranon se ekzistojnë një numër mënyrash për të verifikuar autenticitetin e dokumenteve.⁸⁴⁹ Të dhënat për 'kronologjinë e ruajtjes së provave' janë një mjet i tillë për arritjen e qëllimit të verifikimit të autenticitetit të një dokumenti.⁸⁵⁰ Dhe autenticiteti i Paketave në këtë çështje është i qartë, duke pasur parasysh, midis të tjerash: (i) përshkrimin nga Pumper të materialeve të sekuestruara; (ii) dëshminë e Mobergut se si është marrë Paketa 1 në veçanti; (iii) dëshmitë e të akuzuarve dhe të tjerëve se si iu dhanë Paketat ZPS-së; (iv) përshkrimin e përmbajtjes së Paketave të dhëna nga të akuzuarit në video, të cilat pasqyrojnë artikujt e kohës në media dhe faqet e Paketave të paraqitura si provë. Rid shqyrtoi vetëm një pjesë të vogël të këtyre provave, që do të thotë se ai nuk është në gjendje të konstatojë se çfarë ndikimi ka hetimi i ZPS-së në provat e pranuar.

318. Nga hetimi i të akuzuarve prej ZPS-së kanë dalë prova që vërtetojnë fajësinë e

⁸⁴⁶ *Shih në përgjithësi* Pumper, T.1157, 1446.

⁸⁴⁷ *Shih* Reid, T.3324-42.

⁸⁴⁸ Si shembull spikatës, mbrojtësi i Gucatit argumentoi në Dosjen Paraprake se një intervistë e ZPS-së në lidhje me hetim më të gjerë të dorëzimit të Paketave ishte 'pseudo'. Versioni i Redaktuar Publik i Dosjes Paraprake të Mbrojtjes së Hysni Gucatit, KSC-BC-2020-07/F00258/RED, 12 korrik 2021 (versioni i redaktuar u njoftua më 2 shtator 2021), para.135. Më tej, mbrojtësi i Gucatit vendosi t'i lexonte Pumperit katër faqe të transkriptit të kësaj interviste, edhe pse ajo nuk e kishte parë më parë. Pumper, T.1173-77. Por, çfarëdo që Mbrojtja e Gucatit donte të thoshte me këtë spektakël, që atëherë është bërë e pakuptimtë – intervista u paraqit pa u përpjekur që të respektohen kriteret ligjore për një deklaratë të tillë dhe pranimi i saj u refuzua.

⁸⁴⁹ Reid, 2D00012, para.22; Reid, T.3263-64.

⁸⁵⁰ Reid, T.3287-92.

tyre. Nuk ka defekte në mbledhjen e provave të pranuar që do të mund të hidhnin dyshime në besueshmërinë e tyre, veçanërisht sa u përket provave të videoincizimeve nga burime të hapura që janë në thelb të kësaj çështjeje.

L. PËRFUNDIM

319. Siç është parashtruar më lart në këtë pjesë, shikuar së bashku me paraqitjen e fakteve dhe cilësimin ligjor të atyre fakteve, të akuzuarit duhet të shpallen fajtorë për të gjashtë pikat e Aktakuzës.

320. Sipas kriterit të pranuar gjerësisht për fajësi të shumëfishtë të zhvilluar nga TPNJ-ja/TPNR-ja,⁸⁵¹ verdiktet e fajësisë duhet të shqiptohen për të gjitha pikat në Aktakuzë. Sipas këtij kriteri nevojitet vetëm krahasimi abstrakt i elementeve ligjore të krimeve në Aktakuzë – rrethanat konkrete të çështjes, siç është se të gjashtë pikat burojnë nga e njëjta praktikë e përgjithshme veprimi, nuk duhet të konsiderohen në fazën kur vendoset se a duhet të shpallet fajësi e shumëfishtë.⁸⁵²

321. Të gjashtë pikat pasqyrojnë interesa të mbrojtura të ndryshme dhe kanë elemente materialisht të ndryshme nga njëra-tjetra. Në veçanti: (i) Pika 1 përmban kushtin e pengimit përmes ‘kërcënimit të rëndë’ që nuk e përmban Pika 2, ndërsa Pika 2 përmban kushtin ‘duke vepruar bashkërisht’ që nuk e përmban Pika 1; dhe (ii) Pika 5 përmban kushtin e zbulimit të paautorizuar të çfarëdo ‘informacion [të mbrojtur] të nxjerrë në një procedurë zyrtare’ që nuk e përmban Pika 6, ndërsa Pika 6 përmban kushtin e zbulimit të paautorizuar të ‘identitetit apo të dhënave personale të një personi të mbrojtur në procedurë penale apo të përfshirë në një program të veçantë

⁸⁵¹ *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para. 322-24; *Nahimana et al.* AJ, ICTR-99-52-A, para.1019; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.* Judgment, IT-96-21-A, 20 February 2001, paras 412-13. *Shih gjithashtu* ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Bosco Ntaganda against the decision of Trial Chamber VI of 7 November 2019 entitled ‘Sentencing judgment’, ICC-01/04-02/06-2667-Red, 30 March 2021, para.131 (përmbledh evoluimin e jurisprudencës së TPNJ-së në këtë pikë).

⁸⁵² *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para. 323-32.

për mbrojtje ' që nuk është element që kërkohet sipas Pikës 5.

322. Shpalljet e fajësisë për të gjitha pikat në Aktakuzë janë të domosdoshme për të pasqyruar fajësinë e plotë të të akuzuarve, dhe po ashtu edhe format e përgjegjësisë penale që zbatohen për të nxjerrë këto verdikte fajësie.⁸⁵³ Kërkohet që Trupi Gjykes të bëjë konstatime për të gjitha format e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, edhe pse janë forma alternative të përgjegjësisë penale, për të garantuar që dokumentacioni është i qartë për procedura të apelit.⁸⁵⁴ Kur i njëjti veprim mund të cilësohet sipas të gjitha formave të përgjegjësisë penale, të akuzuarit duhet të shpallen fajtorë sipas cilësdo formë të përgjegjësisë penale kryesore (kryerje ose bashkëkryerje) që Trupi Gjykes konsideron se pasqyron më së miri përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarve.⁸⁵⁵

V. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

A. HYRJE

Në këtë rast po shkoj edhe unë në burg", duke shtuar më pas: "tash ti je ka më tut me dhjetë vjet. 300 vjet të më japshin për qitë punë, unë e qes. Unë, unë, jam ka foli unë edhe me Kryesia komplet...na jena të përgatitun 300-vjet...Ne jemi kanë të përgatitun me vdek.⁸⁵⁶

323. Kjo është vetëm një nga deklaratat e shumta sfiduese të Haradinajt në prani të bashkakuzuarit, që nuk lë dyshim se, po t'u jepet mundësia, Haradinaj, Gucati dhe të tjerë individë që mendojnë kështu, do të kryejnë krime të tjera të njëjta me ato për të cilat të akuzuarit janë akuzuar.

324. Do të ishte e paarsyeshme të pritet diçka tjetër. Nuk mund të pritet ndryshe, kur të akuzuarit e kanë përshkruar publikisht dhe paturpësisht DHSK-në si

⁸⁵³ Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para. 34-37.

⁸⁵⁴ Parashtrime në lidhje me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, KSC-BC-2020-07/F00341, para.34.

⁸⁵⁵ *Shih ngjashëm ICC, Prosecutor v. Al Mahdi, Judgment and Sentence, ICC-01/12-01/15-171, 27 September 2016, para. 57-60.*

⁸⁵⁶ P00035ET, f.13.

'inekzistente'⁸⁵⁷ dhe të parëndësishme,⁸⁵⁸ kanë deklaruar se është përgjegjësi e tyre ta sabotojnë⁸⁵⁹ dhe se, po t'u jepej mundësia, do ta shpërbënin,⁸⁶⁰ kërcënuan se do ta paguante çmimin,⁸⁶¹ dhe u betuan që të bëjnë çmos që ta turpërojnë.⁸⁶² Nuk mund të pritët ndryshe kur Haradinaj tha se çdo herë që OVL-UÇK-ja do të merrte dokumente si ato që kishte marrë, ZPS-ja nuk do të ishte në gjendje t'i ndalte.⁸⁶³ Nuk mund të pritët ndryshe kur vetëm disa ditë para arrestimeve Gucati tha se nuk do të pendohej për publikimin e dokumenteve të marra nga OVL-UÇK-ka dhe po të dënohej me pesë vjet burgim⁸⁶⁴ ndërsa Haradinaj tha se do të ndihej krenar dhe i nderuar nëse do të arrestohej për veprimet e veta.⁸⁶⁵ Nuk mund të pritët ndryshe kur të akuzuarit vazhdojnë të mbajnë të njëjtat qëndrime brenda OVL-UÇK-së me 10.000 anëtarë⁸⁶⁶ që i kishin para arrestimit,⁸⁶⁷ vazhdojnë ta kundërshtojnë këtë institucion,⁸⁶⁸ dhe thanë në gjykatë se do t'i përsërisnin nga e para veprimet që sollën këtë gjykim.⁸⁶⁹

325. DHSK-ja dhe ZPS-ja ende kanë mandate dhe detyrime për të përmbushur, ndër të cilat garantimin e proceseve penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase lidhur me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare.⁸⁷⁰ DHSK-ja dhe ZPS-ja duhet të vazhdojnë të mbrojnë viktimat dhe dëshmitarët, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre.⁸⁷¹ Nevoja për këtë është veçanërisht e theksuar duke pasur parasysh

⁸⁵⁷ P00001ET, f.3, 6.

⁸⁵⁸ P00028ET, f.7-8.

⁸⁵⁹ P00028ET, f.8-9.

⁸⁶⁰ P00028ET, f.11.

⁸⁶¹ P00001ET, f.3.

⁸⁶² P00030ET, f.15.

⁸⁶³ P00006ET, f.14.

⁸⁶⁴ P00028ET, f.12.

⁸⁶⁵ P00025ET, f.1-2, 9-10.

⁸⁶⁶ Marashi, T.2528-30.

⁸⁶⁷ Haradinaj, T.2707.

⁸⁶⁸ Gucati, T.2204, 2412-3; Haradinaj, T.2876-9, 2915; *Shih gjithashtu* Gucati, T.2272.

⁸⁶⁹ Haradinaj, T.3024, 3046-47; Gucati, T. 2221-22, 2401; *Shih gjithashtu* Gucati, T.2219-20.

⁸⁷⁰ Neni 1(2).

⁸⁷¹ *Shih, për shembull*, nenet 23(1), 39(11), 40(6), rregullat 30(2), 80.

çështjet gjyqësore në DHSK-së, në fazën e gjykimit dhe të procedurës paraprake.

326. Disa dëshmitarë që dëshmuan në çështjen aktuale *Mustafa* ishin në gjendje për herë të parë në jetën e tyre t'i tregojnë Gjykatës dhe botës për ngjarjet traumatike që kishin përjetuar para më shumë se 20 vjetësh. Dëshmi të tilla janë kyçe për vendosjen e drejtësisë dhe janë të mundshme vetëm kur Gjykata është në gjendje t'i mbrojë në mënyrë adekuate viktimat dhe dëshmitarët, përfshirë nga krime si ato të kryera nga të akuzuarit.

327. Ndërsa çështja *Mustafa* është në gjykim, Gjykata gjithashtu ka dy çështje në fazën e procedurës paraprake. Ndër to është çështja *Thaçi dhe të tjerët* e cila, duke pasur parasysh fushëveprimin e Aktakuzës së konfirmuar dhe fazën aktuale të procesit, logjikisht mund të pritët se do të zgjasë për njëfarë kohe. Në këtë çështje do të ofrohen prova të shumta dhe, rrjedhimisht, ruajtja e integritetit të procesit do të jetë shqetësimi kryesor.

328. Trupi Gjykses nuk duhet ta lejojë dështimin e Gjykatës ashtu siç do të dëshironin të akuzuarit dhe disa të tjerë. Ai mundet dhe duhet ta ndalë këtë. Ekziston vetëm një mënyrë për ta bërë këtë në kontekst të këtij gjykimi – duke shqiptuar të akuzuarve dënime të gjata me burgim për të akuzuarit që, njëherazi pasqyrojnë peshën e krimeve që kanë kryer dhe shërbejnë për të parandaluar ata dhe të tjerët që ta rrezikojnë sërish ardhmërinë e DHSK-së dhe ZPS-së. Nëse Trupi Gjykses e bën këtë, dëshmitarët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me Gjykatën, të drejtat dhe dinjteti i tyre do të respektohen, dhe DHSK-ja dhe ZPS-ja do të jenë në gjendje të përmbushin mandatet e tyre.

329. Më poshtë, duke pasur parasysh nenin 44(5) dhe urdhrin e Trupit Gjykses,⁸⁷² ZPS-ja trajton, midis të tjerash, dënimet që Trupi Gjykses mund të shqiptojë kundër të akuzuarve, peshën e krimeve të të akuzuarve dhe pasojat e mëdha të tyre,

⁸⁷² Urdhri për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave, KSC-BC-2020-07/F00553, para.17.

ekzistencën e një numri faktorësh rëndues dhe rëndësinë e parandalimit dhe dënimit me burgim para se të kërkojë nga Trupi Gjykses që të shqiptojë kundër secilit të akuzuar dënimin me gjashtë vjet burgim dhe gjobë simbolike prej 100 eurosh.

B. DËNIMET PËRKATËSE

330. Në përputhje me rregullën 163(4), Trupi Gjykses përcakton dënimin në lidhje me çdo akuzë të Aktakuzës për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit. Dënimi i njësuar nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë.⁸⁷³ Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënitit me burgim, Trupi Gjykses zbret kohën që i akuzuari është mbajtur në paraburgim në rast se është mbajtur.⁸⁷⁴

331. Në përputhje me nenin 44(4), dënimi i shqiptuar kundër personave të shpallur fajtorë për krime sipas nenit 15(2) është në pajtim me dënimet për ato krime të përcaktuara në KPK-në e vitit 2019.⁸⁷⁵

332. Provat e parashtuara më lart vërtetojnë fajësinë e të akuzuarve përtej dyshimit të arsyeshëm në lidhje me krimet në Aktakuzë. Rrjedhimisht, dënimet përkatëse janë si në vijim.

333. Në lidhje me Pikën 1, pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, neni 401(1) i KPK-së përcakton që të akuzuarit dënohen me tre muaj deri në tre vjet burgim. Sidoqoftë, meqenëse ky pengim është kryer

⁸⁷³ Rregulla 163(4).

⁸⁷⁴ Rregulla 163(6).

⁸⁷⁵ Megjithëse Ligji i referohet KPK-së së vitit 2012, në KPK-në e vitit 2019 u rinumërtuan dispozitat e përmendura në Ligj, ndër të cilat edhe ato ku bazohen akuzat e ngritura kundër të akuzuarve, *shih* Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes, KSC-BC-2020-07/F00057, 27 tetor 2020 para.24; Vendimi i Konfirmimit, KSC-BC-2020-07/F00074/RED, para. 13-14. Dispozitat përkatëse janë të njëjta sa i përket spektrit të dënimeve që zbatohen për krimet e paraqitura në Aktakuzë.

kundër një gjykatësi, një prokurori, një zyrtari të gjykatës ose zyrtari të prokurorisë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare,⁸⁷⁶ në përputhje me nenin 401(5), Trupi Gjykses duhet të shqiptojë dënimin me një deri në pesë vjet burgim.

334. Në lidhje me Pikën 2, pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes veprimeve të përbashkëta të një grupi, neni 401(2) i KPK-së përcakton që të akuzuarit dënohen me gjobë ose me deri në tre vjet burgim. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se ky pengim është kryer: (i) nga udhëheqësi ose organizuesi i grupit që e kryen këtë vepër penale;⁸⁷⁷ dhe/ose (ii) kundër gjykatësit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës ose zyrtarit të prokurorisë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare,⁸⁷⁸ në përputhje me nenet 401(3) dhe/ose (5), Trupi Gjykses duhet të shqiptojë dënimin me një deri në pesë vite burgim.

335. Në lidhje me Pikën 3, frikësim gjatë procedurave penale në përputhje me nenin 387 të KPK-së, Trupi Gjykses dënon të akuzuarit duke shqiptuar gjobë deri në 125,000 euro dhe me dy deri në dhjetë vite burgim.

336. Në lidhje me Pikën 4, hakmarrje sipas nenit 388(1) të KPK-së, të akuzuarit gjobiten dhe dënohen me deri tri vite burgim.

337. Në lidhje me Pikën 5, shkelje e sekretit të procedurave përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur në përputhje me nenin 392(1) të KPK-së, Trupi Gjykses duhet t'i dënojë të akuzuarit duke u shqiptuar gjobë ose me deri në një vit burgim.

338. Në lidhje me Pikën 6, shkelje e fshehtësisë së procedurave përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur në përputhje me nenin 392(2) të KPK-së, Trupi Gjykses duhet t'i dënojë të akuzuarit duke

⁸⁷⁶ *Shih* para. 170-174, 189-197 më lart.

⁸⁷⁷ *Shih* para. 19-20, 260-267 më lart.

⁸⁷⁸ *Shih* para. 170-174, 189-197 më lart.

shqiptuar dënimin me deri tre vjet burgim. Sidoqoftë, meqenëse kjo vepër penale rezultoi me pasoja të rënda për personat e mbrojtur ose procedurat penale u bënë të pamundshme ose u penguan seriozisht,⁸⁷⁹ në përputhje me nenin 392(3) të KPK-së, Trupi Gjykses duhet t'i dënojë të akuzuarit me gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim.

339. Të akuzuarit janë akuzuar në bazë të formave të shumëfishta të përgjegjësisë penale. Dispozitat e KPK-së që kanë të bëjnë me këto forma përcaktojnë se secili bashkëkryes dënohet siç është përcaktuar për veprën penale.⁸⁸⁰ E njëjta gjë vlen për personat që pajtohen të kryejnë vepër penale,⁸⁸¹ dhe personat që tentojnë të kryejnë vepër penale.⁸⁸² Ndërsa KPK-ja parasheh që dënimi mund të zvogëlohet në rastin e tentimit,⁸⁸³ nuk ekziston dispozitë e tillë sa i përket bashkëkryerjes ose marrëveshjes për të kryer vepër penale.

340. Personat fajtorë për nxitje dënohen sikur ta kishin kryer veprën penale nëse ajo vepër penale është kryer ose është tentuar, por nuk është kryer.⁸⁸⁴ Nëse Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit nxitën cilëndo nga veprat penale të përfshira në Pikat 1-3 ose 6 dhe kryerja e këtyre veprave penale as nuk është tentuar, të akuzuarit dënohen për tentim.⁸⁸⁵ Nëse Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit ndihmuan në kryerjen e veprave penale, dënimi për ta është më i lehtë se për kryesit e veprës penale.⁸⁸⁶

C. KRIMET E KRYERA NGA TË AKUZUARIT JANË PADYSHIM TË RËNDA

341. Penalizimi i veprimeve si ato të ndërmarra nga të akuzuarit gjatë kuadrit kohor të Aktakuzës ka për synim parandalimin e pengimit të drejtësisë.⁸⁸⁷ Ky penalizim

⁸⁷⁹ *Shih* para. 125-134, 173, 190-191, 205, 207, 259 më lart.

⁸⁸⁰ KPK, neni 31.

⁸⁸¹ KPK, neni 35(1).

⁸⁸² KPK, neni 28(3).

⁸⁸³ KPK, neni 28(3).

⁸⁸⁴ KPK, neni 32(1) dhe (2).

⁸⁸⁵ KPK, neni 32(3).

⁸⁸⁶ KPK, neni 33(1).

⁸⁸⁷ *Shih Peçana* TJ, IT-05-88/2-R77.2, para.39.

është kyç për mbrojtjen e integritetit të proceseve të DHSK-së, sidomos sepse veprime të tilla mund të pengojnë zbulimin e të vërtetës, të drejtën e viktimave për drejtësi dhe, në fund të fundit, aftësinë e Gjykatës për përmbushjen e mandatit të vet. Meqenëse veprat penale si ato të të akuzuarve përbëjnë kundërshtim të drejtpërdrejtë të integritetit të procesit gjyqësor, veprat penale që kanë kryer janë padyshim të rënda.⁸⁸⁸

342. Trupi Gjykues gëzon kompetencë të gjerë gjykimi gjatë përcaktimit të dënimit të përshtatshëm për të akuzuarit për shkak të obligimit që ta individualizojë dënimin për t'ia përshtatur rrethanave të të akuzuarve dhe peshës së krimeve të tyre.⁸⁸⁹

343. Në këtë kontekst, pesha nuk i referohet vetëm peshës objektive të krimit, por gjithashtu edhe rrethanave konkrete të çështjes dhe formës së shkallës së pjesëmarrjes së të akuzuarve në krime.⁸⁹⁰ Pasojat e veprimeve të të akuzuarve, përfshirë pasojat e dëmshme të mundshme që veprimet e të akuzuarve mund të kenë në punën e gjykatës dhe pasojat personale dhe psikologjike të mundshme dhe konkrete për viktimat e krimeve, janë faktor tjetër i rëndësishëm gjatë vlerësimit të peshës së krimit.⁸⁹¹

23. Pjesëmarrja e të akuzuarve në krime ishte e drejtpërdrejtë, sistematike, e vazhdueshme, e qëllimshme dhe entuziaste

344. Midis faktorëve që kanë lidhje me analizimin e pjesëmarrjes së të akuzuarve në krime janë roli konkret i të akuzuarve në kryerjen e tyre,⁸⁹² mënyra e qëllimshme në të

⁸⁸⁸ *Shih Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.397; *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.218.

⁸⁸⁹ *Shih Jokić AJ*, IT-05-88-R77.1-A, para.40; *Marijačić and Rebić* TJ, IT-95-14-R77.2, para.46; *Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.397; *Akhbar Beirut SJ*, STL-14-06/S/CJ, para.15; *2012 Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.4, para.52; *Tupajić* TJ, IT-95-5/18-R77.2, para.31; *Pećanac* TJ, IT-05-88/2-R77.2, para.39; *Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para.84.

⁸⁹⁰ ICTR, *Prosecutor v. Nshogoza*, Judgement, ICTR-07-91-A, 15 March 2010, para.98.

⁸⁹¹ *Shih Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para 86-87; *2011 Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.3, para.80; *Hartmann* TJ, IT-02-54-R77.5, para.80; *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.219; *Bemba et al.* Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para 76-79, 93-96, 111-114.

⁸⁹² *Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.399.

cilën u kryen krimet,⁸⁹³ dhe mënyra sistematike e veprimeve të të akuzuarve.⁸⁹⁴

345. Siç është parashtruar më lart,⁸⁹⁵ të akuzuarit morën pjesë në krime midis të tjerash përmes këqyrjes së informacionit konfidencial dhe jopublik, pjesëmarrjes në vendime nëse ta shpërndanin dhe si ta shpërndanin atë dhe si, dhe përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete, përfshirë konferencat për shtyp dhe paraqitjet publike, ku bënë akuza dhe komente frikësuese kundër dëshmitarëve, duke shpërndarë në mënyrë të përsëritur identitetet e tyre, të dhënat personale dhe prova, dhe duke inkurajuar në mënyrë të përsëritur të tjerë që ta shpërndanin këtë informacion.

346. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e secilit të akuzuar në kryerjen e krimeve është e drejtpërdrejtë, midis të tjerash përmes pjesëmarrjes individuale në çdo vendim që çoi në kryerjen e krimeve, duke marrë pjesë personalisht dhe duke folur në secilën nga tri konferencat për shtyp dhe në disa paraqitje televizive, dhe kontribuan në realizimin e planit të tyre përmes postimeve në media sociale në profilet personale.

347. Natyra e drejtpërdrejtë e pjesëmarrjes së të akuzuarve në krime bëhet menjëherë e qartë vetëm nga ngjarjet që ndodhën në ditën e parë nga 19 ditët që mbulon Aktakuza. Gjatë konferencës së parë për shtyp, Haradinaj deklaroi se personat e përmendur në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë duhet ta dinin tani 'se janë emra të lexum dhe nuk po del këtu diçka që është dikush i fshehtë' sepse vendndodhja e saktë, fletëthirjet, dhe deklaratat e dhëna jepen në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë,⁸⁹⁶ duke shtuar, në mënyrë retorike, 'si ju garantohet

⁸⁹³ 2011 *Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.3, para.78.

⁸⁹⁴ *Bemba et al.*, Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para. 76-79, 93-96, 111-114; *Akhbar Beirut* SJ, STL-14-06/S/CJ, para.17; *Shih gjithashtu Rašić* SJ, IT-98-32/1-R77.2, para.18; 2012 *Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.4, para 54, 57; *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.222; *Senessie* SJ, SCSL-2011-01-T, para 18, 22; *Jović* TJ, IT-95-14 & IT-95-14/2-R77, para.26.

⁸⁹⁵ *Shih* para. 277-278 më lart.

⁸⁹⁶ P00001ET, f.3-4.

mbrojtja dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush',⁸⁹⁷ dhe duke vënë në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë kishin për qëllim t'u bënte të qartë dëshmitarëve se, në vend se të mbroheshin, ata do të shfrytëzoheshin, gjithashtu duke vënë në dukje se personat që kanë dhënë informacion nuk janë mbrojtur por janë vrarë, diskredituar ose nënçmuar.⁸⁹⁸ Gucati dëshmoi se mbështeste gjithçka që kishte thënë Haradinaj gjatë tri konferencave për shtyp.⁸⁹⁹

348. Vetëm disa orë më vonë, kur prezantuesi i programit në të cilin u paraqit Gucati vuri në dukje se mund të ndodhte ndonjë gjë sepse dokumentet përmbanin emra, Gucati u përgjigj i patrazuar se kjo mund të ndodhte.⁹⁰⁰

349. Natyra e drejtpërdrejt e pjesëmarrjes në krime shihet gjithashtu nga komentet frikësuese për dëshmitarët e ZPS-së që vetë të akuzuarit i bënë publikisht gjatë tërë kuadrit kohor të akuzave në Aktakuzë, ku Gucati iu referua këtyre dëshmitarëve si 'shqipfolës' ose 'tradhtarë' që gënjejnë,⁹⁰¹ dhe Haradinaj i përshkruan si 'njerëz pa shkollë' dhe 'naiva'⁹⁰², 'çetnikë, kriminelë',⁹⁰³ 'kriminelë, gjakpirës',⁹⁰⁴ dhe spiunë që tradhtuan popullin e vet.⁹⁰⁵ Komentet e tyre frikësuese u përsëritën nga përkrahësit e tyre.⁹⁰⁶

350. Natyra sistematike, e vazhdueshme, e qëllimshme dhe entuziaste e pjesëmarrjes së të akuzuarve në kryerjen e krimeve në Aktakuzë konfirmohet midis të tjerash nga fakti se ata përsëritën të njëjtat veprime kriminale. Pas secilës nga tri dërgesat të OVL-UÇK-ja, të akuzuarit këqyrën dokumentet dërguar atyre, mbajtën

⁸⁹⁷ P00001ET, f.4-5.

⁸⁹⁸ P00008ET, f.26.

⁸⁹⁹ Gucati, T.2374-75.

⁹⁰⁰ P00009ET, f.8.

⁹⁰¹ P00009ET, f.6-7, 12-13.

⁹⁰² P00015ET, f.2.

⁹⁰³ P00033ET, f.1-2.

⁹⁰⁴ P00008ET, f.7.

⁹⁰⁵ P00008ET, f.26.

⁹⁰⁶ *Shih* P00070 (P00070ET).

konferenca për shtyp në të cilat zbuluan dhe shpërndanë informacion konfidencial dhe jopublik që përmbanin dokumentet e pranuar, dhe bënë zbulime të ngjashme gjatë disa paraqitjeve televizive të mëvonshme. Mënyra e veprimit të të akuzuarve tregon midis të tjerash se vetëm arrestimi i tyre arriti të ndalte veprimet e tyre kriminale, sidomos duke pasur parasysh se urdhrat e dorëzuara në OVL-UÇK më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 nuk arritën të njëjtin rezultat.

351. Fjalët e vetë të akuzuarve nuk lënë dyshime për natyrën e qëllimshme të rolit të tyre në krime. Për shembull, gjatë konferencës së parë për shtyp, Haradinaj konfirmoi se kishte qenë vendim i tij, i Gucatit dhe i ndihmësve që t'i bënin publike dokumentet konfidenciale, duke thënë: 'ne me pat dashtë si kishim bë publik hiç.'⁹⁰⁷

352. Vetë fjalët e të akuzuarve demonstrojnë më tej entuziazmin e tyre, sidomos shprehjet e përsëritura të falënderimit për marrjen e dokumenteve në OVL-UÇK, duke i bërë thirrje personit (personave) që i dorëzuan këto dokumente që ta bëjnë këtë përsëri,⁹⁰⁸ dhe shprehën qëllimin që të bëjnë publike çdo gjë që do të merrej nga OVL-UÇK-ja.⁹⁰⁹

353. Këmbëngulja e të akuzuarve gjithashtu vërtetohet nga fakti se ata i ndërmorën këto veprime përkundër urdhrave të dorëzuara në OVL-UÇK më 8, 17 dhe 22 shtator 2020, në të cilat konkretisht thuhej se informacioni të cilin të akuzuarit po e bënin publik ishte i ndjeshëm dhe jopublik dhe nuk duhej të shpërndahej më tej. Vërtet, pas sekuestrimit të Paketës 2, Gucati pranoi se punonjësit e ZPS-së i kishin dorëzuar kopjen e urdhrat të dytë dhe se punonjësit i kishin thënë se dokumentet që i sekuestronin nuk mund të shumëfishoheshin e as të shpërndahejshin dhe se emrat e

⁹⁰⁷ P00001ET, f.8.

⁹⁰⁸ P00001ET, f.1-2; P00080 (P00080ET); P00083, p.SPOE00222250 (P00083ET, p.SPOE00222250); P00006ET, f.4; P00017ET, f.5; P00075 (P00075ET); P00083, p.SPOE00222248 (P00083ET, p.SPOE00222248); P00033ET, f.2-3; P00007ET, f.2; P00008ET, f.2-4.

⁹⁰⁹ *Shih* para. 385-390 më poshtë.

dëshmitarëve nuk mund të bëheshin publikë.⁹¹⁰ Haradinaj pranoi se gjatë sekuestrimit të Paketës 2, përfaqësuesit e ZPS-së konfirmuan ndjeshmërinë e materialit të sekuestruar dhe pranoi se urdhri i dytë përfshinte obligimin për Haradinajn dhe të tjerët që mos t'i publikonin.⁹¹¹

24. Pengimi i punës së një institucioni të tërë gjyqësor i bën veprimet e të akuzuarve veçanërisht të rënda

354. Secili rast duhet të vlerësohet individualisht dhe në bazë të kornizës ligjore përkatëse, duke ia përshtatur dënimin peshës së krimit dhe rrethanave individuale të personit të shpallur fajtor.⁹¹²

355. Ky nuk është rast ku i akuzuari apo dikush i lidhur me të ndërhyjnë në gjykim për motive personale. Të akuzuarit u angazhuan në përpjekje të vazhdueshme për ta sulmuar DHSK-në si tërësi. Veprimet e tyre ndikojnë në çdo gjykim aktual dhe të ardhshëm të kësaj gjykate dhe në të gjithë komunitetin e dëshmitarëve në të cilët mbështetet ZPS-ja për t'i ndjekur penalisht çështjet. Rrethanat konkrete të çështjes kundër të akuzuarve, përfshirë kombinimin e faktorëve në vijim i bëjnë veprimet e të akuzuarve veçanërisht të rënda. Kjo duhet të pasqyrohet në dënimin që do të shqiptohet.

356. *Koha e kryerjes së krimeve.* Krimet u kryen para se të bëhej publike përmbajtja e edhe një aktakuze të vetme kundër cilitdo të akuzuar, ku arrestimi i të akuzuarit Salih Mustafa ndodhi vetëm një ditë para arrestimit të të akuzuarve. Në kohën e kryerjes së veprave penale, asnjë dëshmitar nuk kishte dëshmuar para Gjykatës në ndonjë proces. Salih Mustafa ende nuk e kishte bërë as paraqitjen e parë para gjykatës.

357. I vetmi informacion publik për ecurinë e çështjeve të DHSK-së ishte se ZPS-ja

⁹¹⁰ P00004ET, f.3, 8.

⁹¹¹ P00033ET, f.1; P00017ET, f.1, 4-6; P00020; P00007ET, f.3.

⁹¹² *Shih Jokić AJ, IT-05-88-R77.1-A, para.40; Bulatović Appeal Decision, IT-02-54-A-R77.4, para.62.*

kishte dorëzuar aktakuza kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe të tjerëve që nuk ishin identifikuar. Të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për këtë,⁹¹³ ku Gucati i karakterizoi aktakuzat që ende nuk i kishte parë si të motivuara politikisht⁹¹⁴ dhe Haradinaj i hodhi poshtë si 'vetëm një pamflet i Gjykatës' dhe 'shantazh'.⁹¹⁵ Duke pasqyruar synimin e të akuzuarve, Tomë Gashi deklaroi se publikimi i dokumenteve nga OVL-UÇK-ja nënkuptonte se gjykatësi duhet të mendojë dy herë para se të vendoste a ta konfirmonte aktakuzën kundër President Thaçit dhe të tjerëve, dhe se shpresonte se dokumentet e rrjedhura do të ndihmonin që të mos konfirmoheshin aktakuza kundër President Thaçit.⁹¹⁶

358. Kjo do të thotë se krimet ndodhën në një kohë veçanërisht të ndjeshme meqenëse Gjykata vetëm sa kishte filluar procedurat gjyqësore zyrtare. Kuptohet që vëmendja e dëshmitarëve dhe viktimave në të gjitha hetimet dhe çështjes gjyqësore ishte përqendruar në DHSK-në dhe ZPS-në, duke shpresuar se këto institucione do të ishin në gjendje t'i mbronin interesat e tyre. Për rrjedhojë, të akuzuarit i kryen veprimet në një moment veçanërisht të ndjeshëm të ekzistencës së kësaj Gjykate dhe rrezikonin të dëmtonin që në fillim procesin gjyqësor, gjë që të akuzuarit e pranuan se donin ta bënin.⁹¹⁷

359. *Qëllimet që të akuzuarit përpiqeshin të arrinin.* Synimi i të akuzuarve ishte që të pengonin punën e DHSK-së/ZPS-së në përgjithësi, e jo në lidhje me ndonjë dëshmitar, hetim apo gjykim konkret.⁹¹⁸ Haradinaj tha se ai dhe të tjerët po i kryenin veprimet e tyre për ta diskredituar profesionalizmin e pretenduar të Gjykatës,⁹¹⁹ se dokumentet që po i bënin publike mund të përdoreshin për ta sulmuar besueshmërinë e DHSK-

⁹¹³ P00037ET, f.1-4.

⁹¹⁴ P00037ET, f.1-2.

⁹¹⁵ P00039ET, f.2.

⁹¹⁶ P00007ET, f.16-17.

⁹¹⁷ *Shih, për shembull*, P00018ET, f.5-6.

⁹¹⁸ *Shih* nënpjesën IV.F.2 më lart.

⁹¹⁹ P00034ET, f.2; P00011ET, f.56.

së,⁹²⁰ dhe se ishte e rëndësishme që dokumentet që i ishin dhënë OVL-UÇK-së të sabotonin punën e kryer nga Gjykata.⁹²¹ Gucati tha se ai dhe të tjerët 'janë të interesu me demasku Dhomat Speciale',⁹²² e theksoi rëndësinë që të demonstrojnë se Gjykata ishte e pavlerë,⁹²³ përshkroi sabotimin e DHSK-së si përgjegjësi të tij,⁹²⁴ dhe shprehu dëshirën që ta heqë qafe DHSK-në dhe ta shpërbëjë.⁹²⁵ Ky synim tregon shkallën e dëmit që të akuzuarit donin ta shkaktonin me veprimet e tyre. Qëllimi i tyre përfundimtar ishte që kjo gjykatë ta ndalte punën.

360. *Lloji dhe sasia e informacionit të bërë publik nga të akuzuarit.* Kjo përfshinte: (i) mbi njëqind kërkesa për koordinim dhe kërkesa të përgjithshme për ndihmë në çështje penale që ishin pjesë e hetimeve të TFHS-së dhe ZPS-së dhe kishin të bënin me to;⁹²⁶ (ii) raporte të brendshme dhe korrespondencë të autoriteteve serbe;⁹²⁷ (iii) tridhjetë e pesë deklarata ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve që ishin marrë nga autoritetet serbe, përfshirë të dhëna personale dhe informacion të hollësishëm për krime të rënda;⁹²⁸ dhe (iv) një dokument konfidencial të ZPS-së ku analizoheshin disa prova dhe ligji përkatës në lidhje me pesë individë, dhe ku përmendeshin afërsisht 150 dëshmitarë dhe hollësi të deklaratave të tyre.⁹²⁹ Duke e vënë këtë material në dispozicion të publikut, të akuzuarit zbuluan identitetet dhe të dhënat personale të qindra dëshmitarëve të klasifikuar dhe të mbrojtur si konfidencial nga ZPS-ja.⁹³⁰

⁹²⁰ P00007ET, f.3-5.

⁹²¹ P00030ET, f.18.

⁹²² P00004ET, f.8.

⁹²³ P00029ET, f.2.

⁹²⁴ P00028ET, f.8-9.

⁹²⁵ P00028ET, f.11.

⁹²⁶ Pumper, T.1470-1; P00086, para. 7-9; P00088, para. 6-12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; P00139-P00150.

⁹²⁷ P00088, para.8; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; Pumper, T.860-61.

⁹²⁸ P00088, para.12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; P00087, para.4; Pumper, T.885-87.

⁹²⁹ P00086, para. 29, 31; P00090, para. 7-10, Shtojca 5; P00035ET, f.3; P00011ET, f.30; Pumper, T.949-961, 1471.

⁹³⁰ *Shih*, në lidhje me Paketën 1, P00086, para. 9-12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; P00088, para.12; Pumper, T.860-61, 866, 870-88, 1470-71, 1474. *Shih*, në lidhje me Paketën 2, P00086, para. 22-27, Pumper, T.915-

361. Përveç bërjes së këtij informacioni publik duke ia dhënë përfaqësuesve të mediave, vetë të akuzuarit i thanë emrat dhe/ose të dhënat personale të shumë dëshmitarëve⁹³¹ dhe, me gojën e tyre, bënë të qartë midis të tjerash se ZPS-ja: (i) kishte kryer dhe/ose po kryente veprime hetimore në lidhje me shumë vende, përfshirë [REDAKTUAR];⁹³² (ii) konsideronte Azem Sylën, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin si të dyshuar;⁹³³ dhe (iii) kishte hetuar disa anëtarë të tjerë të UÇK-së.⁹³⁴ ZPS-ja nuk kishte bërë publike asgjë nga ky informacion në atë kohë.⁹³⁵

362. Zbulimet e informacionit nga të akuzuarit në lidhje me vendet në të cilat ZPS-ja kishte kryer ose po kryente hetime krijoi rreziqe se mund të ishte komprometuar siguria e personave që diheshin se kishin qenë viktime të krimeve në ato vende ose që kishin informacion përkatës. Kjo është e vërtetë sidomos duke pasur parasysh gjykimet e mëparshme publike në lidhje me ato vende dhe/ose famën e keqe të krimeve të kryera në ato vende. Zbulimi i këtyre vendeve gjithashtu rrezikoi aftësinë e ZPS-së për kryerjen e hetimeve të domosdoshme në lidhje me to.

363. Pasojat e dëmshme të zbulimit publik të informacionit nuk po zmadhohen aspak duke pasur parasysh mundësinë që të rrezikojnë veçanërisht bashkëpunimin e dëshmitarëve dhe palëve të treta. Faktikisht, gjatë viteve, tribunalët penalë ndërkombëtarë kanë mësuar nga përvoja se krime të njëjta si ato të kryera nga të akuzuarit mund të sabotojnë lehtësisht punën e një gjykate.

364. Kjo gjykatë duhet të mësojë nga përvojat e tribunalëve të tjerë dhe të shqyrtojë në këtë aspekt nëse dënimet e shqiptuara në çështjet e mëparshme të ndërhyrjes në

18; P00090, para. 5-6, Shtojca 3; *Shih*, në lidhje me Paketën 3, P00086, para.31; P00090, para. 7-9, Pumper, T.949-50.

⁹³¹ *Shih* para. 32, 63-64, 68, 97, 120 më lart.

⁹³² P00035ET, f.2; P00002ET, f.3.

⁹³³ P00035ET, f.2.

⁹³⁴ P00009ET, f.5-6.

⁹³⁵ *Shih* Pumper, T.931-32 (seancë private).

drejtësi kanë qenë të mjaftueshme për pasqyrimin e peshës së veprave dhe parandalimin e tyre në të ardhmen. Megjithatë, rrethanat e kësaj çështjeje, përfshirë ato të përcaktuara më lart në lidhje me kohën, qëllimet që synoheshin dhe llojin e sasinë e informacionit, ndryshojnë materialisht nga ato në çështjet e mosbindjeve para gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe gjykatave vendore në Kosovë. Rrjedhimisht, këto çështje japin orientim të pakët për dënimin e përshtatshëm.⁹³⁶

365. Faktikisht, 'ndryshimet midis çështjeve shpesh janë më domethënëse se ngjashmëritë dhe rrethana të ndryshme lehtësuese dhe rënduese mund të diktojnë rezultate të ndryshme'⁹³⁷ Edhe kur ekzistojnë çështje të ngjashme, ato nuk ofrojnë listë ligjrisht detyruese të dënimeve, sidomos duke pasur parasysh faktin se çdo çështje përmban një numër të madh ndryshoresh.⁹³⁸ Gjithashtu, nuk ekziston asnjë kriter që e detyron Trupin Gjykes të shqyrtojë nëse i njëjti dënim është shqiptuar për një akuzë më të rëndë apo më të lehtë për mosbindje në një çështje tjetër.⁹³⁹

25. Krimet e të akuzuarve kanë pasoja me ndikim të gjerë për dëshmitarët

366. Veprimet e të akuzuarve përbëjnë ndërhyrje të rëndë në administrimin e drejtësisë sepse midis të tjerash krijuan rrezik real që të cenohet besimi në aftësinë e DHSK-së për të miratuar masa mbrojtëse efektive dhe që dëshmitarët (gjithashtu edhe shtetet dhe subjektet e tjera që mundësojnë kontaktet me dëshmitarë) të ndërrojnë mendjen për bashkëpunim me ZPS-në dhe Gjykatën, duke ndikuar pashmangshmërisht në aftësinë e Gjykatës për ushtrimin e juridiksionit në ndjekjen penale dhe ndëshkimi e shkeljeve të rënda të të drejtës humanitare siç përcaktohet me

⁹³⁶ *Shih STL, Case against Al Khayat Reasons for Sentencing Judgment*, STL-14-05/S/CJ, 6 October 2016, para.22; *ICTY, Prosecutor v. Tabaković, Sentencing Judgment*, IT-98-32/1-R77.1, 18 March 2010, para.15; *Shih gjithashtu Vendimi i Apelit në çështjen Bulatović*, IT-02-54-A-R77.4, para.62.

⁹³⁷ *Dragomir Milošević AJ, Case No. IT-98-29/I-A*, para.326; *2010 Šešelj Contempt AJ*, IT-03-67-R77.2-A, para.41.

⁹³⁸ *Dragomir Milošević AJ, Case No. IT-98-29/I-A*, para.326; *2010 Šešelj Contempt AJ*, IT-03-67-R77.2-A, para.41.

⁹³⁹ *Shih Bulatović Appeal Decision*, IT-02-54-A-R77.4, para.62.

mandatin e saj.⁹⁴⁰ Mbrojtja e dëshmitarëve, përfshirë përmes masave mbrojtëse, është kyçe për suksesin e Gjykatës,⁹⁴¹ ashtu siç është besimi publik në efikasitetin e masave të tilla.⁹⁴²

367. Si rezultat i veprimeve të të akuzuarve, dëshmitarët shprehën zemërim, shqetësim dhe frikë, dhe u ndien të frikësuar.⁹⁴³ Një person që e kontaktoi ZPS-në i tha Jukiqit se ai i kishte besuar ZPS-së por emri i tij tani ishte bërë publik dhe familja e tij ishte në rrezik, duke vënë në dukje se e dinte se çfarë u kishte ndodhur dëshmitarëve në Kosovë, gjë që Jukiqi e kuptoi se ishte fjala për dëshmitarët që ishin kërcënuar gjatë procedurave ligjore në Kosovë.⁹⁴⁴

368. Veprimet e të akuzuarve gjithashtu i bënë dëshmitarët të shprehnin mungesën e vullnetit për të vazhduar bashkëpunimin me ZPS-në.⁹⁴⁵ Në veçanti, një dëshmitar ishte aq i frikësuar për sigurinë e vet dhe të familjes dhe aq i vendosur që të mos bashkëpunojë më tej sa që e pyeti ZPS-në nëse mund ta informojë DHSK-në se ai nuk mund të gjendet.⁹⁴⁶

369. Gjithashtu, veprimet e të akuzuarve bënë të nevojshme marrjen e masave të sigurisë ose masave mbrojtëse në lidhje me shumë dëshmitarë,⁹⁴⁷ duke përfshirë sigurimin e numrave telefonikë dhe telefonave të rinj për komunikim të sigurt, përgatitjen e planeve urgjente për menaxhimin e rrezikut, dhe zhvendosjen jashtë

⁹⁴⁰ *Shih Marijačić and Rebić TJ, IT-95-14-R77.2, para.50; 2011 Šešelj Contempt TJ, IT-03-67-R77.3, para.80; Nshogoza TJ, ICTR-07-91-T, para.218; Haxhiu TJ, IT-04-84-R77.5, para.34; Hartman TJ, IT-02-54-R77.5, para.80.*

⁹⁴¹ *Shih Nshogoza TJ, ICTR-07-91-T, para.218; Haxhiu TJ, IT-04-84-R77.5, para.34; Nzabonimpa et al. TJ, MICT-18-116-T, para.399; Shih gjithashtu Reid, T.3360-61.*

⁹⁴² *Shih 2011 Šešelj Contempt TJ, IT-03-67-R77.3, para.80; Hartmann TJ, IT-02-54-R77.5, para.80; Marijačić and Rebić TJ, IT-95-14-R77.2, para.50.*

⁹⁴³ *Jukić, T.1693, 1699-1700, 1703-07, 1719; Shih gjithashtu Jukić, T.1712, 1714-15, 1722-24, 1726, 1731-32.*

⁹⁴⁴ *Jukić, T.1704-05, 1758-59.*

⁹⁴⁵ *Jukić, T.1702-03, 1905; Pumper, T.1012.*

⁹⁴⁶ *Pumper, T.1009-10, 1012.*

⁹⁴⁷ *Jukić, T.1763.*

Kosovës.⁹⁴⁸ Përgatitja e planeve urgjente të menaxhimit të rrezikut dhe zhvendosja ishin masa të jashtëzakonshme për një numër të kufizuar dëshmitarësh. Kjo bëri të nevojshëm vlerësimin se ekzistonte nivel i lartë i kërcënimit ndaj dëshmitarëve.⁹⁴⁹

370. Një tjetër faktor i rëndësishëm sa u përket pasojave të veprimeve të të akuzuarve është se pjesëmarrja e madhe e mediave në konferencat për shtyp të OVL-UÇK-së,⁹⁵⁰ që ishte rezultat i vendimeve të të akuzuarve për t'i ftuar për pjesëmarrje,⁹⁵¹ rezultoi në njohuri të gjerë të publikut për këto ngjarje⁹⁵² dhe në publikimin e përmbajtjes së dokumenteve konfidenciale të TFHS-së/ZPS-së përfshirë emra të dëshmitarëve dhe prova, në shtyp dhe në internet.⁹⁵³ Fakti që materiali i shpërndarë nga të akuzuarit përfundoi në mënyrë të parashikueshme në internet, 'e zgjeroi pafundësisht informacionin e shpërndarë', duke rritur shtrirjen e nxjerrjes së paautorizuar të informacionit dhe duke e rritur peshën e krimeve.⁹⁵⁴

D. EKZISTOJNË SHUMË FAKTORË RËNDUES

371. Në përputhje me nenin 44(5) dhe rregullën 163(1)(b), në përcaktimin e dënimit të të akuzuarve, Trupi Gjykses merr parasysh, sipas rastit, rrethanat rënduese kur është e zbatueshme. Lista e rrethanave rënduese e përcaktuar në rregullën 163(1)(b) nuk është shteruese. Trupi Gjykses ka kompetencë të gjerë vendimmarrjeje gjatë përcaktimit se çfarë përbën rrethanë rënduese, që duhet të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm, dhe rëndësinë që duhet t'i jepet.⁹⁵⁵

26. Të akuzuarit shpërdorën kompetencat apo detyrën zyrtare në kryerjen e

⁹⁴⁸ Jukić, T.1707-09, 1762-63, 1882-84, 1891-92, 1901-02.

⁹⁴⁹ Jukić, T.1760-61; *Shih gjithashtu* Jukić, T.1708, 1906.

⁹⁵⁰ P00012ET, f.7; Berisha, T.1516-17; Gucati, T.2170, 2199-2201; Haradinaj, T.2730, 2783; Haradinaj, 2D00001ET, para. 57-58, 110.

⁹⁵¹ *Shih* para. 27-28, 62, 94 më lart.

⁹⁵² Jukić, T.1715-16; *Shih gjithashtu* Marashi, T.2537.

⁹⁵³ *Shih* para. 37, 78, 82, 92, 112, 156, 165 më lart.

⁹⁵⁴ 2011 *Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.3, para.78; *Hartman* TJ, IT-02-54-R77.5, para.82.

⁹⁵⁵ *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.220; *Jokić AJ*, IT-05-88-R77.1-A, para.40; *Pećanac* TJ, IT-05-88/2-R77.2, para.39; *Beqaj* TJ, IT-03-66-T-R77, para.61.

krimeve

372. Shpërdorimi i kompetencave apo detyrës zyrtare është rrethanë rënduese e përmendur shprehimisht në rregullën 163(1)(b)(ii).

373. Gucati kishte qenë i angazhuar me OVL-UÇK-në për gati njëzet vjet në kohën kur u arrestua, dhe ishte zgjedhur kryetar i OVL-UÇK-së në vitin 2017, kur Haradinaj u zgjodh zëvendëskryetar dhe zëdhënës.⁹⁵⁶ Si kryetar, sipas vetë Gucatit, ai kishte shumë përgjegjësi.⁹⁵⁷ Ai ishte përgjegjës për administrimin e përditshëm të OVL-UÇK-së, përfshirë financat, dhe ishte 'përgjegjës pikërisht për mbrojtjen dhe interesin e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës'.⁹⁵⁸ Ai mori pjesë në takime të nivelit të lartë, dhe lloji të anëtarët e parlamentit në lidhje me përpilimin e legjislacionit lidhur me veteranët.⁹⁵⁹

374. Dokumentet konfidenciale të TFHS-së/ZPS-së u dorëzuan në OVL-UÇK. Kjo do të thotë se, nëse nuk do të kishin qenë të angazhuar në atë organizatë, ata as nuk do të kishin pasur qasje në ato dokumente. Vendimi i tyre për t'i bërë dokumentet publike u mor në kontekst të kompetencave të tyre konkrete dhe funksioneve zyrtare.⁹⁶⁰

375. Të akuzuarit gjithashtu shpërdorën kompetencat ose postet e tyre për të tërhequr sa më shumë që ishte e mundshme vëmendjen e mediave dhe publikut në lidhje me dokumentet që po i bënin publike pa autorizim, duke synuar të shkaktonin dëm maksimal. Gjithashtu, si pjesë e rolit të tyre në OVL-UÇK, ata dolën në programe televizive dhe e shfrytëzuan këtë mundësi që ta shpërndanin edhe më tepër

⁹⁵⁶ Gucati, T.2158-59; Gucati, 1D00003ET, para. 8, 74; Haradinaj, 2D00001ET, para.16; Haradinaj, T.2723, 2730, 2750, 2935; *Shih gjithashtu* P00001ET, f.7-8; P00002ET, f.1-2; P00004ET, f.2.

⁹⁵⁷ Gucati, 1D00003ET, para.9.

⁹⁵⁸ Gucati, T.2159-60; Gucati, 1D00003ET, para.9.

⁹⁵⁹ Gucati, T.2159-60; Gucati, 1D00003ET, para.9.

⁹⁶⁰ *Shih* para. 27, 62, 94 më lart.

informacionin konfidencial. Dëshmia e Gucatit se 'Zoti Haradinaj nuk mund të flet në emër të vet se është nënkryetar dhe zoti Haradinaj, gjithmonë, nëse ka folur, ka folur në emër të Organizatë së Veteranëve të luftës.',⁹⁶¹ është e rëndësishme në këtë aspekt.

376. Nëse Trupi Gjykes nuk konstaton se të akuzuarit *shpërdorën* kompetencat apo detyrën zyrtare në OVL-UÇK, fakti se ata i *shfrytëzuan* ato megjithatë duhet të merret parasysh dhe të pasqyrohet në dënimin e tyre.⁹⁶²

27. Viktimat e krimeve të të akuzuarve ishin veçanërisht të cenueshëm apo pa mbrojtje

377. Kryerja ose pjesëmarrja në krime ku viktimat është veçanërisht e cenueshme apo pa mbrojtje është rrethanë rënduese e përmendur shprehimisht në rregullën 163(1)(b)(iii).⁹⁶³ Dëshmitarët të dhënat personale dhe/ose dëshmitë e të cilëve të akuzuarit i bënë publike pa autorizim ishin midis viktimave të krimeve të tyre; këta dëshmitarë ishin edhe të cenuar edhe pa mbrojtje.

378. Dëshmitarët ishin të cenueshëm, midis të tjerash, duke pasur parasysh atmosferën e frikësimit që vazhdon në Kosovë.⁹⁶⁴ Ndër dëshmitarët të dhënat personale dhe/ose dëshmitë e të cilëve të akuzuarit i bënë publike pa autorizim, ishin edhe disa që ishin nën masa mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata. Masa të tilla gjithashtu sugjerojnë cenueshmëri të veçantë lidhur me dëshmitarë përkatës duke pasur parasysh se masat e asaj natyre urdhërohen për të mbrojtur, midis tjerash, sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e

⁹⁶¹ Gucati, T.2430.

⁹⁶² *Shih* ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.* Public Redacted Judgement on the appeals of the Prosecutor, Mr. Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr. Fidèle Babala Wandu and Narcisse AReido against the decision of Trial Chamber VII entitled "Decision on Sentence pursuant to Article 76 of the Statute", ICC-01/05-01/13-2276-Red, 8 mars 2018, para. 121-30.

⁹⁶³ *Shih gjithashtu Beqaj* TJ, IT-03-66-T-R77, para.62.

⁹⁶⁴ *Shih* para. 202-203 më lart.

dëshmitarëve.⁹⁶⁵

379. Cenueshmëria e disa dëshmitarëve gjithashtu ilustruhet nga nevoja për të zhvendosur dy dëshmitarë të tillë dhe për përgatitur plane urgjente të menaxhimit të rrezikut në lidhje me të tjerë.⁹⁶⁶

380. Dëshmitarët ishin pa mbrojtje sepse nuk ishin pyetur për vendimin e vetëdijshëm të të akuzuarve që ta zbulonin informacionin e tyre pa autorizim.

28. Krimet e të akuzuarve kishin viktima të shumëfishta

381. Kryerja ose pjesëmarrja në kryerjen e krimit me viktima të shumëfishta është rrethanë rënduese e përmendur shprehimisht në rregullën 163(1)(b)(iv).

382. Përmes veprimeve të tyre gjatë kuadrit kohor të akuzave, të akuzuarit nxorën identitetet dhe të dhënat personal të qindra dëshmitarëve, të klasifikuara dhe të mbrojtura nga ZPS-ja si konfidenciale.⁹⁶⁷ Vetëm Paketa 1 përmbante tridhjetë e pesë deklarata ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë të dhëna personale dhe informacion të hollësishëm për krime të rënda.⁹⁶⁸ Në Paketën 3 përmendeshin afërsisht 150 dëshmitarë si hollësi të deklaratave të tyre.⁹⁶⁹

383. Fakti që aq shumë dëshmitarë u implikuan nga veprimet e të akuzuarve duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese.⁹⁷⁰

29. Të akuzuarit kanë shprehur qartë synimin që të kryejnë krime të tjera të

⁹⁶⁵ *Shih, për shembull*, rregulla 80.

⁹⁶⁶ Jukić, T.1707-09, 1762-63, 1882-84, 1891-92, 1901-02.

⁹⁶⁷ *Shih*, në lidhje me Paketën 1, P00086, para. 9-12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; P00088, para.12; Pumper, T.860-61, 866, 870-88, 1470-71, 1474. *Shih*, në lidhje me Paketën 2, P00086, para. 22-27, Pumper, T.915-18; P00090, para. 5-6, Shtojca 3; *Shih*, në lidhje me Paketën 3, P00086, para.31; P00090, para. 7-9, Pumper, T.949-50.

⁹⁶⁸ P00088, para.12; P00090, para. 3-4, Shtojca 1; P00087, para.4; Pumper, T.885-87.

⁹⁶⁹ P00086, para. 29, 31; P00090, para. 7-10, Shtojca 5; P00035ET, f.3; P00035, min.00:06:54-00:10:28; P00011ET, f.30; P00011, min.00:39:20-00:39:58; Pumper, T.1471, 949-61.

⁹⁷⁰ *Shih Senessie SJ*, SCSL-2011-01-T, para. 15, 18; *Shih gjithashtu Margetić TJ*, IT-95-14-R77.6, para.86.

njëjta

384. Të akuzuarit nuk shprehën thjesht vetëm falënderimin për marrjen e dokumenteve në OVL-UÇK dhe ftuan personin (personat) që i dorëzoi dokumentet ta bënin këtë përsëri.⁹⁷¹ Si gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës si edhe në bankën e të akuzuarve, të akuzuarit e bënë tepër të qartë se çfarë do të bënin nëse do të merrnin dokumente të tilla në të ardhmen.

385. Më 9 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se nëse do të merrte përsëri material të njëjtë si dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, do ta bënte publik edhe nëse OVL-UÇK-ja do ta shkelte ligjin me këtë.⁹⁷² Dy ditë më vonë, Haradinaj deklaroi se, sa herë që do të merrnin dokumente, do t'i bënin publike.⁹⁷³

386. Gjatë konferencës së dytë për shtyp, Haradinaj përsëriti premtimin e tij se sa herë që OVL-UÇK-ja do të merrte dokumente, do t'i bënte publike.⁹⁷⁴ Gjatë një interviste po të njëjtën ditë, Haradinaj kujtoi se ai dhe të tjerë kishin deklaruar publikisht se do të nxirrnin çfarëdo materiali që do të merrnin, që komprometon DHSK-në dhe ZPS-në.⁹⁷⁵ Të nesërmen, Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja u tha punonjësve të ZPS-së se çdo herë që do të merrnin dokumente të DHSK-së do t'i bënin publike.⁹⁷⁶ Më 20 shtator 2020, Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerë do të bënin publike çdo gjë që saboton ZPS-në, sepse ata nuk e njihnin atë.⁹⁷⁷

387. Gjatë konferencës së tretë për shtyp, Haradinaj vuri në dukje se personi që i

⁹⁷¹ P00001ET, f.1-2; P00001, min.00:01:26-00:06:30; P00080 (P00080ET); P00083, p.SPOE00222248, SPOE00222250 (P00083ET, p.SPOE00222248, SPOE00222250); P00006ET, f.4; P00017ET, f.5; P00075 (P00075ET); P00033ET, f.2-3; P00007ET, f.2; P00008ET, f.2-4.

⁹⁷² P00024ET, f.7-8.

⁹⁷³ P00021ET, f.3-5.

⁹⁷⁴ P00002ET, f.4.

⁹⁷⁵ P00018ET, f.1-2.

⁹⁷⁶ P00004ET, f.3.

⁹⁷⁷ P00025ET, f.9-10.

solli dokumentet la një porosi duke thënë se tani e tutje do të sillte CD.⁹⁷⁸ Haradinaj tha se ai dhe të tjerë e mirëpritën këtë dhe se OVL-UÇK-ja do të bënte publike çdo gjë që do të merrnin.⁹⁷⁹ Më vonë të njëjtën ditë, Gucati i konfirmoi fjalët e Haradinajt, duke thënë se personi i panjohur që i kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK u kishte thënë se do të sillte CD me materiale; Gucati gjithashtu deklaroi se OVL-UÇK-ja do t'i bënte ato dokumente publike.⁹⁸⁰ Gjatë një interviste tjetër, Gucati tha se do të bënte publike të gjitha dokumentet që do të mund të merrte.⁹⁸¹

388. Nuk ka arsye për ta dyshuar deklaratën e Haradinajt se ai dhe të tjerë në OVL-UÇK 'sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate' dhe se '[k]ena me punu kundër kësaj gjykate. Fund'.⁹⁸² Gjatë një interviste tjetër atë ditë, Haradinaj tha se nuk do t'i zbatonte urdhrat e gjykatës e as nuk do ta njihte atë, dhe se ishte detyrë e tij dhe të tjerëve të punonin kundër saj.⁹⁸³ Pak para arrestimit, Haradinaj tha se nëse do të merrte dokumente të tjera do t'ua jepte mediave.⁹⁸⁴

389. Gjatë dëshmisë, Gucati pranoi se kishte bërë deklarata publike për shtypin midis 7 dhe 22 shtatorit 2020 se do ta bënte publik çdo dokument të sjellë në OVL-UÇK, duke shtuar 'Thashë s'jam tuj u frigu prej as punës time ça kam bo'.⁹⁸⁵ Në pyetjen se a do t'i përsëriste veprimet e tij nga e para, Gucati dëshmoi: 'Unë jam deklaruar edhe ma herët dhe ditën e djeshme dhe të pardjeshme jam deklaruar, e nderuara. Unë s'jam gardian i askujt, asnjë institucioni në vendin tim ma së pari, po as ne Hagë, këtu në Holandë. Unë ruaj zyrat e mia ku unë punoj unë. Jam gardian i asaj pune ku jam i thirrur. Kështu që unë ju kisha bërë lutje mos na provokoni me dokumentacione.'⁹⁸⁶ Kjo

⁹⁷⁸ P00035ET, f.2-3.

⁹⁷⁹ P00035ET, f.2-3; *Shih gjithashtu* P00030ET, f.2-4.

⁹⁸⁰ P00029ET, f.2.

⁹⁸¹ P00028ET, f.7-8.

⁹⁸² P00015ET, f.2; P00015, min.00:03:24-00:04:59.

⁹⁸³ P00026ET, f.2, 4-5.

⁹⁸⁴ P00026ET, f.4-5.

⁹⁸⁵ Gucati, T.2221-22; *Shih gjithashtu* Gucati, T.2219-20.

⁹⁸⁶ Gucati, T.2401.

nuk është aspak befasuese duke pasur parasysh disa pjesë të tjera nga dëshmia e tij ku tha: 'jam kundër kësaj Gjykate dhe prapë them jam kundër kësaj Gjykatës',⁹⁸⁷ se ai e ka 'humbur besimin'⁹⁸⁸ dhe se: 'Po t'i kisha edhe 100 vjet ymër, mbas këtyne viteve që i kam 54, këtë Gjykatë, kam thënë me kohë, nuk e përkrahi'.⁹⁸⁹

390. Dëshmia e Haradinajt konfirmoi atë të Gucatit në këtë aspekt. Ai dëshmoi se, nëse do t'i jepeshin dokumente: 'të njëjtë do të veproj se hala kam mendimin e njëjtë. Për q' aq sa kam vepru që kam bo drejtë'.⁹⁹⁰ Haradinaj tha se nëse do t'i jepej material që ai e konsideronte se ishte në interesin publik, do ta bënte publik përsëri⁹⁹¹ dhe se, përveç nëse do të ndryshohej DHSK-ja, ai do të ishte gjithmonë kundër saj,⁹⁹² duke shtuar më vonë se do të ishte 'kundërshtar'⁹⁹³ i ZPS-së.

391. Nëse të akuzuarit, po t'u jepej mundësia, do të kryenin krime të njëjta si ato për të cilat janë akuzuar gjithashtu provohet nga refuzimi i tyre absolut për t'iu bindur urdhrave gjyqësorë dhe nga kundërshtimet e tyre gjatë gjykimit.

392. Më 6 dhjetor 2021, Kryegjykatësi i Trupit Gjyqësor e paralajmëroi Mbrojtjen që të mos përmendte në seancë të hapur asnjë nga emrat që janë në dokumentet që iu sekuestruan OVL-UÇK-së përveç emrit të Vladimir Vukçeviqit.⁹⁹⁴ Pak kohë pas kësaj, Gucati e shkeli këtë urdhër, duke përmendur një emër që ishte i ndaluar të përmendej në seancë të hapur dhe duke shtuar në mënyrë sfiduese, 'nuk kam frikë të përmend emrin e tina [...] atë njeri s'mund ta mbroj'.⁹⁹⁵ Kryegjykatësi i Trupit Gjyqësor përsëriti paralajmërimin e mëhershëm dhe Gucati konfirmoi se e kuptonte se nuk mund të

⁹⁸⁷ Gucati, T.2412-13; *Shih gjithashtu* Gucati, T.2272.

⁹⁸⁸ Gucati, T.2181.

⁹⁸⁹ Gucati, T.2204.

⁹⁹⁰ Haradinaj, T.3024.

⁹⁹¹ Haradinaj, T.3046-47.

⁹⁹² Haradinaj, T.2876-79.

⁹⁹³ Haradinaj, T.2915.

⁹⁹⁴ Gucati, T.2146.

⁹⁹⁵ Gucati, T.2175-77.

përmendte emra përveç nëse i kërkohej konkretisht.⁹⁹⁶ Sidoqoftë, Gucati e përmendi emrin e të njëjtit person në seancë të hapur disa herë pas kësaj.⁹⁹⁷ Haradinaj gjithashtu e përmendi emrin e të njëjtit person në seancë të hapur.⁹⁹⁸

393. Gucati gjithashtu përmendi emrin e një punonjësi të ZPS-së në seancë të hapur⁹⁹⁹ në shkëlqe të qartë të urdhrave të Trupit Gjykses,¹⁰⁰⁰ duke shtuar: 'nuk ka mundësi – nuk ka nevojë që emri i këtij personi të mbahet i fshehtë.'¹⁰⁰¹ Gucati e bëri këtë në disa raste të tjera¹⁰⁰² përkundër paralajmërimeve të përsëritura të Kryegjykatësit të Trupit Gjykses që mos ta bënte këtë.¹⁰⁰³ Kur avokati i ZPS-së që po bënte pyetje e paralajmëroi Gucatin që mos ta përmendte këtë emër në seancë të hapur, ai tha: 'mendoj se nuk ka asgjë të keqe të përmendet emri i tij'.¹⁰⁰⁴

394. Mungesa e keqardhjes¹⁰⁰⁵ së bashku me treguesin e synimit për të kryer krime të tjera të njëjta si ato për të cilat ngarkohet i akuzuari konsiderohen të rëndësishme për dënimin që do të shqiptohet¹⁰⁰⁶ dhe duhet të konsiderohen si rrethanë tepër rënduese në çështjen kundër të akuzuarve.

395. Në qoftë se Trupi Gjykses nuk e merr parasysh si faktor rëndues treguesin e qartë se të akuzuarit synojnë të vazhdojnë të kryejnë krime të njëjta si ato për të cilat janë akuzuar, gjithsesi atij duhet t'i jepet rëndësia e duhur në dënim, sidomos duke pasur parasysh nevojën për parandalim.

⁹⁹⁶ Gucati, T.2176-77.

⁹⁹⁷ Gucati, T.2262-63, 2350, 2436.

⁹⁹⁸ Haradinaj, T.2811.

⁹⁹⁹ Gucati, T.2166.

¹⁰⁰⁰ *Shih për shembull*. Vendim mbi Klasifikimin dhe Versionet e Redaktuara Publike të Provave Materiale Jogojore, KSC-BC-2020-07/F00350, 5 tetor 2021; Pumper, T.1168-69. *Shih gjithashtu* Transkript, 30 mars 2021, T.213-14.

¹⁰⁰¹ Gucati, T.2166.

¹⁰⁰² Gucati, T. 2167-68, 2199, 2251.

¹⁰⁰³ Gucati, T. 2167-68, 2199, 2251.

¹⁰⁰⁴ Gucati, T.2251.

¹⁰⁰⁵ *Shih* para.400 më poshtë.

¹⁰⁰⁶ 2011 *Šešelj Contempt* TJ, IT-03-67-R77.3, para.79.

E. NUK EKZISTOJNË FAKTORË LEHTËSUES

396. Trupi gjykues ka kompetence të gjerë diskrecionale gjatë përcaktimit se çfarë përbën rrethanë lehtësuese, që duhet të vërtetohet në bazë të tërësisë së gjasave dhe çfarë rëndësie duhet t'i jepet.¹⁰⁰⁷

397. Nuk ka rrethana që do të mund ta lehtësonin dënimin që do të shqiptohet kundër të akuzuarve. Konkretisht, nuk ka rrethana që nuk përbëjnë arsye për përjashtimin e përgjegjesisë penale.¹⁰⁰⁸ Të akuzuarit nuk u dorëzuan vullnetarisht, dhe nuk bashkëpunuan me ZPS-në dhe DHSK-në.¹⁰⁰⁹ Përkundrazi, të akuzuarit bënë të qartë se nuk do të bashkëpunonin me këtë Gjykatë, të cilën nuk e njohin¹⁰¹⁰ dhe të cilën Haradinaj e konsideron inekzistente¹⁰¹¹ dhe Gucati e konsideron jorelevante.¹⁰¹² Faktikisht, Gucati tha se e konsideron përgjegjësi të tij që ta sabotojë Gjykatën¹⁰¹³ dhe se, po t'i jepej mundësia, ai dhe të tjerë do ta shpërbënin,¹⁰¹⁴ ndërsa Haradinaj u betua se do të bëjë çmos për ta turpëruar.¹⁰¹⁵ Haradinaj gjithashtu tha se nuk do ta zbulonte identitetin e personit që i dorëzoi dokumentet në OVL-UÇK edhe nëse ky person nuk do të kishte pasur maskë.¹⁰¹⁶

398. Të akuzuarit nuk u provokuan në asnjë mënyrë për t'i kryer krimet. Roli i tyre në kryerjen e krimeve nuk ishte aspak i vogël, ku të dy morën pjesë si kryes kryesorë. Ata nuk u vetëdeklaruan fajtorë, e as nuk tentuan t'i ndreqnin shkeljet dhe/ose t'i

¹⁰⁰⁷ *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.220; *Jokić* AJ, IT-05-88-R77.1-A, para.40; *Pećanac* TJ, IT-05-88/2-R77.2, para.39; *Beqaj* TJ, IT-03-66-T-R77, para.63.

¹⁰⁰⁸ *Shih* rregulla 163(1)(a)(i) dhe rregulla 95(5); *Shih gjithashtu* nënpjesën IV. **Error! Reference source not found.** më lart.

¹⁰⁰⁹ *Shih* rregulla 163(1)(a)(ii).

¹⁰¹⁰ P00021ET, f.3-5; P00018ET, f.1-2; P00006ET, f.14; P00007ET, f.2-3; P00025ET, f.1-2, 9-10; P00026ET, f.2, 4-5.

¹⁰¹¹ P00001ET, f.3, 6.

¹⁰¹² P00028ET, f.7-8.

¹⁰¹³ P00028ET, f.8-9.

¹⁰¹⁴ P00028ET, f.11.

¹⁰¹⁵ P00030ET, f.15.

¹⁰¹⁶ P00035ET, f.10.

zbusnin pasojat e tyre.

399. Që keqardhja të përbëjë faktor lehtësues, ajo duhet të jetë e njëmendtë dhe e sinqertë.¹⁰¹⁷ I akuzuari mund të shprehë keqardhje të sinqertë pa e pranuar pjesëmarrjen në krim.¹⁰¹⁸ Në rrethana të tilla, keqardhja duhet të shoqërohet me njëfarë vetëfajësimi moral për veprimet e gabuara personale, pa e pranuar përgjegjësinë apo fajësinë penale personale.¹⁰¹⁹ Krahas shprehjeve të tilla të keqardhjes, i akuzuari mund të shprehë gjithashtu mirëkuptim, dhembshuri ose hidhërim për viktimat e krimeve të Aktakuzës; megjithëse kjo nuk përbën pendim, mund të konsiderohet si faktor lehtësues.¹⁰²⁰

400. Në këtë rast, nuk ka pasur shprehje të njëmendta të keqardhjes apo shenja të mirëkuptimit, dhembshurisë apo hidhërimit. Përkundrazi, Gucati nuk shprehu aspak pendim apo keqardhje në lidhje me veprimet për të cilat po gjykohej.¹⁰²¹ Ai dëshmoi: 'nuk kam nevojë të kërkoj falje [...] nuk kam arsye që të kërkoj falje përderisa unë s'kam vjedhë dhe se s'kam thy kërrkënd shpirtnisht'¹⁰²² dhe se 'edhe 50 paketa të ishin ardhur, unë më nuk do të isha merr me deklaratat e tyne.'¹⁰²³ Haradinaj gjithashtu dëshmoi se nuk ndjen keqardhje për veprimet e tij.¹⁰²⁴

401. Kjo mungesë e keqardhjes është shumë e rëndësishme, gjithashtu sepse tregon se nuk ka absolutisht garanci se të akuzuarit nuk do të ndërmerrnin veprime të njëjta në të ardhmen. Përkundrazi, ekzistojnë të gjitha shenjat se ata do t'i kryenin këto krime përsëri.¹⁰²⁵ Kjo mungesë shtangëse e keqardhjes bën gjithashtu të qartë si drita

¹⁰¹⁷ *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para.365.

¹⁰¹⁸ *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para.365.

¹⁰¹⁹ *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para.365.

¹⁰²⁰ *Strugar* AJ, IT-01-42-A, para.366.

¹⁰²¹ Gucati, T.2401; *Shih gjithashtu* Gucati, T.2205, 2208.

¹⁰²² Gucati, T.2401.

¹⁰²³ Gucati, T.2266.

¹⁰²⁴ Haradinaj, T.3021.

¹⁰²⁵ *Shih* para. 384-393 më lart.

e diellit se veprimet e të akuzuarve nuk ishin aspak lajthitje.

402. Gjithashtu, nuk duhet t'i jepet rëndësi asnjë parashtrimi për karakterin e mirë të të akuzuarve. Karakteri i mirë mund të jetë në disa raste tregues i rrezikut më të vogël për përsëritjen e krimit, por jo kur – siç është rasti këtu – të akuzuarit janë të vendosur në synimin e tyre që të kryejnë krime të tjera.

403. Gucati është lindur në vitin 1967¹⁰²⁶ ndërsa Haradinaj në vitin 1963.¹⁰²⁷ Për këtë arsye, ata nuk janë në moshë të shtyrë dhe nuk ka arsye për ta konsideruar moshën e tyre si faktor lehtësues. Fëmijët e tyre janë të moshës madhore¹⁰²⁸ dhe për rrjedhojë, nuk duhet të ketë faktor lehtësues për shkak të nevojës për të mbështetur materialisht familjet e tyre. Shëndeti i dobët duhet të konsiderohet si lehtësim në rrethana të jashtëzakonshme ose raste 'të rralla'.¹⁰²⁹ Nuk ka prova që tregojnë se ky kriter i lartë mund të përmbushet në lidhje me ndonjërin nga të akuzuarit, ku të dy kanë marrë pjesë personalisht në shumicën dërmuese të seancave.

404. Drejtësia e luftës në Kosovë nuk është e rëndësishme në këtë çështje, dhe çfarëdo krime që pretendohet se u kryen gjatë asaj lufte nuk lidhen mjaftueshëm me veprat penale që shqyrtohen këtu, për të justifikuar ndonjë rrethanë lehtësuese.

405. Në fund, Trupi Gjykses nuk duhet të marrë parasysh, si rrethanë lehtësuese, asnjë pretendim se veprimet e të akuzuarve ishin të motivuara nga dëshira për të zbuluar të vërtetën ose nga ndonjë vlerë e veçantë morale apo shoqërore, duke pasur parasysh se metodat që vendosën të përdornin përbënin plan kriminal të paramenduar.¹⁰³⁰

¹⁰²⁶ Gucati, T.2151.

¹⁰²⁷ Haradinaj, 2D00001ET, para.1.

¹⁰²⁸ Gucati, T.2152; Haradinaj, 2D00001ET, para. 8, 65.

¹⁰²⁹ Rašić SJ, IT-98-32/1-R77.2, para.30.

¹⁰³⁰ *Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.404; *Akhbar Beirut* SJ, STL-14-06/S/CJ, para.18; *Shih gjithashtu Kabashi* SJ, IT-04-84-R77.1, para.13.

F. DËNIMI I PËRSHTATSHËM

30. Parandalimi është faktor kyç në dënimin e të akuzuarve

406. Qëllimi i ndëshkimit të krimeve si ato të kryera nga të akuzuarit është i dyanshëm:

E para, dënimi është ndëshkues sepse dënon veprimet për të cilat është konstatuar se pengojnë, dëmtojnë apo keqpërdorin administrimin e drejtësisë. E dyta, dënimi ka efekt parandalues që siguron mbrojtjen e interesit të drejtësisë duke parandaluar përsëritjen e një veprimi të tillë në të ardhmen.¹⁰³¹

407. Sa i përket parandalimit,

Edhe parandalimi special edhe ai i përgjithshëm janë qëllime të rëndësishme të dënimit në të drejtën penale. Qëllimi i parandalimit special është që ta dekurajojë keqbërësin nga përsëritja e krimit në të ardhmen, ndërsa parandalimi i përgjithshëm synon t'i dekurajojë të tjerët nga kryerja e krimeve të ngjashme.¹⁰³²

408. Rrjedhimisht, dënimi që do të jepet kundër të akuzuarve duhet të pasqyrojë në mënyrë të përshtatshme peshën e krimeve të kryera nga të akuzuarit dhe të parandalojë vetë të akuzuarit dhe të tjerët që të kryejnë vepra të ngjashme në të ardhmen.¹⁰³³

(a) Parandalimi special

409. Në këtë rast, nevoja për parandalim special buron midis të tjerash nga deklaratimet e shumta të të akuzuarve, si gjatë periudhës që mbulon Aktakuza ashtu dhe gjatë dhënies së dëshmive të tyre, se, po t'u jepej mundësia, do ta ndërmerrnin të

¹⁰³¹ *Tupajić* TJ, IT-95-5/18-R77.2, para.31; *Shih gjithashtu Kabashi* SJ, IT-04-84-R77.1, para.11; *Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para.84; *Akhbar Beirut* SJ, STL-14-06/S/CJ, para.15; *Bemba et al.* Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para.18(i). Rehabilitimi gjithashtu konsiderohet të jetë qëllim relevant, edhe pse më pak i rëndësishëm, i dënimit, *shih Kabashi* SJ, IT-04-84-R77.1, para.11.

¹⁰³² *Kabashi* SJ, IT-04-84-R77.1, para.11; *Shih gjithashtu Bemba et al.* Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para.18(i).

¹⁰³³ *Shih Marijačić and Rebić* TJ, IT-95-14-R77.2, para. 46, 51; *Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.397; *Akhbar Beirut* SJ, STL-14-06/S/CJ, para.15; *2012 Šešelj Contempt*, IT-03-67-R77.4, para.52; *Tupajić* TJ, IT-95-5/18-R77.2, para.31; *Pećanac* TJ, IT-05-88/2-R77.2, para.39; *Kabashi* SJ, IT-04-84-R77.1, para.11; *2009 Šešelj Contempt*, IT-03-67-R77.2, para.37; *Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para.84.

njëjtat veprime për të cilat gjykohen.¹⁰³⁴

410. Të akuzuarit ende kanë të njëjtat poste në OVL-UÇK të cilat i kishin gjatë periudhës së Aktakuzës, dhe në Kosovë ka persona që vetëm janë ushtrues detyre në ato poste.¹⁰³⁵ Rrjedhimisht, pas lirimit, është e mundshme se ata do të vazhdojnë funksionet e tyre në OVL-UÇK, duke iu dhënë çdo mundësi dhe mjete unike që të vazhdojnë të pengojnë punën e këtij institucioni.

411. Gjithashtu, të akuzuarit kanë marrë informacion konfidencial të shumtë nga ZPS-ja në përputhje me detyrimet për nxjerrjen e informacionit, duke iu dhënë të akuzuarve municion shtesë për sulmet e tyre kundër DHSK-së/ZPS-së.

(b) *Parandalimi i përgjithshëm*

412. Duke pasur parasysh se ruajtja e integritetit të administrimit të drejtësisë është veçanërisht e rëndësishme kur gjykatat gjykojnë çështje që kanë të bëjnë me vepra të rënda penale, është kyçe që parandalimit dhe denoncimit të përgjithshëm t'i jepet rëndësi e lartë gjatë dënimit të krimeve si ato që janë kryer nga të akuzuarit.¹⁰³⁶

413. Në këtë rast nevoja për parandalim të përgjithshëm është e mprehtë. OVL-UÇK-ja ka mbi 10.000 anëtarë¹⁰³⁷ brenda një strukture të organizuar hierarkike që shtrihet në mbarë Kosovën.¹⁰³⁸ Vendimi për t'i bërë publike dokumentet e marra prej OVL-UÇK-së ishte marrë unanimisht nga kryesia 23-anëtarëshe e OVL-UÇK-së.¹⁰³⁹ Siç tha Haradinaj, 'kryesia komplet' e OVL-UÇK-së është e gatshme të rrezikojë 300 vite burgim për t'i zbuluar dokumentet konfidenciale dhe jopublike të TFHS-së/ZPS-së;

¹⁰³⁴ *Shih* para. 384-390 më lart.

¹⁰³⁵ Haradinaj, T.2707.

¹⁰³⁶ *Shih* GAA TJ, ICTR-07-90-R77-I, para.10; *Nzabonimpa et al.* TJ, MICT-18-116-T, para.397; *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.218.

¹⁰³⁷ Marashi, T.2528-30.

¹⁰³⁸ Marashi, T.2524-27; Gucati, T.2158-59, 2217.

¹⁰³⁹ Haradinaj, T.2746; Haradinaj, 2D00001ET, para.73.

ata janë 'të përgatitun me vdek' për kauzën e tyre.¹⁰⁴⁰

414. OVL-UÇK-ja ka qenë në gjendje të mobilizojë mbështetje masive gjatë tentimeve të mëparshme për ta shpërbërë ose ndryshuar këtë institucion. Haradinaj tha se OVL-UÇK-ja kishte mbledhur 115.000 nënshkrime pas thirrjes për shpërbërjen e DHSK-së¹⁰⁴¹ dhe se OVL-UÇK-ja mblodhi 11.700 nënshkrime për kërkesën që Kuvendi i Kosovës ta ndryshonte ligjin për DHSK-në.¹⁰⁴²

415. Gjatë një interviste më 25 shtator 2020, Haradinaj tha: 'Sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund', duke shtuar se nuk do të ishin vetëm Haradinaj, Gucati ose Klinaku që do t'ia jepnin dokumentet mediave, meqenëse edhe anëtari me rang më të ulët i UÇK-së do ta bënte këtë, dhe se: '[k]emi me e qit në media.'¹⁰⁴³ Faktikisht, provat në këtë çështje vërtetojnë se anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së ose persona të lidhur me ta, kanë të njëjtat qëllime si të akuzuarit sa i përket këtij institucioni. Kur u pyet se a ishte i kënaqur që deklaratat e dëshmitarëve të mbrojtur ishin bërë publike, Marashi, anëtar i Këshillit Drejtues të OVL-UÇK-së, u përgjigj: 'Jam i lumtur edhe sot jam i lumtur.'¹⁰⁴⁴ Klinaku ka premtuar publikisht se do ta shpërndajë informacionin konfidencial të DHSK-së po t'i jepet mundësia.¹⁰⁴⁵

416. Rrjedhimisht, është thelbësore që Trupi Gjykses të marrë çfarëdo mase që mundet për të garantuar se nuk do të ketë përsëritje të krimeve të njëjta si ato të të akuzuarve.¹⁰⁴⁶ Masa më e rëndësishme dhe efektive do të ishte dënimi i të akuzuarve

¹⁰⁴⁰ P00035ET, f.13; P00035, min.00:24:44-00:25:16.

¹⁰⁴¹ Haradinaj, T.2708-09.

¹⁰⁴² Haradinaj, 2D00001ET, para.17; *Shih gjithashtu* P00042ET, f.1.

¹⁰⁴³ P00015ET, f.2.

¹⁰⁴⁴ Marashi, T.2537.

¹⁰⁴⁵ *Shih* Shtojcën të Parashtrime Përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, KSC-BC-2020-07/F00273/A01, 10 gusht 2021; Shtojca 1 e Parashtrimeve Përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, KSC-BC-2020-07/F00228/A01, 11 qershor 2021.

¹⁰⁴⁶ *Shih Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para.87.

me burgim të gjatë.

417. Parandalimi përmes dënimit që do të jepet kundër të akuzuarve është më se i nevojshëm, sidomos duke pasur parasysh fazën e proceseve të ndryshme para kësaj gjykate. Në veçanti, në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, që është në fazën e procedurës paraprake, katër nga anëtarët më të lartë të UÇK-së, njëri prej të cilëve ka qenë president i Kosovës, gjykohen lidhur me akuza për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte gjatë periudhës prej më shumë se një vit e gjysmë në vende në mbarë Kosovën dhe në pjesë të Shqipërisë. Tundimi i të akuzuarve dhe mbështetësve të tyre për t'i penguar këto procese vetëm se do të shtohet gjatë zhvillimit të asaj çështjeje dhe të tjerave. Trupi Gjykses duhet të mundësojë që këto tundime të ndalohen të rezultojnë në veprime të tjera kriminale që do të mund ta cenonin këtë institucion.

31. Dënimet duhet të jenë kryesisht me burgim

418. I vetmi dënim që Trupi Gjykses mund ta shqiptojë kundër të akuzuarve në lidhje me Pikat 1-2 dhe 6, duke pasur parasysh rrethanat konkrete të kësaj çështjeje është me burgim.¹⁰⁴⁷ Sidoqoftë, Trupi Gjykses duhet të caktojë edhe gjobë krahas burgimit në lidhje me Pikat 3 dhe 4¹⁰⁴⁸ dhe mund të japë gjobë ose burgim në lidhje me Pikën 5.¹⁰⁴⁹

419. Në çështjet e mosbindjes, gjykatat e tjera gjatë marrjes së vendimit nëse duhet të shqiptohet dënim me burgim apo gjobë, kanë gjykuar se më përcaktues janë pesha e krimit dhe qëllimi i dënimit.¹⁰⁵⁰ Gjobat janë dënime më pak kufizuese kundër personit të dënuar se burgimi¹⁰⁵¹ dhe gjithashtu duhet të merren parasysh mjetet

¹⁰⁴⁷ *Shih* nenet 401(1)(3)(5) dhe 392(3) të KPK-së.

¹⁰⁴⁸ *Shih* nenet 387 dhe 388(1) të KPK

¹⁰⁴⁹ *Shih* neni 392(1) i KPK-së.

¹⁰⁵⁰ *Shih* GAA TJ, ICTR-07-90-R77-I, para.10; *Beqaj* TJ, IT-03-66-T-R77, para. 66-67; *Margetić* TJ, IT-95-14-R77.6, para.93; *Nshogoza* TJ, ICTR-07-91-T, para.219; *Bangura et al.* SJ, SCSL-2011-02-T, para.89; *Senesie* SJ, SCSL-2011-01-T, para.22.

¹⁰⁵¹ *Shih* *Bemba et al.* Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para.133.

financiare të të akuzuarit.¹⁰⁵²

420. Gjatë shqyrtimit nëse duhet të caktohet gjobë, faktorë kyçë janë nëse vetë të akuzuarit do ta paguanin atë gjobë nga xhepi i tyre dhe nëse pagesa do t'i parandalonte, ata ose të tjerët, që të përfshihen në veprime të ngjashme kriminale në të ardhmen.¹⁰⁵³

421. Në këtë aspekt, fakti që OVL-UÇK-ja ka mbi 10.000 anëtarë¹⁰⁵⁴ dhe treguesi se OVL-UÇK-ja së paku pjesërisht mbështetet financiarisht nga qeveria¹⁰⁵⁵ sugjeron se të akuzuarit do të mund të mblidhnin fonde të mjaftueshme nga mbështetësit dhe individë të të njëjtit mendim për ta paguar gjobën. Rrjedhimisht, gjoba do të kishte efekt të vogël ndëshkues apo parandalues. Përkundrazi, ajo do të caktonte vlerë monetare për kryerjen e krimeve si ato për të cilat janë akuzuar të akuzuarit. Ekzistojnë të gjithë treguesit se të akuzuarit dhe shumë të tjerë janë të gatshëm dhe janë në gjendje që ta paguajnë atë çmim financiar për të penguar punën e këtij institucioni në të ardhmen.

422. Rrjedhimisht, për të pasqyruar peshën e krimeve të të akuzuarve dhe për t'i parandaluar ata dhe të tjerët nga sfidimi i autoritetit të institucionit, është i përshtatshëm dënimi me burgim.¹⁰⁵⁶

32. Dënimi që kërkohet

423. I njëjti dënim duhet të shqiptohet për secilin të akuzuar duke pasur parasysh se pjesëmarrja e tyre në krime ka qenë e barabartë. Gjithashtu, të njëjtat rrethana rënduese vlejnë për secilin të akuzuar, dhe nuk ekzistojnë faktorë lehtësues në lidhje me asnjërin prej tyre.

¹⁰⁵² *Bemba et al.* Second Sentencing Decision, ICC-01/05-01/13-2312, para.134.

¹⁰⁵³ *Bangura et al.* SJ, SCSL-2011-02-T, para.89.

¹⁰⁵⁴ Marashi, T.2528-30.

¹⁰⁵⁵ Gucati, T.2159-60.

¹⁰⁵⁶ *Shih Nshogoza TJ*, ICTR-07-91-T, para.219.

424. Pas shqyrtimit të spektrit të dënimeve përkatëse dhe faktorëve të përcaktuar më lart (veçanërisht peshës ekstreme të veprimeve të të akuzuarve, rrethanat e shumta rënduese, mungesën e rrethanave lehtësuese, rëndësinë kyçe të parandalimit dhe nevojën për dënim me burgim), dhe duke pasur parasysh se në përputhje me rregullën 163(4) Trupi Gjykses duhet së pari të përcaktojë dënimin në lidhje me secilën akuzë në Aktakuzë, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të shqiptojë dënimet në vijim kundër secilit të akuzuar:

- a. Pika 1: Pesë vjet burgim;
- b. Pika 2: Pesë vjet burgim;
- c. Pika 3: Gjashtë vjet burgim dhe 100 euro gjobë;
- d. Pika 4: Tre vjet burgim dhe 100 euro gjobë;
- e. Pika 5: Një vit burgim; dhe
- f. Pika 6: Pesë vjet burgim.

425. Në rregullën 163(4) kërkohet nga Trupi Gjykses që të shqiptojë një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimeve kriminale të të akuzuarve, një dënim të vetëm që nuk është më pak se dënimi më i lartë individual i përcaktuar për secilën akuzë. Trupi Gjykses mund t'i dënojë të akuzuarit me burgim me kohëzgjatje sikurse është parashtruar në lidhje me Pikat 1-6, në mënyrë kumulative ose me dënim më të gjatë në burgim se çfarë është parashtruar në lidhje me cilëndo Pikë.

426. Për të pasqyruar tërësinë e veprimeve kriminale të të akuzuarve, ZPS-ja kërkon dënim të njësuar për secilin të akuzuar me gjashtë vjet burgim dhe gjobë prej 100 eurosh. Gjopa duhet t'i paguhet Administratores si shumë e plotë brenda një muaji. Mospagimi i gjobës brenda afatit duhet të rezultojë në zgjatjen e burgimit me një muaj.

G. NUK KA NEVOJË TË ANASHKALOHET PROCEDURA E RREGULLËS 159(6)

427. Formulimet në rregullat 159(6), 162(1), dhe 164(1) bëjnë të qartë se përcaktimi i dënimit së bashku me shpalljen e aktgjykimit siç parashikohet në rregullën 159(6) është procedura standarde; dispozitat e rregullave 162 dhe 164 janë përjashtim i kësaj. Duke pasur parasysh rrethanat e kësaj çështjeje, nuk ka nevojë të anashkalohej procedura e rregullës 159(6) dhe Trupi Gjykses mundet dhe duhet ta përcaktojë dënimin që do jepet për të akuzuarit në aktgjykim. Veprimi ndryshe do ta zgjaste këtë çështje në mënyrë të panevojshme dhe do të përbënte përdorim joefikas të burimeve të gjykatës dhe të palëve.

428. Nëse Trupi Gjykses vendos se duhet të zbatohet procedura sipas rregullave 162 dhe 164 të Rregullores, pas reflektimit të mëtejshëm dhe duke pasur parasysh provat tashmë në dispozicion të Trupit Gjykses, ZPS-ja nuk synon të mbështetet në informacion apo prova shtesë lidhur me dënimin dhe paraqet parashtrimet në vijim në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykses.¹⁰⁵⁷

429. Në përputhje me rregullën 162(1), të dy palët mund të parashtrojnë 'çfarëdo informacioni me rëndësi për përcaktimin e dënimit, i cili mund të ndihmojë trupin gjykses në përcaktimin e dënimit të duhur'. Përmendja e qartë e termit 'informacion' dhe jo 'prova' tregon se nuk është e nevojshme që informacioni të përmbushë kriteret për pranimin e provave.

430. Megjithëse rregulla 162(5) thotë se Trupi Gjykses mbështetet në 'provat e paraqitura' dhe vë në dukje se ai mund të 'dëgjojë dëshmi shtesë', kjo nuk mund të interpretohet logjikisht se e ndalon Trupin Gjykses që të shqyrtojë çfarëdo 'informacioni' të parashtruar në përputhje me rregullën 162(1), meqenëse ky interpretim do ta bënte rregullën 162(1) krejtësisht të tepërt. Ajo që kërkohet në rregullën 162(5) është se për përcaktimin e dënimit duhet mbështetur në provat e paraqitura deri në atë moment dhe 'në qoftë se është e nevojshme' Trupi Gjykses

¹⁰⁵⁷ Urdhri për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave, KSC-BC-2020-07/F00553, para. 17.

